

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

INSTITUTI ALBANOLOGJIK – PRISHTINË

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE –
TIRANË

“75–VJETORI I HAPJES SË SHKOLLAVE
SHQIPE NË KOSOVË DHE NË
MAQEDONINË PERËNDIMORE”

(Konferencë shkencore, 20 nëntor 2016, Shkup)

17



Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË
SHQIPTARËVE – SHKUP, NË BASHKËPUNIM ME
INSTITUTIN ALBANOLOGJIK – PRISHTINË, DHE
QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE – TIRANË

Vëllimi 17 – 2017

Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Sevdail Demiri

Këshilli redaktues:
Akad. Marenglen Verli
Dr. Hysen Matoshi
Dr. Skender Asani
Dr. Avzi Mustafa
Dr. Sevdail Demiri
Dr. Hidajete Azizi

Redaktor teknik: *Naser Fera*

Copyright© ITSHKSH, 2017
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN 978–608–4653–45–5

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

INSTITUTI ALBANOLOGJIK – PRISHTINË

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE –
TIRANË

SCUPI – 17

***75–VJETORI I HAPJES SË SHKOLLAVE
SHQIPE NË KOSOVË DHE NË
MAQEDONINË PERËNDIMORE***
(Konferencë shkencore, 20.11.2016, Shkup)

***75-ГОДИШНИНАТА ОД ОТВОРАЊЕТО НА
АЛБАНСКИТЕ УЧИЛИШТА ВО КОСОВО И
ЗАПАДНА МАКЕДОНИЈА***
(Научна конференција, 20.11.2016, Скопје)

***75TH ANNIVERSARY OF THE OPENING OF
ALBANIAN SCHOOLS IN KOSOVO AND
WESTERN MACEDONIA***
(Scientific Conference, 20.11.2016, Skopje)

SCUPI
Shkup, 2017

Ky botim financohet nga:



Republika e Maqedonisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

TRYEZA E LËNDËS:

HYRJE.....	9
XHEVAT LLOSHI & DAVID HOSAFLOOK: TE FILLIMET E SHKOLLIMIT SHQIP PËR SHQIPTARËT NË MAQEDONI DHE NË KOSOVË	12
QERIM LITA: ERNEST KOLIQI DHE SHKOLLAT KOMBËTARE SHQIPTARE NË TOKAT E LIRUARA.....	19
RAGIP GJOSHI: SHKOLLA SHQIPE NË KOSOVË GJATË VITEVE 1941–1944	44
NEBI DERVISHI: SHKOLLAT SHQIPE NË STRUGË E RRETHINË (1941–1944).....	56
MARENGLEN VERLI: SHEMBULL NGA HISTORIA E SHKOLLAVE SHQIPE NË PRESPË NË VITET 1942–1943	79
HYSEN MATOSHI: KONTEKSTI SOCIO–KULTUROR I HAPJES SË SHKOLLAVE SHQIPE (1941)	90
SABILE KEÇMEZI–BASHA: KONTRIBUTI ARSIMOR E ATDHETAR I PROF. YMER BERISHËS NË TOKAT E LIRUARA (1941–1945).....	95
AVZI MUSTAFA: MËSIMBESIMI NË SISTEMIN ARSIMOR KOMBËTAR SHQIPTAR GJATË VITEVE 1941–44.....	106
XHELADIN MURATI: PËR ROLIN HISTORIK TË SHKOLLAVE FILLORE TË PARA SHQIPE (1941–1944), DHE TË MËSUESVE TË TYRE	118
TAHIR ZAJAZI: VËSHTRIM NË KATËR BARRIERA QË E DENIGRUAN ARSIMIN SHQIP NË MAQEDONI (1941–2016) ..	136
SKENDER ASANI & SEVDAIL DEMIRI: GJENDJA E (MOS)ARSIMIMIT NË TERRITORET VERILINDORE SHQIPTARE.....	145

MEMLI KRASNIQI: KONTRIBUTI I STUDIUESIT ABDYLAZIZ VESELI, PËR HISTORINË E ARSIMIT SHQIP NË KOSOVË NË VITET 1941–1944	152
MILAZIM ELSHANI & DAUT BISLIMI: SHKOLLAT SHQIPE DHE KUADRI ARSIMOR NË NËNPREFEKTURËN E SUHAREKËS (1941/42).....	159
HAMDİ V. THAÇI: REXHEP KRASNIQI (1906–1999), DREJTORI I PARË I SHKOLLËS NORMALE–LICEALE “SAMI FRASHËRI” NË PRISHTINË.....	167
NURIDIN AHMETI: VËSHTRIM MBI PËRMBAJTJET HISTORIKE TË NJË TEKSTI MËSIMOR TË VITIT 1943	181
HAXHI ADEMI: DISA TË DHËNA RRETH ARSIMIT SHQIP NË KOSOVË, NË ZONËN ITALIANE TË PUSHTIMIT, GJATË LDB–SË	189



Nga punimet e konferencës në Hotel “Bushit” - Shkup

HYRJE

Konferenca shkencore “75–vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore”, ishte një bashkëorganizim mes tre instituteve shkencore të Shkupit, Prishtinës dhe Tiranës, si rezultat i një bashkëpunimi të mirëfilltë viteve të fundit në këmbimin e përvojave shkencore në këto tre kryeqendra shqiptare.

Organizimi i kësaj konference shkencore përkoi me tre momente të rëndësishme të historisë së shqiptarëve të këtyre trevave. Duke shkuar në radhë kronologjike, me këtë rast u shënua 108 vjetori i Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir, 75–vjetori i hapjes së shkollave të para shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore, si dhe 9–të vjetori i themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Pa dyshim, që të trija këto data, janë të lidhura ngushtë me njëra–tjetrën, dhe flasin për zhvillimin arsimor, kulturor dhe shkencor të shoqërisë shqiptare në këto hapësira, pra që nga njësimi i alfabetit e deri te themelimi i instituteve hulumtuese–shkencore.

Mbështetës kryesor i këtij organizimi ishte Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë, prandaj në fillim fjalë përshëndetëse pati ministri Pishtar Lutfiu, i cili përgëzoi bashkëpunimin shumë domethënës të tre instituteve të studimeve albanologjike në trekëndëshin Shkup–Prishtinë–Tiranë, për të kujtuar dhe memorizuar momente shumë të rëndësishme të historisë së arsimit e kulturës shqiptare në këto troje.

Me pjesëmarrjen e tij në këtë konferencë na nderoi edhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i Republikës së Kosovës, prof.dr.Arsim Bajrami, i cili theksoi rëndësinë e bashkimit të

potencialit shkencor në këto kryeqendra shqiptare, e cila duhet të shërbejë edhe si model për strategji të tjera ndërveprimi.

Në emër të nikoqirit të konferencës, foli drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, i cili tha se ardhja e mësuesve shqiptarë në këto anë, që për herë të parë hapën shkolla shqipe dhe sollën libra shkollor në gjuhën shqipe, për shqiptarët e Maqedonisë ishte një mision shumë fisnik dhe me përmasa kombëtare, që për nga rëndësia mund të krahasohet vetëm me misionarët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të vëllezërve Frashëri e të rilindësve të tjerë të kohës.

Punimet e konferencës i përshëndetën edhe drejtori i QSA-së së Shqipërisë, Marenglen Verli, drejtori i IA të Kosovës, Hysen Matoshi, dhe drejtori i ISSHP të Tiranës, David Hosaflook.

Më pas në dy seanca, mbi 15 studiues, paraqitën punimet e tyre shkencore, ku e vlerësuan lartë nismën e qeverisë shqiptare të viteve 1941–44, e cila që në fillim ndërmorri masa të shpejta për arsimimin e popullsisë shqiptare në Kosovë e në Maqedoninë perëndimore. Ministri i atëhershëm i Arsimit, atdhetari, mësuesi dhe politikani, Ernest Koliqi, dërgoi mbi 200 mësues ambicioz të shqipes, të cilët mbollën farën e diturisë në këto troje.

Kështu, me interes u ndoqën kumtesat e historianëve dhe studiuesve, si: Beqir Meta, Xhevat Lloshi, David Hosaflook, Qerim Lita, Ragip Gjoshi, Nebi Dervishi, Marenglen Verli, Hysen Matoshi, Sabile Basha, Avzi Mustafa, Xheladin Murati, Tahir Zajazi, Skender Asani, Sevdail Demiri, Memli Krasniqi, Daut Bilimi, Hamdi Thaçi, Nuridin Ahmeti, etj.

Pa dyshim, tema e cila u shtjellua në këtë konferencë, është një ngjarje e madhe në historinë e arsimit shqiptar, kur ende pa përfunduar Lufta e Dytë Botërore, nga Shqipëria erdhën më se 200 mësues dhe mbollën farën e diturisë në trojet shqiptare jashtë shtetit amë. Mësuesit e parë në këto troje, ishin ndër kuadrot më të

përgatitur të kohës, të cilët me shumë elan, energji dhe kompetencë arsimuan një plejadë të tërë të kuadrove të cilët më pastaj do të jenë bartës të proceseve shumë të rëndësishme shoqërore. Mësuesit e parë brumosën te brezat e rinj ndjenjat e pastra kombëtare, duke i frymëzuar ata për ta dashur dhe mbrojtur gjuhën, flamurin dhe atdheun shqiptar. Kontributi i tyre është i jashtëzakonshëm në zhdukjen e errësirës së analfabetizmit, dhe krijimin e perspektivave të reja.

Prandaj, edhe botimi i këtyre punimeve në këtë numër të veçantë të serisë periodike të ITSHKSH-së, “Scupi”, është një akt vlerësimi i asaj ngjarjeje madhore për historinë e arsimit shqip, por edhe një mirënjohje e thellë për të gjithë mësuesit iluministë të asaj kohe.

Këshilli organizues/redaktues

XHEVAT LLOSHI
DAVID HOSAFLOOK

Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante – Tiranë

TE FILLIMET E SHKOLLIMIT SHQIP PËR SHQIPTARËT NË MAQEDONI DHE NË KOSOVË

Shkollë shqipe do të thotë shkollë në gjuhën shqipe. Për ta ngritur këtë shkollë në fillimet e saj nevojitet të parapërgatiten atëherë të paktën këto tri anë: gjuha e shkruar, tekstet dhe mësuesit.

Po edhe vetë gjuha e shkruar nis me përcaktimin e alfabetit. Nga kjo pikëpamje, çdo përpjekje për të ndërtuar alfabetin e shqipes, duke përmendur të parin që e njohim drejtpërdrejt, Gjon Buzukun më 1555, ka qenë një hap drejt këtij synimi. Udhë e shkronjave të shqipes është udhë për të dera e shkollës, ku mësimet e para janë pikërisht për shkronjat, për abëcënë.

Ana e dytë janë tekstet mësimore dhe ndër ta dihet se e para është abetarja. Nuk e dimë a ka pasur ndonjë abetare përpara Naum Veqilharxhit, domethënë botimit të tij të vitit 1844, por na lejohej të hamendësojmë se në të gjitha rastet, kur përmendet mësimi i shqipes përpara tij, natyrisht që do të ketë pasur qoftë edhe një fletë me shkronjat e alfabetit, sepse abetare do të thotë fletët e abëcësë. Kurse libri i dytë që vjen pas asaj është vetvetiu gramatika. Libri i gramatikës nuk është një tekst i zakonshëm, që lexohet, për arsyen se ai është bërë që të mësohet dhe të përdoret drejt gjuha e shkruar, domethënë është bërë për ta përvetësuar pak nga pak gjatë një periudhe kohe dhe për t'iu rikthyer herë pas here. Zakonisht këtë punë për gjuhën amtare ne e bëjmë me një mësues. Rrjedhimisht, ai që harton një gramatikë ka parasysh jo një lexues, por një nxënës,

gjë që nënkupton shkollën. Kështu, hartimi i gramatikave të shqipes është udha tjetër për te dera e shkollës.

Është e vërtetë që kemi njoftime për gramatika të para të shqipes në fillim të shek. XVIII nga autorë të huaj dhe për të huajt, madje përpara tyre i tillë ka qenë pjesërisht *Fjalori latinisht–shqip* i Frang Bardhit (1635) si një tekst mësimor për latinishten dhe shqipen bashkë, por përsëri F. Da Lecce (1716) e hedh fjalën, që një vepër si ajo e tija e presin edhe shqiptarët. Pas këtyre vijnë njoftimet e Pjetër Bogdanit (i cili kishte punuar shumë vite në anët e Kosovës), se i kishte humbur një gramatikë e ungjijt të tij, Andrea Bogdanit. Për të mos shkuar më tej, edhe Vangjel Meksi në fillim të shek. XIX kishte përgatitur një gramatikë, duke qenë vetë mësues. Shkurt, gramatikat ku përfshihej shqipja natyrshëm përfshinin edhe nxënës shqiptarë. Gjithsesi, këtu vijnë te ndërlikdha me anën e tretë, domethënë me çështjen e mësuesve për shkollën shqipe.

Numri i shkollave të huaja në trevat shqiptare ka qenë jo i vogël, ndërsa në to kanë qenë mësues edhe shqiptarë, nganjëherë shumica shqiptarë. Prej këndej mund të kalojmë te pohimi, se mësuesit e shqipes janë përgatitur së pari pikërisht në shkollat në gjuhë të huaja dhe kanë punuar po në shkolla të atilla. Duke zotëruar një gjuhë të huaj të shkruar, domethënë edhe alfabetin e gramatikën e saj, ata në mënyrën më të natyrshme bënin përpjekje edhe për shqipen. Sidomos kur edhe shumica e nxënësve të shkollës ishin shqiptarë pothuaj pashmangshmërisht kalohej te shqipja. Shembulli më i qartë është shkolla e Voskopojës në shek. XVIII, në të cilën ishin mësues T. Kavalioti dhe Dh. Voskopojari, me prejardhje vllahe dhe i dyti nën tryshninë e fortë të rrymës greqizuese, e megjithatë që të dy kanë përgatitur libra, në të cilët është pjesë organike shqipja, ndërsa nënkuptohet se i donin për t'i pasur në duar nxënësit shqiptarë.

Rrjedhimisht, për të gjurmuar fillimet na kërkohet të shohim gjithashtu shkollat në gjuhë të huaja në trevat shqiptare dhe të hulumtojmë sa ka qenë pjesëmarrja e nxënësve shqiptarë dhe sa kanë qenë mësues shqiptarë. Figura më bindëse në këtë vështrim

është Daut Boriçi, i cili u arsimua në shkollat osmane dhe jepte mësim në të tilla shkolla, ndërsa pastaj hartoi abetaren me shkronjat e osmanishtes dhe, nuk ka dyshim, se kishte parasysh nxënës shqiptarë. Po kështu do të themi në tërësi për letërsinë orientaliste shqipe me alfabet arab. Kush do ta lexonte atë? Vetëm ata që e njihnin atë alfabet të vështirë, ndërkohë që ishin arsimuar në shkolla jo shqipe. Gjithsesi, jo pak autorë orientalistë kanë qenë mësues shkollash, si Tahir Gjakova, Tahir Popova, Jonuz Efendi, Hilmi Maliqi, Ymer Paçarizi etj.

Ka rëndësi të tërheqim vëmendjen edhe te një aspekt më i përgjithshëm. Arsimin shqip në Maqedoni dhe në Kosovë ne e veçojmë për arsye studimore, sepse deri në ndarjen e shqiptarëve me kufij politikë nga Fuqitë e Mëdha më 1913, në vetëdijen e shqiptarëve dhe në veprimtaritë e tyre nuk ishte i pranishëm ndonjë kufi i tillë. Dëshmia më e qartë është Kongresi i Manastirit, që u mbledh me një përfaqësim gjithëshqiptar. Edhe Kongresi i Elbasanit, i cili ishte vijim i tij më pak se një vit më vonë, po këtë përfaqësim kishte. Në këtë rast kishim drejtpërdrejt një kongres për shkollat shqipe dhe njëri ndër vendimet e tij ishte çelja e Shkollës Normale, ku do të përgatiteshin mësues pa dallim nga të gjitha trevat dhe për të gjitha trevat shqiptare.

Meriton të përmendet për vështirimin e gjerë të kësaj problematike punimi i Jashar Rexhepagiqit¹ i vitit 1972, i cili shton se edhe prania e shumë shkollave në një vend, siç ishin shkollat në gjuhë të huaja në Prizren dhe pesë në Shkup, ka ndikuar që edhe shqiptarët të nxiteshin për të pasur shkollat e veta. Studentë shqiptarë kanë qenë në Universitetin e Stambollit kur ishte rektor Hasan Tahsini. Dy udhëtarët angleze, G. M. Mackenzie dhe A. P. Irby² nga vizita e tyre më 1861 kanë shënuar se kishte shkolla turke edhe për vajzat shqiptare në Prishtinë, Vuçiternë e Pejë. Autori serb M. S. Millojeviq³ më 1872 ka shënuar, se bejlerë dhe të tjerë të fshatrave në rrethinën e Pejës mësojnë shqip. Pas reformave dhe ligjit të vitit 1869 numri i shkollave laike osmane u shtua mjaft. Prej vitit 1908

në Shkup u lejua që të jepej si lëndë gjuha shqipe në idadien. Nga fundi i vitit 1910 u emërua mësues i shqipes Salih Gjuka në Shkollën normale osmane të Shkupit.

Njëkohësisht me ndërhyrjen e Italisë dhe të Austrisë fillesa të shkollave shqipe janë krijuar nga veprimtarët katolikë. Me sa duket, shkolla më e vjetër prej françeskanëve ka qenë në Prizren, ku për italishten jepeshin shpjegime dhe bëheshin biseda shqip. Më pas në Prizren kanë qenë mësues të kualifikuar, si Lazër Lumezi e Mati Logoreci. Shkolla fillore e Gjakovës thuhet se e ka nisur punën që më 1851, ndërsa më vonë del ndër mësuesit e saj edhe Ndue Bytyçi. Në shkollën e Pejës nga fundi i shek. XIX librat tashmë ishin kryesisht shqip. Të dhëna për shkollat ka edhe në librin e albanologut J. G. von Hahn prej udhëtimeve të tij në Drin e Vardar.⁴

Nuk ka dyshim, se me Lidhjen e Prizrenit dhe me veprimtarinë e Shoqërisë së Stambollit më 1879 hapet një etapë e re, për të cilën mund të themi se nga përpjekjet për shkollën shqipe kalohet në etapën e luftës për shkollën kombëtare. Sipas J. Rexhepagiqit, më të parat shkolla të kësaj periudhe kanë qenë në Prizren, Zym, Gjakovë e Pejë dhe në Shkup, Manastir e Ohër. Pas vitit 1900 u hapën shkolla edhe në Stubëll, Ferizaj e Zllokuqan. Figura madhore e kulturës shqiptare, Shtjefën Gjeçovi, ishte nga Janjeva dhe ka qenë mësues i shqipes në Zym, Pejë etj.

Nga ana e kundërt, duke u kufizuar me shkollat e para kombëtare, Hysni Myzyri⁵ e ka kaluar përciptazi periudhën para Lidhjes së Prizrenit. Gjithsesi, si ai edhe autorë të tjerë e kanë kaluar në heshtje ndihmesën në këtë fushë të Shoqërisë Biblike dhe të misionarëve protestantë. Nuk mund të hyjmë në hollësi për të treguar se si ky trajtim i ka lënë të cunguara fillimet e arsimit shqip, ndërkohë që si rrjedhojë janë shprehur edhe njaft konstatime e gjykime të gabuara. Po sjellim ndonjë shembull të vogël. Sipas H. Myzyrit, “Gjerasimi vendosi të bëjë një udhëtim të gjatë nëpër Shqipëri që nga Manastiri gjer në Mirditë e në Shkodër.”⁵ Ky është

një gabim tipik dhe trashanik. Kurrësi Gjerasimi nuk mund të vendoste vetë të bënte një udhëtim të tillë pa pasur një mbështetje. Ne i kemi të dhënat dokumentare për të treguar se puna ka qenë krejt ndryshe, por e keqja është se autorë të tillë shkruajnë jashtë çdo realiteti konkret historik. Edhe sot, kur janë gjithë mjetet e transportit dhe hotelet, nuk besoj se dikush do të vendoste kaq thjesht të bënte një udhëtim të tillë, pa shtuar këtu se udhëtimi kërkon edhe kthimin përsëri në Manastir. Ngjarjet dhe vendimet e rëndësishme bëhen në rrethana të caktuara dhe me mbështetje konkrete. Edhe H. Koliqi në librin e vëllimshëm për historinë e arsimit e përmend vetëm si “Vëllazëria” shoqërinë e themeluar nga Gjerasimi, ndërkohë që ajo ashtu si edhe sot quhej “Vëllazëria Ungjillore”, kurse për A. Tomsonin thotë se erdhi në Shqipëri më 1864, ndërsa ai e ka vizituar disa herë Shqipërinë (për herë të parë më 1863).

Për më tepër, interesimi i shoqërive protestante amerikane për shqiptarët e Maqedonisë fillon në vitin 1859 me udhëtimin e misionarit dhe gjuhëtarit të famshëm Elias Rigz (Elias Riggs, 1810–1901), i cili pastaj ka shkruar për shqiptarët e gjuhën e tyre, si dhe për nevojën e një qendre protestante amerikane në Manastir, çka u realizua më 1873 në stilin e zakonshëm të misionit, që përfshinte jo vetëm ungjillëzimin, por edhe çeljen e shkollave të përgjithshme në gjuhët amtare.

Duke u mbështetur në një pasuri të gjerë dokumentare, që kemi shtënë në duar prej disa kohësh, na është mundësuar për këtë drejtim studimesh të shtojmë një varg gjërash, që po i përmendim si mbështetje kundrejt pohimeve të mësipërme.

Për herë të parë librin shqip në Manastir e kanë çuar më 1864–1865 librashitësit e A. Tomsonit (Alexander Thomson, 1820–1899): H. Riedel-i dhe A. Davidsoni. Pa kaluar shumë kohë Shoqëria Biblike ka caktuar Shkupin dhe Manastirin si qendra për shpërndarjen e librave. Dëshmitë e Shoqërisë Biblike na tregojnë rreziqet e mëdha dhe fatkeqësitë që kanë pësuar librashitësit Klundt,

Sosnovski, Seefried, Ciku etj., të cilët udhëtonin nga Shkupi në qytetet kryesore të Kosovës e të Maqedonisë Perëndimore, duke shpërndarë librat jo vetëm shqip, por edhe në gjuhët e gjithë popujve të rajonit. Më pas K. Kristoforidhi ka shkuar deri në Shkup, duke bartur me vete si përkthimet biblike, ashtu edhe Abetaren e tij. Në vijim këtë detyrë e kryen vëllezërit Qiriazi. Gjergji në depozitën e tij për botimet e Shoqërisë Biblike mbante edhe një librari të vogël të fshehtë për librat shqip. Me këtë bëhet e kuptueshme përse më 1888 valiu i Manastirit u betua, se do ta bënte shitjen e librave shqip aq të vështirë dhe të kushtueshme, sa që Shoqëria Biblike do të detyrohej të hiqte dorë nga ajo punë.

Gjerasim Qiriazi, një vit pasi u pranua në bashkësinë protestante, hyri në Kolegjin Amerikan të Samokovit me shpenzimet e Misionit Amerikan. Përfaqësuesi i shquar i Shoqërisë Biblike në Stamboll, A. Tomsoni më 1882 u rekomandoi misionarëve në Manastir të hapnin një klasë të mbrëmjes shqip. Ai i bëri ftesën e bashkëpunimit Gjerasimit më 1883, duke i shprehur dëshirën që fëmijët shqiptarë të kishin mundësinë të ndiqnin mësim në gjuhën shqipe. Në mesin e vitit 1885 Gjerasimi e nisi mësimin e shqipes me tri vajza, nxënëse të shkollës së vajzave të Misionit Amerikan. A. Tomsoni një vit më pas e ka quajtur me shumë rëndësi shkollën e tij në Manastir. Ajo nuk vijoi kur Gjerasimi bashkë me të motrën u shpërngulën në Korçë më 1891 për të hapur Shkollën e Vashave. Nënkonsulli britanik H. Shipley ka pohuar më 1893 se përpjekjet arsimore të Gjerasimit për anën mësimore gëzonin përkrahjen e madhe të Misionit Amerikan, madje edhe shkollat e Korçës e të Kolonjës këtë e kishin të vetmen mbështetje nga të huajt.

Sevasti Qiriazi ka shkruar se ishte Gjerasimi, që i mësoi shkrimin e këndimin në gjuhën amtare në Manastir, ndërsa para saj i kishin nisur këto mësim edhe shoqet e saj, rrjedhimisht, **e para shkollë shqipe për vajzat shqiptare ka qenë në Manastir, në shtëpinë e familjes Qiriazi.** Mund të thuhet, se në Manastir u përpunua projekti i Shkollës së Vashave të Korçës dhe prej andej erdhën

themeluesit dhe mësueset e saj. Plejada e shquar e Qiriazëve ka qenë edhe përgatitësja e teksteve shkollore.

Kur u themelua Klubi “Bashkimi” i Manastirit, një nga përkujdesjet e tij kryesore ishte të përhapej mësimi i shqipes edhe në Ohër, Strugë e Dibër. Dhe kjo do të thotë, se veprimtaria për shqipen në shkollë nuk ka qenë e kufizuar në Manastir, por ka rrezatuar edhe në viset e tjera shqiptare. Me vendim të këtij Klubi u ngrit shtypshkronja më 1909 dhe kështu aty nisi botimi i teksteve shkollore, ndër to e para Abetarja e Parashqevi Qiriazit. Ndërsa Gjergji që më 1899 kishte botuar “Fizikën” dhe ka lënë dorëshkrim një tekst të botanikës me titullin “Bimëtregonjë”. Nuk na ka ardhur edhe një gramatikë e shqipes, të cilën e pati hartuar Gjerasimi.

Punimet për arsimin shqip dhe për veprimtarët e shkollës shqipe kohët e fundit janë shtuar njaft, ndërsa janë pasuruar edhe burimet dokumentare. Kemi kështu të dhëna të reja që na e ndriçojnë më plotërisht rrugën historike, si edhe vështrime më të thelluara duke kapërcyer kufizimet e politizuara. Në këtë kumtesë ne vetëm sa i prekëm fillimet të shqiptarët e Maqedonisë dhe të Kosovës, por besojmë se panja do të ndriçohet më mirë nga tërësia e punimeve të tjera. Sidoqoftë, zhvillimet e mëtejshme pas Pavarësisë dhe deri në gjysmën e dytë të shek. XX mund të thuhet se nuk nisnin nga zeroja, sepse kishin një trashëgimi të mëparshme.

SHËNIMET

1. REXHEPAGIQ, J. (1972): *Shkollat dhe arësimi në Kosovë nga fundi i shekullit XVIII gjer më 1918*. “Kosova”, nr. 1. Prishtinë, f. 107–238.
2. MACKENZIE, G. M. & IRBY, A. P. (1864): *Notes on South Slavonic Countries*.
3. MILOJEVIĆ, M. S. (1872): *Putopis dela prave (Stare) Srbije, II*. Beograd.
4. HAHN, J. G. VON (1867): *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*. Wien.
5. MYZYRI, H. (1973): *Shkollat e para kombëtare shqipe*. Tiranë, f. 92.
6. KOLIQI, H. (2002): *Historia e arsimit dhe e mëndimit pedagogjik shqiptar*. Prishtinë.

QERIM LITA

Shkup

ERNEST KOLIQI DHE SHKOLLAT KOMBËTARE SHQIPTARE NË TOKAT E LIRUARA

Me kapitullimin e Mbretërisë Jugosllave, tokat shqiptare nën pushtimin e asaj mbretërie u ndanë në tri zona pushtuese: Zona pushtuese italiane, Zona pushtuese bullgare dhe Zona pushtuese gjermane. Më 29 qershor 1941, qeveria italiane solli vendim përmes të cilit, qeverisë shqiptare iu dha e drejta e ushtrimit të pushtetit civil për “viset e Kosovës, Dibrës dhe Strugës”. Për rrjedhojë, qeveria shqiptare më 8 korrik emëroi Fejzi Alizotin, ministër Shteti, përkatësisht komisar i Lartë Civil, për “ushtrimin e pushtetit civil në Kosovë, Dibër e Strugë”, me qendër në Prizren¹.

Bashkimi i pjesës më të madhe të tokave shqiptare me Shqipërinë, u prit me një entuziazëm të lartë nga popullsia shqiptare, e cila këtë bashkim edhe pse erdhi si rrjedhojë e interesave strategjike të shteteve të Boshtit, e konsideronte si çlirim kombëtar. E gjithë kjo ishte si rrjedhojë e politikës tejte diskriminuese nga ana e pushtuesit serb. Ky diskriminim kishte arritur deri në ato përmasa sa që te shqiptarët ishte krijuar bindja se cilido pushtues që të vij nuk mund të jetë më i egër se ai serb, apo siç thuhet në një dokument ushtarak jugosllav “le të vijë edhe dreqi i mallkuar, do të jetë më mirë se kështu”². Lidhur me këtë edhe nënprefekti i Gostivarit, Xhevat

¹ Tokat e liruara, përmbledhje dokumentesh, përzgjedhjen, përkthimin, redaktimin dhe hyrjen: Qerim Lita, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2016, vëllimi 1, dok.nr. 3, fq.80-81.

² Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Politika e Mbretërisë jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941, përmbledhje dokumentesh, përzgjedhjen, parathënien dhe redaktimin: Qerim Lita, Shkup-Prishtinë, 2012, dok. Nr. 89, fq. 240-241.

Kallajxhiu, shkruante se popullsia shqiptare në atë rreth “derdh lot gëzimi”, që pati lumturinë të shpëtojë nga robëria e tmerrshme tridhjetëvjeçare, duke u shprehur: “Shyqir që ngjafim këto ditë të bashkohemi me Shqipërin, pa dhe me vdekur tani jemi të gëzuar”³.

Qeveria shqiptare i kushtoi rëndësi të veçantë hapjes së shkollave shqipe në Tokat e Liruar. Për këtë qëllim, ministri i Arsimit, Ernest Koliqi, në pjesën e dytë të muajit maj 1941, dërgoi në Kosovë, inspektorin e lartë të këtij dikasteri, Ndue Palucin, me detyrë, siç thuhej në njoftimin e Koliqit, dërguar më 14 qershor 1941 Ministrisë së Punëve të Brendshme: “për të studjue në vend nevojat më të ngutëshme, që kanë të bëjnë me jetën arsimore”⁴. Në fillim të muajit korrik përmes një raporti të detajuar, Paluci, e përshkruante gjendjen shumë të palakmueshme arsimore e kulturore të popullsisë shqiptare. Nga të dhënat që kishte arritur t'i grumbulloj në terren, numri i përgjithshëm i shqiptarëve që kishin pas fatin të studionin nëpër universitet e ish Jugosllavisë ishte 78, prej tyre 16 kishin diplomuar, 11 ishin në semestrin e fundit dhe 51 student në semestra të ndryshëm⁵. Duhet theksuar se gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, një grup studentësh shqiptarë nga rrethi i Pejës, në krye me Esat Mekulin, i shkruajnë një letër, përmes së cilës ankoreshin për shkallën shumë të ulët të zhvillimit kulturor—arsimor shqiptar, që ishte si rrjedhojë e politikës “diskriminuese të regjimit të mëparshëm jugosllav”. Një politike e tillë antishqiptare nga ana e ish regjimit, siç pohojnë ata, ishte zhvilluar “nëpërmjet rrugës brutale ekonomike e politike; masave agrare e masa tjera për nënshtrimin dhe eliminimin e tërësishëm të elementit tonë”. Duke u nisur nga e gjithë ajo, si edhe nga interesi kombëtar për një zhvillim sa më të shpejtë kulturor e arsimor, studentët Palucit i shtrojnë këto kërkesa:

³ Tokat e liruar, po aty, vëllimi 1, dok. 60, fq. 171-181.

⁴ Po aty, vëllimi 4, dok. nr. 603, fq. 51-52.

⁵ Po aty, dok. nr. 618, fq. 73-82.

a/ hapjen urgjente të kurseve në gjuhën shqipe, të cilat do të shfrytëzoheshin si hyrje para hapjes së shkollave fillore e të mesme për vitin e ardhshëm shkollor;

b/ hapjen e internateve shtetërore për nxënësit e shkollave të mesme, sipas principit të internatit të Medresesë së Madhe në Shkup. Me këtë shumicës së nxënësve të mirë do u mundësohej qasja në shkollë;

c/ dhënia e bursave shtetërore të gjithë nxënësve që e kanë kryer maturën, si edhe atyre të cilët deri dje kanë studiuar”⁶.

Ndërkohë, më 23 qershor 1941, ministri Koliqi, përmes një shkrese njoftonte Këshillin e Ministrave, për dërgimin e misioneve të jashtëzakonshme shkollore në Tokat e Liruar. Në shkresë shprehimisht thuhej: “Kam nderin të njoftoj se Ministria e Arsimit ka vendosë me dërgue s’afërmi në Kosovën e në Dibrën e çlirume nga një Misjon të jashtëzakonshëm për të studjue në vend gjenden arsimore nga çdo pikëpamje, si dhe ka një grup mësuesish për të hapë, me anën e këtyneve, kurse verore të gjuhës shqipe për të mëdhaj e të vegjël. Gjithashtu ka vendosë me dërgue një sasi të madhe librash, Flamujsh e kuadresh..”⁷.

Për rrjedhojë, Ernest Koliqi, në pjesën e dytë të muajit qershor 1941, emëroi katër Mision të Jashtëzakonshme Shkollore, edhe atë: Misioni i Jashtëzakonshëm Shkollor për Kosovë, në përbërje: Ali Hasharova – kryetar, ndërsa anëtarë: Jonuz Bllakçorri, Abdylrahim Buza, Flora Pali, Shaban Arra, Zef Pali, Xhavid Nimani dhe Fadil Haxhihoxha⁸; Misioni i Jashtëzakonshëm Shkollor për Prefekturën e Dibrës: Prof. Fadil Repishti – kryetar, ndërsa anëtarë: Emin Çomo, Prof. Kel Gashi, Selim Alliu, Mexhit Bekteshi dhe Pjetër Elezi⁹; Misioni i Jashtëzakonshëm Shkollor për Çamëri nën

⁶ Po aty, dok. nr. 604, fq.52-57.

⁷ Po aty, dok. nr. 608, fq. 60.

⁸ Po aty, dok. nr. 609. fq. 60-63..

⁹ Po aty, dok. nr. 612, 613 fq. 64-68.

udhëheqjen e Hysni Babametos¹⁰ dhe Misionin e Jashtëzakonshëm Shkollor për Mitrovicë në krye me Prof. Rexhep Krasniqin¹¹.

Misionet në fjalë, si detyrë parësore patën, të kryejnë studimin e gjendjes faktike të arsimit fillor e të mesëm në ato vise, si p.sh.: cilat ishin qendrat shkollore që kishin funksionuar gjatë vitit shkollor 1940/41; sa ishte numri i nxënësve dhe i mësuesve për secilën shkollë veç e veç; sa dhe cilat nga ato qendra shkollore ishin të pastra shqiptare, sa të përziera e sa të pastra sllave, përkatësisht greke; në çfarë gjendje janë objektet shkollore; ku duhet, ose mund të hapen shkolla tjera; sa djem e vajza shqiptare e kanë kryer ose e kanë ndjekë shkollimin e mesëm etj. Përveç kësaj, Misioni duhej që për një afat sa më të shkurtë të bëj organizimin e kurseve verore për mësimin e gjuhës shqipe si me të miturit ashtu edhe me të moshuarit¹². Për këtë qëllim, nga ana e Ministrisë së Arsimit, me 23 qershor u lëshua një qarkore deri te inspektoritë e Arsimit, në të cilën kërkohet që në baza vullnetare të hartojnë lista të arsimitarëve, të cilët siç thuhet në të: “çfaqin dëshirën e tyre me u transferue në vendet e shliueme.”¹³.

Duke u mbështetë në raportet e inspektorateve, qartë shihet se një numër i madh i arsimitarëve, me kënaqësi e kishin pranuar të punojnë në viset e çliruara, me ç’rast, po i referohemi raportit të Inspektorisë së Arsimit për qarkun e Durrësit, dërguar në fillim të muajit korrik 1941 deri te Ministria e Arsimit, ku thuhet: “Jemi të lumtun t’ia paraqesim Asaj P.T. Ministrije një listë të gjatë arsimitarësh vullnetarë, të cilët janë gati me derdhë gjithë energjitë e vlefshme të tyre për ringjalljen e vendeve të shliueme. Vullnetarët e këtij qarku arrijnë numrin 19; shumica e këtij numri njihet prej kësaj Inspektorije si element i zgjedhun dhe puntuer.”¹⁴. Ngjashëm raportonin edhe inspektorit tjera arsimore; Tiranës, Shkodrës,

¹⁰ Po aty, dok. nr. 616, fq.69-70.

¹¹ Po aty, dok. nr.626, fq. 97-98.

¹² Po aty, dok. nr. 609, 612, 613, 616, po aty.

¹³ Po aty, dok. nr. 614, fq. 68.

¹⁴ AQSH.F.195.V.1941.D.113.fl.75.

Elbasanit, Kukësit, Gjirokastrës, Korçës e Beratit, ku brenda një afati të shkurtë kohorë numri i tyre arriti mbi 150¹⁵. Të gjithë ata u vendosën nëpër qendra më të mëdha të Tokave të Liruar, të cilët hapën kurse verore në gjuhën shqipe.

Kurset verore që u hapën gjatë verës së vitit 1941, ndikuan pozitivisht te mbarë popullsia e gjerë shqiptare të këtyre viseve, e cila krahas kurseve kërkonte nga autoritet e atëhershme qeveritare shqiptare, hapjen sa më shpejtë të shkollave të rregullta shqiptare. Lidhur me këtë, kryetari i bashkisë së Dibrës, Shemsi Hatipi, i shkruante një letër prefektit të prefekturës së Dibrës, Lale Koçit, nëpërmjet së cilës e njoftonte atë se në ditët e fundit “shumë persona nga parijsia e qytetit na janë drejtue tue kërkuar me ngulm hapjen e shkollave në këtë vend.” Një kërkesë e tillë, sipas Hatipit, ishte e arsyeshme sepse, siç do të shprehet: “populli i këtij vendi, që, ma në fund, e merrnin ditën me jetue në diellin e ngrohët të lirisë, ka nevojë të ngutëshme me u ushqye me atë Kulturë, qi pat mungue, po thue, prej shekujsh e me çranjosë çdo vragë helmuese të kulturës sllave...”¹⁶. Drejtuesit e Komitetit të Kosovës, Bedri Pejani dhe Rexhep Mitrovica, më 2 shtator 1941, përmes një letre falënderojnë Koliqin për dërgimin e mësuesve në krahinën e Mitrovicës, të cilët siç thuhet në letër: “i kan sjell një shërbim të pa-çmueshëm lëvizjes kombëtare, i kan dhënë popullatave t’ona kuptimin ma të mire e ma praktik t’energjis e zotësis shqiptare”. Në letër më tej ata shkruanin: “krejt vendi përgjithësisht dhe Komiteti i Kosovës, posaçërisht, e ka ndije fellësisht vleftën e madhe të përpjekjeve tyne. Besojmë pra Zotnija e Juej do të na i dërgoni këto mësues dhe për vjetin shko. 941–942 tuj i futë në listën e arsimtarve që do të shënohen për këto krahina. Do të keni mirësi, po mëjherë, me i lajmrue se krejt populli i këtyre krahinave do t’a presi me gëzim të madh këthimin e tyne ndër në...”¹⁷. Letër

¹⁵Tokat e liruar, vëllimi 4, po aty, dok. nr. 620, 621, 622, fq. 84-97, dok. nr. 629, 630. Fq. 103.

¹⁶Po aty, dok. nr. 665, fq. 151-152.

¹⁷Po aty, dok. Nr. 654, fq. 134-135.

falënderuese ministrit Koliqi i erdhi edhe nga kryetari i Bashkisë së Tetovës, Dr. Xhafer Sulejmani, përmbajtja e së cilës ishte si vijon: “Me rastin e mbylljes së kursit veror të gjuhës Shqipe ndër këto vise, populli i Tetovës falënderon me gjithë zemër Shkelqësin t’Uej për dhuratën e çmueshme që i dërgoj këtij trualli Shqiptar por të pa fat deri tash, përujtesija, aktiviteti e urrejtja e mësuesvet Shqiptar ashtë çmue fort. Lutemi sa ma parë që këjo vepër të vazhdohet me çeljen e shkollave të rregullta”¹⁸.

Ndërkohë, kryetari i Komisionit të Jashtëzakonshëm shkollor për Prefekturën e Dibër, prof. Sami Repishti, përmes një shkrese dërguar më 2 shtator 1941 Ministrisë së Arsimit, i propozonte atij dikasteri të dërgoheshin të gjithë mësuesit e angazhuar në kurset verore sa më parë në ato treva, për shkak mbajtjes së “entuziamit të ngjallun te popullsia prej kurseve të para shqipe”. Përveç kësaj, Repishti e shihte të domosdoshme që: kurset për të rritur të vazhdojnë deri në mbarim të vitit; personeli i cili do të dërgohej në ato krahina të përbëhej prej elementeve shumë të pjekur dhe të përgjegjshëm në detyrën e marrë, njerëz të sakrificës e të atdhetarisë; të dërgohen sa më shumë mësuese me mision e porosi të veçantë për me hy ndër familjet shqiptare dhe me bërë përpjekje maksimale për emancipimin e gruas shqiptare; mësueset që do të dërgohen duhet të jenë në mënyrë të veçantë e mbi të gjitha të ndershme e të sjellshme etj.¹⁹.

Për rrjedhojë, Këshilli i Administratës pranë Ministrisë së Arsimit, më 1 tetor 1941, solli vendim për hapjen e 116 shkollave fillore kombëtare në Tokat e Liruar. Në të veç tjerash thuhej: “Transferimin e numrit të nevojshëm të personelit mësues..., nga shkollat e Shqipnis së përparshme në këto shkolla kombëtare, qi për herë të parë po hapen në viset e lirueme: Administrimin e Arsimit Filluer në Kosovë e Dibër tue hapë pesë Inspektori me qendra në Prizrend, në Pejë, në Prishtinë, në Dibër të Madhe dhe

¹⁸ Po aty, dok. nr. 655, fq. 135.

¹⁹ Po aty, dok. nr. 653, fq. 133-134.

në Tetovë; Dekretimin e hapjes së shkollave të sipërshtetë nga ana e Titullarit të Ministris s'Arsimit...etj.”²⁰. Sipas vendimit shkollat fillore kombëtare shqiptare do të hapeshin si më poshtë:

Prizreni me rrethinë: Prizreni 2 shkolla fillore me 17 mësues, f. Korishë 1 shkollë me 1 mësues, f. Novak 1 shkollë me 1 mësues: Dragashi me rrethinë; f. Vranishtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Rapçe 1 shkollë me 1 mësues, f. Brodë 1 shkollë me 1 mësues, f. Restelicë 1 shkollë me 1 mësues: Suhareka me rrethinë: Suharekë 1 shkollë me 1 mësues, f. Mushtishtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Nishur 1 shkollë me 1 mësues: Gjakovë me rrethinë: Gjakovë 1 shkollë me 10 mësues, f. Cërnabreg 1 shkollë me 2 mësues, f. Irzniq 1 shkollë me 2 mësues, f. Novosellë, 1 shkollë me 2 mësues, f. Çernijan 1 shkollë me 1 mësues, f. Dobrigje 1 shkollë me 1 mësues, f. Voksh 1 shkollë me 1 mësues: Rahovec me rrethinë: Rahovec 1 shkollë me 4 mësues, f. Hoça e Vogël, 1 shkollë me 1 mësues, f. Hoça e Madhe 1 shkollë me 2 mësues, f. Banjë 1 shkollë me 2 mësues, f. Caralluk 1 shkollë me 1 mësues, f. Kijevë 1 shkollë me 2 mësues, f. Drenovc 1 shkollë me 2 mësues, f. Mamushë 1 shkollë me 2 mësues: Pejë me rrethinë; Pejë 1 shkollë me 12 mësues, f. Papraçan 1 shkollë me 1 mësues, f. Strellcë 1 shkollë me 3 mësues, f. Kucishtë 1 shkollë me 1 mësues: Istok me rrethinë: Istok 1 shkollë me 3 mësues, f. Gjyrakoc 1 shkollë me 2 mësues, f. Uhca 1 shkollë me 2 mësues, f. Vrellë 1 shkollë me 1 mësues, f. Zllakuçan 1 shkollë me 1 mësues: Drenicë me rrethinë: Serbicë 1 shkollë me 1 mësues, f. Turiçevc 1 shkollë me 2 mësues, f. Obri 1 shkollë me 1 mësues: Plavë me rrethinë; Plavë 1 shkollë me 3 mësues, Guci 1 shkollë me 3 mësues: Prishtinë me rrethinë: Prishtinë 2 shkolla me 15 mësues, f. Sedllarë 1 shkollë me 1 mësues, f. Komoran 1 shkollë me 1 mësues, Lipjan 1 shkollë me 1 mësues, f. Rufe i Ri 1 shkollë me 1 mësues, Janjevë 1 shkollë me 3 mësues: Ferizaj me rrethinë; Ferizaj 1 shkollë me 3 mësues, Shtime 1 shkollë me 2 mësues, f. Greminjë 1 shkollë me 1 mësues, f. Talinovc i Madh 1 shkollë me

²⁰ Po aty.dok. nr. 673, fq. 159-164.

1 mësues, f. Mirash 1 shkollë me 1 mësues, f. Bibaj 1 shkollë me 1 mësues, f. Slivovë 1 shkollë me 1 mësues: Gjilan me rrethinë; Gjilan 1 shkollë me 4 mësues, f. Bresalcë 1 shkollë me 1 mësues, f. Strezovë 1 shkollë me 1 mësues, f. Hogoshtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Cërnica 1 shkollë me 1 mësues, f. Koretinë 1 shkollë me 1 mësues: Dibër e Madhe me rrethinë; Dibër e Madhe 1 shkollë 8 mësues, f. Banishtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Zhirovnicë 1 shkollë me 2 mësuesë, f. Vidush 1 shkollë me 1 mësues, f. Radastush 1 shkollë me 1 mësues, f. Trebishtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Velebërdë 1 shkollë me 1 mësues, f. Skudrinë 1 shkollë me 1 mësues, f. Kosovrast i Epërm 1 shkollë me 1 mësues, f. Zepishtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Pareshtë 1 shkollë me 1 mësues: Strugë me rrethinë: Strugë 1 shkollë me 6 mësuesë, f. Radohoshtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Ladorishtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Veleshtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Labënishtë 1 shkollë me 2 mësues, f. Livadhi 1 shkollë me 1 mësues: Kërçovë me rrethinë: Kërçovë 1 shkollë me 7 mësues, f. Strelcë 1 shkollë me 1 mësues, f. Shytovë 1 shkollë me 1 mësues, f. Sërbicë 1 shkollë me 1 mësues, f. Tuhinë 1 shkollë me 1 mësues, f. Jagoll-Delencë 1 shkollë me 1 mësues, f. Zajas 1 shkollë me 2 mësues, f. Dërgovë 1 shkollë me 1 mësues: Gostivar me rrethinë; Gostivar 1 shkollë me 8 mësues, f. Dobërdol 1 shkollë me 1 mësues, f. Vrapçishtë 1 shkollë me 2 mësuesë, f. Debreshë 1 shkollë me 2 mësuesë, f. Zdunje 1 shkollë me 1 mësues, f. Vërtok 1 shkollë me 2 mësuesë, f. Radhenë 1 shkollë me 1 mësues, f. Reçan 1 shkollë me 2 mësues, f. Tërnovë 1 shkollë me 1 mësues, f. Banicë e Poshtme 1 shkollë me 1 mësues, f. Banicë e Epërme 1 shkollë me 1 mësues, f. Llakavicë 1 shkollë me 1 mësues, f. Forinë 1 shkollë me 1 mësues, f. Çegran 1 shkollë me 1 mësues: Tetovë me rrethinë; Tetovë 2 shkolla me 12 mësues, f. Shipkovicë 1 shkollë me 1 mësues, f. Xhepçishtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Zhelinë 1 shkollë me 2 mësues, f. Reçicë e Madhe 1 shkollë me 1 mësues, f. Pallçishtë 1 shkollë me 1 mësues, f. Kamjan 1 shkollë me 2 mësues, f. Negotinë 1 shkollë me 1 mësues, f. Pirok 1 shkollë me 1 mësues, f. Gradec 1 shkollë me 1 mësues, f. Bogovinë 1 shkollë

me 1 mësues, f. Miletinë 1 shkollë me 1 mësues dhe f. Çellopek 1 shkollë me 2 mësues²¹. Përveç kësaj, vendimi përfshinte edhe 5 pika tjera të cilat në vazhdim po i paraqesim:

2. Transferimi i numrit të nevojshëm të personelit mësimor, pranë së cilës shkollë, nga shkollat e Shqipërisë së mëparshme në këto shkolla kombëtare, të cilat për herë të parë po hapen në viset e liruar.

3. Administrimi i Arsimit Fillor në Kosovë e Dibër duke hapur pesë Inspektori me qendra në Prizren, Pejë, Prishtinë, Dibër e Madhe dhe në Tetovë.

4. Dekretimin e hapjes së shkollave të sipërshtënuara nga ana e Titullarit të Ministrisë së arsimit.

5. Këshillit të Ministrave t'i propozohet Dekretimi i pesë vendeve të reja për Inspektore të Arsimit Fillor të cilët do të dërgohen në qendrat e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, dhe

6. Me përmbajtjen e pikës 1 të këtij vendimi do të njoftohen Mëkëmbësia Mbretërore, Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Komanda e Përgjithshme e KK.MM. dhe Komisariati Civil të Viseve të Liruar të Kosovës, Dibrës e të Strugës²².

Hapja e shkollave shqipe në Tokat e Liruar, përveç kuadrit mësimor kërkonte edhe kushte tjera, në radhë të parë ato financiare, andaj ministri Koliqi me 14 tetor 1941, i drejtohet Kryesisë së Këshillit të Ministrave, nga e cila kërkonte rritjen e buxhetit të Ministrisë së Arsimit për 2,5 milionë franka shqiptarë, për siç thuhet “nevojat e arsimit të zonës së lirueme” dhe se pa aprovinin e kësaj shuma nga Qeveria shqiptare: “kjo Ministri ka me qenë në pamundësi për dërgimin e personalit arsimit dhe për prokurimin e materialeve të domosdoshme për hapjen e shkollave

²¹ Po aty.

²² Po aty.

dhe të konvikteve”²³. Të njëjtën ditë, Koliqi emëroi Shaban Arrën inspektor të arsimit për Prefekturën e Prishtinës, Beqir Haçin, inspektor arsini për Prefekturën e Dibrës dhe Beqir Spahun inspektor të arsimit për Prefekturën e Prizrenit, si dhe disa drejtor didaktik edhe atë: Ibrahim Fehmiun me qendër në Prizren, Kolë Kozmaqin në Prishtinë, Lazër Kakariqin në Pejë, Edip Tërshanën në Dibër të Madhe dhe Mexhit Bekteshin në Tetovë²⁴.

Me 25 tetor, ministri Koliqi, përmes një shkrese urgjente kërkonte nga Këshilli i Ministrave të miratoj listën e mësuesve të cilët ishin caktuar të dërgoheshin në Tokat e Liruar për hapjen e shkollave kombëtare shqiptare. Në shkresë ai ndër të tjerave vinte në dukje që “shërbimin, qi kanë me kryemun këta mësues e mësuese në viset e naltpërmenduna, ka me qenë vetëm atëherë i siguruem ma së miri, kur n’ato anë të funksjonojnë rregullisht çdo degë e administratës shtetnore dhe veçanërisht ajo e sigurimitpublik..”²⁵. Në vazhdim po e paraqesim listën e plotë të, inspektorive e të drejtorive Didaktike dhe të shkollave fillore kombëtare në Tokat e Liruar, si dhe numrin e mësuesve të paraparë për të punuar në ato shkolla, që Ernest Koliqi më 25 tetor ia përcjell Kryeministrit për miratim:

PREFEKTURA E DIBRËS SË MADHE

Inspektoria e Dibrës së Madhe

Inspektor		1. Beqir Haçi
Drejtor didaktik		1. Selim Alliu, Peshkopi, Zërqa
Drejtor didaktik		1. Edip Tërshana, Dibër të Madhe dhe Strugë
Sekretar		1. Mynyr Shehu

²³ Po aty, dok. nr. 667, fq. 156.

²⁴ Po aty, dok. nr. 672, fl. 158-159.

²⁵ Po aty. Skudrinë

mësues Shkolla dhe mësuesët

Dibër e Madhe qyteti

Shkolla Nr. 1

Drejtor		Xhevat Xhafa
Mësues		Liri Babameto
“		Remzi Pustina
“		Ibrahim Kuka
“		Menduh Skikuli

Shkolla nr. 2

Drejtor		Naim Babameto
Mësues		Esat Mezelxhiu
“		Ajshe Ruka
“		Eleni Dasho
“		Fahri Sulo

FSHATRAT

Banishtë	Mësues	Hasan Rrapi
Zherovnicë	“	Sait Xaxa Remzi Prapaniku
Radastushë	“	Hysen Abdyhoxha
Trebishtë	“	---
Vidush	“	Hiqmet Kasapi
Velebërdë	“	Qamil Kopani
Skudrinë	“	---
Kosovrast i Epërm	“	Fadil Hoxha
Zepishtë	“	Ali Tanhai
Xhitinjan	“	Thanas Caku
Paresh		==

NËNPREFEKTURA E STRUGËS

Strugë qyteti

Shkolla Nr.1

Drejtor		
Mësues		Faik Pajuni
“		Alipi Pajuni
“		Gjergj Bullati
“		Hasan Belshaku
“		Xhyhere Belshaku
“		Hysen Pajenga

Fshatrat

Radohoshtë	Mësues	Jonuz Balla
Ladorishtë	“	Ktheofan Dokja
Veleshtë	“	Skender Hoxha
Labënishtë	“	Dalip Zejneli
	“	Nexhip Minerolli
Livadhi	“	Enver Palluqi

PREFEKTURA E PEJËS

Inspektoria e Pejës

Inspektor		-----
Drejtor Didaktik		Lazër Kakariqi
Sekretar		-----

Shkollat dhe mësuesit

Pejë qyteti

Shkolla Nr.1

Drejtor		Nuredin Kopliku
Mësues		Muharrem Bllakçori
“		Persa Gjorbabaj
“		Bajram Gashi
“		
“		-----

Shkolla Nr.2

Drejtor		Jonuz Balla
Mësues		Ismet shaqiri
“		Katerina Gjini
“		Zija basha
“		Naxhije Taraku

Fshatrat

Papraçan	Mësues	Abdyrrahim Çavolli
Strelcë	“	Halil Agusholli
Kuçishtë Ver	“	-----

NËNPREFEKTURA E ISTOGUT

Istok	K/ Mësues Mësues “	Elhami Nimani Arif halili -----
Gjyrakoc	“	Minush Lipoveci
Vrellë	“	Hysni Zaimi
Zllakuçan	“	Ndrec Ndoi

NËNPREFEKTURA E DRENICËS

Serbicë	Mësues	Jaho Dibra
Turiçevc	“	Lutfi Zyberaj
Obri	“	Seit Bakalli

NËNPREFEKTURA PLAVË – GUCI

Plavë	Mësues “	Shaban Ferri -----
Guci	“ “ “	Jusuf Çeka Elefterije Çeka -----

PREFEKTURA E PRISHTINËS

Inspektoria e Prishtinës

Inspektor		Shaban arra
Drejtor Didaktik		Kolë Kozmaqi me shërbim tëpërkohshëm në Gjakovë
Sekretar		-----

Shkollat dhe mësuesit

Prishtinë qyteti

Shkolla Nr. 1

Drejtor		Rexhep Dalipi
Mësues		Xhemal Xhahysa
“		Tef Kuçani
“		Luçije Koci
“		Sali Morina
“		Marianthi filaj
“		-----
“		-----

Shkolla Nr.2

Drejtor		Luigj Koci
Mësues		Luçije Kuçani
“		Mustafa Krantja
“		Asllan Mesareja
“		Tom Gjshja
“		Mahmut Kaja
“		Virgjini Dodbiba
“		Abdyl Keçi

Fshatrat

Sedllarë	Mësues	Bajram Nure
Komoran	“	-----
Lipjan	“	-----
Rufi i Ri	“	-----
Janjevë	“	Shyqri Zokolli
	“	Tom Shoshi
	“	Vangjeli Shoshi

NËNPREFEKTURA E FERIZAJT

Ferizaj	Drejtor Mësues “ “ “	Fadil Idriz Hoxha Naxhije Taraku Frano Kurti Gjergj Marku Koço Paproko
Shtime	Mësues “	Rexhep Shpendi Ajshe Shpendi
Greminjë	“	-----
Talinofc i Madh	“	Rrahman Palushi
Mirash	“	-----
Bibaj	“	-----
Slivovë	“	-----

NËNPREFEKTURA E GJILANIT

Gjilan	K/Mësues Mësues “	Elez Gashi Filip Gashi Ganije Gashi
Bresalcë	“	Sadije Gjilani
Strezovë	“	---
Hogoshtë	“	Fadil Haxhi Hoxha
Cërnice	“	---
Koretinë	“	-----

NËNPREFEKTURA E TETOVËS

Inspektoria e Tetovës

Inspektor		-----
Drejtor Didaktik		Mexhit Bekteshi
“		-----
Sekretar		-----

Shkollat dhe mësuesit

Tetovë qyteti

Shkolla Nr.1

Drejtor		Elez Maho
Mësues		Abdi Kërçini
“		Zejnel Zajmi
“		Aleksandra Bibaja
“		Sotir Gallani
“		Margarita Gallani
“		Qemal Haxhihasani

Shkolla nr. 2

Drejtor		Beqir Kllojka
Mësues		Lazër Bibaja
“		Pano Hido
“		Josif Todi
“		Lirije Todi

Fshatrat

Shipkovicë	Mësues	Mehmet Daradaku
Xhepçishtë	“	Vangjel Dako
Zhelinë	“	Nos Topalli
	“	-----
Reçicë e Madhe	“	Qemal Agolli

Pallçishtë	“	-----
Kamjan	“	Nos Deliana
	“	-----
Negotinë	“	Jorg Bekteshi
Pirok	“	Sadik Kadilliu
Gradec	“	-----
Bogovinë	“	Hamid Pitja
Miletinë	“	-----
Çellopek	“	Myrteza Peza
	“	-----

NËNPREFEKTURA E GOSTIVARIT

Gostivari qyteti

Shkolla nr. 1

Drejtor		Hamdi Geni
Mësues		Liri Ekmekçiu
“		Hysni Ekmekçiu
“		Osman Lufta
“		Ahmet Gjylaçi
“		Mit’hat Hoxha
“		Kov Bibaja
“		Alush Baltëza

Fshatrat

Dobërdoll	Mësues	Skender Haxhihyseni
Vrapçisht	“	Xhafer qatipi
	“	-----
Debreshë	“	Irfan Oruçi
	“	Abaz Xhafa
Zdunje	“	-----
Vërtok	“	Mit’hat Cami
	“	Abedin Faja
Radhenë	“	Selman Qorri

Reçan	“	Gafur Rada Hamdi Zbazuni
Tërnovë	“	-----
Banic e Poshtme	“	Gani Graceni
Banic e Epërme	“	Ahmet Pere
Llakavicë	“	Mihal Pjeshkazini
Forinë	“	Petrit Serjani
Çegran	“	Kristaq Progri

NËNPREFEKTURA E KËRÇOVËS

Kërçova qyteti

Shkolla Nr. 1

Drejtor		Behxhet Hoxholli
Mësues		Artenisi Hoxholli
“		Xhaferr Shefkiu
“		Sulejman Karai
“		Ibrahim Doraci
“		Thomaidha Rako
“		Levro Doraci

Fshatrat

Strelcë	Mësues	Remzi Xhemali
Shytovë	“	-----
Serbicë	“	Mahmut Dumani
Tuhinë	“	-----
Digoll–Dolencë	“	Hasan Safa
Trapçindoll	“	-----
Zajas	K/Mësues Mësues “ “	Gavril Santo Ismail Bedhija Ridvan Palluqi Xhaferr Narazani
Dërgovë	“	Petrit Hakani

PREFEKTURA E PRIZRENIT

Inspektoria e Prizrenit

Inspektor		Beqir Spahiu
Drejtor Didaktik		Ibrahim Fehmiu – Prizren
“ “		Muharrem Musa – Kukës
“ “		-----
		Gjakovë
Sekretar		-----

Shkollat dhe mësuesit

Prizren qyteti

Shkolla Nr.1

Drejtor		Rrok Zojzi
Mësues		Qazim Sulejmani
“		Mhill Shala
“		Mehmed Gjevori
“		Shefqet Veliu
“		Muzafer Gostivari
“		Myrteza Shehdulla
“		Ana Delhysa
“		-----
“		-----

Shkolla Nr. 2

Drejtor		Sulejman Aliu
Mësues		Myfit Shehaj
“		Shyhrete Shehdulla
“		Sherini Shehdulla
“		Nuri Sherifi
“		Pina Ndocaj
“		Marija Berisha

Fshatrat

Korishë	Mësues	Ramadan Mehmeti
Novak	“	-----
Zym	“	Kel Rroku

NËNPREFEKTURA E DRAGASHIT

Vranishtë	Mësues	-----
Rapçe	“	Xhaferr Xarra
Rrodë	“	Selim Kopliku Shqyri Haxhia
Restelicë	“	Idriz Fishta

NËNPREFEKTURA E SUHAREKËS

Suharekë	Mësues	Hilmi Duli
Mushtishtë	“	Ramadan Reçi
Nishur	“	-----

NËNPREFEKTURA E GJAKOVËS

Gjakova qyteti

Shkolla Nr. 1

Drejtor		Demush Gjakova
Mësues		Zeki Shehi
“		Abdullah Behri
“		Nuriye behri
“		Ndoc Kujxhia

Shkolla Nr. 2

Drejtor		Jusuf Puka
Mësues		Shyqri Hafizi
“		Hajdar Shehdulla
“		Shyqri Jakova
“		-----

Fshatrat

Cërnabreg	Mësues	Beqir Kastrati Haki Taha
Irzniq	“ “	Abdyl Xhafa Dule Pashaj
Novosellë	“ “ “	Gjergj Shota Muhamet Uruçi -----
Cernian	“	-----
Dobrigjë	“	Xhemal Kaloshi
Voksh	“	-----

NËNPREFEKTURA E RAHOVECIT

Rahovec	K/Mësues Mësues “ “	Sali Kolgeci Zef Agimi Nebi Dino -----
Hoça e Vogël	“	-----
Hoça e Mafhe	“ “	Malo Beci Jorg Huta
Banjë	“ “	Jovan Dodi -----
Sarallup	“	-----
Kijevë	“ “	Gasper Bicaj -----
Drenofc	“ “	Jak Lukaj Irfan Kuçi
Mamushë	“ “	Dhimitër Kushi Magdalena Kushi

NËNPREFEKTURA E ULQINIT

Ulqin	K/Mësues Mësues “ “	Jahja Domnori Zef Tarnaku Angelina Pistuli Xhemal Lopçi
Tuz	“ “	Faik Tuzi -----
Salcë	“	-----
Peçuricë	“ “	Ramadan Milla Luigj Shkjezi
Gorancë	“	-----
Koziq	“	Hasan Ibrahim
Katërkollë	“	Preng Jakova
Sukovinë	“	Shuk Shllaku
Ostros	“	-----
Martiq	“	----- ²⁶

Të njëjtën ditë, Koliqi, përmes një qarkoreje, njoftonte të gjitha shkollat e mesme, konviktet dhe inspektoratet e arsimit për hapjen e shkollave shqipe në Tokat e Liruar. Në të shprehimisht thuhej: “Vjeti shkolluar qi po hapet, tue u shtri tashti dhe jashtë kufijve të vjetër t’Atdheut, mund të quhet me plot kuptimin e fjalës një vjet historik, sepse Shkolla Shqiptare po nis me veprue edhe në viset e lirume.. Arsimi Kombtar, qi e ka pasë mbajtë idealin e irredentizmit në gji të vet, pregatitet me të gjitha fuqinat e veta me plotsue nevojët e krahinave qi u bashkuenë tekembranja me Atdhe. Për të qenë në naltësin e kësaj detyre historike qi po i ngarkohet Shkollës Shqiptare, duhet qi shpirti i sakrificit të shkëlqejë çë prej ma të madhit e deri të ma të voglin pjestar të familjes arsimore. Çdo dyshim, çdo plogti, çdo akt mos–interesimi, ka me u quejtë mungesë besimi kundrejt Atdheut...”²⁷.

²⁶ Po aty, fq. 175-183; AQSH. F. 195. V. 1941. D. 113, fl. 120-131.

²⁷ AQSH. F. 195. V. 1941. D. 113. Fl. 132.

Ndërkohë, listës së sipërme iu shtuan edhe 22 mësues të cilët ishin paraparë të dërgohen në krahinën e Mitrovicës: Peter Elezi – inspektor, Rifat Spahiu, drejtor shkolle si dhe mësuesit: Xhevdet Doda, Bedri Gjinaj, Fethi Dizdari, Shaqir Hoti, Kolë Jakova, Isa Aliaj, Dedë Shala, Marika Shala, Gjergj Martini, Zografa Martini, Muharrem Çollaku, Dhimitër Fullani, Kasem Gega, Ndoc Çurçia, Xhevat Xhafa, Rok Jakova, Mustafa Krantje, Idriz Fishta, Shqyri Sokoli dhe Kiço Kasapi²⁸.

Pasi u kryen të gjitha parapërgatitjet e duhura, përfshi këtu edhe transportin e organizuar nga Ministria e Arsimit, në pjesën e parë të muajit nëntor rreth 200 mësues anë mbanë vendit që nga Gjirokastra e deri Shkodër hapën shkollat e para shqipe në Tokat e Liruar. Në telegramin qarkor drejtuar Inspektorateve të arsimit fillor të: Beratit, Peshkopisë, Durrësit, Kukësit, Elbasanit, Shkodrës, Gjirokastrës, Korçës dhe Vlorës, Ernest Koliqi në mënyrë të qartë e të prerë do të shprehet: “Personelit t’Arsimit Filluer të transferuem në Kosovë e Dibër nuk i merret asnjë arsye parasysh për mosparaqitje në detyrën e re. Lutjet qi kanë parashtrur mbeten pa veprim. Me 10 Nënduer nisja e tyne duhet të ketë marrë fund. Në këtë ditë lajmroni se cilët nuk kanë dashë me u nisë gja qi do të konsiderohet si kundërvajtje urdhnit të dhanë.”²⁹.

Në prag të nisjes së mësuesve shqiptarë në kryerjen e misionit të tyre të shenjtë, Koliqi përmes një qarkore ua përcolli këto porosi: “Mos me u përzi në çashtje politike, fetare e minoritare; mos me u przi në çashtje lokale a po administratash të tjera; me u –pru mirë me popull e me ja fitue zemrën këtij me punën t’uej të naltë të zbatueme me mend e me themel si brenda edhe jashtë shkollës; me i trajtue nxansit e nxanset me dashtuni atnore dhe në mënyrën ma të përsosun të një edukatori, tue i ndihmue me durim qi të kapërcejnë vështirësitë e fillesës e veçanërisht në mësimet e para; me

²⁸ AQSH. F. 195. V. 1941. D. 210. Fl. 63.

²⁹ AQSH. F. 195. V. 1941. D. 113. Fl. 134.

jetën t'uej private të rregullt e të ndershme të jeni shembulla ma e përsosun e vetive burrnore të shqiptarit të kulturuar”³⁰.

Më 13 nëntor 1941, Ernest Koliqi, Qeverisë shqiptare ia dorëzoi Projekt–Dekretin mbi organizimin e shkollave fillore në Tokat e Liruar³¹, i cili pa as një ndryshim u dekretua më 20 nëntor 1941 nga Francesco Jacomoni. Në nenin 2, paragrafi 1 të Dekretit thuhej: “Ministri i Arsimit autorizohet, tue fillue prej vjetit shkolluer 941–942 me themelue me Dekret të vetin, ndër tokat e aneksueme aq shkolla sa nevojiten për t’i sigurue Arsimin Filluer djalëris”³².

Përkundër faktit se dekretimi për hapjen e shkollave shqipe u bë më 20 nëntor, të njëjtat u hapën në pjesën e parë të atij muaji. Në raportin e drejtorit didaktik të Tetovës, Mexhit Bekteshi, dërguar më 6 nëntor 1941 Inspektorisë së Arsimit në Dibër të Madhe, vihej në dukje interesimi i jashtëzakonshëm i popullsisë shqiptare për ardhjen e mësuesve në atë pjesë shqiptare: “habitemi, kur shohim të vijnë grumbull katundarët për me marrë mësuesin e vet me karrocë e ta shoqnojnë atë me buzë në gas”, thuhej në fillim të raportit, për të shtuar: “tue i drejtue fjalë t’ambla e simpathije, sikurse asht e vërtetë që asht i dërguem për t’i qitë në dritë, kënaqen kur u flet në gjuhën e ambël shqipe.... Arsimtari fluturon nga gëzimi, kur shef një popull të tanë që e adhuron e i del përpara me të math e me të vogël...”³³.

Krahas shkollave fillore, me Dekret Mëkëmbësor të datës 12 nëntor 1941, në Tokat e Liruar do të hapen edhe shkolla të mesme kombëtare edhe atë: Normalja “Sami bej Frashri” në Prishtinë, Liceu Shtetëror në Prizren, Liceu Shtetëror në Tetovë, Instituti Teknik Bujqësor Mashkullor në Pejë, Institut Teknik Tregtar në Gjakovë, Shkollë Profesionale në Tetovë, Shkollë Profesionale në

³⁰ AQSH. F. 195. V. 1941. D. 16. Fl. 1.

³¹ AQSH. F. 195. V. 1941. D. 113. Fl. 153-154.

³² AQSH. F. 195. V. 1941. D. 113. Fl. 156-159.

³³ AQSH. F. 195. V. 1941. D. 180. Fl. 117-118.

Kërçovë, Shkollë Profesionale në Dibër, Shkollë Profesionale në Gjiçan, Shkollë Profesionale në Ferizaj, Shkollë Profesionale në Strugë, Shkollë Profesionale në Gostivar, Shkollë Profesionale në Ulqin dhe Shkollë Profesionale femërore në Prizren³⁴.

Këtu duhet veçuar Normalen e Prishtinës, e cila për tre vite sa funksionoi dha një kontribut të jashtëzakonshëm në krijimin e kuadrit të mirëfilltë qoftë kombëtar po ashtu edhe edukativ–arsimor. Në këtë shkollë punuan personalitet më të shquara intelektuale e atdhetare shqiptare të asaj kohe si: Dr. Rexhep Krasniqi, Dr. Myftar Spahiu, prof. Arshi Pipa, prof. Ymer Berisha, prof. Ibrahim Hakiu–Kelmendi, Vasil Antoni e shumë të tjerë.

Hapja e shkollave të para kombëtare shqiptare, në historiografinë më të re shqiptare konsiderohet si Rilindja e dytë për shqiptarët e këtyre trojeve. S’do mend se për këtë meritë të madhe patën mësuesit shqiptarë, të cilët me kërkesë të Ministrisë së Arsimit, përkatësisht ministrit Koliqi, me kënaqësi pranuan të vijnë në këto vise, duke i lënë të gjitha privilegjet që i gëzonin atje, vetëm e vetëm që t’ju dalin në ndihmë vëllezërve të tyre, të cilët posa ishin çliruar nga robëria tridhjetëvjeçare serbe. Ata gjatë punës së tyre trevjeçare, krahas punës edukativo–arsimore, vepruan edhe në vetëdijesimin kombëtar të popullsisë shqiptare të këtyre viseve, duke krijuar një plejadë të kuadrit rinor, i cili pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, përkundër dhunës dhe terrorit komunist jugosllav, arriti ta mbajë gjallë frymën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

³⁴ Tokat e liruara, vëllimi 4 po aty, fq. 214-217.

RAGIP GJOSHI

Prishtinë

SHKOLLA SHQIPE NË KOSOVË GJATË VITEVE 1941–1944

E vështirë, e gjatë dhe e mundimshme ka qenë udha e shkronjave shqipe në të gjitha trojet shqiptare, në veçanti në Kosovë. Shënimi i 75-vjetorit të shkollës shqipe, që po përkujtohet sivjet në mbarë trojet shqiptare, është rast i mirë për ta parë rrugën e derikëtushme të arsimit shqip. Arsyet janë të shumta, por disa janë më të nevojshme të shkruhen e të thuhën.

Të rralla janë rastet e popujve që e paguan shtrenjtë të drejtën për shkrimin e gjuhës sa populli shqiptar. U derdh shumë gjak për t'i shpëtuar asimilimit. Por, kur Lufta e Dytë Botërore kishte marrë përmasa të gjëra në Evropë, fuqitë nazifashiste kishin pushtuar pos, shteteve të tjera, edhe të gjitha viset e banuara me shqiptarë. Pas Shqipërisë, kapitulloi edhe Jugosllavia. Në këtë kohë u pushtuan edhe viset e territorit të Republikës së Kosovës së sotme. Atëherë Kosova u nda në tri zona okupimi: italiane, gjermane dhe bullgare. Pothuajse shumica e trojeve të Kosovës i takoi zonës italiane të okupimit. Kështu, pjesa më e madhe e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore iu bashkua Shqipërisë me Dekretligj Mbretëror dhe me Dekret të Mëkëmbësi të Mbretit, nr. 264, të datës 12. VIII. 1941.³⁵

Në të tri zonat e okupimit u ngre administratë e pushtetit në shërbim të pushtuesve. Shtypja e gjatë dhe e egër kishte reflektuar që shqiptarët rrethanat e reja t'i përjetojnë e perceptojnë në çdo pikëpamje, si një përngjarje me lirinë e vërtetë, sepse tirania e

³⁵ Ali Hadri, *Okupacioni system nga Kosovu i Metohiji 1941-1944*, Jugoslaaven-ski Istoriski Casopis, Beograd, 1966, f. 7-9.

periudhës së viteve 1918–1941 kishte kaluar të gjitha përmasat e gjenocidiale.³⁶ Me nismën e ministrit shqiptar E. Koliqi, në Kosovë u dërgua një kontingjent mësuesish, sepse Kosova kishte mungesë të kuadrove arsimore–pedagogjike. Kjo punë vuri në lëvizje reflektimin e inteligjencës shqiptare në Kosovë që për nxënësit shqiptarë të çelëshin sa më shpejt shkolla shqipe kudo.

HYRJE

Vitin 1941 Kosova e nisi me një rregullim të ri administrativ. Kjo trevë u nda në tri zona okupimi: italiane, gjermane dhe bullgare. Pjesa më e madhe e Kosovës i takonte Zonës italiane të okupimit. Administrimi ishte i organizuar në prefektura, si ajo: e Prishtinës, e Prizrenit, e Pejës, e Mitrovicës. Pas këtij administrimi inteligjenca shqiptare iu përvesh punës për hapjen e shkollave. Po në këtë kohë në Kosovë dhe në trojet shqiptare, edhe shërbimet e tjera shtetërore, si: financat, gjyqet, administrata, mbaheshin dhe kryheshin në gjuhën shqipe.

Ministri shqiptar i Arsimit, Ernest Koliqi³⁷, në Kosovë dërgoi grupin e parë të mësuesve, sepse Kosova kishte mungesë të kuadrove arsimore–pedagogjike. Kjo punë kompensohej edhe me angazhimin e hoxhallarëve dhe të gjithë atyre që e njihnin alfabetin e Manastirit. Në këtë veprimtari të çmueshme, përveç kontingjentit të mësuesve të ardhur nga Shqipëria, angazhoheshin edhe ish–nxënësit shqiptarë që kishin mësuar shkrim–leximin në gjuhën serbokroate apo ndonjë gjuhë tjetër.³⁸ Organizoheshin edhe kurse të veçanta për zhdukjen e analfabetizmit dhe kështu rritej dëshira për mësimin dhe përdorimin e gjuhës së shkruar shqipe.

³⁶ Po aty f. 9

³⁷ Në të përkohshmen *Shejzat*, nr. 1 gusht 1957 dhe nr. 4-5, nanduer-dhetuer 1957, ky kolos shkruan për arsimin dhe e definon si:... *kroje të reja në parnas shqiptar*.

³⁸ Në Kosovë dhe në trojet jashtë Shqipërisë deri në vitin 1941 përhapja e shkrim–leximit ishte e ndaluar, sanksionohet dhe dënohet, sepse mësimi ishte i lejuar vetëm në gjuhën serbe apo maqedonase.

Edhe gjatë kësaj kohe, edhe në vitet e para të shkollës shqipe, rëndësi e veçantë i është kushtuar mësimi të gjuhës shqipe dhe historisë si lëndë mësimore. Shqiptarët rikthyen të drejtën për përdorimin e simboleve kombëtare etj. Në Kosovë, pas 23 vjetësh të ndalimit të shkollimit në gjuhën shqipe, rihapen shkollat në gjuhën shqipe. Arsimi fillor ishte pesëvjeçar dhe i obligueshëm. Gjatë kësaj periudhe, përveç qindra shkollave fillore të porsahapura, nisi punën edhe shkolla e mesme në Prishtinë.³⁹ Të gjitha këto institucione, përfshirë edhe kurset pedagogjike për kualifikimin e mësuesve, ndikuan në vetëdijesimin arsimor dhe kombëtar dhe në zbutjen e analfabetizmit dhe përhapjen e mësimi të gjuhës shqipe. Kjo ishte një periudhë shumë e rëndësishme në historikun e zhvillimit të shkollave dhe të arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë.⁴⁰

1.1. SFIDAT E ARSIMIT SHQIP NË KOSOVË PARA VITIT 1941

Mësimi i gjuhës shqipe në Kosovë është dokumentuar në mesjetë. Ka dëshmi se mësimi i gjuhës shqipe ka nisur në institucione arsimore–edukative fetare. Për një organizim të tillë njihet Shkolla e Stubllës së Vitisë (1584).⁴¹ Pra, shkolla shqipe i ka rrënjët që në shekullin XV. Ishin këto shkollat e para kishtarë të hapura pranë manastireve, të njohura si shkolla të qytetit, shkolla të gramatikës latine, akademi, kolegje etj (Stubëll, Pedhanë, Kurbin, Shkodër etj). Në këtë kohë e kanë origjinën edhe tekstet mësimore të vjetra të cilat përdoreshin në shkolla. I kësaj kohe është *Meshari* i Gjon Buzukut i shkruar me alfabet latin.

³⁹ Ndër shkollat e para të mesme dhe profesionale meritojnë të veçohen janë: Liceu i Shtetit *Gjon Buzuku* në Prizren, Instituti Teknik Bujqësor - Gjymnazi i Pejës, Shkolla Femnore e Punës 28 *Nëntori*, Shkolla Normale *Gjon Kazazi* në Gjakovë, Shkolla Normale *Sami Frashëri* në Prishtinë.

⁴⁰ Ali Hadri, *LNÇ në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë, 1971, f. 125

⁴¹ Ragip Gjoshi, *Shkolla e parë shqipe, shkolla e Stubllës, Malësia*, 2014, f. 175

Për traditën e mësimit të gjuhës shqipe me alfabet arab është e besueshme të ketë ekzistuar edhe në Kosovë. Ishte kjo periudhë e hapjes së shkollave të huaja pranë kishave, xhamive e teqeve, për të pasuar me periudhën e Rilindjes Kombëtare, kur lindi misioni i ri për inteligjencën shqiptare të kohës. Është një epokë që shënon interesimin e shqiptarëve për shkencën dhe arsimin, për dijen dhe lirinë e çlirimin e vendit. Në këtë kohë depërtojnë edhe idetë pedagogjike e didaktike evropiane në trevat shqiptare. Pas hapjes së shkollave të para kombëtare, këto përpjekje ndjeshëm u shtuan edhe në Kosovë. Por pas vitit 1912 (pas shkëputjes së Kosovës nga trugu i Shqipërisë), kjo trevë u katandis në shtypje e dhunë. Përdorimi i shkronjave shqipe u sanksionua. Atij që i gjendej qoftë edhe një abetare shqipe dënohej e persekutohej rëndë.

Në vitin 1914 pjesët e trojeve të Kosovës që kishin mbetur nën okupimin austro-hungarez u lejuan të arsimoheshin në gjuhën shqipe dhe lënda mësimore Gjuhë dhe Letërsi Shqipe kishte vend kryesor në këto shkolla, ndërkaq në pjesët e tjera të tokave të Kosovës, që ishin nën administrimin e sundimit bullgar, nuk lejohej mësimi në gjuhën amtare. Sërish vijnë ditë të rënda për shkollën shqipe dhe për shqiptarët në Kosovë. Kështu, nga viti 1918 deri në vitin 1941 në Kosovë dhe për shqiptarët ishte i ndaluar mësimi në gjuhën shqipe dhe administrata në gjuhën shqipe.

Për hapjen e shkollave në viset jashtë Shqipërisë londineze ka rëndësi edhe Qarkorja për Inspektorët e Arsimit e 15 nëntorit 1940 (*Mbi mësimin e gjuhës në shkollat fillore*), lëshuar nga ministri i Arsimit, Ernest Koliqi. Misioni arsimor i Koliqit si ministër i Mbretërisë Shqiptare, i cili kryetar të Misionit të Jashtëzakonshëm e emëroi Ali Hashrovën e Januz Blakçorrin, zv/kryetar dhe anëtarë: Shaban Arrën, Zef Palin, Xhavit Nimanin e Fadil Hoxhën, si dhe Muharrem Musën, sekretar.⁴² Ky mision kishte hartuar program të

⁴² Abdylaziz Veseli, *Shkollat dhe arsimi shqip në Prefekturën e Prishtinës...1941-1944: II*, Gjilan, 2003, f. 85

veçantë të misionit të rëndësishëm.⁴³ Kryetari i këtij misioni, studiues kompetent i nevojave arsimore të shkollës shqipe në Kosovë, ishte angazhuar për të sjellë në Kosovë mësues me ndërgjegje të lartë kombëtare. Anekënd Kosovës u sollën afër 600 mësues shqiptarë, në disa kontingjente gjatë këtyre viteve, të cilët ndihmuan hapjen e shkollave shqipe dhe mësimin e gjuhës shqipe.

Lidhur me realizimin e këtij misioni, Koliqi thotë: “Në verën e vjetit 1941 dyqind mësues të Shqipnis së vjetër (kështu e quante autori vendlindjen, vërejtje inja, R. Gj.) u derdhën nëpër popullësi shqiptare të viseve të naltëpërmendura dhe i vunë themelet e arsimit kombëtar”. Shumica prej këtyre mësuesve mbetën në Kosovë, deri në kohë kur me një vendim tjetër një numër i madh i tyre u dëbuan nga politika jugosllave.⁴⁴ Në programet mësimore të kësaj kohe gjuha shqipe kishte rëndësi të veçantë. Sa për ilustrim po shënojmë faktin se gjuha shqipe si lëndë mësimore në klasën e parë mësohej 14 orë në javë: *zhvillim germash : 4 orë në javë; shkrim e këndim (lexim): 5 orë në javë; rrëfime e kallëzime: 2 orë në javë; ushtrime të të folurit: 2 orë në javë; recitim: 1 orë në javë.*⁴⁵ Edhe në klasat e tjera të shkollimit fillor gjuha shqipe si lëndë mësimore kishte peshë për nga fondi javor i orëve dhe për nga përmbajtjet mësimore. Në klasën e dytë gjuha shqipe mësohej 14 orë në javë, në klasën e tretë 14, në të katërtën 13 dhe në të pestën 13 orë në javë.

Për përkushtimin e Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë për arsimin në Kosovë flet më së miri përmbajtja e *Qarkores, me disa udhëzime për edukatën patriotike të nxënësve në shkollën fillore*, e 15 marsit 1944, në të cilën figuron ministër Koço Muka, por qëllimi i tij është i njëjtë me të Koliqit. Këto udhëzime synonin që nxënësit shqiptarë të fitojnë ngritje të vetëdijes kombëtare, duke bërë thirrje

⁴³ AQSh, Fondi 295, viti 1941, dosja 180, fleta 7 dhe 8

⁴⁴ 12 dhjetori 1941 njihet si ditë e shënuar e hapjes së shkollës shqipe në Kosovë

⁴⁵ AQSh, Fondi 295, viti 1941, dosja 27, fleta 48

për mësimdhënësit që të mos kufizohen vetëm në orët e rregullta mësimore.

Për ta mbjellë e forcuar edukatën dhe ndërgjegjen kombëtare, me këto udhëzime kërkohet që në ciklin e ulët të shkollimit të mësohen: *vjershat e thjeshta me frymë kombëtare të përshtatshme për të vegjël; Këngë të lehta patriotike të mësueme me kujdes; Kallxime të thjeshta ngjarjesh kombëtare të prallëzueme e të paraqitura gjallëmsht prej mësuesit; Kallëzime të thjeshta rreth jetës e veprave të njerëzvet të përmendun të historisë lokale dhe historisë kombëtare; Legjenda në lidhje me vende e objekte me vlerë historike, që gjenden në krahinën ku vepron shkolla; dhe Manifestime e zbukurime klasësh për ditët e festave kombëtare.*⁴⁶

Edhe për nxënësit e ciklit lëndor jepeshin udhëzime të gjata, të përmbledhura në shtatë kapituj të rëndësishëm, për krijimin e ndjenjës sa më të fuqishme atdhetare tek nxënësit. Lidhur me zhvillimet arsimore në Kosovë njoftohet përherë Ministria. Në një raport të 25 korrikut 1941 mbi aktivitetet arsimore, Misioni i Jashtëzakonshëm i raportonte ministrit E. Koliqi: *Sapo arritëm në Kosovë, e hecëm tanë Kosovën, si pjesën e pushtueme prej trupave italo-shqiptare, ashtu edhe atë prej gjermanëve, e erdhëm në kontakte me autoritetet lokale dhe me popullin për t'i caktue qendrat e kurseve dhe numrin e nxansave për secilin kurs të gjuhës shqipe.*⁴⁷ Në këtë kohë në gjithë Kosovën organizoheshin kurse të gjuhës shqipe dhe forma të tjera të arsimit të të rriturve. Mësoheshin vjersha, recitime, dramatizime dialogësh, këngë dhe gjimnastikë. Kuadri mësimor, që punonte në këto kurse verore, paguhej mirë nga Ministria e Arsimit në Tiranë.

⁴⁶ Pjesë nga përmbajtja e *Qarkores, me disa udhëzime për edukatën patriotike të nxënësve në shkollën fillore*, 15 mars 1944, e nënshkruar nga ministri i Arsimit, Koço Muka.

⁴⁷ Raporti paraprak mbi gjendjen e Kosovës, mbi kurset e gjuhës shqipe e mbi veprimtarinë e Misionit të Jashtëzakonshëm (AQSh, FMA-295, viti 1941, dosja 137, fleta 185).

Vetëm në qytetin e Prizrenit kurset verore i ndiqnin 1 200 fëmijë të moshës 7–12 vjeçare.⁴⁸ Këso kurse organizoheshin anekënd Kosovës. Organizoheshin edhe për gra. Mbaheshin për ata që nuk dinin shkrim e lexim, për mosha të ndryshme.⁴⁹ Sipas dëshmive të kohës, gjuha shqipe filloi të mësohej pothuajse në të gjitha medresetë. Vetëm gjatë vitit 1941 këtë punë e kryenin mbi 150 mësues të ardhur nga Shqipëria dhe 27 mësues nga Kosova. Ata arritën që t’ua mësojnë shkrimin dhe leximin e gjuhës shqipe mbi 28 000 vijuesve të të gjitha moshave. Për çdo vit shtohet nevoja për begatimin e përmbajtjeve programore të punës edukativo–arsimore. Po ashtu, për shkak të rritjes së nevojave për kuadër arsimor, në Kosovë u hapën kurse pedagogjike gjatë verës 1942.⁵⁰ Plani mësimor për këto kurse pedagogjike kishte këto lëndë mësimore: *Gjuhë shqipe: 9 orë në javë; Histori e gjeografi të Shqipërisë: 4 orë në javë; Këngë: 2 orë; Psikologji: 2 orë; Pedagogji: 4 orë; Didaktikë e përgjithshme–didaktikë e veçantë (metodikë): 5 orë në javë; Ushtrime praktike (praktika mësimore): 12 orë në javë; 8 orë hospitime, 2 orë punë e pavarur e kursistit, 2 orë analizë e kritikë për hospitimet.* Provimet përfundimtare mbaheshin para katër komisioneve veç e veç.⁵¹

Në Mitrovicë, më 26 mars të vitit 1942, arrihet një Marrëveshje, me të cilën, pos të tjerash, thuhet: *U arrit marrëveshja që të gjitha shkollat të fillojnë menjëherë punën. Të hapen shpejt shkollat dhe gjimnazet për fëmijët shqiptarë.*⁵² Ishte ky një akt ku zyrtarisht u legalizua shkolla dhe arsimi shqip në pjesën e Kosovës, që ishte nën

⁴⁸ Ibrahim Fehmiu, *Mbyllja e kurseve të para shqipe në Kosovë, puna e kryer dhe detyrat e ardhshme të arsimit*, gazeta Kosova, Tiranë, 1941, nr. 16, f. 4

⁴⁹ Abdylaziz Islami, *Shkollat dhe arsimi shqip në Prefekturën e Prishtinës gjatë periudhës 1941-1945*, Prishtinë, 2003, f. 469

⁵⁰ Sipas Dekret Mëkambësues nr. 43 të 28 shkurtit 1942 të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë

⁵¹ Raport rreth kursit pedagogjik në Prishtinë (korrik-tetor 1942). (AQSh, f. 295, viti 1942, dosja 235, f. 3)

⁵² Arhiv Vonjo-istorijskog Instituta, Krajskomandatura 838, Kosovska Mitrovica, fig. 360-361, 16-III-1942

okupimin gjerman e që solli hapjen e shkollave edhe në fshatrat më të thella malore. Gjatë viteve 1941–1944 në Kosovë kishte arritur të ketë një shtriçje të gjerë e më të zhvilluar rrjeti shkollor, me të gjithë pasojat e së kaluarës së rëndë. Shqiptarët e Kosovës iu përveshën punës me zell për sigurimin e lokaleve për shkolla dhe për kuadrot që do të punonin në shkollat e sapohapura.

Në shkollat që ndërttoheshin, përveç lokaleve të mësimi, kishte edhe lokale banini për mësuesit.⁵³ E rëndësishme ishte që në to grumbulloheshin nxënësit dhe ata të shkolloheshin në gjuhën amtare. Kudo nëpër shkollat e kësaj periudhe, me rastin e festave kombëtare, pranë tyre zhvilloheshin aktivitete kombëtare: akademi, që fillonin me këndimin e himnit kombëtar, për të vazhduar pastaj me shfaqjen e programeve të larmishme, siç ishin recitalet, skeqet e deri te koncertet, përgatitur nga nxënësit dhe arsimtarët. Ishin shumë të theksuara në këto programe recitimet e vjershave me përmbajtje patriotike.⁵⁴

Shkollat e kësaj periudhe i përshkonte fund e krye një frymë e patriotizmit. Mësohej për kombin, për flamurin, për vendlindjen, për Shqipërinë. Ish—nxënësit e shkollave të kësaj kohe tregojnë edhe sot se mësimi gjithmonë fillonte dhe mbaronte me këndimin e himnit të flamurit. Vëmendje u kushtohej luftërave të popullit shqiptar për pavarësi. Në këto shkolla lartësoheshin personalitetet e shquara të lëvizjes sonë kombëtare, si: Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Shotë dhe Azem Galica etj.⁵⁵

⁵³ AJ, f. MP, f. 464; d. br. 485/20-IV-1929 (Objektet shkollore të kësaj periudhe do të mund të ndaheshin në tri grupe: shkollat që ishin ngritur gjatë viteve 1918-1941; objektet e institucioneve fetare, siç ishin xhamitë, vakëfet e lokalet e tjera të tyre; dhe lokalet e meremetuara e të adaptuara nëpër shtëpi private).

⁵⁴ Shih rrëfimin e një bashkëbiseduesi në veprën e prof. dr. Abdullah R. Vokrrit, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)*, Prishtinë, 1990.

⁵⁵ Hakif Bajrami, *Rrethi i Llapit gjatë viteve 1941-1944*, Prishtinë, 1975, punim i mbrojtur i magistraturës.

Dyert e shkollave të Kosovës të parët i hapën mësuesit që erdhën nga Shqipëria.⁵⁶ Gjatë viteve 1915–1918 erdhi një numër simbolik, për t’u shtuar dukshëm gjatë viteve 1941–1944 dhe për të vijuar më së shumti gjatë viteve 1946–1948. Është e vështirë të jepet saktësisht numri i tyre, por besohet se numri i përgjithshëm kalonte shifrën 700. Por, pak vite më pas rrethanat e mira e të favorshme për mësimin e gjuhës shqipe do të ndryshojnë. Kur Jugosllavia titiste, në vitin 1948, i prishi marrëdhëniet me ish-BRSS–në dhe me vendet e Evropës lindore, dhunshëm dëboi nga Kosova 714 mësimdhënës të ardhur nga Shqipëria. *Këta mësues u zëvendësuan me mësues serbë e malazezë. Pjesa dërrmuese e tyre ishin mësues të pakualifikuar.*⁵⁷

1.2. PERSPEKTIVA E RE PËR SHQIPTARËT E KOSOVËS, HAPJA E SHKOLLAVE SHQIPE E VITIT 1941

Pas kapitullimit të Jugosllavisë së vjetër, në Kosovë *italianët e gjermanët shtruan nevojën e ngutshme të ngritjes së pushtetit të ri.*⁵⁸ Ky administrim lejoi përdorimin e gjuhës shqipe në administratë shtetërore dhe në shkolla. Kështu që, arsimi u përdor si instrument për t’i kënaqur ndjenjat kombëtare të shqiptarëve. Lejimi i hapjes së shkollave shqipe, në të cilat do të mësonin mbi 90 % e popullsisë analfabete, u prit mirë.

Një dritë shprehe për shkronjat shqipe dhe shqiptarët e Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare nën Jugosllavi filloi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fillimi i vitit shkollor 1941/42 solli gëzim të madh për

⁵⁶ Musa Kraja, Mati Logoreci, Tiranë, 1987, f. 29. (Duke nisur nga Mati Logoreci me të vëllanë, Pashkon. Derisa Mati hapi shkollën e parë shqipe në Prizren (1888), Pashkoja shkoi në Gjakovë, për të hapur edhe atje shkolla shqipe, si mësuesit e parë profesionistë, që vunë gurin e themelit të arsimit të Kosovës).

⁵⁷ Abdullah R. Vokri, Ibrahim Kolqi, mësues dhe patriot, Prishtinë, 1993, f. 118-119

⁵⁸ Ali Hadri, *Lufta Nacional Çlirimtare në Kosovë, 1941-1945*, Prishtinë, 196, f.134

fëmijët shqiptarë dhe për të gjithë arsimdashësit. Në shkollat në gjuhën shqipe, në Kosovë mësimdhënia zhvillohej sipas tri planeve dhe programeve mësimore, varësisht nga zonat okupuese të pushtuesve.

Gjatë periudhës 1941 deri në vitin 1944 pjesa më e madhe e territorit të Kosovës i takonte pushtimit italian, andaj në shkollat fillore në këto zona mësimi zhvillohej *sipas planeve dhe programeve mësimore të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë*.⁵⁹ Në këtë periudhë historike, plani mësimor i shkollës fillore ishte i planifikuar të jetë pesëvjeçar (pesëklasëshe).⁶⁰

<i>Lëndët mësimore</i>	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>V</i>
1. Gjuhë shqipe	14	14	14	13	13
Gjithsej	14	14	14	13	13

Tabela 1. *Fondi i orëve mësimore sipas Planit mësimor të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë*⁶¹ për gjuhë shqipe, 1941–1945

Në shkollën shqipe rëndësi të veçantë i është kushtuar mësimin të gjuhës shqipe si lëndë mësimore. Ishte kjo përpjekja e dytë institucionale e mësimin të gjuhës shqipe, që duket të jetë themeltare për arsimin shqip në Kosovë.

<i>Mësimet e gjuhës</i>	<i>Klasat</i>				
	I	II	III	IV	V
Zhvillim germash	4	—	—	—	—
Shkrim e këndim	5	5	5	4	4

⁵⁹ Abdylaziz Islami, *Arsimi në gjuhën shqipe në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë, 2001

⁶⁰ Sipas këtij Plani, për gjuhën shqipe nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë ishte paraparë një fond orësh mësimore, 13 dhe 14 orë në javë për nxënësit shqiptarë të Kosovës.

⁶¹ AQSh, Fondi 295, dosja 112

Rrëfime e kallëzime	2	2	2	1	1
Ushtrime të të folurit	2	1	1	1	1
Recitim	1	1	1	1	1
Hartim	—	2	2	3	3
Diktim	—	2	2	—	—
Ortografi	—	1	1	3	3
Gjithsej orë/javë	14	14	14	13	13

Tabela 2. *Lënda e gjuhës shqipe për nxënësit e shkollës fillore pesëklasëshe ishte ndarë në tetë lëmenj mësimorë. Fondi i orëve mësimore sipas lëmenjve.*⁶²

PËRFUNDIM

Historia e arsimit të Kosovës gjatë viteve 1941–1944 aktivitetet arsimore i ka zhvilluar në shumë dimensionë. Vetëm në vitin 1941 llogaritet që në këto kurse kanë kaluar rreth 28 mijë vjues të moshave të ndryshme. Sipas shënimeve arkivore, në vitin 1942 veprimtarinë arsimore në gjuhën shqipe e zhvillonin rreth 174 shkolla pesëklasëshe, që është bazament i shkollës shqipe në këto troje. Punën mësimore në këto shkolla e zhvilloi kuadri mësimor prej 359 mësuesish. Punën mësimore në këto shkolla e zhvilloi kuadri mësimor prej 359 mësuesish. Në 174 shkolla fillore shqipe gjatë vitit shkollor 1941/42 mësimet i ndoqën 15 988 nxënës, prej të cilëve vajza 3 132. Viti i dytë i punës dhe i veprimtimit të shkollës fillore shqipe, në krahasim me vitin shkollor 1941/42, ishte në shkallë më të lartë. Krahasuar me vitin shkollor 1941/42, në vitin e dytë shkollor 1942/43 ishte rritur numri i nxënësve të shkollave fillore për 4.52, numri i shkollave fillore për 65, ose 27.19 % dhe numri i mësuesve për 231. Në vitin shkollor 1942/43 punuan gjithsej 239 shkolla fillore shqipe. Në këto shkolla mësimet i

⁶² Sipas Qarkores së Ministrisë së Arsimit nr. 971-118, datë 13. VI. 1941

zhvilluan 590 mësues (prej tyre 92 mësues) me gjithsej 25 544 nxënës (20 513 meshkuj, ose 80.4 % dhe 5 031 vajza, ose 19.6 %). Rrethanat e pasigurisë dhe të trazirave të luftërave e të çrregullimeve të ndryshme shoqërore u reflektuan edhe në jetën e punës shkollore gjatë vitit shkollor 1943/44. Në këtë vit shkollor, në krahasim me vitin e kaluar, paraqitet një zbritje e numrit të nxënësve prej 25 544 në 20 846, ose për 4 698 nxënës dhe numrit të shkollave prej 239 në 221, ose 18 shkolla fillore më pak. Në periudhën 1941–1944 në Kosovë dhe në Maqedoni për herë të parë në historinë e arsimit shqip u hapën dhe funksionuan 12 shkolla të mesme dhe profesionale në gjuhën shqipe, në të cilat ishin përfshirë 848 nxënës (721 meshkuj dhe 127 vajza).⁶³

Tekstet mësimore të kësaj kohe kryesisht ishin hartuar nga Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Rexhep Krasniqi, Ahmet Gashi, Karl Gurakuqi, etj. Rol të veçantë në mesin e shkollave të Kosovës së kësaj periudhe kishte Shkolla Normale “Sami Frashëri”. Këto vite të shkollimit në gjuhën shqipe hapën portat e zhvillimit të arsimit në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore.

⁶³ Po aty f. 70

NEBI DER VISHI*Universiteti i Tetovës***SHKOLLAT SHQIPE NË STRUGË
E RRETHINË (1941–1944)**

Fati i një kombi dhe ardhmëria e tij qëndron në duart e arsimimit të brezit të ri. Pajisja e rinisë me ide të shëndosha dhe sidomos të gjalla, i siguronë kombit një jetë të gjatë e një të ardhme të shkëlqyer, duke i rezervuar atij një vend meritë në piedestalin e kombeve të qytetëruara.

Edhe pse jemi një ndër kombet më të lashta në Evropë që civilizimin dhe historinë e tij e ngriti mbi vlerat e mirëfillta kombëtare, duke shërbyer si burim gllabërimesh dhe si kult stoik ku çdokush mundohet të përvetësojë pjesët më të vyera të tij, përsëri identitetin e ruajtëm edhe pse me shumë mund dhe sakrificë.

Nuk ka dyshim se, pavarësisht nga rrethanat politike–ushtarake, pavarësisht nga situata ekonomike, në një moment të caktuar, një popull a një komb, fatet e veta, perspektivën e vetë, më shumë se ç’do gjë, i ka të lidhura me nivelin e arsimit e të kulturës kombëtare.

Edhe popullatën e qytetit të Strugës me rrethinë dallgët e historisë e kanë hedhur nga një pushtim në pushtimin tjetër, gjatë epokave të ndryshme historike. Në vitet 1918–1941, atë e gjeti të pushtuar nga Mbretëria S.K.S (Mbretëria e Jugosllavisë). Gjendja e popullatës shqiptare ishte tepër e vështirë. Sistemi dhe aparati shtetëror ushtronin dhunë të pandërprerë ndaj popullatës civile, shqiptare të pambrojtur.

Për t’i realizuar idetë e tyre shkombëtarizuese dhe asimiluese në Strugë dhe rrethinë u hapën disa kurse dhe shkolla në gjuhën serbe. Kjo mënyrë e shkollimit të shqiptarëve nga ky rajon, konsiderohej

si zhdukje përfundimtare e elementit reaksionar shqiptar që në djep, pra që në moshën fëmijërore dhe kalitja e tyre me ide proserbe. Por, edhe pse nën forcën e dhunës, edhe ky synim i qarqeve sllave, u pa se po dështon, pasi idetë nacionaliste tek shqiptarët ishin të pranishme më shumë se kurrë.

Niveli i shkollimit në Strugë e rrethinë ishte tepër i ulët, dhe si rezultat i kësaj, analfabetizmi ishte dukuri e cila ishte e përhapur në më se 98% e popullsisë së kësaj krahine. Kjo shihej qartë edhe nga sigurimi i kuadrit vendas, ku në listën organike të arsimit në këto vite (1941 – 1944), mund të inkuadroheshin vetëm dy struganë (Belul Efendiu Kadiu—Jusufi dhe Mehmetali Hoxha).

Të gjitha këto detyra dhe obligime, të cilave iu mëshua fort, i'u dhanë arsimitarëve kryesisht nga Elbasani, Korça, Pogradeci, Durrësi, etj. Emrin e bukur e kuptimplotë misionar të arsimit në mjedisin mikpritës struganë, të etur për emancipim shoqëror, për flamur të Skënderbeut e për Shqipërinë etnike, vlera këto që u'a lehtësuan barrën e përgjegjësisë qytetare e profesionale, ata jo vetëm që i përmbushën, por edhe i tejkaluan.

Hapja dhe shtrirja e shkollave shqipe në Nënprefekturën e Strugës u kondicionua sa nga numri i paktë dhe i papërshtatshëm i lokaleve ekzistuese, aq edhe nga mungesa e mjeteve financiare të domosdoshme për ngritjen dhe meremetimin e objekteve të tjera.

Në shumë fshatra me popullsi homogjene shqiptare objektet shkollore ose mungonin ose ishin lënë të papërfunduara nga qeveria e Beogradit, e cila me politikën e saj diskriminuese privoi shqiptarët dhe privilegjoj pakicat serbe të vendosura këtu.

Në rrethana të tilla barra më e rëndë i mbeti pushtetit lokal, Bashkisë së Strugës dhe 12 komunave të tjera, por pati fshatra që shfaqën dëshirë për ndërtimin e shkollave sipas udhëzimeve që do t'u jepeshin. Bashkia e qytetit të Strugës mezi gjeti një ndërtesë private për shkollë, afër lagjes ortodokse, kurse objekti ekzistues me

dy kate e dhjetë auditorë mbahej arbitrarisht nga ushtria italiane, e më pas, për disa muaj, edhe nga ajo gjermane.

Për këto arsye, viti shkollor 1941/42 filloi jo në shtator, por aty nga mesi i dhjetorit, megjithëse vendimi i takon datës 1 tetor të vitit 1941.

Shkollat e para shqipe u hapën në Strugë (“Kongresi i Manastirit”), në Labënishtë, në Livadhi, në Belicë të Poshtme, në Radohozhdë, në Veleshtë, në Ladorishtë, etj. Gjatë këtij viti shkollor u angazhuan 16 mësues, midis tyre tri femra, të cilët edukonin e arsimonin në gjuhën shqipe 895 nxënës, nga këto 338 femra. Shkollat në Livadhi (11 dhjetor 1941), në Koroshishtë (7 maj 1942) dhe Kalishtë (11 maj 1942), i hapën dyert vetëm për vogëlushët e klasës së parë, me klasa paralele kolektive. Me cikël 4 – 5 vjeçar punonin shkollat e Belicës së Poshtme dhe Rodohozhdës (I – IV), Strugës e Labënishtës.

Të gjitha shkollat fillore ishin të përziera, me një epërsi të dukshme të meshkujve. Probleme të mëdha kishte shkolla “Kongresi i Manastirit” në Strugë, e cila pothuajse e kishte të pamundur për të përballuar dhe përfshirë numrin e madh të nxënësve, ndërkaq për kushte më të mira mësimi u veçuan shkollat në Belicë të Poshtme dhe në fshatin Radohozhdë.

Në këto shkolla, klasat nga e dyta në të pestën, u krijuan me ata nxënës që kishin ndjekur shkollat fillore katërvjeçare sllave. Duke u ndalur rreth këtij fenomeni specifik, revista “*Shkolla Shqiptare*”, shpjegon: “Ndoshta këto klasa nuk mund të përkojnë me ato që kanë kryer të rinjtë në shkollat sllave, p.sh., një fëmijë që ka mbaruar klasën e tretë do të ndjekë mësimet e klasës së dytë, në qoftë se shihet se nuk mund t’i ndjekë si duhet mësimet e klasës së tretë, por në disa raste mund edhe të ndjekë klasën e vet rregullisht. Kjo punë mbetet në dorë të arsimitarit të ndërgjegjshëm që gatuan brumin e arsimit. Kështu kanë me u kryer klasa të rregullta”.

Nga sa shihet, formimi i klasave përbënte një problem të komplikuar, veçanërisht të vështirë për mësuesit kursistë. Klasat përmblihdnin grupmosha të ndryshme, brenda kufijve të Ligjit mbi Arsimin Fillor të Detyruar, nga 6 deri në 15 vjeç. Mësuesi u la i lirë të vendosë vet, në përputhje me nivelin e perspektivën e secilit nxënës, nëse “x” apo “y” prej tyre do të ndiqte këtë apo atë klasë.

Në vitin shkollor që pasoi, 1942/43, dora-dorës, gjeografia e shkollave pësoi ndryshime në Strugë. Kështu, shkolla të reja u hapën në Koroshishtë (7 maj), në Kalishtë (11 maj), në Borovec, në Podgorcë (22 dhjetor “Iljaz Podgorca”), e në vitin 1943 në Frëngovë e Dollogozhdë. Në shkollën e fshatit Veleshtë, gjatë vitit shkollor 1942/43, frekuentonin edhe fëmijët e fshatit Dobovjan. Numri i mësuesve dhe i nxënësve në 12 shkollat arriti përkatësisht në 28 mësues (8 femra) dhe 1381 nxënës, prej të cilëve 439 femra. Pra, krahasuar me vitin e parë shkollor, numri i nxënësve u rrit për 1,5 herë.

Edhe pse në rrethana lufte e varfërie të skajshme, këto shkolla mbijetuan me sakrifica të shumta. Por, pas kapitullimit të Italisë fashiste (8 shtator 1943) dhe me vendosjen në Shqipëri të pushtetit të ri, nazifashizmit gjerman, situata politike dhe ekonomike u përkeqësua më tej.

Ndërkohë, Bashkia e Strugës harxhoi 16 mijë franga shqiptare për meremetimin e shkollës së qytetit, të dëmtuar nga ushtria gjermane.

Për mungesë lokalesh ishte në dilemë, së paku deri në fund të shkurtit 1944, fillimi i mësimit edhe në fshatrat Veleshtë e Dollogozhdë, ndërsa në Frëngovë dhe Borovec shkollat u mbyllën.

Përveç shkollave fillore, Ministria e Arsimit, më 12 nëntor 1943, dha pëlqimin për hapjen e një shkolle profesionale edhe në Strugë. Ajo, gjatë vitit mësimor 1941/42, nuk kaloi caqet e një kursi gatimor me nxënës që kishin kryer ish shkollën fillore jugosllave. Nëse nxënësit pajiseshin me dëftesa, fitonin të drejtën për të hyrë

në klasat e para të shkollave të mesme që do të hapeshin në vitin shkollor 1942/43.

Arsini parashkollor dhe ai i mesëm u anashkaluan me kërkesa e premtime të ndërsjella nga baza e qendra. Shkolla private dhe të huaja nuk u hapën, ndërsa shkollat fillore serbe të paraluftës, këto vatra antishqiptare, kudo u mbyllën.

Në fshatrat me popullsi joshqiptare, sipas Misionit Shkollor, dikasteri i arsimit mund të dërgonte një ose dy mësues shqiptarë të cilët duhej të mos e njihnin sllavishten, e për vitin e parë të mësohej vetëm gjuha shqipe. Kështu, shkolla nuk do ta humbte vazhdimësinë, shqipja do të hynte menjëherë si gjuhë zyrtare, ndërsa sllavishtja do të fillonte të zhdukej. Pikërisht ky është shqetësimi që e shtyn I. Kalanoskin (maqedonas) të thotë: “Në vitin 1942, në kuadër të denacionalizimit, në Strugë dhe rrethinë u morën masa serioze edhe për organizimin e shkollave ku mësimi duhej të zhvillohej në gjuhën shqipe dhe në frymën e ideologjisë fashiste, ndërsa fëmijët maqedonas, për herë të parë dhe në mënyrë obliguese duhej të regjistroheshin në shkollat shqipe”. Ndërsa në vijim ai shton: “Në disa fshatra të Strugës ka pasur rezistencë rreth hapjes së këtyre shkollave në gjuhën shqipe”, pohim ky që i shkon për shtati autorit për fshatrat me popullsi maqedonase.

Ndryshe nga sa parashikonte Ligji mbi Arsimin Fillor, me qëllim që të krijohej hapësirë më e gjerë arsimimi në gjuhën shqipe, me Dekret Mëkëmbësor, 20 nëntor 1941, vetëm përgjatë dy viteve mësimore (1941/42 dhe 1942/43) u tolerua mosha e pranimit të fëmijëve në klasën e parë fillore, nga mosha 6 – 9 vjeç dhe detyrimi shkollor nga 13 deri në 15 vjeç./ Rrjedhimisht, nxënësit që ishin pajisur me dëftesë lirimi të shkollës fillore katërvjeçare jugosllave, në qershor të vitit 1941 iu nënshtruan klasës së pestë fillore sipas rregullimit shkollor shqiptar. Nga ky detyrim u liruan të gjithë ata nxënës që provonin me dëshmi shkollore të posaçme se kishin ndjekur rregullisht kurset përgatitore pranë shkollave të mesme të themeluara në viset e aneksuara.

Në plan-programet e shkollave fillore shënohen këto lëndë:

1. Gjuhë shqipe (këndim, shkrim, ushtrime të foluri e gramatikë, shkrim e ortografi, hartim);
2. Aritmetikë dhe elemente të gjeometrisë;
3. Njohuri më të rëndësishme nga historia e gjeografia si dhe tema mbi atdheun, kombin, shtetin me rrethin e Perandorisë italiane;
4. Kallzime e lexime me brendi morale e patriotike, njohuri mbi rregullimin e shtetit, detyrat e të drejtat e njeriut dhe të qytetarit shqiptar fashist;
5. Dituri natyre dhe higjienë;
6. Vizatim;
7. Punëdore;
8. Këngë;
9. Edukatë fizike;
10. Bujqësi (në klasë të tretë dhe të katërt, e cila zinte një vend të gjerë në program, në përshtatje me profilin bujqësor të vendit ku ndodhej shkolla).

Siç shihet, programi nuk përfshinte asnjë orë mësimi në gjuhë të huaj, përfshirë dhe italishten.

Mësimi i besimit (religjionit) mund të zhvillohet dy herë në javë, jashtë orarit mësimor dhe vetëm në gjuhën shqipe.

Fillimi dhe struktura e vitit shkollor 1941/42 nuk përkonte me atë të prefekturave të tjera të Mbretërisë Shqiptare (Tiranë, Korçë, Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë e Berat), ku për shkak të gjendjes së luftës (italo-greke) e të veprimeve ushtarake shkollat u mbyllën përkohësisht apo u pezulluan. Ndërsa në këto qarqe viti shkollor i jashtëzakonshëm, 1941 – 1942, zgjati 10 muaj dhe u nda në dy pjesë: 1 shtator 1941 – 15 janar 1942 dhe 1 shkurt 1942 – 30

qershor 1942. Në Nënprefekturën e Strugës ky vit shkollor zgjati 9 muaj. Ai u përpjesëtua në tre tremujorë, duke filluar kah mesi i nëntorit dhe duke përfunduar në fund të qershorit të po këtij viti.

Realizimi i planit mësimor u orientua në dy kufij, në atë maksimal për shkollat në tre fuqi mësimore dhe atë minimal, të reduktuar, për ata me një ose dy të tilla. Duke marrë parasysh veçoritë e këtyre shkollave, Ministria e Arsimit linte në kompetencë të inspektorateve arsimore që për tri vite shkollore të njëpasnjëshme të shpallë rregulla dhe udhëzime tranzitore për zbatimin e programit të mësimin.

“Puna ndryshon krejt në shkollat e atyre qendrave të pakta – tërhiqte vëmendjen “Shkolla Shqiptare” – ku shqipja është varfëruar njaft prej përzierjes së fjalëve turqisht e pak sllavisht. Në shkollat e kësaj dore nuk mund që njëherë për njëherë të aplikohet as programi e orari i lëndëve mësimore të paraprirë për shkollat e tjera e as teknika e zakonshme e çdo mësimi. Prandaj mësuesit që veprojnë në ato, gjenden para një pune krejt të re e njaft të vështirë”.

Niveli i njohurive cenohej jo vetëm nga ky fakt dhe nga defektet e shkollave me klasa kolektive dhe heterogjene, por edhe nga mangësitë dhe vonesat në sigurimin e shpërndarjen e teksteve. Madje, familjet e varfra nuk kishin mundësi t’i blejnë tekstet shkollore për fëmijët e tyre. Vërehej gjithashtu edhe vakumi i plotë i bazës materiale didaktike etj.

Vlerësimi i nxënësve bëhej mbi bazën e sistemit me katër nota: 1– shumë mirë, 2–mirë, 3–njaftueshëm, 4– pamjaftueshëm, çka ndryshonte me atë që thuhej në Ligjin mbi Arsimin Fillor të vitit 1942, ku fiksohej klasifikimi me 10 nota e më e ulëta ishte njëshi.

Drejtimi dhe organizimi i procesit mësimor–edukativ në Nënprefekturën e Strugës kryhej nga Drejtoria Didaktike me titullarë, përkatësisht: M. Bekteshi, Gani Dahi, Mehmet Daihu,

ndërsa në shkolla, nga drejtorët e drejtuesit: F. Pajuni, B. Hoxholli, Dalip Zendeli, Nos Topalli, Hamit Pitja e I. Sejfullai.

Drejtoria Didaktike, me varësi nga inspektoria e Arsimit në Dibër, krahas ndihmës e kontrollit në shkolla, herë–herë organizonte konferenca pedagogjike, kurse për gra, hapte ekspozita me punimet e tyre etj.

Punë e lëvdeshme u krye edhe jashtë shkollës, si në qytet edhe në fshat. Për nga lloji i vet, jehonë të veçantë pati manifestini gjimnastikor që u organizua më 14.V.1942 në Tetovë, me pjesëmarrjen e nxënësve të pesë qyteteve të Prefekturës së Dibrës.

Sipas njoftimeve të publikuara në gazetën “Tomorri”, manifestini zgjati dy orë dhe u ndoq nga 6000 shikues. “Tetova gjëmoi nga kënga dhe britmat që morën dhenë”. (“Tomorri”, 23. V. 1942)

Nuk munguan edhe nisma tjera të bukura e me vlerë patriotike. “Me nxënësit u organizuan shfaqje argëtuese në popull, me qëllim që të lartësohet shpirti kombëtar. Këto shfaqje janë zhvilluar ndër festa e ndër ditë të rastisura e kanë pasur për qëllim për popullin një nxitje edukative njaft të dukshme, sidomos sa i përket rrënjosjes së ndjenjës kombëtare”.

Shfaqje argëtuese iu kushtua edhe përfundimeve të viteve shkollore, zakonisht në muajin qershor.

Nuk mund të kuptohen këto shkolla pioniere pa kontributin kolektiv e shpirtin arsindashës të struganëve e pa karakterin kombëtar të tyre. Historia e këtyre shkollave që hodhën farën e arsimit shqip në Nënprefekturën e Strugës gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, mbajnë nënshkrimin e 70 arsimtarëve që punuan aty në intervale të ndryshme kohore, ndërsa një pjesë gjatë viteve 1941 – 1944, si: Dalip Zendeli, Hasan Belshaku, Gjylhere Belshaku, Faik Pajuni, Hysen Pajenga, Gani Dahu, Telha Çela, Bexhet Hoxholli, Artemisa Hoxholli, Jonuz Balla, Skënder Hoxha, Enver Palluqi, Gjergji Bullti, Theofan Dokja, Erijeta Panduri, Afërdita Mançi, Liri Topalli, Mehmet Dahu, Hysen Hoxha, Eleni

Dasho, Belul Jusufi (Strugë), Nexhip Minarolli, Mustafa Katadri, Pandi Treska, Afërdita Deliana, Dedë Shala, Tefta izgari, Marika Shala, Hamit Pitja, Shpresa Kenzi, Theodora Pisha, Mahmut Torro, Syrija Minarolli, Qemal Matraxhiu, Uran Zaharia, Afërdita Minarolli, Hysen Ekmeçiu, Nos Deliana, Mehmetali Mustafa (Strugë), Afërdita Gjylapi, Vera Xhelo, Fatushe Çerekja, Marie Dashi, Violetë Monçi, Alush Baltëza, Liri Ekmeçiu, Sofika Stavre, Tomor Starova, Agim Shqera, Nos Topalli, Fevra Pisha, Theodor Thoma, Piro Trebicka, Todi Dhamo, Qerim Hoxha, ismail Matraxhiu, Mexhit Bekteshi, Ibrahim Sejfullai, Gani Doni, Dehar Hoxha, Risto Kavaja (Strugë), Sadete Hashimi, Afërdita Goroshnjaku, Sefedin Shahini, Perikle Bebi, Xhafer Narazani etj.

“Në skemën e piramidës së nëpunësve, në shkallë më të ulët qëndronin arsimtarët. Për të lehtësuar deri diku jetën e vështirë ekonomike, kur kishte shtrenjtësi dhe mungesë të theksuar produkteve ushqimore, madje disa të racionuara, edhe një farë shpërblimi nuk iu dha në rregull njësoj e kudo arsimtarëve, gjë që arsyetohej me gjendjen e varfër financiare të bashkive e të komunave”.

Ministria e Arsimit iu rrek këtij problemi dhe në dhjetor të vitit 1941 i bëri të ditur kryesisë së Këshillit të Ministrave: “Duke marrë në shqyrtim të imtë kërkesën rreth gjendjes ekonomike të Kosovës e Dibrës..., që të eci puna e kërkuar me aq zell e flijim, na duhet sot t’u përgjigjemi mundësisht sa më parë nevojave të ngutshme ekonomike në të cilën ndodhen këta mësues. Rroga e tyre e panjaftueshme për përballimin e jetesës ka mbetur e pandryshueshme... Lutemi – vazhdon ajo, që kjo çështje të gjejë zgjidhje të shpejtë e të mundshme në favor të arsimtarëve, në analogji me trajtimin ekonomik që do të kenë nëpunësit e administratave të tjera”.

Rreth këtij problemi, me qëllim sensibilizimi të opinionit, u shfaq edhe shtypi i kohës. “Duam me besue – thuhet në artikullin “Struga për arsim” – në atdhedashurinë e shpirtin e sakrificës së

tyre si dhe bujarinë e bashkisë, për ata të qendrës, të katundeve për mësuesit e vet, për me u dhënë përkrahjen e pakursyer jo vetëm si në vitet e kaluara, por edhe më të madhe në lidhje me shtrenjtësinë e jetesës.

Megjithatë, ata u shquan si mësindhënës e edukatorë, veprimtarë e propagandues të çështjes kombëtare, përkrahës të luftës antifashiste, duke lënë kështu një emër dhe imazh të pashlyeshëm të misionarit të shenjtë, të atyre që e hodhën farën e arsimit në trevën e Strugës e më gjerë.

Dhe me të drejtë gazeta “Tomorri”, do të prononcohet: “Një vit pune i mësuesve të këtyre anëve, duhet të shkruhet me shkronja të arta në jetën e këtyre vendeve”.

Pushtimi fashist i vendit, siç dihet, u shoqërua jo vetëm me terror e dhunë të egër, por dhe me një tok masash në thelb demagogjike, siç ishin “bashkimi” nën një çati shtetërore i pjesës më të madhe të trojeve etnike, në një kohë që vetë shteti shqiptar kishte pushuar së qëni subject i pavarur, hapja e shkollave dhe gazetave shqipe, mësimi e përdorimi i lirë i gjuhës shqipe, etj.... Të gjitha këto krijuan një gjendje të re; madje në disa aspekte, përfshi këtu edhe arsimin, me kushte mjaftë lehtësuese e favorizuese në raport me regjimin e mëparshëm të Karagjorgjeviqëve. Por, pikërisht këtu qëndronte edhe kompleksiteti i situatës së krijuar, nga kuptimi I së cilës do të varej shumë ecuria e proceseve historike, orientimi dhe përcaktimi i rrugës që do të ndiqnin shqiptarët për të realizuar aspiratat kombëtare.

Në rrethanat e krijuara ishte e nevojshme të sigurohej parasëgjithash një kuptim i drejtë i thelbit të ndryshimeve të ndodhura në vend, për të arritur pastaj në një ndërgjegjësim e angazhim të popullsisë shqiptare në procese politike që ndikonte momenti historik.

Në situatën e krijuar dy elementë thelbësorë historikë e politikë evidentoheshin në mënyrë të qartë. Politika shkombëtarizuese e ndjekur për dekada nga shovinistët serbë kishte goditur rëndë

arsimin, gjuhën dhe kulturën shqiptare. Shqiptarët si popullsia më e diskriminuar në mbretërinë jugosllave, ishte privuar dhe nga e drejta elementare e shkollimit në gjuhën amtare. Tani shtrohej detyra urgjente që masat e marra nga okupatori, pavarësisht nga qëllimet dhe objektivat që synonte ai, të shfrytëzoheshin maksimalisht nga subjekti shqiptar, të gjuhës, të historisë e të kulturës kombëtare, duke pasur parasysh se ato përfaqësojnë tiparet thelbësore të një kombi, elementet bazë, pa të cilat nuk mund të rrojë e të përparojë një komb, nuk mund të realizojë aspiratat e veta kombëtare.

Por, në momentin e dhënë, vetëm kjo nuk mjafton. Popullsia shqiptare dhe subjekti politik shqiptar që vepronte në këtë rrafsh duhet të kuptonin e të ndërgjegjësoheshin se në momentin aktual para tyre shtrohej dhe një detyrë tjetër po kaq e madhe e patriotike, organizimi dhe pjesëmarrja aktive në Luftën Antifashiste. Këto detyra primare, që ushqenin dhe fuqizonin njëra tjetrën, duheshin trajtuar e realizuar në unitet të pandarë dhe në funksion të zgjedhjes së çështjes kombëtare. Pikërisht në këtë kuptim, me përgjegjësi nisën përpjekje intensive të forcave arsimdashëse, por edhe atyre politike, për organizimin e arsimit shqip dhe hapjen e shkollave shqipe në “viset e liruar”. Këto përpjekje çuan shpejt në rezultatin e shumëpritur.

Qysh në vjeshtën e vitit 1941 nisi hapja e shkollave shqipe në Prefekturën e Dibrës (Strugë, Dibër, Kërçovë, Gostivar e Tetovë). Kështu shumë shpejt u krijua një rrjet i gjerë shkollash fillore e më pas edhe të mesme. Për koordinimin e punës u krijua një komision i jashtëzakonshëm enkas për “Viset e liruar”, që ndiqte hapjen, kompletimin dhe funksionin e shkollave dhe kurseve në gjuhën shqipe. Për kushtet e atëhershme, pjesëmarrja në shkolla e kurse ishte mjaft e mirë. Sipas të dhënave, në kohën e pushtimit, në viset e “liruar” u arrit të organizoheshin 173 shkolla fillore në gjuhën shqipe, tri shkolla të mesme dhe disa gjimnaze të ulëta. Në këto

kishte gjithsej 267 paralele ku mësimin e zhvillonin 264 mësues dhe 13.665 nxënës (*A.Hadri, Lëvizja NÇ, 116*).

Hapja e shkollave shqipe shtroi nevojën e plotësimit me kuadrin e nevojshëm arsimor, i cili në këto vise ishte i pakët e pamjaftueshëm. Kësaj nevoje ju përgjigjën, veç kuadrove vendase, dhjetëra mësues të ardhura nga vise të ndryshme të Shqipërisë, nga Elbasani, Shkodra, Korça, Gjirokastra, Tirana, Pogradeci, Kruja e Burreli, Vlora e Durrësi.

Kështu, më 6 korrik 1941 u nis nga Tirana për në Dibër (që ishte caktuar edhe qendër e administratës së Prefekturës) një komision arsimor, rreth të cilit u mbledhën 42 arsimtarë që do të punonin në viset shqiptare në Prefekturën e Dibrës. (*Musa Kraja, “Mësuesit për kombin shqiptar”, Tiranë, 1993, fq.441*). Më 8 korrik Komisioni i përbërë nga Kol Gashi, Mexhit Bekteshi, Patër Elezi nga Elbasani dhe Selim Aliu zhvilloi mbledhjen e parë nën drejtimin e zëvendës-kryetarit Emin Çomo. Më pas erdhi këtu edhe fadil Repishti që ishte kryetar i grupit. Entuziazmit dhe interesimit të banorëve, mësuesit e ardhur nga Shqipëria ju përgjigjen me një punë këmbëngulëse e plotë pasion për organizimin e zhvillimit të shpejtë të arsimit shqip, për zgjerimin e numrit të nxënësve të shkollave. Në zonën e Kërçovës, gjithashtu u organizua e u gjallërua jeta mësimore e kulturore në mjaft shkolla, në mesin e të cilave nisi të dallohej shkolla “Kastriotët” ku punonin mësuesit Mahmud Dumani, Violeta Kote, Antoneta Sherko (*Po aty*). Mësuesit pishtarë të ardhur nga Shqipëria u pritën me nderime e entuziazëm edhe në Tetovë, Gostivar, Dibër dhe në Strugë. Mësuesit e apasionuar si Faik Pajuni, Skender Hoxha, Enver Paluqi, hysen Panjenga, gjylhere e Hasan Balshaku, Telha Çela, Mehmet Dahi, Dalip Zeneli, Skender Tupe, Nexhip Minarolli, todi dhamo, tomor Starova, Bexhet Hoxholli, Qemal Haxhihasani, Dhimitër Fullani, Myrteza Kacadej, pavlina Frashëri, etj. Që nisën punën në këto vise u bënë figura të dashur e të respektuar për shkak

të angazhimit e të përkushtimit në organizimin mbi baza kombëtare të shkollave shqipe.

Mësuesit e ardhur nga Shqipëria ju përgjigjen menjëherë apelit të forcave politike e arsindashëse. Në këtë ndërmarrje fisnike ata u frymëzuan nga ndjenjat patriotike, nga preokupimi për fatet e kombit për të ardhmen e vendit. Shumica e mësuesve të ardhur këtu ishin dhe veprimtarët të dalluar, shoqëror, me një eksperiencë dhe në fushën e organizimit politik, të fituar në përpjekjet për organizimin e rezistencës antifashiste në Shqipëri. Madje një përpjekje për organizimin e rezistencës antifashiste në Shqipëri. Madje një pjesë e mirë e tyre kishin ardhur këtu me orientim të Lëvizjes Antifashiste nacionalçlirimtare, të armatosur dhe me platformën e saj atdhetare. Kjo ua shtonte atyre përgjegjësit dhe mundësit për të milituar në radhët e popullsisë shqiptare këtu, të etur jo vetëm për dije e kulturë, por dhe për liri e pavarësi.

Kuadri arsimor i ardhur nga Shqipëria shfrytëzoi dhe mjeshtri detyrën e mësuesit për të forcuar tek nxënësit ndërgjegje kombëtare. Në shkollë atyre u flitej për historinë, traditat, të shkuarën e lavdishme, për luftërat e pareshtura të popullit për liri e pavarësi. Flitej gjithashtu dhe për gjendjen e rëndë në të cilën vendi nën pushtimin fashist dhe nevojën e organizimit të Luftës Antifashiste kundër tij. Gradualisht, me rritjen e ndërgjegjes revolucionare, nxënësit filluan të aktivizoheshin në kryerjen e detyrave të caktuara, si korrierë e ndërlidhës, në shpërndarjen e trakteve e në gjurmimin e spiunëve, në shoqërimin e ilegalëve e në grumbullimin e informative. Edhe mbledhjet e prindërve shfrytëzoheshin për të propaganduar idetë dhe qëllimet e Luftës Antifashiste.

Me punën e palodhur e vetëmohuese të kuadrit të ardhur nga Shqipëria e të kuadrit vendas, u arrit që shkolla shqipe të bëhej një vatër e zjarrtë e arsimit dhe edukimit të brezit të ri dhe një qendër e lëvizjes revolucionare e nacional-çlirimtare. E vetëdijshme për misionin dhe detyrat që kishin, shkolla diti të organizohej e të

organizohej drejt një rezistence aktive kundër regjimit të pushtimit. Kjo rezistencë gjeti shprehje fillimisht në kundërshtimin e programeve politike e të aktiviteteve kulturore me karakter e përmbajtje fashiste, për t'u vënë më pas në ballë të demonstratave e të përleshjeve me forcat pushtuese. Kjo situatë që bëhej gjithnjë e më konfliktuoze e më dramatike, i shqetësoi së tepërmi organizmat e regjimit kuisling, të cilat u përpoqën ta problematizonin e ta ndryshonin me abatimin e masave të rrepta ndaj mësuesve e nxënësve. Kështu, Ministria e Arsimit, me qarkoren e lëshuar më 16 prill 1943 u kërkonte prindërve të nxënësve që të ndikojnë tek fëmijët e tyre, “për ta shpëtuar shkollën–shpirtin e kombit” (*AQSH Fon. Ministria e Arsimit, Qarkore, dt. 16.04.1943*). Kurse në një qarkore tjetër të lëshuar më 09.VII.1943, ajo urdhëronte në mënyrë të prerë që “nxënësit nuk duhet të merren me politikë por t'i përqendrojnë fuqitë e veta në mësim” (*po aty, qarkore e Ministrisë së Arsimit, dt. 9.VII.1943*).

Nga ana tjetër, organet e dhunës, në lidhjen e tyre, ndiqnin me vëmendje punën e shkollave dhe goditnin herë pas here arsintarët dhe punonjësit e arsimit, që dyshoheshin se zhvillonin veprimtari kundër regjimit të pushtimit. Kështu, në janar të vitit 1943 Ministria e Punëve të Brendshme njoftonte Ministrinë e Arsimit se “autoritetet e sigurimit në Dibër kanë arrestuar inspektorin e arsimit të atjeshme, z. Beqir Kaçi, masi është vërtetuar se zhvillonte aktivitete antifashiste”. (*AQSH, Fondi 252, viti 1993, dos, 164*).

Por, këto masa nuk lëkundën e nuk dobësuan veprimtarinë atdhetare e revolucionare të mësuesve patriotë e të nxënësve të tyre, e për rrjedhojë ato nuk mundën ta largojnë dot shkollën nga rruga e zgjedhur, nga rezistenca dhe lufta e vendosur kundër pushtuesit fashist. Madje në këtë rrugë ajo shkroi faqe të reja heroizmi, duke pasuruar kështu traditat atdhetare e revolucionare në vitet e luftës së Dytë Botërore.

Në Nënprefekturën e Strugës u hapën shtatë shkolla fillore të ciklit pesëvjeçar, me klasa me mosha të përziera, të gjitha me kuadër të

ardhur. Këto shkolla filluan të funksionojnë në një hark kohor prej fundit të muajit nëntor e fillimit të muajit dhjetor të vitit 1941, si: shkolla “Kongresi i Manastirit” në Strugë, shkollat në fshatrat Ladorisht, Radohozhdë, Belicë e Poshtme, Veleshtë, Labënishtë dhe në Livadhi. Gjatë vitit 1942 u hapën shkollat në Koroshishtë (7 maj), në Kalishtë (11 maj), në Podgorcë (22 dhjetor) e Borovec. Gjatë vitit 1943 u hapën shkolla edhe në Frëngovë e Dollogozhdë.

SHKOLLA “KONGRESI I MANASTIRIT” – STRUGË

Shkolla “Kongresi i Manastirit” në qytetin e Strugës ishte shkollë pesëklasëshe, e hapur aty nga fundi i muajit nëntor 1941. Në vitin e parë shkollor 1941/42 shkolla punoi me këtë kuadër arsimor: Faik Pajuni (drejtor), Alipi Pajuni, Gjergji Ballati, Hasan Belshaku, Gjylhere Belshaku, Hysen Pajenga, Alush Baltëza dhe Mahmut Torro.

Në vitin shkollor 1942/43 në këtë shkollë mësimet i zhvilloi ky kuadër arsimor: Dedë Shala, Marije Shala, Afërdita Gjylapi, Antoneta Gjylapi, Telha Çela, Mehmetali Mustafa (nga Struga), Mehmet Dahi (drejtor i shkollës).

Më 3 janar 1944, drejtori didaktik i Strugës, Mehmet Dahi, në bashkëpunim me Bashkinë e Strugës, siguruan lokalin shkollor në ndërtesën e rojës kufitare me shtatë ambiente mësimore. Në vitin shkollor 1943/44, për shkaqe tanimë të njohura, mësimi filloi aty nga fundi i muajit janar të vitit 1944, me këtë kuadër arsimor: Dedë Shala, Alush Baltëza, Telha Çela, Mahmut Torro, Hysni Ekmexhiu, Liri Ekmexhiu, Dalip Zendeli, Artemisi Hoxholli, Violetë Monçi, Fatushe Çerekja, Marije Dashi, Liri Topalli (edukatore), Erijeta Pandi (edukatore), Tefta Izgari (edukatore) dhe Bexhet Hoxholli (drejtor i shkollës).

Në kuadër të shkollës “Kongresi i Manastirit”, në vitin shkollor 1943/44 punojnë (funksionojnë) edhe tri paralele me mësim parashkollor.

SHKOLLA PROFESIONALE (ZEJTARE) NË STRUGË

Këshilli Administrativ i Ministrisë së Arsimit në Tiranë, më datë 4 shkurt 1944, me vendim nr. 7, vendosi që në qytetin e Strugës të hapet një shkollë profesionale, duke hapur vetëm klasën e parë në vitin shkollor 1943/44, me 19 nxënës, e cila fillon me mësimet më 21 shkurt 1944.

Nxënësit e kësaj paraleleje mësimet i zhvillonin pranë shkollës “Kongresi i Manastirit”, ndërkaj drejtimi i saj në fillim iu ngarkua drejtorit të Shkollës “Kongresi i Manastirit”, Bexhet Hoxhollit, kurse mësues në këtë paralele ka qenë Dedë Shala.

Drejtori Bexhet Hoxholli, krahas detyrës së drejtuesit dhe sekretarit të shkollës, mbante edhe 10 orë mësim nga lëndët gjuhë shqipe, histori, gjeografi, gjeometri, shkenca, vizatim, muzikë e gjimnastikë.

Sipas disa njohurive të pakonfirmuara, në qytetin e Strugës kishte funksionuar një shkollë profesionale që në vitin 1941/42, drejtor i së cilës ka qenë Ibrahim Sejfullahu, që ka pasur të kryer shkollën normale në gjuhën turke në Manastir në vitin 1912.

KURSI PËR GRA NË QYTETIN E STRUGËS

Me nismën e drejtorit didaktik të Strugës, Gani Dahiut, më 22 shkurt 1943 ishte hapur një kurs për gra në qytetin e Strugës me qëllim që të luftohej analfabetizmi në mesin e femrave. Për të rritur numrin e vijueseve të kursit, e sidomos të pjesëmarrjes të femrës të përkatësisë fetare ortodokse, drejtori didaktik Gani Dahiut, e kishte paraparë edhe arsimin funksional të femrës shqiptare, përkatësisht mësimin dhe aftësimin e saj që, krahas shkrim–leximit si dhe të nxënies së gjuhës shqipe, të mësojë edhe zejen e rrobaqepësisë (prerje–qepje). Mësimet në këtë kurs filluan rregullisht më 1. 3. 1943.

Mësimet zhvilloheshin me nga dy orë mësimore çdo ditë: një orë shkrim–lexim të gjuhës shqipe dhe një orë i dedikohej zëjes së prerje–qepjes. Mësimi i punëdores bëhej në interval kohor nga ora 15 deri në orën 16, kurse i shkrim–leximit dhe gjuhës shqipe zhvillohej në interval kohor 16 h – 17 h.

Mësimin e gjuhës shqipe e mbanin mësueset Gjyllhere Belshaku dhe Marie Shala, ndërkaq mësimet e punëdores (prerje–qepje), e mbante mësuesja Vera Xhelo, e cila kishte kryer një shkollë zëjtare pesëklasëshe për prerje–qepje.

Për organizimin dhe mbarëvajtjen e këtij kursi ndihmoi edhe paria e Strugës e cila grumbulloi shumën prej 1344 frangash shqiptare, si dhe siguroi inventarin (makinat qepëse) dhe një lokal të përshtatshëm në qendër të qytetit. Mësueset Marie Shala dhe Gjyllhere Belshaku e mbanin mësimin e gjuhës shqipe secila nga 5 orë në javë.

SHKOLLA FILLORE “VELESHTA” – VELESHTË

Shkolla fillore “Veleshta” në Veleshtë është hapur në ditët e para të muajit dhjetor të vitit 1941. Në vitin shkollor 1941 – 42, mësues i parë ka qenë Skender Hoxha nga Elbasani, i cili që më 23 tetor 1941, nga inspektorati i Elbasanit, urdhërohet me transfer për në fshatin Veleshtë, ndërkaq në vitin shkollor 1943/44, mësues pranë kësaj shkolle kanë qenë: Nexhip Minarolli, Shpresa Kenxho dhe Ferda Pisha.

Edhe pranë shkollës fillore në Veleshtë u organizuan kurse për të rritur. Kursi për rininë e mbetur jashtë shkollës si të tejmoshuar përfshinte djemtë e rritur që u kishte kaluar mosha për t’u përfshirë në shkollën fillore si të obliguar sipas ligjit.

Në vitin shkollor 1942/43 në shkollën e Veleshtës u organizuan dy kurse dhe atë: kursi i parë që fillon më 21.11.1942 dhe mbaron më 15.2.1943, me dy paralele; dhe kursi i dytë i cili fillon më 15.2.1943 dhe përfundon më 15.6.1943, poashtu me dy paralele.

Rreth organizimit të këtyre dy kurseve për të “moshuarit”, të dhënat janë nxjerrë nga raporti që drejtori i shkollës fillore në Veleshtë, Hamit Pitja, ia dërgon Ministrisë së Arsimit në Tiranë më 1943. Sa i përket numrit të nxënësve, të dhëna kemi vetëm për vitin shkollor 1942/43, kur shkolla numëronte 187 nxënës (133 meshkuj e 54 femra).

SHKOLLA FILLORE “LADORISHTI” – LADORISHTË

Shkolla fillore në fshatin Ladiorishtë fillon me punë aty nga mesi i muajit dhjetor 1941. Mësuesi i parë ka qenë Theofan Dokja, ndërkaq në vitin shkollor 1943/44 mësues kanë qenë: Qemal Katraxhiu dhe Sofika Stavre.

Rreth numrit të nxënësve në vitin e parë shkollor nuk kemi të dhëna, ndërsa në vitin që pason (1942/43) numri i nxënësve ka qenë 94 (79 meshkuj dhe 15 femra). Në vitin shkollor 1943/44 janë evidentuar vetëm 5 nxënës.

SHKOLLA FILLORE NË LABËNISHTË

Shkolla në Labënishtë fillon me punë në fillim të muajit dhjetor të vitit shkollor 1941/42, me pesë klasa, dhe përfundon më 29. Vi. 1942 me 277 nxënës të regjistruar (180 meshkuj dhe 97 femra). Mësuesit pishtarë në këtë fshat kanë qenë Dalip Zendeli dhe Nexhip Minarolli nga Pogradeci.

Në vitin shkollor 1942/43 në shkollën e Labënishtës ka punuar ky kuadër arsimor: Nos Deliana nga Elbasani, Afërdita Deliana dhe Uran Zaharia gjithashtu nga Elbasani, ndërkaq numri i nxënësve ka qenë 221, prej të cilëve 88 femra.

Pranë shkollës fillore në Labënishtë, që në verën e vitit 1941, për dy muaj rresht, është mbajtur kursi i gjuhës shqipe nën kujdesin e mësuesit pishtar Dalip Zendeli.

SHKOLLA FILLORE NË RADOHOZHDE

Shkolla fillore në Radohozhdë u hap në dhjetor të vitit 1941. Në vitin e parë shkollor (1941/42), mësuesit e parë kanë qenë Jonuz Balla e Nos Topalli nga Elbasani. Ky i fundit punoi deri në fund të vitit shkollor 1943/44.

Numri i nxënësve në këtë shkollë ka qenë: 1942/42 – 153 nxënës (69 femra); 1942/43 – 103 nxënës (48 femra); dhe 1943/44 vetëm 23 nxënës.

SHKOLLA FILLORE NË BELICË TË POSHTME

Shkolla fillore në Belicë të Poshtme është hapur në dhjetëditëshin e parë të dhjetorit 1941. Që në fillim të vitit shkollor 1941/42 në këtë shkollë u formuan 4 klasa me 78 nxënës (14 femra), ndërkaq mësuesi i parë ka qenë Perikli Bebija. Në vitin shkollor 1942/43 numri i nxënësve ka qenë 54, prej të cilëve 17 kanë qenë femra. Në këtë shkollë ka punuar edhe mësuesi Todi Dhamo. Në vitin shkollor 1943/44 numri i nxënësve në këtë shkollë arrinte në 19.

SHKOLLA FILLORE “LIVADHIA” NË LIVADHI

Shkolla e parë shqipe në fshatin Livadhi u hap më 11 dhjetor 1941, me një klasë në vitin e parë, me 43 nxënës (14 femra e 29 meshkuj). Mësuesi i parë ishte pishtari i arsimit në këto anë Enver Palluqi, i biri i Begirit, i lindur në Elbasan në vitin 1918. Ai punoi në këtë shkollë deri në fund të vitit shkollor 1943/44.

Në vitin shkollor 1942/43 në kuadër të shkollës kishte një paralele të kombinuar me klasën e parë e të dytë me gjithsej 57 nxënës (40 meshkuj e 17 femra), ndërsa në vitin 1943/44 numri i nxënësve u zvogëlua në 11.

Mësuesi Enver Palluqi pranë kësaj shkolle hapi edhe kursin për të moshuarit. Kursi i parë nisi me punë më 14 dhjetor 1941 dhe përfundoi më 31 dhjetor 1942, ndërsa kursi i dytë filloi më 14 janar 1943 dhe përfundoi më 25 qershor 1943.

SHKOLLA FILLORE NË KOROSHISHTË

Edhe shkolla e Koroshishtës hapet në vitin shkollor 1941/42, por për shkaqe objektive mësimi fillon me një vonesë të madhe (më 7.V.1942) dhe vazhdon gati gjatë tërë verës së vitit 1942. Mësues i parë ishte korçari Pandi Treska, i cili punon edhe dy vitet e ardhshme. Numri i nxënësve në këtë shkollë ka qenë si vijon: 1941/42 – 38 nxënës (12 femra); 1942/43 – 44 nxënës (12 femra); dhe 1943/44 vetëm 13 nxënës.

SHKOLLA FILLORE “ILJAZ PODGORCA” NË PODGORCË

Shkolla fillore “Iljaz Podgorca” në Podgorcë u hap më 21 dhjetor 1942 me 113 nxënës (38 femra), me kuadër mësimor Tomorr Starova e Theofan Dokja. Në vitin shkollor 1943/44 numri i nxënësve ra në 27 vetë.

Edhe në fshatin Podgorcë, në kuadër të shkollës fillore “Iljaz Podgorca”, u organizua kursi për zhdukjen e analfabetizmit për të moshuarit, numri i të cilëve, në fillim, më 21 dhjetor 1942, arrinte në 71 vetë, por deri në fund të kursit, më 31 maj 1943, numri i tyre mbeti vetëm 43. Edhe kursin me të moshuar e mbanin mësuesit pishtarë Tomorr Starova nga Pogradeci dhe Theofan Dokja.

SHKOLLA FILLORE NË FSHATIN KALISHTË

Edhe shkolla fillore në fshatin Kalishtë u hap gjatë vitit shkollor 1941/42, por me një vonesë shumë të madhe, më 11 maj 1942, prandaj ajo punoi deri në fund të gushtit, me 36 nxënës (11 femra), me mësuesin e parë Skender Tupja. Në vitin shkollor 1942/43 numri i nxënësve ka qenë 42 (11 femra), ndërsa në vitin shkollor 1943/44 numri i tyre ra në 12 vetë, ndërsa mësues ka qenë Mehmedali Mustafa.

Historia e këtyre shkollave është pjesë e historisë së përgjithshme të popullit shqiptar. Nuk mund të thuhet se këtu, në të kaluarën, s'ka pasur përpjekje për ta vështruar shkollën shqipe në lidhje me rrethanat e ngjarjet politike. Por, përpjekje të tilla, zakonisht, ishin të pamundura, sepse regjimi i egër serb nuk lëshonte kurrësi pe. Megjithatë, vargjet e famshme të Naimit të madh çdo herë mbetën prezentë:

Gjuha jonë

Sa e mirë, sa e ëmbël,

sa e gjerë, sa e lehtë,

sa e lirë, sa e bukur,

sa e vlerë.

Nuk mund të kuptohen këto shkolla pioniere pa kontributin kolektiv e shpirtin arsimdashës të struganëve, pa karakterin kombëtar.

Historia e këtyre shkollave që shpërthyen në Strugë e gjetiu, në rrethanat e Luftës II Botërore, mbajnë nënshkrimin e 73 arsimtarëve që punuan në këtë krahinë, në intervale kohore të ndryshme, të cilët u shquan si mësimdhënës, veprimtarë e propagandistë të çështjes kombëtare, duke lënë kështu gjurmë e imazhin e pashlyeshëm të misionarit. “Një vit pune e mësuesve të këtyre anëve, – nënvizonte gazeta “Tomorri”, – duhet të shkruhet me shkronja të arta në jetën e këtyre vendeve”, jo vetëm të tyre, shtoj unë, por edhe në historinë e shkollës shqipe.



Mësuesit në Strugë dhe rrethinë 1944



Shkolla fillore "Kongresi i Manastirit" – Strugë 1942–1943



*Shkolla fillore "Livadhi"–Livadhi 08.VI.1943,
me mësues Enver Palluqi nga Elbasani*

MARENGLEN VERLI

Qendra e Studimeve Albanologjike – Tiranë

SHEMBULL NGA HISTORIA E SHKOLLAVE SHQIPE NË PRESPË NË VITET 1942–1943

Historia e arsimit është një nga aspektet më të rëndësishme të historisë sonë, që ka rol të veçantë, madje të pazëvendësueshëm, në Lëvizjen Kombëtare që nga shekulli XIX. Për një rol të tillë të arsimit kombëtar në momente të caktuara, veçanërisht në momente rilindjeje, dëshmon historia e çdo kombi. Dhe nuk ka dyshim se pavarësisht nga rezultatet ushtarake dhe politike, pavarësisht nga situata ekonomike në një moment të caktuar, një popull a komb, fatet e veta, të ardhmen e vet, më shumë se çdo gjë i ka të lidhura me nivelin e arsimit e të kulturës kombëtare, të cilat janë bazë e vetëdijes dhe e pjekurisë së tij. Një komb i shtypur politikisht, një komb me ekonomi të dobët, i ka të gjitha shanset të rifitojë të drejtat e veta dhe të zhvillohet nëse nuk i ndal përpjekjet për të qenë së pari një komb i arsimuar dhe i kulturuar. Arsimi e kultura kombëtare është i vetmi bastion që s’duhet lëshuar kurrë, sepse pas tij nuk ka më ku të bëhet qëndresë, sepse po u thye ai vjen humbja e identitetit, vjen asimilimi dhe harresa. Ja përse studimi i historisë së arsimit dhe të shkollës shqipe, në etapat e ndryshme të zhvillimit dhe në momentet specifike të Luftës së Dytë Botërore, në një region po kaq specifik si ai i Prespës, përbën një kontribut jo vetëm në rrafshin shkencor por edhe kombëtar, që s’duhet të anashkalohet nga historiografia.

Deri më sot historia e arsimit shqip ose hapja e shkollave shqipe në rajonin e Prespës në vitet e Luftës, çka përbën objektin e kësaj kumtese, nuk është marrë në studim posaçërisht. Problemet, pengesat ose arritjet në këtë rajon nuk janë vënë në dukje. Sidoqoftë, para se të flitet në këtë plan të ngushtë duhet paraqitur

një pasqyrë e gjendjes së arsimit në kuadrin e përgjithshëm të Kosovës e më gjerë për vitet përkatëse, si edhe të dhënat më të domosdoshme për përbërjen etnike të trevës së Prespës.

Dihet se në vitet 1918–1941 popullsia shqiptare, që jetonte në trojet e veta etnike të përfshira në Mbretërinë e Jugosllavisë, ishte e privuar nga e drejta e arsimimit në gjuhën shqipe. Sipas të dhënave të kohës, në vitin e fundit të ekzistencës së atij shteti, përkatësisht në vitin shkollor 1940–1941, në viset shqiptare funksiononin rreth 370 shkolla, prej të cilave 265 shkolla ishin në Kosovë⁶⁴. Të gjitha shkollat i zhvillonin mësimet vetëm në gjuhën serbe, mësuesit dhe mbi 70 për qind e nxënësve ishin sllavë. Për pasojë në një territor të populluar asokohe në masën rreth 70 për qind nga shqiptarë, ose ku popullsia shqiptare arrinte në 800–900 mijë banorë, shkollat i ndiqnin jo më shumë se 14–15 mijë nxënës shqiptarë. Madje numri i tyre në shkollat e mesme ishte aq i pakët sa llogaritej vetëm në 2 për qind të nxënësve të këtyre shkollave. Numri i përmendur i nxënësve shqiptarë ndoshta mund të dyfishohet nëse merren parasysh edhe fëmijët që ndiqnin arsimin fetar në mejtepe dhe në medrese, por as aty mësimi nuk zhvillohej në gjuhën shqipe, pa përmendur më tej se niveli i njohurive që merrnin nxënësit e mejtepeve ishte shumë i ulët⁶⁵.

Pas kapitullimit të Mbretërisë Jugosllave, në prill të vitit 1941, në situatën e re të krijuar në territoret shqiptare të Kosovës të pushtuara nga Italia dhe Gjermania, duke filluar nga muaji nëntor e në vijim, u hapën 173 shkolla fillore, rreth 18 për qind e të cilave në zonën gjermane, si edhe disa shkolla të mesme me gjithsej 268 paralele, 264 mësues dhe 13 665 nxënës⁶⁶. Flitet për hapjen edhe të 68 shkollave të tjera në viset e Strugës, të Dibrës, të Tetovës e të

⁶⁴ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 642, dos.368, fl.1-5; A. Hadri, *Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941)*, “Gjurmime Albanologjike”, nr.2, 1968, Prishtinë, 1969, f.184.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ M. Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë, 1977, f.23.

Gostivarit, që gjithashtu ishin nën pushtimin italian, ku shërbenin rreth 150 mësues dhe ndiqnin mësimet 4 677 nxënës⁶⁷. Nëse të dhënat e fundit do të merren të sakta, del se në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nën pushtimin italian dhe gjerman u hapën 235 shkolla fillore dhe 15 shkolla të mesme, të cikleve të ulëta e të larta të marra së bashku, ku shërbenin 414 arsimtarë dhe mësonin 18 342 nxënës të rregullt, pa llogaritur edhe dhjetëra kurse për zhdukjen e analfabetizmit dhe arsimimin e të rriturve⁶⁸.

Burimet që kemi pasur mundësi të konsultojmë na informojnë për situatën arsimore në trevat shqiptare lindore të pushtuara nga Italia, përkatësisht të Prefekturës së Dibrës (pas gushtit të vitit 1944 të prefekturave të Dibrës e të Tetovës), por nuk lejojnë të konkludojmë nëse është pasur parasysh edhe nënprefektura e Prespës (Carev–Dvorit), e cila ishte e lidhur administrativisht me Prefekturën e Korçës. Një arsye e dytë për paqartësinë është se në Prespë, për mungesë kuadri, shkollat nuk u hapën në të njëjtën kohë me shkollat e viseve të sipërpërmendura, por vetëm në marsin e vitit 1942. Në këtë mënyrë ato mund të mos jenë përfshirë në numrin e shkollave që funksionuan fillimisht në vitin shkollor 1941–1942. Sidoqoftë, pavarësisht nëse shkollat e Prespës janë llogaritur ose jo në statistikat ende të pafiksuara, që pasqyrojnë gjendjen e arsimit shqip në “viset e lirume” pas prillit të vitit 1941 deri në vitin 1944, për këtë rajon me tipare njaft specifike nuk ka

⁶⁷ *Po aty*. Të dhënat e autorit janë nxjerrë nga ditari i Sadullah Zenelit - Dajes (Nyrbo - Suedi, 1995).

⁶⁸ *Po aty*, f.24; Sipas M. Kodrës, *Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1944)*, Kumanovë, 1966, f.89, më 17 nëntor të vitit 1941 në Dibër, Strugë, Kërçovë, Gostivar dhe Tetovë, fillimisht punonin 114 arsimtarë. Sipas këtij autori, deri në qershor të vitit 1942, vetëm në Tetovë, Gostivar dhe në Kërçovë ishin hapur 32 shkolla fillore, punonin 73 arsimtarë dhe frekuentonin shkollat rreth 10 mijë nxënës, duke përfshirë në këtë numër edhe kursistët kundër analfabetizmit. Gjithashtu përmendet hapja e një gjimnazi në Tetovë me 65 nxënës dhe e 4 shkollave profesionale në Gostivar, Kërçovë, Dibër e Strugë; Shih dhe “Fletorja Zyrtare”, Tiranë, 21 nëntor 1941, 25 nëntor 1941.

pasur ndonjë studim të veçantë. Të dhënat e mëposhtme besojmë se do të shërbejnë sadopak për ndriçimin e problemit.

Popullsia shqiptare e brigjeve lindore të Ohrit dhe të Prespës deri në vitet e Luftës së Dytë Botërore nuk kishte pasur rast të arsimohet në gjuhën amtare as në mënyrë masive e as në mënyrë të organizuar. Nuk është vendi të përmenden këtu shkaqet që penguan zhvillimin e arsimit shqip në këtë rajon gjatë periudhës së sundimit osman dhe më pas gjatë sundimit bullgar e serb. Këto shkaqe janë pak a shumë të njohura. Ajo që vlen të përmendet është se në sajë të përpjekjeve të atdhetarëve shqiptarë të fushës së arsimit të viseve të Korçës dhe të Manastirit, si edhe të dëshirës së madhe të banorëve shqiptarë të rajonit për t'u arsimuar në gjuhën amtare, pati në radhët e këtyre të fundit që mësuan spontanisht të lexonin e të shkruanin në gjuhën shqipe. Një gjë e tillë është vënë re vite më vonë konkretisht në krahinën e Prespës, të cilën e zgjodhëm si një territor specifik për të pasqyruar hapjen e shkollave të para shqipe pas vitit 1941⁶⁹.

Në vitin 1941, në rrjedhat e Luftës së Dytë Botërore, pas kapitullimit dhe copëtimit të Mbretërisë Jugosllave, 32 fshatra të Prespës u aneksuan nga Italia. Të organizuara në një nënprefekturë me qendër në Carev-Dvor, ato u lidhën administrativisht me Prefekturën e Korçës. Pykëzimi bullgar në Ohër e shkëputi këtë territor të ish-Banovinës së Vardarit nga lidhja e drejtpërdrejtë me viset më në veri të aneksuara nga Italia, të cilat u përfshinë në prefekturën e Dibrës⁷⁰. Sidoqoftë problemet ishin të njëjta, duke përfshirë edhe çështjen e arsimimit të popullsisë, po ashtu edhe veprimet për zgjidhjen e tyre. Veçse, ndryshe nga viset e Prefekturës së Dibrës, ku shkollat e para shqipe u hapën qysh në

⁶⁹ Kujtime të arsimtarëve të viteve 1942-1943 në nënprefekturën e Prespës, mbledhur nga autori.

⁷⁰ M. Kodra, *vep. e perm.*, Kumanovë, 1996, f.55-72.

vitin shkollor 1941–1942, shkollat në Prespë u hapën pak më vonë, për mungesë të kuadrit të nevojshëm mësimdhënës⁷¹.

Mendojmë se është e nevojshme që, para se të ndalemi në problemën e arsimit në Prespë, të japim disa të dhëna të përgjithshme për këtë nënprefekturë. Së pari, nënprefektura e Prespës ose e Carev–Dvorit, sipas emrit të qendrës së saj, ishte më jetëshkurtra prej njësisë administrative që u krijuan në “viset e lirume”. Ajo pushoi së ekzistuari pjesë–pjesë në korrik–shtator të vitit 1943, kur fshatrat që e përbënin kaluan nën kontrollin bullgar⁷². Së dyti, Prespa ishte ndër viset që kishin pësuar më shumë ndryshime në përbërjen etnike të popullsisë gjatë shekullit të fundit. Të 32 fshatrat e saj, sipas statistikës së vitit 1941, të organizuara në 3 komuna, kishin 13 179 banorë, prej të cilëve 3 084 banorë ose 23,4 për qind ishin shqiptarë. Komuna e Qendrës ose e Carev–Dvorit përfshinte 14 fshatra me 4 482 banorë, prej të cilëve 572 ose 12,7 për qind ishin shqiptarë. Komuna e Podmoçanit përfshinte 10 fshatra me 3 618 banorë, prej të cilëve 1418 ose 39,2 për qind ishin shqiptarë. Komuna e Lubonjës përfshinte 8 fshatra me 5 079 banorë, prej të cilëve 1 094 ose 21,5 për qind ishin shqiptarë⁷³. Të gjithë banorët, si shqiptarët edhe maqedonët, merreshin kryesisht me bujqësi, blegtori e pjesërisht edhe me peshkim⁷⁴.

Të dhënat e vitit 1941, duke i krahasuar me të dhëna më të hershme, dëshmojnë se popullsia shqiptare në Prespë po shkonte prej vitesh drejt pakësimit, qoftë si rezultat i asimilimit, qoftë për shkak të shpërnguljes së banorëve të nxitur në vitet ‘20–‘30 me gjithfarë njetesh nga autoritetet serbe, që synonin shkom–bëtarizimin dhe serbizimin e këtij rajoni. Sipas statistikave osmane të vitit 1908 dhe disa shënimeve statistikore të vitit 1930 në rajonin

⁷¹ Kujtime të arsimtarëve të viteve 1942–1943 në nënprefekturën e Prespës.

⁷² M. Kodra, *vep. e përm.*, f.64–65.

⁷³ *AQSh*, Fondi: Zyra Qendrore e Statistikës, viti 1941, dos.71, dok.107–116.

⁷⁴ *Po aty*, dos.68, fl.75.

e Prespës së paku 1/3 e popullsisë ishte shqiptare⁷⁵. Madje në vitet e fundit të sundimit osman kjo përqindje duhet të ketë qenë më e lartë, por ishte reduktuar në mënyrë fiktive për shkak të kriterëve të kryerjes së regjistrimeve nga administrata e kohës. Statistikat osmane, ashtu dhe ato bullgare të kësaj periudhe pohojnë se popullsia maqedone (“bullgare” – sipas dokumentacionit) nuk përbënte veçse diçka më tepër se gjysmën e popullsisë të marrë në tërësi, ndërkohë që dihet se rajoni përgjithësisht është i banuar vetëm prej këtyre dy grupeve etnike⁷⁶.

Sipas të dhënave të vitit 1930, në 32 fshatrat e sipërpërmendura të Prespës shqiptarët ishin të pranishëm në 14 fshatra (Asomat, Arvat, Bellocerkë e Epërme, Bellocerkë e Poshtme, Carev-Dvor, Dermen, Gerçan, Kranjë, Koziak, Kazhan, Nakolec, Podmoçan, Sapocke, Çarshovë) dhe në tërësi përbënin 1/3 e popullsisë, në këto 14 fshatra përbënin 56 përqind të popullsisë (539 shtëpi shqiptare nga 961 shtëpi gjithsej)⁷⁷. Pikërisht në disa prej këtyre fshatrave do të hapeshin për herë të parë në historinë e krahinës shkollat e rregullta shqipe.

Me shtrirjen e arsimit shqip në Kosovë dhe në viset shqiptare lindore, të përfshira në zonën italiane të pushtimit që nga prilli i vitit 1941, organet kompetente të arsimit në Tiranë planifikuan hapjen e shkollave edhe në nënprefekturën e Prespës⁷⁸. Por ndërsa

⁷⁵ *Po aty*, Fondi: Koleksion dokumentesh para vitit 1912, viti 1908, dos.699, fok.2.5; *Po aty*, Fondi: Ministria e Punëve të Jashtme, viti 1930, dos.194, dok.165-169.

⁷⁶ *Po aty*, Fondi: Koleksion dokumentesh para vitit 1912, viti 1908, dos.699, dok.2-5.

⁷⁷ *Po aty*, Fondi: Ministria e Punëve të Jashtme, viti 1930, dos.194, dok.168.

⁷⁸ Zonat e pushtimit u fiksuan në takimin e 21-24 prillit në Vjenë midis Ribentropit dhe Çianos. Më 17 maj të vitit 1941 Musolini vendosi aneksimin e Maqedonisë Perëndimore, kurse Françesko Jakomoni këtë e zyrtarizoi me dekretin e 12 gushtit. Sipas regjistrimit të vitit 1941 (*AQSh*, Fondi: Zyra Qendrore e Statistikës, viti 1941, dos.68, dok.75-105) në gjithë viset e aneksuara nga Italia shqiptarët përbënin rreth 70 përqind të popullsisë. Në zonën e aneksuar nga Gjermania mbetën rreth 100 mijë shqiptarë. Kurse në zonën e aneksuar nga

në viset e tjera shkollat u hapën që në vjeshtën e vitit 1941 (ndonëse pa një datë të njëjtë, por sipas mundësive), prefektura e Korçës mundi ta plotësojë kuadrin e nevojshëm arsimor që u dërgua në Prespë vetëm nga fundi i shkurtit ose fillimi i marsit të vitit 1942⁷⁹. Ai përbëhej kryesisht nga të porsadiplomuarit në shkollat pedagogjike të specializuara, si nga Instituti Femëror i Tiranës “Nana e Skënderbeut” (ish shkolla “Nana Mbretneshë”) dhe nga Shkolla Normale e Elbasanit.

Në harkun kohor 1941–1942 në shkollat e sipërpërmendura u realizuan dy vite mësimore për të plotësuar kohën e humbur në vitin shkollor 1940–1941, kur mësimet u ndërprejnë për shkak të situatës së krijuar nga lufta italo–greke. Kështu të porsadiplomuarit, pasi kryen vitin e fundit të studimeve në vjeshtë – dimrin e vitit 1941–1942, morën diplomat në fund të shkurtit të vitit 1942 dhe 10 ditë më vonë ishin në krye të detyrës.

Në nënprefekturën e Prespës më 9 mars të vitit 1942 u hapën 5 shkolla fillore të ciklit 5–vjeçar (me klasa me mosha të përziera), të gjitha me kuadër të ardhur, të cilat filluan të funksionojnë njëherësh në Carev–Dvor (qendra e nënprefekturës), në Podmoçan (qendër komune), si edhe në fshatrat Kranjë, Koziak dhe Bellacerkë, me popullsi mbizotëruese shqiptare⁸⁰. Arsimitarët e parë (Ali Dangëllia, Efterpi Avrazi dhe Remziu... në Carev–Dvor, Kozma Gjata, Amali Berberi, Meropi Face, Raqi Grabocka në Podmoçan, Koço Çamçe, Meropi Maliqi, Faik Take, Elisaveta Treska, Rafail Koteli, Maria... etj., në Koziak, Kranje dhe Bellocerkë)⁸¹ shfrytëzuan si objekte

Bullgaria mbetën rreth 150–200 mijë shqiptarë ose dyfishi i numrit të maqedonëve që mbetën në zonën italiane. (Shih: M. Kodra, *vep. e përm.*, f.60, 62).

⁷⁹ Në vjeshtën e vitit 1941 në viset shqiptare të Maqedonisë Perëndimore të përfshira në prefekturën e Dibrës u emëruan 114 mësues (*Fletorja zyrtare*, Tiranë, 21 nëntor 1941), kurse në prefekturat e Kosovës edhe 264 mësues të tjerë (A. Hadri, *Lëvizja nacional-çlirimtare në Kosovë 1941–1945*, Prishtinë, 1971, f.116).

⁸⁰ Kujtime të arsimtarëve të viteve 1942–1943 në nënprefekturën e Prespës. Shih edhe: *AQSh*, Fondi: Ministria e Punëve të Jashtme, viti 1930, dos.194, dok.168.

⁸¹ Kujtime të arsimtarëve të viteve 1942–1943 në nënprefekturën e Prespës.

shkollore ndërtesat e shkollave serbe, të ndërtuara në vitet e ekzistencës së Mbretërisë Jugosllave. Kurse mjetet mësimore u desh të rinovoheshin. Arsimitarët, të gjithë të pajisur me një kulturë të shëndoshë kombëtare e demokratike, u kujdesën veçanërisht për pajisjen e klasave me portretet e Skënderbeut dhe të atdhetarëve të shquar të Rilindjes shqiptare, si vëllezërit Frashëri etj., dhe në raste festash të ekspozimit në mjediset e shkollave të flamurit kombëtar pa shenjat fashiste (sëpatat e Liktorit). Në këtë mënyrë, të pesë shkollat e para shqipe që u hapën në Prespë në vitin 1942 patën një karakter të pastër kombëtar.

Veprimtaria pedagogjike dhe fryma kombëtare e shkollave shqipe të Prespës u forcua në vitin e dytë mësimor 1942–1943, që filloi në vjeshtën e 1942–shit pas pushimeve të shkurtra të arsimtarëve e nxënësve dhe që u zhvillua normalisht deri në gjysmën e dytë të qershorit të vitit 1943. Për këtë ndikuan pozitivisht organizimi i programit mësimor për nëntë muaj, si edhe disa lëvizje kuadri të kryera gjatë këtij viti mësimor (u emëruan rishtas), të ardhur nga nënprefekturat e tjera të Korçës, Gaço e Enrieta Konomi në Carev–Dvor, Bashkim Shkëmbi, Margarita Totokoçi në Podmoçan etj.). Këto lëvizje, ndonëse nuk u shoqëruan me ndonjë rritje të dukshme të numrit të arsimtarëve (u shtua deri më 14–15 numri i tyre), çuan në forcimin e mëtejshëm të punës së shkollës, sepse njëherazi lehtësuan ngarkesën mësimore në shkollat me më shumë nxënës dhe alternuan më mirë punën e arsimtarëve të rinj me ata me përvojë⁸².

Gjatë vitit shkollor 1942–1943 u vu re emërtimi i shkollave me emra kombëtarë⁸³, festimi i ditës së 28 Nëntorit, ditës së Flamurit, festimi njaft i organizuar e me një program të pasur kombëtar i ditës së mbarimit të shkollës ose i ndarjes së dëftesave, si edhe forcimi i propagandës antifashiste⁸⁴. U gjallërua dukshëm puna në

⁸² Po aty.

⁸³ Dimë emrin që iu vu shkollës së Podmoçanit, e cila u quajt “Naim Frashëri”.

⁸⁴ Kujtime të arsimtarëve të viteve 1942–1943 në nënprefekturën e Prespës.

kurset me të rriturit për mësimin e shkrim–këndimit të gjuhës shqipe. Përveç shqiptarëve në këto kurse, sikurse në shkollën e rregullt për të miturit, filluan të jenë gjithnjë e më tepër të pranishëm edhe maqedonët. Sigurisht meritë për këtë zhvillim të shkollës dhe të arsimit shqip në Prespë kishin në radhë të parë arsimtarët, që me aftësitë e tyre profesionale dhe me frymën humane e demokrate që i karakterizonte, u bënë të dashur jo vetëm për popullsinë shqiptare, por siguruan edhe respektin e simpatinë e popullsisë maqedone⁸⁵. Ata neutralizuan propagandën e fuqishme bullgaromadhe, që përpiqej të bindte popullsinë maqedone se ndodhej nën pushtimin shqiptar, duke vënë shenjën e barazimit midis italianëve pushtues dhe shqiptarëve nën pushtim. Arsimtarët u përpoqën të kapërcenin barrierën e gjuhës maqedone. Ata vlerësuan se në të mirë të procesit mësimor e të bashkëjetesës duhej të punonin jo vetëm për t’u mësuar gjuhën shqipe fëmijëve maqedonë, por edhe ata vetë të përvetësonin gjuhën maqedone⁸⁶.

Kështu për 16 muaj që vijoi të ekzistojë shkolla shqipe në Prespë, rreth 400–500 fëmijë, më shumë se gjysma e të cilëve ishin shqiptarë, si edhe dhjetëra të rritur mësuan të shkruanin e të lexonin në gjuhën shqipe⁸⁷. Zbatimi rigoroz i programit të shëndoshë mësimor, jepte njohuri edhe në një sërë disiplinash të tjera të procesit mësimor, si matematika, historia etj. Dhe kryesorja ishte se në kushtet e pushtimit u krijua fryma e mirëkuptimit dhe e bashkëpunimit të frytshëm. Këto suksese të dukshme që u arritën duke kapërcyer një varg vështirësish, përcillnin mesazhe miqësie. Mesazhe të tilla shqiptarët kanë dhënë dhe janë gati të përcjellin gjithmonë. Kërkesa e tyre e vetme është reciprociteti.

⁸⁵ Po aty. Respekti e simpatia e popullsisë maqedonase sikurse kujtojnë arsimtarët veteranë lidhet jo vetëm me veprimtarinë pedagogjike në shkollë, por edhe me qëndrimin gjatë kohës së lirë me pjesëmarrjen në raste gëzimi ose fatkeqësie e deri në raporte miqësore që krijuan disa prej tyre me familjet maqedonase ku ishin strehuar.

⁸⁶ Kujtime të arsimtarëve të viteve 1942–1943 në nënprefekturën e Prespës.

⁸⁷ Po aty.



Shkolla fillore “Naim Frashëri”, Podmoçan (1942–1943)



Nxënëse të shkollës “Nëna Mbretëreshë” (1938)



*Arsintare të diplomuara në shkollën “Nëna Mbretëreshë” (1944)
Në qendër, ulur, Amalia Berberi*



Arsintare shqiptare dhe vajza maqedonase në Podmoçan (1942)

HYSEN MATOSHI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

KONTEKSTI SOCIO-KULTUROR I HAPJES SË SHKOLLAVE SHQIPE (1941)

Hapja e shkollave shqipe në viset shqiptare, të pushtuara nga sllavët e jugut, përkatësisht të Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore, kundruar në formatet e asokohshme shtetërore, u bë në një kontekst të veçantë shoqëror. Në fakt ishte rënia nën sundimin nazifashist të këtyre hapësirave, pra viti 1941, momenti historik që solli ndryshime të mëdha në jetën e shqiptarëve. Ky zhvillim nuk shënonte arritjen e lirisë për shqiptarët, në kuptimin e mirëfilltë të saj, sikundër ka ndonjëherë përpjekje në historiografinë tonë të paraqitet ky ndryshim historik, por gjithsesi ishte një moment i rikthese, pas gati tri dekadash të robërimit nga pushtues që nuk i njihnin as edhe të drejtat më elementare të manifestimit të identitetit kombëtar të popullsisë shqiptare.

Fillimisht dua të ndalem te konteksti i këtij zhvillimi historik në këto hapësira, te fakti se përse nga popullsia shqiptare rënia nën Italinë dhe Gjermaninë nuk u kuptua si një pushtim klasik, dhe përse një zhvillim i tillë nuk mund të kundrohet as edhe si një çlirim i mirëfilltë kombëtar.

E para, ka të bëjë me definimin terminologjik të pushtimit si “rrëmbim të lirisë e të pavarësisë së një vendi”⁸⁸, kuptohet nga një vend a një fuqi ushtarako-politike e jashtme. Ky definim e vë jashtë përkufizimit të këtillë ndërhyrjen e shteteve nazifashiste në hapësirat shqiptare jashtë trungut të shtetit amë. Në kuptimin e mirëfilltë të këtij definimi, pra të pushtimit, sa i përket hapësirës

⁸⁸ Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, redaktor shkencor Jani Thomai, Tiranë, 2006, f. 863.

sonë etnike, mund të flitet vetëm për Mbretërinë Shqiptare, e cila, duke qenë një shtet sovran, fillimisht u pushtua nga Italia e më vonë edhe nga Gjermania. Ky definim qartësisht e kodifikon pushtimin si humbje të lirisë dhe të pavarësisë. Pra, s'do mend se trojet shqiptare nën Mbretërinë Jugosllave tashmë, për më shumë se dy dekada, ishin nën pushtim. Më 1941 mund të thuhet se u ndërrua vetëm pushtuesi, se këto vise ranë nën një sundim tjetër.

E dyta, në perceptimin e masave të gjëra popullore të shqiptarëve “pushtimi” italian, në fakt, u përjetua krejtësisht ndryshe nga pushtimi serbo-malazias i vitit 1912 dhe ripushtimi i tyre pas Luftës së Parë Botërore. Fundi i robërisë absolute sllave u prit me një ndjenjë lehtësimi, ngase popullsia shqiptare deri atëherë ishte e privuar nga të gjitha të drejtat elementare dhe sidomos nga ato të drejta që kishin të bënin me theksimin dhe zhvillimin e veçantive identitare. Njëkohshëm format e represionit, të zbatuara nga pushtuesit sllavë mbi popullsinë autoktone shqiptare, ishin të paimagjinueshme, ndërsa përfshinin vrasje masive, shpronësime, shpërngulje, konvertime me forcë fenë ortodokse dhe në identitetin serb e malazias. Në rrethana të këtilla pushtimi i vetë Mbretërisë Jugosllave nga nazifashistët për shqiptarët ishte suspendim, për njëfarë kohe, i robërisë më të egër që e përjetuan gjatë gjithë historisë së tyre.

Italia fashiste, në mënyrë të veçantë, u përpoq që ta kapitalizonte këtë situatë të re, duke nisur që nga rregullimi administrativ i trojeve etnike shqiptare. Kështu, pjesën më të madhe të Kosovës së sotme dhe pjesë shqiptare të Maqedonisë Perëndimore ia bashkoi Shqipërisë, duke krijuar të ashtuquajturën “Shqipëri të Madhe”, e cila, për hir të së vërtetës, duhet thënë se jo që nuk ishte e madhe, por madje nuk ishte as e përmasave të Shqipërisë etnike, ngase pjesë të tëra të tokave shqiptare, sikurse dihet, mbetën nën sundimin gjerman dhe bullgar, përkatësisht nën shtete të tjera. Ky veprim i sunduesve të rinj, përgjithësisht nga shqiptarët, u përjetua si një lehtësim dhe veçmas njohja e të drejtave, sikundër ishin ajo e

shkollimit në gjuhën amtare, e manifestimit të lirshëm të identitetit kombëtar, organizimi i një administrate lokale të drejtuar nga vendësit dhe me përdorim të gjuhës shqipe etj., për të cilat të drejta, në të kaluarën e afërt, as që mund të bëhej fjalë.

Gjithsesi e tëra kjo nuk ishte një çlirim i mirëfilltë, funksional dhe rezultativ, ngaqë projekti i nazifashistëve nuk ishte çlirimi i kombit shqiptar dhe përmbushja e aspiratave të tij të drejta e historike. Fundja, ky bllok politiko–ushtarak nuk ia ka sjellë lirinë dhe prosperitetin askujt, madje as vetë kombeve në gjirin e të cilëve lindi dhe u zhvillua. Fashizmi, sikundër është e ditur, ishte një e keqe e madhe për mbarë njerëzimin. Rrjedhimisht edhe për shqiptarët. Megjithatë, kjo e keqe aq e madhe ishte shumë më e vogël se sundimi i egër jugosllav i kësaj hapësire. Perceptimi për *“vaktin e Shqipnisë”*, siç njihet në kujtesën popullore, si periudhë e mirë për shqiptarët e këtyre hapësirave, buron nga dallimi i madh ndërmjet qasjes së dy pushtuesve: të parët, sllavët e jugut, kërkonin tokat e shqiptarëve pa pronarët e tyre, pra pa shqiptarë, ndërsa të dytët, italianët e gjermanët, te shqiptarët kërkonin partnerë për realizimin e synimeve të tyre ekspansioniste në Ballkan.

Tanimë është e njohur se disa hapa të sunduesve të rinj ishin tejet jetëshkurtër, ndër ta edhe formati shtetëror që krijuan për shqiptarët, i cili zgjati vetëm pak më shumë se tre vjet. Kjo erdhi si rezultat i ndryshimeve të mëdha të asokohshme në rrafshin e përgjithshëm dhe i krijimit të koalicionit antifashist pothuajse në përmasa globale. Megjithatë, kishte edhe veprime ndikimi i të cilave pati efekte përtej kohëzgjatjes së këtij sundimi. Hapja e shkollave në gjuhën shqipe ishte, pa dyshim, një pikë kthese në historinë e shqiptarëve të këtyre trevave.

Mirëpo, cila ishte pozita arsimore e kulturore e shqiptarëve gjatë pushtimit jugosllav? Deri në këtë kohë shqiptarët përbënin një popullsi dërrmuese analfabete dhe jo gjithaq të ndërgjegjshme në planin kombëtar. Ndonjëri nga shqiptarët e paktë të shkolluar arsinimin dhe dijet mund t’i merrte vetëm në shkollat në gjuhën

serbe. Madje, edhe në shkollat e pakta fetare islame, sikundër kanë qenë dy medresetë shkupjane “Isa Begu” dhe Medreseja e Madhe, e cila për ironi të fatit mbante emrin e Kral Aleksandrit, mësimi zhvillohej në gjuhën serbe. Konteksti social dhe kulturor, në të cilin mezi gjëllinin shqiptarët nën Mbretërinë Jugosllave, ishte i pafavorshëm në secilën pikëpamje: një komb i shtypur pa të drejta themelore nacionale, politike, sociale, ekonomike, arsimore, kulturore, fetare etj., i vënë detyrimisht në kufirin e zhdukjes fizike dhe të zhbërjes së plotë kulturore. Shpronësimet dhe shpërnguljet në vitet 20 dhe 30 mbi popullatën më të nëpërkëmbur në shtetin e atëhershëm jugosllav (por edhe në mbarë Evropën) kishin marrë përmasa tronditëse. Përballë një rreziku të këtille popullata shqiptare nuk kishte as edhe një formë veprimi të organizuar. Nëse nuk do të pasonin zhvillimet historike të Luftës së Dytë Botërore, të cilat i ndryshuan rrjedhat historike edhe në Ballkanin e trazuar, projektet institucionale serbe lidhur me shqiptarët, me premisa të qarta shkombëtarizuese dhe shfarosëse, do të realizoheshin për një kohë të shkurtër. Në kontekst të zhvillimeve të reja, shqiptarët u faktorizuan në disa sfera të jetës, veçmas në atë arsimore, ku u hodhën hapat e parë, por domethënës e larghedhës për etapat e mëpastajme zhvillimore.

Vendimi i Qeverisë shqiptare, 75 vjet më parë, për të dërguar në këto vise qindra mësues të kualifikuar nga Shqipëria londineze ishte jetik për ngritjen arsimore e kulturore të shqiptarëve të mbetur jashtë saj, për fillimin e procesit të kombëtarizimit të këtyre sferave. Në këtë drejtim veçmas vihet në spikamë roli i madh ministrit të Arsimit në Qeverinë e atëhershme shqiptare, Ernest Koliqi⁸⁹, figurë e shquar e kulturës dhe e letrave shqipe.

Për tre vjet të funksionimit të shkollave shqipe në terren u krijua një gjendje tjetër, breza të tërë shqiptarësh mësuan shkrim–leximin në gjuhën amtare, duke krijuar një potencial të rëndësishëm për

⁸⁹ Për më tepër informacion shih Fjalori enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 1211 – 1212.

ecjen e mëtejme në drejtim të krijimit të një sistemi arsimor me zhvillim të qëndrueshëm. Mësimi në gjuhën amtare për shqiptarët ishte një arritje që shkonte përtej rolit të zakonshëm që ka arsimimi. Entuziazmi i madh i krijuar kudo ndër shqiptarët, i nxitur nga ky veprim, vihet në pah më së miri në shkrimin e Peter Elezit⁹⁰, që e parafrizonte popullsinë e Dibrës, sipas së cilës “gjuha ishte tapia e vendit”. Hapja e shkollave në gjuhën shqipe nuk ishte thjesht e vetëm një tapi objektive për gjendjen ekzistuese të hapësirës shqiptare, për më tepër ishte një garanci për të ardhmen e tyre kombëtare.

⁹⁰ Peter Elezi, Në bisedë me gjind që flasin në gjuhë të vet – gjuha asht tapija e vendit, gazeta “Kosova”, 27 shtator 1941, f. 4 - 5. Cituar sipas librit “Tokat e liruara 1941-1944” (Përmbledhje dokumentesh), vëllimi IV, botoi “Logos A”, Shkup – Prishtinë – Tiranë, 2016, f. 142-148. Përgatiti për botim dr. Qerim Lita.

SABILE KEÇMEZI-BASHA

Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

KONTRIBUTI ARSIMOR E ATDHETAR I PROF. YMER BERISHËS NË TOKAT E LIRUARA (1941–1945)

Profesor Ymer Berisha u lind më 13 maj 1912, në fshatin Gjurgjevik i Madh, Komuna e Klinës. Ishte i biri i Shaban Berishës dhe nënës Fazë, e bija e Jetish Tafilit, nga Turiçefci i Drenicës. Familja e profesor Ymer Berisha, është familje e vjetër vendase, e formuar në frymën e traditave patriotike, bujare e mikpritëse, e cila ishte shembull për të mirë⁹¹.

Ymer Berisha, shkollën fillore e kreu në Fushë-Krujë, ndërsa Normalen në Elbasan. Më vonë shkollimin kishte vazhduar në Normalen e Elbasanit. Atje pati fat si mësues ta ketë Aleksandër Xhuvanin, por në një ekskursion të mvonshëm në territoret e Shqipërisë kishte takuar shkollanin nam madh, At Gjergj Fishtën⁹². Pas njohjes me të, në mes tyre u lind një miqsi e sinqert. Duke i ditur biografinë e familjes, At Gjergj Fishta u angazhua që një bursë për të studiuar në Itali t'i ndahej Ymer Berishës.

Ati i urtë dhe i mençur, kishte llogaritur në zgjuarsinë dhe dashurinë e tij të madhe që kishte ndaj atdheut. Bile ka të dhëna se në takimin e

⁹¹ Sabile Keçmezi-Basha, Formimi dhe veprimtaria e Organizatës patriotike ilegale shqiptare “Besa Kombëtare”, Rilindja” Tiranë, 21 maj -22 qershor 1999; Sabile Keçmezi-Basha, Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë 1945-1947, Prishtinë, 1998.

⁹² Emin Fazlija, Hamid Emini- Brunçaj (19.09.1909-16.10.1986) “Doktori” i Maleve të Lirë të Drenicës Dardane, Prishtinë, 2009,249-250; bkdsh.de.tl/**Prof.--Ymer-Berisha**-.htm, 10 nëntor 2016

par , Fishta i kishte thënë dhe e kishte porositur Ymer Berishën: “Të njihja edhe kur s’te kisha njohur, dhe mbi të gjitha ta duash Shqipërinë”.

Ymer Berisha që kur ishte nxënës, nisi të bashkëpunojë me fletushkën e Shkollës – “MËSUESI” dhe atë “NORMALISTI”. Duke mos qenë i kënaqur vetëm me kryerjen e shkollës së mesme, i etur vazhdimisht për dituri, ai shkoi në Itali dhe u regjistrua në Universitetin e Firences, në Fakultetin e Shkencave Natyrore, ku studioi paralelisht Historinë dhe Gjeografinë. Më vonë, studioi edhe në Akademinë Ushtarake në Romë të cilën e kreu, po ashtu, me sukses të shkëlqyeshëm dhe u gradua me gradën e majorit të Ushtrisë këmbësore. Më pas studioi edhe Gjuhën e letërsisë italiane. Ishte njëri ndër studentët më të dalluar të brezit të tij dhe studimet arriti t’i përfundojë me rezultate shumë të larta dhe në kohën e caktuar. Gjatë qëndrimit të tij në Itali, Ymer Berisha asnjëherë nuk i shkëputi lidhjet shpirtërore me Kosovën. Mbante takime të rregullta me student shqiptar dhe në çdo takim bisedonin për situatën e rënduar dhe për fatin e saj në të ardhmen. Vetën e konsideronte një student të përjetshëm, prandaj menjëherë shkoi në Sorbonë të Francës, ku studioi edhe shkencat filologjike⁹³. Nuk dimë sa qëndroi në Universitetin e Sorbonës, por e dimë se, porsa Italia fashiste okupoj Shqipërinë, ai i ndërpreu studimet dhe u kthye në Shqipëri. Edhe pse kishte përfunduar Akademinë ushtarake ai nuk u inkadrua në Ushtrinë Shqiptare, por e filloi punën si mësimdhënës në fshatrat e Fushë-Krujës, Kukësit, Peshkopisë, Lushnjës e Beratit duke menduar se kontakti me nxënës e të rinj do të jep rezultate më të mëdha në aspektin kombëtar.

⁹³ Sabile Keçmezi-Basha, Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë, 1945-1947, Prishtinë 1998, 83

Në bazë të dhënave që kemi, në Kosovë gjatë periudhës së Mbretërisë së karagjorgjeviçëve, nuk kishte funksionuar asnjë shkollë shqipe. Mbi 95% e popullsisë shqiptare ishte analfabete. Duke parë këtë gjendje dhe duke ndjerë nevojën për hapjen e shkollave në gjuhen shqipe me iniciativën e Ministrit të Arsimit, Ernest Koliqi,⁹⁴ i cili me 12 nëntor të vitit 1941 kishte dal me dekretin e veçantë, sipas të cilit në “viset e liruar” duhej hapur një varg shkollash të mesme të profileve të ndryshme⁹⁵. Fillimisht Ministria e Arsimit emëroi 12 mësues. Deri në gjysmën e dhjetorit u paraqitën vetëm shtatë: Ymer Berisha, Lirak Dodbiba, Reuf Zajmi, Zeqir Spahija, Musa Dizdari, Myftar Spahija dhe Filip Ndocaj. Kështu Shkolla Normale filloi punën më 17 dhjetor 1941. Gjatë vitit shkollor 1941/42 u shtuan edhe këta mësindhënës: Llazar Berisha, Abdyrrahman Buza, Adem Bazhdari, Kolë Parubi dhe Ahmet Gashi. Ndërsa drejtor ishte Prof.dr. Rexhep Krasniqi.

Duke parë këtë gjendje dhe duke ndjerë nevojën për hapjen e shkollave në gjuhen shqipe, Ymer Berisha me mësues të tjerë, u hyri punëve për shkollimin e rinisë shqiptare, për organizimin dhe ngritjen e arsimit. Pas hapjes së Gjinnnazit – Normales “SAMI FRASHËRI”⁹⁶ në Prishtinë, prof.Ymer Berisha u inkuadrua si

⁹⁴ Ernes Koliqi (Shkodër, 20 Maj 1903 - Romë, 15 janar 1975) ishte mësues, poet, romancier, eseist, përkthyes, gazetar, madje dhe dramaturg, ministër arsimit në qeverinë Vërlaci, botues dhe pedagog. Cilësohet bashkë me Mitrush Kutelin, si bashkëthemelues i tregimit modern shqiptar sa i përket krijimtarisë, ndërsa në punët politike e arsimore ka meritë për dërgimin e 200 arsimtarëve në trojet e Shqipërisë *së Lirue*me (Wikipedia).

⁹⁵ Arkivi Qendror Shqiptar, F. 295, viti 1941, dok. 235, f.39

⁹⁶ Gjinnnazi “Sami Frashëri” është shkolla e parë e mesme në gjuhën shqipe në Kosovë. Zanafilla e këtij gjinnnazi është kah fundi i shekullit të XIX fillimi i shekullit XX, pra qysh në periudhën e sundimit turk. Kuptohet se në këtë periudhë edhe pse nxënësit dhe arsimtarët ishin shqiptarë, mësimi mbahej në gjuhën turke, sepse pushteti osman i asaj kohe nuk lejonte shkollën në gjuhën shqipe. (Wikipedia)

mësimdhënës, ku ligjëroi dy lëndë: Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe si dhe Historinë. Veç këtyre dy lëndëve ai ligjëronte edhe historinë e gjeografisë së Shqipërisë, dhe në mungesë të kuadrit ai jepte edhe lëndë të tjera. Profesor Ymer Berisha ishte një pedagog i mrekullueshëm, interpretues shembullor i njohurive të thella shkencore, poliglot, njohës i disa gjuhëve që i fliste dhe i shkruante rrjedhshëm, si italishten, frëngjishten, gjermanishten, anglishten, latinishten, greqishten, spanjishten e serbokroatishten, fitoi besimin dhe admirimin e nxënësve dhe të gjithë atyre që arritën ta njohin.

Ai nuk pushonte kurrë. Vazhdimisht studionte, vazhdimisht lëvizte nga një vend në tjetrin duke u marrë edhe me hulumtime arkeologjike. Gërmoi nëpër lokalitete të vjetra, kryesisht në fshatrat e Prekorubës – Drenicë, në Çabiq dhe AçaREV⁹⁷. Gjatë punës hulumtuese gjeti, mblodhi dhe grumbulloi shumë eksponate të kulturës sonë si monedha, armë, vegla pune, stoli, etj. Këtë thesar material dhe shpirtëror të popullit tonë që nga parahistoria, e mblodhi, e sistemoi dhe e studioi duke dëshmuar kështu për lashtësinë e popullit shqiptar, autoktoninë e tij. Mblodhi e shënoi të dhëna historike nga kujtesa e popullit, shumë legjenda, këngë, etj., që dëshmojnë për kulturën, besën, trimërinë, traditën tonë shekullore dhe etnopsikologjinë. Rrëfimet e njerëzve i shënonte besnikërisht, i sistemonte dhe i studionte me kujdes ato kujtime që ishin ruajtur e ishin përcjellë brez pas brezi. Njerëzit me kujtesë të fortë i konsideronte “Arkiva të gjalla që lëvizin”. Dhe pas një pune të gjatë me nxënësit, zemra ia donte që të lidhej me çështjen kombëtare dhe rrjedhën e ngjarjeve bashkëkohore. Shpesh në orët

⁹⁷ Islam Dobra, Prof. Ymer Berisha, (Kryetari Lëvizjes Nacional Demokratike dhe Komandat i Ushtrisë Popullore për Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore, Prishtinë, 2002, 68

e mësimit prof. Berisha iu thoshte nxënësve të vet se “Pa bashkim kombëtar nuk ka zgjidhje të çështjes sonë të përgjithshme”.

Në gjimnazin “Sami Frashëri” të Prishtinës, punoi në vitet 1941–1944⁹⁸. Gjatë tërë kohës ishte i afërt me nxënësit dhe shquhej për taktikën pedagogjike. Kishte ndikim të dukshëm tek ata. U angazhua me tërë qenien e punoi pa u lodhur për realizimin e çështjes së çlirimit dhe të bashkimit kombëtar.

Rastisi që gjatë qëndrimit në Shqipëri të bëhej mik i ngushtë me Kolë Bibë Mirakaj, që ishte ministër në qeverinë shqiptare deri më 1943. Po në këtë vit, me 12 shtator 1943 prof. Ymer Berisha s’bashku me Atë Bernard Llupin, Prof. Kolë Parubin, prof. Gjergj Martinin etj, inicuan në Pejë formimin e organizatës “BESA KOMBËTARE”, ku prof. Ymer Berisha zgjidhet kryetar i saj. “Besa Kombëtare” ishte organizatë që ishte formuar kryekëput kundër ideologjisë komuniste, dhe qëllimi i saj suprem ishte bashkimi i tokave shqiptare⁹⁹. Por, deri në mars të vitit 1945, shumë pak ose fare pak ishte aktive, ndërsa më vonë, sidomos në pjesën e dytë të vitit zhvillon aktivitet të dendur, dhe luan rol të rëndësishëm në ilegalen shqiptare.

Pas aneksimit të Kosovës Serbisë, prof. Ymer Berishën e gjejmë shumë aktiv në organizimin e popullatës si në Drenicë, në Brigadën e Shaban Polluzhës, në Çetën e Uk Sadikut e vende të tjera anë e kënd Kosovës. Qëllimi parësor i prof. Ymer Berishës ishte që të bënte një lidhje me forcat përparimtare të Shqipërisë Veriut,

⁹⁸ Hamdi V. Thaçi, Gjimnazi “Sami Frashri” 1941-1944, Prishtinë 2001,17; Hamdi V. Thaçi & Bislim Krasniqi, Gjimnazi “Sami Frashri” 1941-2006, Prishtinë 2006.

⁹⁹ **Sabile Keçmezi-Basha, Kontributi i shkollës në Lëvizjen Ilegale Patriotike Shqiptare në Kosovë (1945-1947), E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike”, i mbajtur në Shkodër, qershor 2005**

respektivisht me shkodran t ishte n kontakt t vazhdueshëm si me Kol Bib Mirakajn, Pashk Bib Mirakajn, Muharrem Bajraktarin, At Bemard Lllupin, Marie Shllakun, e shumë t tjer q dhan ndihmes t jashtëzakonshme në ilegalen që vepronte në Kosovë dhe n sendërtimin e qëllimeve t saja p r nj Kosov t lir dhe nj Shqip ri t v rtet .

Pas pushtimit të Kosovës më 1944 u arratis në malet e Drenicës dhe nga aty organizoi rezistencën e armatosur kundër pushtuesve të rinj¹⁰⁰. Prof. Ymer Berisha konsiderohet njëri ndër ideologët dhe krijuesit e platformës politike për mbrojtjen e kufijve etnikë të trojeve shqiptare të Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Gjatë tërë jetës së vet ishte luftëtar i denjë kundër fashizmit e komunizmit¹⁰¹. Ai luftonte për Kosovës dhe për të gjitha trojet shqiptare, që ishin të copëtuara padrejtësisht nga shovinistët fqinjë dhe fuqitë e mëdha¹⁰². Rrezikun kryesor e shihte tek shovinizmi serbomadhi, që mbante Kosovën dhe aspiratat e saja nuk përfundonin me aq. Të njëjtin rrezik e shihte edhe në jugun e Shqipërisë, nga shovinistët grekë. Profesor Ymer Berisha njihnte vetëm një ideologji, ajo ishte ideologjia kombëtare shqiptare, idealet e së cilës gjetën mishërimin e vet në Programin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Si patriot që ishte, Ymer Berisha, angazhohet drejtpërdrejtë në proceset e Kosovës, duke mbajtur kontakte me masën e gjerë shqiptare. Profesori i Gjurgjevikut, në vjeshtën e vitit 1944 do të vijë në Drenicë dhe do të bisedojë me Shaban Polluzhën, Sadik Zenelin, Jusuf Gradicën, Rexhep Vojvodën dhe me shumë njerëz

¹⁰⁰ Tahir Z. Berisha, Emrat që nuk harrohen, Prishtinë 1994, f. 206-207.

¹⁰¹ Sabile Keçmezi-Basha, Ri-okupimi I Kosovës (fejton), gazeta Epoka e Re,

¹⁰² Hamdi V. Thaçi, Drenica Epiqendër e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, Prishtinë 2016, 198-199.

të tjerë autoritarë të kësaj ane e të Artakollit për fatin e Kosovës. Në Drenicë, me 28 nëntor 1944, do të mbajë një tubim me fshatarët e kësaj ane, dhe aty do të thotë: “Nuk ka besë më me serbë, prandaj duhet të organizohemi dhe të luftojmë deri në bashkimin kombëtar”¹⁰³. Mendohet se iniciator dhe themelues i ONDSH-së ishte vet ai, po më 1945, në Kuvendin e Dobërdolit formoi edhe organizatën tjetër ilegale “Besa Kombëtare”. Në emër të kësaj organizate “Nga malet e lira të Dardanisë” i shkruan shefit të misionit ushtarak britanik në Shqipëri, gjeneralit Hadson, një letër me të cilën e njoftonte për terrorin sllavo-komunist mbi popullsinë shqiptare në Kosovë, dhe duke kërkuar ndihmë e përkrahje nga aleatët anglo-amerikanë. Duke i njohur mirë këto rrethana, ai bënte përpjekje të vazhdueshme që shqiptarët në Drenicë, në Llapushë dhe në disa pjesë të Dukagjinit t’i bind për t’iu kundërvënë politikës okupuese me të gjitha forcat, madje së fundi edhe me kryengritje të armatosur.

Me fillimin e kryengritjes në Drenicë, Ymer Berisha thoshte se suksesi i saj do të varet nga zgjerimi i saj në të gjitha anët e Kosovës. Në Drenicë do të sjell armë, dhe siç deklaroi Hajriz Domaneku, në Obri kishte sjellë disa automatikë me të cilët luftuan deri sa u shua rezistenca e Drenicës.¹⁰⁴ Pasi shuhet lufta e Drenicës, profesori prej këtu kaloi në ilegalitet, në anën e Prizrenit, Podrimës dhe Rahovecit. Më vonë angazhohet në unitetin e ilegales shqiptare, dhe në territoret e Dukagjinit formoi komitetet e rajoneve, të rretheve e të komunave, që kishin të njëjtën strukturë si në ONDSH.

¹⁰³ Muhamet Mjeku, *Lufta e Drenicës*, Prishtinë 1991, f. 146.

¹⁰⁴ Po aty, f. 147.

Më 22 tetor 1945, ai e informoi shefin e misionit ushtarak anglez, gjeneralin e lartpërmendur, për përfundimin e luftës së Drenicës dhe për gjendjen në Kosovë. Por ky raport kishte rënë në duart e OZN–ës, sepse korrieri ishte bashkëpunëtor i tyre,¹⁰⁵ (e që nuk ishte hera e parë që një njeri i tillë ishte infiltruar në radhët e lëvizjes). Profesori ishte i shqetësuar për situatën që mbretëronte pas aneksimit të Kosovës Serbisë. Sepse për nga përmasat, qëllimet, metodat që përdorshin, propaganda që zhvillohej, dhuna që zbatohesh mbi shqiptarët ishte e njëjlojtë me atë që ushtrohej dhe përdorej në vitet e sundimit të dinastisë mbretërore të paraluftës. Përpara luftës shqiptarët ishin element destabilizues për Jugosllavinë, ndërsa pas lufte ishin separatistë, e çka jo tjetër. Duke e vërejtur pakënaqësinë e dëshpërimit të popullit, Ymer Berisha vënë lidhje me të gjitha organizatat ilegale, që vepronin në Kosovë dhe intensivisht punoi për të bërë bashkimin e tyre. Sipas Gjon Serreqit, që i jep deklaratë hetuesit në burg: “Me organizatën Besa Kombëtare të Ymer Berishës, kemi pasur lidhje prej qershorit të vitit 1946, nëpërmjet Rexhep Lushit, korrierit të Hilmi Zariqit. Aksione të përbashkëta nuk kemi pasur. Ata kanë kryer aksione në Dukagjin, kurse ne këtu. Ymer Berishën të gjithë ne e kemi nderuar si organizatorin më të aftë. Ai na pat njoftuar se është i ndërlidhur me Muharrem Bajraktarin, me konsullin anglez në Tiranë, Hadsonin”, përfundon Gjoni para organeve hetimore¹⁰⁶. Këtë deklaratë ai e jep diku në orët e hershme të mëngjesit.

Ymer Berisha kishte lidhje të ngushta edhe me Ukë Sadikun dhe me të gjithë krerët e shqiptarëve në ilegalitet. Pas një aktiviteti të

¹⁰⁵ Gojko Medenica, Nata e frorit (Aksioni për zënien e komandantit të bandave balliste për Kosovë e Metohi, Ukë Sadikut), Rilindja 25 shkurt 1965.

¹⁰⁶ ASHAK, Gjykata e Qarkut, Prishtinë, Penale: Aktgjykimi i Gjon Serreqit nr. 66/47

dendur në fshatrat e Gjakovës, dhe pas një konsultimi që pati me Ukë Sadikun, atë e njoftojnë se në malet e Lipovicës do të mbahet kongresi V i ONDSH-së, dhe ai ishte i ftuar të marrë pjesë në të. Sipas të dhënave që i jep Gojko Medenica, me 10 korrik të vitit 1946, në malet e Hereçit të Gjakovës, i rrethuar nga forcat e të ashtuquajturës “Mbrotjtja popullore dhe e milicisë jugosllave”, u vra në udhëtimin e sipër për në Kongresin V të ONDSH-së, që mbahej në Lipovicë¹⁰⁷. Së bashku me përcjelljen bëjnë rezistencë, për të dalë nga rrethimi. Por prof. Ymer Berisha vritet me 8 patriotë, dhe 12 të tjerë plagosën rëndë¹⁰⁸. Së bashku me ta vritet edhe mësuesi Fehmi Kura.¹⁰⁹

Vdekja e prof. Ymer Berishën dhe e bashkëlufëtareve të tij, mbahet fshehur deri më 25 korrik 1946, kur mbahet Kongresi i Lipovicës. Atëherë zbulohet korrieri i rrejshëm (në të vërtetë ishte spiun i S.Gjakoviqit), Rexhep Alush Carabregu¹¹⁰, që një kohë të gjatë kishte luajtur lojën e korrierit, duke bartur letra nga Shtabi II (Organizata nr.2) në Drenicë dhe Besa Kombëtare në Dukagjin. Nga trysnia që iu bë atij nga gjyqi popullor i kongresit në Lipovicë, ai pranoi se Ymer Berisha me ndihmën e tij kishte rënë në grackë dhe ishte likuiduar.¹¹¹ Andaj gjyqi popullor e dënoi aty për aty me pushkatim edhe Rexhep Carabregun, aty afër ku mbahej kongresi.

¹⁰⁷ Gojko Medenica, Nata e frorit (Aksioni për zënien e komandantit të bandave balliste për Kosovë e Metohi, Ukë Sadikut), Rilindja, 1 mars 1965.

¹⁰⁸ Hasan Shala, Izet Hoti, Besa e gurit, Prishtinë 1996, f. 61.

¹⁰⁹ Shaban Braha, Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare (1844-1990), Gjakovë 1991, f. 487.

¹¹⁰ Shefqet Kelmendi, “E djathta shqiptare në mbrotjtje të Shqipërisë etnike-(3)”, 417- 426

¹¹¹ Muhamet Pirraku, Mulla Idriz Gjilani dhe mbrotjtja kombëtare e Kosovës Lindore

Kongresi i Lipovicës i filloi punimet më 25 korrik 1946, dhe në të u propozua që komandanti i përgjithshëm i ilegales shqiptare të emërohet prof. Ymer Berisha, në mungesën dhe në padijen për vrasjen e tij 15 ditë më parë! Pasi u zbulua likuidimi i Ymer Berishës nga ana e UDB-es, shtypi i kohës bënte njoftimin e shkurtër se u vra “ballisti, antipopullori, antidemokrati Ymer Berisha, spiun gjerman, i cili ka qenë i shtyrë dhe i përkrahur nga reaksioni i jashtëm, ka qenë udhëheqës kryesor politik i të ashtuquajturës Komiteti Nacional-Demokratik Shqiptar me të cilat ishin bashkuar spiunët fashistë, zogistë, irredentistë, ballistë dhe tradhtarët e tjerë, të popullit shqiptar, të cilët ishin në shërbim të reaksionit të huaj”.¹¹² Pa fijen e turpit, shtypi i kohës i mëveshëte lloj-lloj epitetesh, duke filluar nga ato më të çoroditurat e deri tek ato më fyeset për një patriot e atdhetar siç ishte prof. Berisha. Qëllimi i parë dhe i fundit i të gjithë këtyre të rënëve kishte vetëm një emër dhe një synim, që të gjitha trojet shqiptare të bashkoheshin në një shtet etnik – Shqipërinë etnike.

¹¹² Ubijen Imer Berisha, rukovodilac svih balističkih bandi, Gazeta “Jedinstvo” 4 gusht 1946



Prof. Ymer Berisha

AVZI MUSTAFA*Shkup*

MËSIMBESIMI NË SISTEMIN ARSIMOR KOMBËTAR SHQIPTAR GJATË VITEVE 1941–44

Rilindja Kombëtare Shqiptare të gjitha forcat e veta i orientoi në ngritjen e vetëdijes kombëtare me moton: “Pa emancipim kulturor, nuk ka as emancipim politik”. Prandaj, shqiptarëve nuk u mbetej asgjë tjetër, përveç që nëpërmjet shkollës në gjuhën amtare, të mund të ngritnin vetëdijen kombëtare, pa dallim feje e krahine. Rilindësit së pari kërkonin bashkimin e të gjithë kombit, dhe nën flamurin kuq e zi, krahas pushkës, të luftonin edhe me pendë, për shpëtimin e Atdheut.

Rilindja Kombëtare, e sidomos Lidhja Shqiptare e Prizrenit, shqiptarët i nxori në arenën botërore si popull i veçantë, që nuk kishte lidhje as me turqit e as me të tjerët. Dhe me tërbim pyetnim Fuqitë e Mëdha, se kush janë këta, çka kërkojnë dhe sa janë?! Edhe pse romantiku shqiptar, Jeronim De Rada, disa herë i qe drejtuar Evropës se e ka borxh ta ruajë këtë popull, dhe se të vetmit shqiptarët u bënë ballë të gjitha stuhive e rrebesheve okupuese gjatë shekujve, por ata nuk i zhdukën nga faqja e dheut, prapëseprapë ajo (Evropa) mbeti e shurdhët.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit i bëri realitet qëllimet shqiptare para botës si komb i veçantë dhe kërkonte bashkimin e të gjitha tokave shqiptare. Por edhe për kundër kryengritjeve të përgjakura, Fuqitë e Mëdha si dhe shtetet sllave të Ballkanit, e copëtuan Shqipërinë që sa më lehtë t’i realizojnë aspiratat e tyre. Një mospërfillje të këtyre ndaj shqiptarëve u shfaq jo vetëm me vendimet grabitqare të Kongresit të Berlinit, por edhe më 1913. Dhe kështu mbi trojet shqiptare u vërsulën një lukuni ujqish me qëllim secili për hesap të

vet të gllabërojnë copa sa më të mëdha nga trugu shqiptar. Populli shqiptar u copëtua në banovina e krahina sllave e greke. Erdhi viti 1939, gjegjësisht 1941, kur në këto troje zuri vend një pushtues i ri, ai italian.

Lufta e Dytë Botërore solli edhe disa panje të reja për shumicën e shqiptarëve të Maqedonisë Perëndimore, Kosovës dhe Malit të Zi. Kjo ndodhi 17 ditë pas kapitullimit të Mbretërisë Jugosllave. Shqiptarët të bashkuar, por pa kushte për ndonjë konsolidim, ishin të detyruar që të kërkojnë ndihmë nga shtetet fqinje dhe të huaja. Duke u mbështetur në ndihmën e të huajve, vendet shqiptare, që kishin qenë nën okupim të Mbretërisë Jugosllave, u ndanë në zona. Zona më e madhe që përfshinte shqiptarët, de fakto i takonte Italisë, ndërsa tjetra i takonte Gjermanisë dhe Bullgarisë. Zona që i takonte Italisë, de jure, ishte zona ku qeverisin shqiptarët dhe quhej Mbretëria Shqiptare. Shqiptarët, të përkrahur nga pushteti italian, për një kohë shumë të shkurtër ngritën administratën e pushtetit të tyre. Për të pasur sa më shumë sukses, ata i përdorën të gjitha mjetet materiale dhe shpirtërore që sa më tepër të ngjallin admirim ndaj tyre, duke dhënë të drejta që shqiptarët e këtyre viseve kurrë nuk i kishin gëzuar. Si detyrë parësore ishte sa më shpejt të ngrihet arsini. Ata menjëherë i hapën shkollat laike dhe sollën mësuesit më të ditur dhe më të ngritur, si në aspektin didaktik, ashtu edhe në aspektin moral dhe profesional. Ata zhvilluan një rrjet shumë të gjerë shkollash dhe arritën që të grumbullojnë një numër të madh nxënësish shqiptarë në këto shkolla.

Shqiptarët e Maqedonisë e të Kosovës, jo pa arsye e quajten çlirim, sepse për herë të parë e bashkuan pjesën më të madhe të trojeve shqiptare me shtetin amë. Ky bashkim u solli shqiptarëve për herë të parë të dëgjohet e të shkruhet edhe fjala shqipe që aq fort e deshën rilindësit tonë, si dhe u hapën shkolla me mësues e administratë shqipe.

Me rastin e fillimit të vitit shkollor, ministri i Arsimit të Mbretërisë Shqiptare, Ernest Koliqi, lëshon një qarkore më 25.10.1941, në të

cilën thuhet: “Për herë të parë themelohet shkolla jashtë kufijve të vjetër shtetëror, të cilat në kuptimin e plotë janë me vlerë historike, të cilat premtojnë se do ta çrrënjisin prapambeturinë dhe do t’i shërojë plagët e robërimit dhe se shkolla shqipe do të jetë në shërbim të popullit”.¹¹³

Edhe pse gjendja e shqiptarëve kudo e sidomos në këto treva ishte tepër e mjeruar në çdo fushë, nuk u kursyen as njetet e as vullneti që shqiptarët e këtyre anëve të arsimohen në gjuhën amtare. Një angazhim të tillë e të pamohueshëm e dha Mbretëria Shqiptare me në krye ministrin e Arsimit, z. Koliqin. E këtë angazhim në mënyrë ilustrative na përshkruan shkrimtari i njohur Martin Camaj kur flet për meritat e Ernest Koliqit në parathënien e librit të novelave të tij ku shkruan: “Në kohë të vështira si ishte Lufta e Dytë Botërore, la gjurmë të pashlyeshme në arsimin kombëtar, në organizimin e shkollave dhe në pajisjen e tyre me tekste, për të parën herë trajtuar me kritere moderne, ndërsa qysh tash historia ia njeh se Koliqi mori guximin me përgjegjësi personale të themelojë shkollat shqipe në Kosovë (këtu hynë edhe trevat ku janë të banuara me shqiptarë etnik nga pjesët e Maqedonisë – A. M.); si Ministër i Arsimit më 1941–1942 dërgoi në Kosovë nga Shqipëria mbi 200 mësues shqiptarë, të cilët pas mbarimit të luftës i vunë themelet e forta të arsimit në gjuhën shqipe”.¹¹⁴

Ishte tepër vështirë të organizosh një sistem edukativo–arsimor në trevat ku pushtuesi kishte punuar natë e ditë që të ndryshojë realitetin historik me dhunë dhe me propagandë për të harruar identitetin e vet. Objektivat kryesore të pushtuesve ishin pasoja të drejtpërdrejta të gjenocidit të ushtruar mbi to, që të bëhej shpër–ngulja e shqiptarëve nga vatrat stërgjyshore.

¹¹³ Këtë dokument e ka ruajtur pishtari i arsimit shqip, Vlash Gjellaj, i ardhur nga Obodi i Shkodrës, i cili punoi si mësues në Maqedoni dhe Kosovë.

¹¹⁴ Shih: Ernest Koliqi, Tregtar flamujsh, botoi Ndërmarrja botuese, “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 1991, f. 5.

Shqiptarët kurrë nuk e përfillën fashizmin si ideologji, por vetëm si simbol bashkimi, sepse periudhat e vuajtjeve të shqiptarëve në të kaluarën kishin lënë gjurma të pashlyeshme në vetëdije. Në një dokument të asaj kohe thuhet: “le të vijë edhe dreqi i mallkuar, vetëm serbi e të na hiqet qafe”.¹¹⁵

Kjo ishte një periudhë shumë e rëndësishme, sepse për herë të parë u vunë themelet e arsimit në gjuhën shqipe. Dhe tani punohej në shumë fronte, jo vetëm me nxënës të rregullt, por edhe me kursistë, seminaristë dhe me tjerë që dëshironin të arsimoheshin në gjuhën amtare, duke përfshirë edhe ata që kishin mbarur shkolla të ndryshme serbe apo fetare. Një pjesë e tyre dërgoheshin në kurse kualifikuese në Shkollën Normale “Sami Frashëri”, në Prishtinë, e një pjesë dërgoheshin në kurset verore në Shqipëri dhe kështu kualifikoheshin edhe mësues nga këto treva.¹¹⁶

Problem më të madh paraqiste pajisja e nxënësve me mjete shkollore, gjegjësisht me tekste shkollore. Edhe pse kuadri i caktuar që vinte në këto treva kishte traste plotë me libra, kjo përsëri nuk mjaftonte, kështu që ndodhte që në ndonjë shkollë të punohej vetëm me një abetare. Përveç abetareve në këtë periudhë u përdorën edhe libra leximi për klasë të ndryshme.

Mbretëria Shqiptare si dhe pishtarët që merreshin me organizimin e hapjeve të shkollave në këto treva ishin shumë të vetëdijshëm se ndjenjat fetare në Viset e Liruarë që përfshinte Kosovën, Tetovën, Strugën dhe Dibërën ishin një faktor vendimtar në përfshirjen e nxënësve dhe hapjen e shkollave. Në baze të Qarkores së Ministrisë së Arsimit në Tiranë dërguar Inspektorisë së Arsimit në Kosovë e Dibër lëshohet udhëzimi mbi zhvillimin e lëndëve mësimore dhe bashkangjitur me të edhe Plani dhe programi i shkollës fillore pesëklasëshe, ku mësimbesimi parashihej si lëndë fakultative dhe ajo të zhvillohej në mejtepet që funksiononin edhe gjatë okupimit serb

¹¹⁵ Abdullah Vokrri, Shkolla dhe arsimit në anën e Llapit (1878-1944), f. 92.

¹¹⁶ Hoxha dhe Isen Kaloshi i pari nxënës në Normalen e Prishtinës, kurse i dyti mësues në këto shkolla.

në këto troje.¹¹⁷ Kjo ndodhi kështu sepse shkolla kombëtare ishte laike dhe se në planet dhe programet mësimbesimi nuk ekzistonte si lëndë.

Mirëpo, Komiteti Mysliman Shqiptar me shkresën dërguar më 29 shator 1941 i drejtohet kabinetit të Kryeministritë midis atij edhe Komitetit të Ministritë së Arsimit që kërkohej që mësimbesimi të figurojë si lëndë mësimore dhe të vlerësohej me notë. Por, në bazë të shkresës me nr. 436/125 të datës 04.01.1941–XIX dhe të shkresës nga ana e Ministritë së Arsimit me nr. 198 të datës 04.01.1941–XIX ku e njoftojnë Komitetin Mysliman se së shpejti pritet të sillet ligji i ri e deri sa nuk sillet ky ligj, aplikimi i notave nuk mund vihet në veprim.¹¹⁸

Shkolla shqipe në shumë fshatra nuk vijohej me rregullsi e sidomos problem ishte me gjininë femërore, sidomos nëpër fshatra, meqë ato nuk vijonin shkollimin, edhe pse në listat zyrtare ishin te evidentuara. Një problem tjetër ishte se nxënësit shqiptarë së pari ndiqnin kurset fetare e pastaj shkollën e rregullt. Ky mësim thuhej se i lodhte shumë dhe se vëmendja në procesin mësimor ishte i dekoncentruar, prandaj u pa e nevojshme që sa më parë të sillet Ligji dhe të zgjidhet kuadri për mësimbesimin, koha e ndjekjes së kësaj lënde, si dhe numri i orëve.

Që nga shkurt–marsi i vitit 1942, Ministria e Arsimit njofton Prefekturat dhe Nënprefekturat për dhënien e lejes që edhe mësimbesimi të jetë pjesë përbërëse e plan–programeve mësimore në shkollat kombëtare shqipe me nga dy orë në javë dhe me pagesë. Në vitin shkollor 1942/43, mësimbesimi hyri në plan–programet mësimore, por si mësim moral e qytetar.¹¹⁹

¹¹⁷ Abdylazis Veseli, Shkollat dhe arsimit shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941–1944, Tetovë, 2000, f. 95.

¹¹⁸ Tokat e Liruar 1941–1944, përmbledhje dokumentesh, përmbledhur nga Qerim Lita, botoi Logos-A, Shkup, 2016.f. 149 (dok. nr. 662).

¹¹⁹ Shiko dëftesat shkollore që kjo lëndë radhitet pas sjelljes.

Komiteti Islam në Tiranë, në krye me kryetarin Behxhet Shapati dhe me kryetarin e Ylemave, Sherif Langun, u ngarkuan që sa më parë të përgatisin elaboratin mbi futjen e mësimbesimit në shkollat shtetërore. Në bazë të një qarkoreje, që mban nr. 447, Kryesia e Këshillit t'Ylemave të Komitetit Mysliman njofton Kryemyftinjtë, Myftinjtë e Nënmyftinjtë, Kryesinë e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare në Shqipëri që me dekret të posaçëm të ngarkojë Kryetarin dhe Këshillit e Ylemave të Komitetit Mysliman në gjithë Shqipërinë për projektimin e një Statuti të ri për Komitetin e gjithë Myslimanëve". Në Statutin e ri një prej detyrave ishte edhe futja me dekret e mësimin fetar për të gjitha shkollat shtetërore. Njerëzit që do të angazhoheshin për mësim feje duhet të ishin së pari shqiptar dhe të kishin kryer ndonjë shkollë fetare, ndërsa si detyrë parësore parashihej që të gjitha ata që do të angazhoheshin, të kenë për qëllim "rënjosjen e ndjenjave fetare, bashkimit e dashtunimit vllaznuer fetarë e kombëtarë shqiptar".¹²⁰

Të interesuarit së pari duhej të drejtoheshin me lutje kryesive, sipas konfesioneve të tyre, e këto pastaj i drejtojnë në Ministrinë e Drejtësisë dhe pas marrjes së lejes dërgoheshin në Ministrinë e Arsimit, e cila i njoftonte Inspektoratet pranë Prefekturave dhe nënprefekturave në Tokat e Liruar.

Pas aprovimit të Statutit të ri dhe marrjes së lejes për mbajtjen e mësimin të fesë, caktimi i mësueseve të mësimbesimit bëhej me përgjegjësinë e udhëheqësve të shkollave dhe të Inspektoratit për Arsim. Kryetari i Ylemave i pranonte të gjitha lutjet dhe propozonte se cili mund të ishte mësues feje. Përparësi kishin ata të cilët shiheshin se u janë zgjuar ndjenjat kombëtare nacionaliste. Kështu, sipas dokumentit nr. 19 të datës 3. XIII/41 së pari lajmërohet shkolla e Ulqinit me propozim që mësues mësimbesimi në këtë qytet të emërohet Izet Zejnuni, i cili njëherazi ishte edhe imam zyrtar për myslimanet dhe njeri i dëshmuar i çështjeve

¹²⁰ AQSH, Qarkore, që mban nr. 447, Kryesia e Këshillit t'Ylemave të Komitetit Mysliman.

shqiptare, kurse për besimin katolik, Dom Nikol Tusha, i cili pa ashtu kryente detyrën e famullitarit të kishës në Ulqin, ndërsa për ortodoksët thuhet në dokument se nuk mund të gjejnë njeri të përshtatshëm “se asnjë nga popat nuk zotërojnë gjuhën shqipe”. Por, që të mos ketë padrejtësi ndaj komuniteti ortodoks, për mësimbesim angazhohet mësuesi i shkollës, Mina Nikolla Gega.¹²¹

Prej vitit shkollor 1942, gjegjësisht prej fillimit të vitit shkollor, varësisht nga personi dhe rregullimi i dokumentacionit, fillohet me dekret të emërohen mësues të mësimbesimit në të gjitha vendet e Mbretërisë Shqiptare, përfshirë edhe Maqedoninë, Kosovën dhe Malin e Zi. Sipas dokumenteve arkivore, mësues të mësimbesimit emërohen sipas përkatësive fetare të shqiptareve. Kështu, sipas dokumentit të arkivit që gjendet një listë e personave që propozohen të emërohen mësues besimi në Kosovë dhe në Maqedoni, si: Ahmet Haxhi Vehabi mësues besimi në Tetovë, Rexhep Ferati në Tetovë, Sali Abdurahmani në Prishtinë, Et–hem Tahir Pishnjari në Reçicë të Tetovës, Zulfë Naziri po ashtu në Reçicë, Hafiz Nexhat Veseli në Xhepçishtë të Tetovës, Hafiz Shaban Halili në Zhelinë të Tetovës, Jahja Baftir (Baftjar) Mënjaku në Shipkovicë të Tetovës, Shefki Ademi në Gajre të Tetovës, Iljaz Idrizi në Pallçishtë të Tetovës, Ramadan Osmani në Gradec të Gostivarit, Nixhmi Abdullahu në Zhelinë, Haki Selmoni në Reçicë, Ajet Kamberi në Strimnicë të Tetovës dhe Zeqir Teufik Lazami në Kamjan të Tetovës.¹²²

Kryetari i Komunitetit Mysliman, dr. Bexhet Shapati, me shkresën nr. 851/1 i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar leje që të emërohen të gjithë ata që kanë shprehur dëshirë dhe që i plotësojnë kushtet. Në shkresën nr. 50 të datës 19.02.1942 thuhet se në viset e Lirume si kandidatë për mësues besimi kanë shprehur dëshirë: Emshi Ismail Rexhepi për shkollën e katundit në Dobërdoll të Gostivarit e Hafiz Ymer Spahija në një shkollë të

¹²¹ AQSH, F. 814, D. 14 .Fl. 7. Dok. 195/942.

¹²² AQSH f. 195 v. 1942 d. 263, n. 8

qytetit të Prizrenit. Për Shkollat e Pejës, Myftinija e Pejës propozon që për mësues të mësimbesimit, sipas cilësive të duhura, të jetë Hafiz Sulejman Pajaziti dhe z. Beqir Mulla Zeqa, pasi këta të dy e “dinë mirë shqipen në të folme e ne të shkruar dhe se është (janë) të aftë për mësim”.

Në Dibër për këtë kurs të mësimbesimit emërohet Dervish Jahja, i cili ngarkohet me 7 orë në shkollën fillore “Skënderbej” dhe me nga dy orë në shkollën fillore “Liria” të Dibrës për klasat e dyta dhe të treta. Meqenëse numri i shkollave edhe i nxënësve po shtohet, Kryesia e Komitetit Mysliman e ndjek me vëmendje këtë gjendje, duke kërkuar nga Ministria e Drejtësisë që të angazhojë mësues të fesë edhe në vendet me më pak nxënës, me shpresë se numri do të rritet. Kështu, në Pallçishtë të Tetovës, për shkak të numrit të madh të nxënësve, Kryesia e Komitetit Mysliman detyrohet ta pranojë Sherif Sherifin nga i njëjti katund, kurse Abdyl Qerimin në fshatin në Ladorishtë të Strugës.

Në bazë të dokumentacionit që disponojmë, shihet se disa mësues të mësimbesimit janë shumë të ngarkuar, si për shembull Ali Hamidi nga Qarku i Prishtinës, i cili është i ngarkuar me 17 orë në javë dhe mban mësim në tri shkolla të qytetit të Prishtinës. Edhe mësuesit e fesë, si Rexhep Ferhati nga Tetova, jep mësim në klasën I, II dhe III; kurse Ahmet Vehapi në klasën IV dhe V në Tetovë. Abdyl B. Mehmeti mbante katër ore në javë në Kamjan, kurse Ahmet Hasani që nga viti 1932 punonte si mësues besimi në nënprefekturën e Kërçovës. Ai mbante pesë orë në javë në të pesë klasat në fshatin Sërbicë (Kastriot) të Kërçovës, ku u mbante mësim 138 nxënësve. Detyrën e mësuesit e kishte marrë më 9 mars 1941 me një pagesë prej 60 frangave shqiptare. Po ashtu kemi edhe pasqyrën e të ngarkuarve me mësim në kursin e besimit në Prizren, si: Pjetër Berisha me 9 orë për elementin e besimit katolik, Sami Xhemaili me 26 orë në shkollën “Bajram Curri” dhe “Adyl Frashëri”, Maksut Spahiu me 22 orë në javë në shkollat: “Shtjefan Gjeçovi” dhe “Haxhi Ymeri” në Prizren, ndërsa Ali Hamiti i

punësuar në shkollën nr. 1 në Prishtinë me 14 orë dhe Islam Emimi në shkollën femërore nr. 2, po në Prishtinë me 12 orë në javë, ku shërbimi pagesor kapte shumë prej 84 frangash shqiptare.

Nga dokumentet mësojmë se për shkak të vonesës së pagesës, disa nga mësuesit e mësimbesimit në disa vende të Shqipërisë janë larguar nga detyra, kurse nga vendet e Lirue me asnjë nuk e kishte vënë këtë çështje në diskutim. Përkundrazi, në Vendet e Lirue kemi kërkesa për angazhim. Kështu, në bazë të një dokumenti shohin se Baftjar Fazliu nga Prishtina njoftohet se dokumentet e tij ende nuk kanë arritur në Inspektorinë e Arsimit që të mund të angazhohej për mbajtjen e mësimbesimit.

Është mjaft interesante që të përmendet se në këtë kohë kemi edhe kërkesa nga ana e femrave, si p.sh. Lutfije Zejnullahu dhe Xhevrije Ali Hysejuni nga Prishtina. Mirëpo, të dyja zonjat nuk pranohen, “sepse nuk ka nevojë” thuhet në dokument për shtesë të personelit. Ata të cilët kishin biografi të mirë, njohje të mirë të gjuhës shqipe dhe dëshmonin patriotizëm, nuk i largonin, por i angazhonin në kurse të ndryshme, si p.sh mësuesin Baftjar Fazliu, i cili kishte konkurruar për lëndën e mësimbesimit dhe i plotësonte kushtet që ta ushtrojë këtë detyrë.

Dëshira për lëndën e mësimbesimit nga ana e prindërve dhe e nxënësve ishte e madhe. Në bazë të letrës protokolluar me nr. 668 , të lëshuar nga Dibra, drejtuar Ministrisë së Arsimit, vërehen ankime të shumta pse në shumë shkolla fëmijët nuk marrin mësim feje dhe pse nuk angazhojnë mësues të fesë se “popullsia e këtyre vendeve janë tepër të dhanun mas fejet një trashëgim në këtë pikë sjell një mos kënaqësi në popull dhe len vend thash e themeve të shumta”.¹²³

Nërkohë të gjithë mësuesit e mësimbesimit gjatë vitit 1942 ishin në sprovë. Ata ndiqeshin nga Inspektori i Arsimit dhe nga përgjegjësit e shkollave. Qëllimi kryesor i përgjegjësve ishte të

¹²³ AQSH, F.dok. 668 të datës 28. 07. 1942.

ndjekin te të gjithë se si e flasin dhe shkruajnë gjuhën shqipe dhe sa e lidhin fenë me traditat e vendit tonë. Në një Raport të lëshuar nga Drejtoria e shkollës fillore “Skenderbeg” të Tetovës jepen sqarime për punën e A. Vahipin, R. Feratin dhe Abdylbaki Memetin. Nga shkresa nr. 153/16 e datës 3.3.1942 shihet se për Abdylbaki Memetin kërkojnë që të pushohet nga puna, sepse ai shumë pak e njeh gjuhën shqipe ose të dërgohet në “katundet Pirok, Çolopek apo Kamjan ku nxënësit janë të gjithë shqiptarë që nuk dinë me fol tjetër gjuhë veç asaj shqipe. Atje Bakiu do të shtërgoheshte me mësue mirë shqipen”.

Nga dokumentacioni i shumtë shohin se ka shumë kërkesa nga hafëzë, hoxhallarë e myderrizë për t’u inkuadruar në mbajtjen e mësimbesimit. Kështu, nga deponimi i dokumentacionit me biografi të dhe ixhazetnametë e tyre, të përkthyer në gjuhën shqipe, dalin në shesh të dhënat për lëvizjet e punës së tyre, kurse atyre që u mungonin ixhazetnametë merrnin dëshmi nëpërmjet njerëzve të firmosur para kompetentëve, si imamëve njerëzve të bashkisë dhe të gjykatës.

Nga biografi të e tyre shihet edhe shkalla e kualifikimit dhe e punësimit të tyre. Kështu, Ali Hamiti, myderriz nga Prishtina, thuhet se ka dhënë mësim në gjimnazin turk në Prishtinë në vitin 1911. Punën e këtij myderrizi e dëshmojnë Mahmut Rexhepi, imam në xhaminë e Prishtinës dhe Mehmet Shabani, polic në Bashkinë e Prishtinës, vërtetuar nga Kryetari i Bashkisë së Prishtinës, Salatin Kelemendi. Por, Inspektorati i Arsimit kërkon sqarime për kandidatin se sa e njeh gjuhën shqipe dhe se a ka nevojë për mësues të fesë në këtë qytet. Sipas shkresës nr. 153/82 të 16.5.1942, ky mësues feje ngarkohet me detyrë në tri shkolla me 17 orë mësimi në javë me një rrogë prej 80 frangash shqiptare. Ka edhe të tillë të cilët nuk pranohen, sepse nuk e njohin gjuhën e folur dhe të shkruar shqipe. Kështu ndodh me Abaz Selam Kabashin, të cilin e drejtojnë dhe e udhëzojnë “që të mësojë mirë

gjuhën shqipe në të shkruem e në të folur dhe rishtazi të bëjë kërkesë”.

Po kështu kemi edhe kërkesën e Azem Dalipit nga fshati Tuhin i Kërçovës, i cili dëshiron të mbajë mësimbesimin në shkollën e Tuhinit dhe të Jagoll–Dolencës. Në biografinë e tij shkruan: Azem Dalipi i lindur në katundin Tuhin të Nën/prefekturës së Kërçovës. Në vitin 1902 ka mbarur Ruzhdijen në Kostur të Greqisë. Pastaj ka ndjekur mësimet në gjuhën arabe në medresenë e Kërçovës. Pas mbarimit të mësimëve 6–vjeçare vazhdon shkollën Normale në Manastir ku edhe është diplomuar. Emërohet mësues në fshatin Veleshtë të Strugës. Me ardhjen e fuqisë Jugosllave është detyruar që ta lëshojë punën dhe merr rrugën për në Turqi. Atje emërohet mësues praktike pranë shkollës Normale të Kostamanit. Pas 6 vjetësh shërbimi ai emërohet Drejtor i shkollës fillore në Bolli dhe në këtë post qëndron deri në vitin 1923 ku thotë se u ktheva në Atdheun tim dhe punova si mësues feje dhe detyrën e mbajta deri në shembjen e regjimit barbar Jugosllav. Gjithashtu thotë se “dinë mirë me shkrua e me këndue gjuhën amtare (Shqipen). “Tash që lumnisht që vendi im u bashkue me Nënë Shqipni, dëshiroj të emnohem mësues besimi në shkollën e Tuinit e Dolencit....Me nderime Azem Dalipi”. Lutja biografike si duket është shkruar nga mësuesi i mirënjohur Petref Therrepela, mësues nga Shqipëria, ngase me ndihmën dhe rekomandimin e tij ai emërohet mësues feje në Tuhin dhe Dolencë.

Nevoja për mësimbesim ishte e madhe tek elementi ortodoks. Në bazë të një shkrese kuptojmë se si Kryesia e Ylemave i drejtohet Sinodit të Shenjtë për emërimin e mësuesve të mësimbesimit ortodoks. Kërkesat më të mëdha ishin në Tetove, Dibër e, sidomos, në fshatrat e Rekës së Epërme dhe në prefekturën e Prizrenit. Edhe pse pagesa ishte 150 franga shqiptare, përsëri kuadër nuk mund të

gjendej. Në Tetovë emërohet Dimitri Risto nga ky qytet, i cili thuhet se e “zotëron gjuhën shqipe”.¹²⁴

Mësimbesimi në shkollat shqipe në këtë periudhë ishte në funksion të gjuhës shqipe dhe të formimit moral e qytetar të nxënësve.

¹²⁴AQSH. F. 195; V. 1942. D. 296. FL: 29111.

*XHELADIN MURATI**Tetovë***PËR ROLIN HISTORIK TË SHKOLLAVE
FILLORE TË PARA SHQIPE (1941–1944), DHE
TË MËSUESVE TË TYRE**

Në historinë e arsimit dhe shkollës shqipe të shqiptarëve të Maqedonisë ka ushtruar një ndikim të fuqishëm hapja e shkollave të para dhe mësuesit e tyre të ardhur nga Shqipëria më 1941 – 1944. Ata erdhën dhe vepruan me një koncept kombëtar, i kundërt me atë që shqiptarët mësonin deri atëherë nga mësuesit serb. Koncepti kombëtar i shkollave dhe mësuesve të tyre e kishin për bazë të mirën, të vërtetën historike, kombin, gjuhën dhe vetëdijen. Ky koncept zhvilloi dhe afirmoi vlerat kombëtare, të cilat ishin drejt shkatërrimit të tyre nga mësuesit serb.

Në këtë drejtim, shkollat e para shqipe dhe mësuesit e tyre, patën mision kombëtar. Ata kryen një mision të dobishëm, qenësor duke ngritur vetëdijen kombëtare. Veçoria më themelore e këtyre shkollave qëndron në faktin se ato vepruan vetëdijshëm, me qëllime të paramenduara, rationale dhe me mjete pedagogjike duke materializuar idetë dhe konceptet arsimore në një popullatë të etshme për dije shqip. Shkollat lanë gjurmët e të kaluarës shqiptare në “Tokat e Lirue me”.

Hapja e shkollave në gjuhën shqipe tregoi se arsimi është arma më e forte për të ndryshuar jetën dhe gjendjen. Përmasa që i jep arsimi botëkuptimit të njeriut është e jashtëzakonshme. Thellimi i të menduarit në gjuhën shqipe, perceptimit, bashkëpunimit, iniciativës dhe guximit, fuqizohen aq shumë sa që përcaktojnë rrugën dhe kahun që njeriu do të ketë në të ardhmen. Këtë e arriti shkolla në gjuhën shqipe në Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër e Strugë.

1. PREMISAT

Shkolla dhe arsini shqip kanë histori dhe traditë të gjatë e të mirëfilltë kombëtare e përparimtare. Për fillet dhe zhvillimin e arsimit e të shkollës në gjuhën shqipe ka patur qasje të dokumentuar duke filluar prej veprimtarisë së atdhetarëve e hoxhallarëve patriot që mësimin e zhvillonin nëpër xhami e bodrume e deri te mësues dhe intelektual të cilët me ndërgjegje punuan në vënien e bazave të arsimit shqip në të gjitha viset ku banonin shqiptarët. E kuptuan këto arsimin si shtyllë për përparimin e kombit dhe faktor për zgjimin e vetëdijes dhe ndërgjegjes kombëtare. Kështu ndodh edhe me mësuesit që punuan në viset shqiptare të Maqedonisë perendimore.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia në vitin 1939 – 1944 në Maqedoninë Perendimore siç e quajmë sot apo në “Maqedoninë shqiptare” ose “Tokat e Lirua” siç përmendet në literaturë, filluan të hapen shkollat e para në gjuhën shqipe. Kështu ndodhi në Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Diber, Strugë dhe në fshatrat për rreth tyre. Hapjen e shkollave e mundësuan ardhja e mësuesve nga Shqipëria me vendim të ministrit të Arsimit, profesor Ernest Koliqi, i cili fillimisht formoi “Misjonin e Jahtëzakonshëm Shkolluer” për të shqyrtuar dhe analizuar nevojat për shkolla dhe arsim shqip në Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër, Strugë apo siç quhet “Prefektura e Dibrës”.¹²⁵ Siç shkruante shtypi i kohës në Shqipëri, është nevojë urgjente për të afirmuar dijen, arsimin, shkollën në viset shqiptare. Gazeta “Tomori”, në vitin 1941, shkruante: “Një shenjë e vogël mjafton të nxisë sentimentin e popullit të përvojatur shqiptar andej kufirit të cilën ka dashur t’ia shuajë serbi 30 vjet me radhë, jo vetëm që nuk mësonte dot shqip, por as edhe serbisht,

¹²⁵ Shiko: Qerim Lita, “Misionarët e parë të arsimit shqip në tokat e lirume”, “Koha”, Shkup, 5 mars 2015, f. 14

sepse serbi s'ka dashur kurrë në këto vise të lejë të krijohet një klasë intelektuale shqiptare".¹²⁶

Natyrshëm, për vetë rendësinë e çështjes, është e arsyeshme të ngremë premisat vijuese:

1. Të mësohet historia që të respektohet e vërteta;
2. Shkolla dhe arsimi kanë qenë dhe mbeten arma më e fortë e përparimit;
3. Shkollat e para në gjuhën shqipe në Maqedoninë Perendimore ndezën shkëndijën e krenarisë së të qenit shqiptar;
4. Shtrirja e shpejt e shkollave në gjuhën shqipe nëpër qytete dhe fshatra krijuan vlera unifikimi;
5. Mësuesit e ardhur nga Shqipëria për organizimin e mësimit nëpër shkolla ishin vërtet mësues të kombit;
6. Shkollat dhe mësuesit dhanë për kombin shumëçka, u bënë shtyllë e zhvillimit të kulturës.

Shkollat e para u dhanë nxënësve culture të plot kombëtare. Filozofia kombëtare që u realizua nga mësuesit dhe shkollat shqipe, udhëhiqeshin nga ideja se me kombëtarë të mirë dhe të arsimuar përparon dhe zhvillohet vendi, kombi dhe njeriu.

2. KONTEKSTI

Shkollat e para në gjuhën shqipe në "Maqedoninë shqiptare" ose "Tokat e liruar" filluan të hapen në vjeshtën e 1941, atëherë kur nis edhe fuqizimi politik e kombëtar i Shqipërisë dhe shqiptarëve të Maqedonisë për një të ardhme ndryshe. Shkollat u hapen me idenë për riorganizimin e shqiptarëve dhe hapësirës shqiptare. Shkollat u hapen me ndihmën e Italisë do të thosha në zonën e influencës për

¹²⁶ Cit. nga libri Vebi Xhemali, Shqiptarët e Maqedonisë në mbrojtje të Shqipërisë etnike 1941 – 1945, Tetovë, 2008, f. 237

të krijuar regjime miqësore. Nisma e shkollave ndodhi kur Lufta e Dytë Botërore ishte në zhvillim të plotë dhe roli i Shqipërisë në rajon fillon të bëhet gjithnjë e më i dobët, sepse lufta u përmbyllë me ndarjen e re të shqiptarëve nga trangu dhe hapësira gjeografike natyrore më 1945.

Në çdo analizë që mund t'i bëhet hapjes së shkollave në gjuhën shqipe është ndoshta vendimi më logjik, i arsyeshëm e historik i ministrit prof. Ernest Koliqit që shqiptarët këndej kufirit si pjesë e popullit me histori, kontribute e vlera të mëdha kombëtare të arsimohen dhe shkollohen në gjuhën e vetë amtare. Njëlloj simbolike në rrugëtimin e shkollës shqipe drejt ardhmërisë paraqet ardhja e mësuesve nga Shqipëria.

Do të dëshiroja në pika të shkurtëra të vë në pah rolin e shkollës e të arsimit shqip, me rastin e 75 vjetorit të shkollave të para shqipe. Duhet theksuar se për këto shkolla dhe arsimin shqip në periudhën 1941 –1944 janë bërë shënime, trajtesa e shkrime të shumta (Q. Lita, V. Xhemaili, Q. Halili, Xh. Murati, A. Llalla etj.), ndër të cilat vlen të përmendi studimin e gjerë e gjithëpërfshirës “Shkollat dhe arsini shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941 – 1944” me autor Abdylazis Veseli (2000) dhe monografinë “Veteranët e arsimit shqip në Tetovë dhe rrethinë prej 1940 – 1960”, të Shoqatës së Pedagogëve Shqiptarë të Tetovës (2000).

Dita kur hapet shkolla e parë në gjuhën shqipe tashmë ka një date, ajo është 1 shtator 1941 në Tetovë, që trajtohet si ditë historike e shkollës shqipe. Ajo quhej shkolla numër 1 ose “Skenderbej”, që punoi në ndërtesën e vjetër të ish shkollës në Mbretërinë e Aleksandrit “Krala Petra”, e cila pas 1945 quhet shkolla fillore “Marshal Tito” ku sot punojnë Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Inspektorati Arsimor dhe Universiteti i Punëtorëve. Shkolla, sipas të dhënave, filloi punën me mësuesit: Abdi Kërçini, Zejnel Zajmi,

Aleksandra Bibaja, Sotir Gallani, Margarita Gallani, Qemal Haxhihasani, Lirije Shahini dhe Spiro Vëllazëroi.¹²⁷

Fakti i hapjes së shkollës së parë në Tetovë, plot 75 vjet më parë është një moment historik dhe i padiskutueshëm për ngritjen e vetëdijes dhe hapjen e terrenit për shkollat e tjera.

Dhe në vazhdimësi shkollat hapeshin nëpër vendbanime shqiptare si: shkolla fillore “Skenderbej”, Tetovë, shkolla fillore “Tajar Tetova” në Tetovë, shkollat fillore në fshatrat e Tetovës “Avni Rustemi” më pas “Naim Frashëri” në Xhepçisht, “Drita” në Zhelinë, “Rexhep Voka” në Shipkovicë, “Vllaznija” në Palçisht, “Oso Kuka” në Kamjan, “Sami Frashëri” në Pirok, “Abdyl Frashëri” në Bogovinë, “Mati Logoreci” në Miletinë, “Lidhja e Prizrenit” në Reçicë e Madhe, “Jani Vreto” në Çellopek, “Dervish Hima” në Lisec, “Muzraka” në Tenovë, “Zgjimi” në Stençë, “Atdheu” në Gajre, “Ilirija” në Neproshten. Në këto shkolla punuan shumë mësues.¹²⁸

¹²⁷ Abdylazis Veseli, Shkollat dhe arsimi shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941 -1944, Cabej, Tetovë, 2000, f. 28;

Abedin Qafjani, Vëzhgim mbi arsimin, kulturën dhe për disa pedagogë eminentë shqiptarë prej 1941 – 1965, Tetovë, 1997, f. 7

¹²⁸ Shiko emrat e mësuesve te: Abdylazis Veseli, Shkollat dhe arsimi shqip në Maqedoni 1941 – 1944, Cabej, Tetovë, 2000, f. 28 – 39; Monografia Veteranët e arsimit shqip në Tetovë dhe rrethinë prej 1940 – 1960, Tetovë, 2000, f. 8 – 12; Qerim Lita, “misionarët e parë të arsimit shqip në tokat e lirueme”, “Koha”, Shkup, 7 mars 2015, f. 14 – 15; Arben Llalla, Historia e arsimit shqip 1941 -1944 në Tetovë, “Koha”, Shkup, 8 janar 2009, f. 15 – 16; Idriz Idrizi, Kujtime, Tetovë, 2011, f. 25 - 26

Abdylaqim Seiti, Andoneta Lako, Amet Treni, Abedin Faja, Ajshe Gjylaçi, Amet Gjylaçi, Amet Punasheci, Elez Maho, Abdi Kërçipi, Zejnel Zajmi, Aleksandra Bibaja, Sotir Gallani, Qemal Haxhihasani, Beqir Killojka, Lazër Bibaja, Pano Hido, Josif Todi, Lirije Todi, Murteza Kacadej, Vangjel Daka, Nos Topalli, Nos Deliana, Qemal Agolli, Jorgj Bekteshi, Sadik Kadilliu, Hamit Pitja, Murteza Peza, Lirije Shahini, Spiro Vëllazëroi, Jonuz Balla, Theodora Biçka, Mit’hat Hoxha, Dhimitër Pulati, Abdylrahim Behluli, Ibrahim Zabzuni, Meri Thoma, Jonuz Balla, Vasil Dhimitrosi, Paulina Grabocka, Elena Todi, Rustem Ismailati, Jusuf Starova, Zenel Zaimi, Hysen Abdihojha, Gani Jahja, Dhimitër Shulitmani, Hasan Egro, Fatbardha Qaushi, Gliqeri Velko, Krisanthi Theme,

Shkollat filluan të hapen edhe në Gostivar me rrethinë si në qytetin e Gostivarit “Naim Frashëri”, “Ismail Qemali” në Banjicë e Epërme, “Agimi” në Dobridoll, “Lirija” në Reçan, “Bajram Curi” në Negotinë, “Halim Deralla” në Gradec, “Seit Najdeni” në Vrapçisht, “Kristoforidhi” në Debresh, “Lirija” në Reçan, “Bajram Curi” në Banicë të Poshtme, “Antin Matea” në Duf, “Gërmenji” në Çajle, “Avni Rustemi” në Çegran, “Drita” në Forinë, “Bashkini” në Raven, “Anastas Vangjeli” në Vërtok, “Hoxha Tahsini” në Llakavicë, “Dud Karbunara” në Zdunjë, “Ali Agja Beu” në Turçan, “Agimi” në Jellofcë. Mësuesit që punuan në këto shkolla është i shumtë.¹²⁹

Në qytetin e Kërçovës me rrethinë u hapen shkollat në Kërçovë “Moisi Golemi”, në Strellcë “Isa Boletini”, “Gjergj Fishta” në

Kadri Jashari, Kadri Hoxha, Lirika Nikolli, Dhimitër Fullahi, Xhafer Narazani, Enver Palluqi, Myfit Sinani, Zija Sadiku, Sulejman Qaushi, Vasil Naqi, Nevruz Vila, Tahsin Daiu, Konstanca Dhimitri, Teofik Spahiu, Spiro Gjini, Theodora Treska, Zef Qurçija, Llambi Nako, Xhafer Narazani, Mehmet Karadaku, Refik Shaqiri, Lazër Stefi, Zeqir Spahiu, Mexhit Bekteshi, Petes Kavaja, Sabri Goda, Koço Floku, Sotir Qirijaku, Zenel Hekali, Zydi Kajnak, Sami Lamçi, Mahmut Dumani, Spiro Popa, Muhamet Qereçi, Sali Qaushi, Suat Qaushi, Zija Mahmuti, Azem Morana, Emin Softa, Haki Hyseni, Talat Cela, Elena Pullati, Dodona Ekali, Vojsava Ekali, Myfit Imeri, Gani Shehu, Kadri Koshari, Ermane Shuli, Meliha Molina, Pjetër Kavaja, Zejnepe Bejleri, Ferosal Belegu, Gjergj Bekteshi. Bashk me këta mësues ka punuar edhe Idriz Idrizi, nga f. Gajre i Tetovës me shkollë normale të kryer (1942).

¹²⁹ Shiko emrat e mësuesve të: Abdylazis Veseli, vepra e cituar, f. 40 – 52; Qerim Lita, “Misionarët e pare të arsimit shqip në tokat e lirume”, Koha, 7 mars 2015, f. 14 – 15. Ata ishin: Abdylahim Behluli, Ahmet Gjylaçi, Ahmet Pere, Abaz Xhafa, Abdylaqim Dogani, Hamdi Gani, Liri Ekmeçiu, Hysni Ekmeçiu, Osman Luta, Mit’hat Hoxha, Kov Bibaja, Alush Ballteza, Skender Haxhihyseni, Xhafer Qatipi, Faik Qatipi, Lefan Oruçi, Mit’hat Cami, Abedin Faja, Selman Qorri, Gafur Rada, Hamdi Zabzuni, Gani Graceni, Mihal Pjeshkazi, Petrit Serjani, Kristaq Progni, Xhemal Voci, Seit Xoxa, Gavril Santa, Elena Pullati, Murteza Peza, Sejfedin Noto, Llambi Naka, Stefan Matea, Krisvagji Niço, Ismail Bedhija, Skender Hoxha, Nazmi Reza, Kamber Xherija, Sami Raça, Jalldeze Haxhihyseni, Ismail Shabani, Skender Haxhiademi, Ali Bajrami, Kristaq Gojo, Baki Zeneli, Vejsel Hyseni, Mehmet Karadaku, Shyqëri Ahmeti. Si mësues në këtë periudhë punoi edhe mësuesi Mustafa Ismaili nga Gostivari me kurse të kryera pedagogjike.

Sërbicë, “Kastrioti” në Zajas, “28 Nanduer” në Dërgovë, “De Rada” në Jagolldo, “Përparimi” në Greshnicë, “Vrana Konti” në Premkë, “Hasan Prishtina” në Cërvicë, “Kosova” në Llapkidoll. Mësuesit që punuan në këto shkolla ishin të shumtë.¹³⁰

Në qytetin e Dibrës u hapen dy shkolla: shkolla nr. 1 ose “Lirija” që më vonë e mori emrin “Kongresi i Dibrës” dhe shkolla nr.2 ose “Skenderbej”. Pas tyre u hap edhe shkolla e tretë filllore “Hoxhë Voka (Vogli)”. Ndërkaq, shkolla u hapen edhe në fshatrat: Banishtë, Zhirovnicë, Radostushë, Vidushë, Velebërdë, Skudrinjë Kosovrast i Epërm, Zepishtë, Xhitiñjan, Paresh, Prapanik, Koxhaxhik, Spas, Konjarë, Boletin dhe Sencë. Në këto shkolla mësim zhvilluan numër i konsiderueshëm i mësuesve.¹³¹

¹³⁰ Shiko emrat e mësuesve të Abdylazis Veseli, vep. E cituar, f. 53 – 57; Qerim Lita, “Misionarët eparë të arsimit shqip në tokat e liriueme”, Koha, 7 mars 2015, f. 14 – 15; Ilmi Velu, Mësuesit e parë dhe shkollat e para shqipe në Kërçovë, Shkup, 2014, f. 7. Ata ishin: Behxhet Hoxholli, Artenisi Hoxholli, Xhafer Shefkriu, Sulejman Karai, Ibrahim Doraci, Thomaidha Rrako, Remzi Xhemali, Mahmut Dumani, Hasan Safa, Gavril Santo, Ismail Bedhija, Ridvan Palluqi, Xhafer Narazani, Kamber Osmani, Petrit Hakani, Nos Deliasi, Tajar Zylfiu, Sulejman Osmani, Urani Zaharija, Marika Naço, Nazmi Reza, Afërdita Deljana, Fadil Hoxha, Jorgj Bekteshi, Reis Poshi, Afërdita Gjylapi, Izet Buzo, Llaqi Prenqi, Antoneta Sherko, Athina Dinisqoti, Afërdita Bekteshi, Ali Myderizi, Marita Kreshova, Selman Hitaj, Selma Musa Hitja, Violeta Kota, Hysen Hasani, Vesel Hyseni, Zenko Mehmeti, Pertef Therepeli, Pandeli Guçi, Vangjel Filo, Jovan Jorgji.

¹³¹ Shiko emrat e mësuesve të: Abdylazis Veseli, vepra e cit. f. 70 – 79; Qerim Lita, “Misionarët e parë të arsimit shqip në tokat e liriueme”, Koha, 7 mars 2015, f. 14 – 15. Ata mësues ishin: Islam Shahini, Lutfi Mehmeti, Elena Pullati, Xhemal Collaku, Shaqir Myhyrdori, Sami Gonxhija, Abaz Shehu, Marjeta Kreshova, Nadie Qaushi, Fetah Ajdini, Hiqmet Kasapi, Sami Gonxhe, Abdi Axhiu, Fadil Hoxha, Dhimitra Gjini, Enriell Panduku, Dhimitër Fullahi, Nexhip Minoreli, Hasan Rrapi, Seit Xaxa, Hysen Abdihoxha, Afërdita Jano, Sofika Progridi, Ibrahim Bajrami, Ibrahim Neziri, Ibrahim Zabzuni, Braho Dobri, Tanas Ceku, Ali Tenhai, Thanas Ceku, Isan Baholli, Servet Mano, Themistokli Treska, Jonuz Balla, Naim Babamato, Zihni Çiça, Jusuf Kaba, Mustafa Shahinaj, Remzi Sefedini, Remzi Prapaniku, Remzi Xhemali, Remzi Pustina, Servo Doraci, Gavril Santo, Gafur Rada, Gani Graceni, Spiro Popa, Hamid Muça, Qamil Blloshmi, Haki Pohuni – Allajbegu, Dalip Zejneli, Teufik Balla, Fahri Sulo, Irfan Oruçi, Ibrahim Doraci, Islam Hoxha, Shyqëri Skenderi, Esat Mezelxhiu, Eleni Dasho, Hidër Manjani,

Në qytetin e Strugës me rrethinë gjithashtu punuan mësues të ndryshëm.¹³² Aty u hap një shkollë në qytet – shkolla numër një, ndërsa shkolla u hapen edhe në fshatrat: Radoshtë, Radolishtë, Veleshtë, Labënishtë, Livadhi, Kalishtë, Koroshishtë, Belicë e Poshtme, Podgorcë, Dellogozhdë, Misllozhdë.¹³³

Në përgjithësi karakteristikat e shkollave të para ishin që nxënësit të mësonin gjuhën shqipe, por edhe lendë të tjera, gjithashtu të rendësishme për kulturën kombëtare. Kështu programet mësimore përfshinin shkrim këndim, gramatikë, letërsi, histori, gjeografi, muzikë, art, etj. Përmbajtjet mësimore përshkoheshin nga fryma patriotike.

Hamdi Zabzuni, Edip Tërshana, Qamil Skuqi, Qemal Agolli, Murteza Peza, Ahmet Gjylaçi, Abaz Xhafa, Hysein Qela, Pjetër Kavaja, Ibrahim Xhafa, Ibrahim Kuka, Jovan Popa, Abdyl Keçi, Ajshe Ruka, Zejnel Zajmi, Xhemal Kulli, Xhevat Xhafa, Kamber Kazazi, Hasan Ibrahim, Muhamet Qerisha, Menduh Skikuli, Mahmud Dumani, Hysen Kola, Hysni Ekmeçiu, Nuri Sula, Ymer Beqiri, Mit'hat Hoxha, Vangjel Daka, Liri Ekmeçiu, Liri Babamato, Beqir Kllojka, Idriz Deda.

¹³² Shiko emrat e mësuesve të: Abdylazis Veseli, vepra e cituar, f. 80 – 88; Qerim Lita, “Misionarët e pare të arsimit shqip në tokat e lirume”, Koha, 7 mars 2015, f. 14 – 15. Ata ishin: Alipi Pajuni, Faik Pajuni, Gjergj Bullati, Hasan Bellshaku, Hysen Pajenga, Xhyhere Bellshaku, Jonuz Balla, Theofan Dokja, Skender Hoxha, Dalip Zejneli, Nexhip Minerolli, Enver Palluqi, Alush Balltezi, Mahmut Toro, Dedë Shala, Marije Shala, Afërdita Gjylapu, Teiha Celo, Mehmetali Mustafa, Behxhet Hoxholli, Hysni Ekmeçiu, Liri Ekmeçiu, Dalip Zejneli, Artemini Hoxholli, Violeta Monçi, Katushe Cerekja, Marije Dashi, Liri Topalli, Enrieta Panduhu, Tefta Izgari, Skender Tupja, Behxhet Hoxholli, Qemal Hatraxhiu, Sofika Stavro, Dalip Zejneli, Nos Deljana, Afërdita Deljana, Uranija Zaharija, Jonuz Balla, Nos Topalli, Pandi Treska, Shpresa Kenxo, Fedhra Pisha, Perikli Bebie, Sadete Hashimi, Todi Lama. Si mësues ka punuar edhe Belul Efendiu, nga Struga në Veleshtë.

¹³³ Më gjerësisht shih edhe në librat: Abdylazis Veseli, Shkollat dhe arsimit shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941 – 1944, Cabej, Tetovë, 2000, f. 27 – 88; Zejnel Lufi, 50 vjet të arsimit shqip në trevën e Strugës, Strugë, 1999, f. 9 – 10; si edhe: Qerim Lita, “Misionarët e pare të arsimit shqip në tokat e lirume”, “Koha”, 7 mars 2015, f. 14 – 15; Qerim Lita, Misionarët e pare të arsimit shqip, “Koha”, 5 – 6 shtator 2012, f. 16

3. ASPEKTE DHE REFLEKTIME

Hapja e shkollave në gjuhën shqipe ishte një projekt madhor me rrënjë të thella kombëtare që unanimisht e përkrahën politika shqiptare dhe shqiptarët e Maqedonisë. Historia 75 vjeçare këtë popullatë e kthen në kohën e sfidave të mrekullueshme.

Së pari, është fakt se shkolla shqipe iu kundërvë shkollës dhe ideve propaguese të shkollës serbe dhe ngritjen e vetëdijes së rrejtshme.

Së dyti, hapja e shkollës shqipe hapi dritare kundër asimilimit të shqiptarëve. Vlera historike e shkollës dhe arsimit shqip ishte therre në sytë e politikës së atëhershme për ngritjen e vetëdijes kundër shpërnguljes së shqiptarëve, kundër çkombëtarizimit.

Si e treta, shkolla bëri propagandë kundër propagandës për arsim në gjuhën amtare. Ajo ua prishi llogaritë politikëbërësve komunist. Ato e shikonin shkollën shqipe si djall. Djalli, thotë populli, as nuk lëvron as nuk punon. Politika maqedonase e udhëhequr dhe e përkrahur nga politika serbokomuniste, morri masa të gjera kundër shkollës shqipe dhe mësuesve të saj.

Por historia e re filloi. Dhe sot shënojmë 75 vjetorin e shkollës së parë shqipe. Ndoshta nuk gabojmë nëse them se shkolla, arsimi shqip filloi të na jap fe, shkrim–lexim, emër, gjuhë, histori, kulturë, gjeografi. Mësuesit punuan me kompetenca të larta profesionale. Ata veprimtarinë e plot pedagogjike dhe arsimore e realizuan në një mjedis të etur për dituri, për gjuhë shqipe dhe histori kombëtare.

Arsimi në këtë periudhë do t'i përgjigjej tri sferave të rëndësishme: kulturore, historike dhe kombëtare. Në këtë kuptim rol të rëndësishëm kishte shkrimi dhe mësimi i gjuhës shqipe, formimin e ndërgjegjes dhe vetëdijes kombëtare dhe ngritjen kulturore të popullatës.

Me hapjen e shkollës së parë dhe vargun e shkollave të tjera, të njëpasnjëshme, arsimi shqip arrin të organizohet mes veti dhe të unifikohej veprimi i tyre, mbase mësuesit e parë shqiptar vinin nga

e njejta hapësirë shqiptare dhe, për rrjedhojë, reflektonin interesa të njejta arsimore, politike, historike e kombëtare.

Vështirësitë në hapjen e shkollave ishin të mëdha, prapambetja nga e kaluara kishte lënë mbresa e pasoja, por shkollat nisën duke përmbytur çdo gjë që e la shqiptarin, popullin të prapambetur, në injorancë e padije, ofroi dije, kulturë, arsim. Shkollat shqipe dhe mësuesit nga Shqipëria u përkrahën nga populli dhe dita më ditë rritej numri i nxënësve. Është me interes të theksoj se edhe femrat, ndoshta jo në numër të madh u përfshin në procesin e shkollimit.

Emrat e mësuesve i shënova në kontekstin e shkollave sipas qyteteve Tetovë, Gostivar, Diber, Kërçovë dhe Strugë me rrethinat, që përmenden në trajtesa, dokumente e burime të ndryshme.¹³⁴ Në vazhdim emrat i jap sipas radhës alfabetike, po megjithatë, ka mundësi të mos jenë përfshirë të gjithë:

–Abaz Xhafa, Abaz Shehu, Abdi Axhiu, Abdi Kërçipi, Ali Bajrami, Ali Tenhai, Ali Myderizi, Abdylhaqim Dogani, Abdylaqim Seiti, Abdyl Keçi, Ahmet Pere, Andoneta Leka, Antoneta Sherko, Afërdita Gjylapi, Alipi Pajuni, Alush Balteza, Antoneta Gjylapi, Afërdita Deljana, Afërdita Monçi, Abedin Faja, Abdyrahim Behluli, Ahmet Gjylaçi, Amet Treni, Azem Morana, Ahmet Gjylaçi, Ajshe Gjylaçi, Ajshe Ruka, Amet Punasheci, Artemini Hoxholli, Aleksandra Bibaja, Athina Dinisqoti, Afërdita Jano, Afërdita Bekteshi, Alush Balltezi;

–Baki Zeneli, Behxhet Haxholli, Beqir Kllojka, Braho Dobri;

–Dalip Zejneli, Dedë Shala, Dodona Ekali;

¹³⁴ Abdylazis Veseli, Shkollat dhe arsimit shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941 – 1944, Cabej, Tetovë, 2000, f. 27 – 88; Arben Llalla, Historia e arsimit shqip në Tetovë 1941 – 1944, “Koha”, 8 janar 2009; Qerim Lita, “Misionarët e parë të arsimit shqip në tokat e lirueme”, “Koha”, 7 mars 2015; Qerim Lita, Misionarët e parë të arsimit shqip, “Koha”, 5 – 6 shtator 2012; Veteranët e arsimit shqip në Tetovë dhe rrethinë prej 1940 – 1960, monografi, Tetovë, 2000; Zejnel Lufi, 50 vjet të arsimit shqip në trevën e Strugës, Strugë, 1999, f. 61 – 62.

–Dhimitër Fullani, Dhimitër Pullati, Dhimitra Gjini, Dhimitër Shulitmani;

–Enver Palluqi, Edip Tërshena, Elena Todi, Elena Pullati, Eleni Dasho, Emin Softo, Enrieta Panduku, Enver Agolli, Enver Kalefi, Erniane Shuli, Elez Maho, Esat Mezelxhiu, ;

–Faik Pajuni, Faik Qatipi, Fahri Sulo, Fatbardha Caushi, Ferosal Belegu, Fetah Ajdini, Fadil Hoxha, Fedhra Pisha;

–Gani Daiu, Gliqeri Velko, Gafur Rada, Gani Jaja, Gani Shehu, Gani Graceni, Gavril Santo;

–Gjergj Bullati, Gjergj Bekteshi;

–Haki Hiseni, Hamdi Gani, Hamit Pitja, Haki Pohuni – Allajbegu, Hasan Rrapi, Hasan Ibrahimini, Hamit Muça, Haso Egro, Hasan Tetelu, Hasan Safa, Hasan Preka, Hasan Belshaku, Hidër Manjani, Hysen Pajenga, Hysen Hasani, Hysen Abdihoxha, Hamdi Zabzuni, Hysni Ekmeçiu, Hysein Cela, Hysen Kola, Hiqmet Kasapi;

–Islam Hoxha, Ibrahim Zabzuni, Ibrahim Doraci, Ibrahim Xhafa, Ibrahim Kuka, Ibrahim Bajrami (nga fshati Radostushë), Ibrahim Neziri, Ismail Shabani, Isan Baholli, Ismail Bedhija, Irfan Oruçi, Izet Buzo, Islam Shahini, Idriz Deda;

–Jalldëze Haxhihyseni, Josif Todi, Jonuz Balla, Josuf Starova, Jorgji Bekteshi, Jovan Popa, Jovan Jorgji, Jorgji Shuteriqi, Jusuf Kaba;

–Kamber Xherija, Kamber Kazazi, Kamber Osmani, Kadri Hoxha, Kadri Jashari, Katusshe Cerekja, Konstanca Dhimitri, Kriseanthi Themo, Koço Floku, Kov Bibaja, Kristaq Gojo, Kristaq Proгри, Krisvagji Niço, Ktheofan Dokja;

–Liri Topalli, Lirie Todi, Liri Ekmeçiu, Liri Babamato, Lirije Shahini, Lirika Nikolla, Lazër Bibaja, Lefan Oruçi, Lutfi Memeti, Llaqi Prenqi, Llambi Naka;

–Marjeta Kreshova, Marika Naqo, Marije Shala, Marije Dashi, Margarita Gollani, Mamut Dumani, Mahmud Toro, Mihal

Pjeshkazini, Mit'hat Hoxha, Mit'hat Cami, Myfit Synojmeri, Meri Thoma, Mexhit Bekteshi, Meliha Molina, Meliha Bejleri, Menduh Skikuli, Mirteza Kacadej, Mihail Pandufi, Mehmet Karadaku, Myrteza Peza, Muhamet Qerisha, Myfit Imeri, Mustafa Shahinaj, Mehmetali Mustafa;

–Naim Babameto, Nadie Qausi, Nazmi Reza, Nexhip Minarolli, Nos Topalli, Nos Deljana, Nexhbedin Aliti, Nuri Sula, Nevruz Vila;

–Osman Luta;

–Pandeli Guçi, Paulina Grabocka, Pano Hido, Pandi Treska, Perikli Bebie, Petrit Sejrani, Petrit Hakani, Pertef Therepeli, Petes Kavaja, Pjetër Kavaja, Pjetër Janura;

–Qamil Skuqi, Qamil Blloshmi, Qemal Agolli, Qemal Hatraxhiu, Qemal Haxhihasani;

–Reis Poshi, Remzi Xhemaili, Remzi Sefedini, Remzi Prapaniku, Remzi Pustina, Ridvan Palluqi, Ruzhdi Guranjaki, Rustem Ismailati;

–Sami Lamçi, Sami Gonxhija, Sami Raça, Sabri Goda, Sadete Hashimi, Sadik Kadilliu, Sali Caushi, Seit Xaxa, Servo Doraci, Skender Hoxha, Skender Tupja, Skender Haxhihyseni, Skender Haxhiademi, Selman Qorri, Spiro Gjini, Spiro Vëllazëroi, Servet Maho, Suat Caushi, Sulejman Qausi, Sulejman Osmani, Sulejman Karai, Selman Hitaj, Selma Musa Hitja, Sejfedin Noto, Spiro Popa, Sofika Progri, Sotir Gollani, Stefan Matea, Sofika Stavro, Sotir Qirjaku;

–Shaqir Myhyrdori, Shukri Skenderi, Shpresa Kenxo, Shyqëri Ahmeti;

–Tanas Ceku, Talat Cela, Tajar Zylfiu, Tahsin Daiu, Tefta Izgari, Teufik Balla, Teufik Spahiu, Tomor Starova, Todi Lama, Thanas Ceku, Themistokli Treska, Theodora Teska, Theomaidha Rraka, Thoma Kalefi, Theodora Biçka;

–Uranija Zaharija;

–Vangjel Daka, Vangjel Filo, Vasil Naqi, Vejsel Hyseni, Vasil Papajani, Vasil Andoni, Vasil Dhimitrosi, Violeta Monçi, Violeta Kota, Vojsava Ekali;

–Xhafer Narazani, Xhafer Shefkiu, Xhafer Qatipi, Xhevat Kallajxhiu, Xhevat Xhafa, Xhemal Kulli, Xhemal Voci, Xhemal Qollaku, Xhyhere Belshaku;

–Ymer Beqiri;

–Zenel Zajmi, Zenel Ekali, Zef Qurçija, Zihni Ciça, Zenko Mehmeti, Zeqir Spahiu, Zija Sadiku, Zejnepe Bejleri, Zija Mehmeti, Zydi Kajnak.

Prandaj është e denjë të përkujtojmë këta mësues që ngjallën ëndërrat dhe nxitën ide. Ata realizuan një projekt të pedagogjik madhor të planifikuar mire me domethënie të madhe historike – kombëtare.

Është me interes të shtoj vendet nga erdhën mësuesit, këta heronj të kombit e të dijes. Sipas të dhënave mësuesit erdhën për t'i shërbyer atdheut dhe numri më i madh i tyre ishte në Tetovë me rrethinë. Mësuesit ishin nga qytetet Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Krujë, Gjirokastrë, Pogradec, Kavajë, Burel dhe Peshkopi.¹³⁵

Mësuesit e parë jepnin punë, djersë e kënaqësi, teksa shihnin përmirësimin e jetës, kujdesin e popullit për shkollë. Ata propagandonin dijen, kulturën, afrimin. Ishin të pajisur me dije pedagogjike dhe i njihnin kërkesat e kohës. Përveç punës me nxënës, ata punonin edhe me të rriturit në arsimimin e tyre, organizonin kurse ku ua mësonin shkrim – leximin, historinë, gjuhën amtare, bënin biseda nga historia e popullit shqiptar, etj. Kështu ata krijuan bazën e andragogjisë kombëtare.

¹³⁵ Shiko Monografinë Veteranët e arsimit shqip në Tetovë dhe rrethinë prej 1940 – 1960, Tetovë, 2000, f. 8 - 12

Mësuesit që realizuan arsimin në shkollat shqipe ishin pionerët e arsimit dhe kulturës shqiptare të mohuar deri në atë kohe. Ky ishte mision i madh me reflektime të gjera shoqërore. Ata punuan në qytete e fshatra të paelektrifikuar, pa shkolla ose ndërtesa shkollore jo adekuate, por kanë punuar me zell dhe përkushtim.

Ata u bënë të njohur ndër bangat e shkollave fillore dhe popullatën. Ata u bënë aplikues dhe drejtues të metodave të reja. U pranuan nga popullata duar hapur dhe me dashuri të madhe e respekt. Për këtë arsye kishte edhe reagime. Në një raport është vërtetuar, sigurisht me keqardhje se “Shqiptarët i donin mësuesit, por jo pushtetin Italian”.¹³⁶

Hapja e shkollave dhe roli i mësuesve qëndronte në përpjekjen për konceptimin e identitetit shqiptar përmes elementit historik, gjuhës, letërsisë, moralit, duke e korrigjuar identitetin e rremë që edukonin dhe zhvillonin mësuesit serb në gjuhën serbe.

Krahas punës voluminoze arsimore e pedagogjike në shkollë, mësuesit ishin prind shembullor, rrezatonin edukatë, ndjesi të lartë qytetare. Ato bënë përpjekje për të bërë gërshetime të ndryshme, të natyrshme të kulturës dhe kombëtares, të gjuhës dhe historisë, të dijes dhe vlerës thjesht të ardhmes dhe të momentit. Në punën e tyre propagonin ndershmëri, dashuri për punën, plot vlera që ende dhe sot shqiptarët e Maqedonisë thirren në to dhe i kujtojnë me respekt, me besnikëri i ruajnë kujtimet e tyre. Në këtë kontekst me të dejtë konstaton V. Xhemaili se “.. kurrë nuk mund të harrohen vitet 1941 – 1944, kjo renesancë katër vjeçare i dha popullit shqiptar të kësaj ane dritë, mësuan për herë të parë shkrim leximin në gjuhën amtare. Kjo veprimtari duhet shënuar me shkronja të arta, ishte tejet e dobishme në ngritjen e vetëdijes kombëtare, të

¹³⁶ Vebi Xhemaili, Shqiptarët e Maqedonisë në mbrojtje të Shqipërisë etnike 1941 – 1945, Tetovë, 2008, f. 60, cit. nga AM – Shkup, Raport dërguar Armata e III e Jugosllavisë, Ministrisë Punëve të Jashtme në Beograd, Kut. 36/7, nr. 771, 12. IX.1939, Beograd

cilët me sakrifica të mëdha dhe në kushte të jashtëzakonshme të pamundshmen e bënë të mundshme...”.¹³⁷

Mësuesit me punën e tyre pedagogjike arritën disa prioritete me rendësi: të krijojnë vlera të përbashkëta, të afirmojnë dhe zhvillojnë gjuhën shqipe të unifikuar, të krijojnë kulturë, të ndërtojnë histori të përbashkët për atë kohë sa ata vepruan.

Për funksionimin e shkollave shqipe dhe rolin e mësuesve në “tokat e lirueme”, ministri Koliqi shkroi edhe pesë porosi të fuqishme e domethënëse për sjelljen, punën dhe për veprimin e tyre (3 shtator 1941):

“1. Mos me u përzi në çashtje politike, fetare e minoritare; 2. Mos me u përzi në çashtje lokale apo administratash të tjera; 3. Me u pru mirë me popull e me ja fitue zemrën këtij me punën t’uej të naltë të zbatueshme me mend e me themel si brenda edhe jashtë shkollës; 4. Me i trajtue nxansit e nxanset me dashtuni atnore dhe në mënyrën ma të përsosun të një edukatori, tue i ndihmue me durim që të kapërcejnë vështirësitë e fillesës e veçanërisht në mësimet e para; dhe 5. Me jetën t’uej private të rregullt e të nderhme të jeni shembulla ma e përsosun e vetive burmore të shqiptarit të kulturuar”.¹³⁸

Veprimtaria arsimore e mësuesve zhvillohej me përgjegjësi dhe sipas aspirimeve të tyre personale e profesionale.

Gjithë veprimtaria pedagogjike që realizuan mësuesit i shërbyen një qëllimi madhor arsimor më sakt, do të thosha, një qëllimi zyrtar. Ky qëllim buronte nga porositë e ministrit, nga misioni i shkollës dhe nga qëllimet shtetërore. Pra roli i shkollës përthyhej sipas detyrimeve dhe funksioneve që kryen çdo shkollë e mësues në kontekstin e detyrimeve kombëtare.

¹³⁷ Po aty, f. 303

¹³⁸ Cit. nga Qerim Lita, “Misionarët e pare të arsimit shqip në tokat e lirueme”, “Koha”, Shkup, 7 mars 2015, f. 15;

Një ish nxënës i mësuesit Vangjel Daka, nga Xhepçisht ditën e parë të shkollës dhe orën e parë mësimore e përshkruan me fjalët vijuese të mësuesit: “Mirë se erdhët nxënës të dashur. Prej sot ju do të mësoni në gjuhën tonë të dashur amtare, e jo siç keni mësuar më parë në gjuhë të huaj serbokroate dhe italiane”.¹³⁹

Me konstituimin e Maqedonisë si njësi federale e ish federatës Jugosllave, komunistët maqedonas e riformuluan politikën e shkollës e të arsimit. Shkollat shqipe filluan të hapen me programe, përmbajtje e ideologji të reja. Mësuesit nga Shqipëria filluan të nëpërkemben, të ndjekën, të largohen, madje edhe të burgosen. Shkollat në përgjithësi e në veçanti ato fillore pas mbarimit të luftës dhe krijimit të Maqedonisë socialiste filluan me një fizionomi të re. Ajo hasi përsëri në mungesë të mësuesve.

Një pjesë e mësuesve të ardhur nga Shqipëria vazhduan të punojnë edhe më tej në shkollat fillore e të mesme. Përsëri në mungesë të kuadrit arsimor vendor për shkolla fillore dhe ato të mesme erdhën mësues kryesisht nga Struga, Dibra, Ohri, Shkupi etj. Vlen të përmendi disa nga këto si: Jusuf Skora, Ali Vishko, Moisi Lutfiu, Nexhat Agolli, Ana Sopi, Hikmet Kasapi, Shazije Hoxha, Nexhat Pustina, Xhavit Kaba, Celebie Toska, Mediha Kuriu, Moisi Lutfiu dhe shumë të tjerë

Shkolla shqipe dhe arsini shqip që në nismë u përballë me veprime joparimore, të paqendrueshme dhe jokonsistente. Kësisoj shkollën shqipe e ndjekin ngatërrestar. Hapja e shkollave aq sa e ngjalli shpresën te shqiptarët për ardhmëri, ajo nxiti shumë udhëheqës shqiptar e jo shqiptar të kohës, të shtyrë, gjithsesi nga politika komuniste, të bëjnë koncesione me interesat e shqiptarëve dhe si të këtillë krijuan historinë dëshpruese, u bënë model i poltrenizmit dhe inkosekuencës politike e kombëtare.

¹³⁹ Nxënësi quhet Sulejman Sadiku, i cili më pas ka qenë arsimtar i gjuhës shqipe dhe drejtor i shkollës në Xhepçisht, sot është në moshë të thyer, në pension. Gjerësisht në librin e tij “Historiku i arsimit dhe i popullatës të fshatrave Poroj, Xhepçisht, Xhermç e më gjerë”, Tetovë, 2010, f. 19

Për më shumë se gjysmë shekulli, skenën arsimore dhe shkollën shqipe në Maqedoni e përcjellë izolimi total nga arsini kombëtar. Pra shkolla shqipe u zhvillua në parime dhe vlera tjetërfare, me dallime të thella politike, programore, ideologjike.

Vetëm se duhet patur parasysh një gjë: derisa flasim për këtë gjendje apo histori të shkollës shqipe në Maqedoni, duhet të tërheqim qartë një vijë ndarjeje midis veprimit arsimor dhe politik të mësuesve. Shkolla shqipe nuk kishte shumë gjëra të përbashkëta me shkollën maqedone. Më anë tjetër, arsini dhe shkolla në një shtet të varfër e nacionalist me pretendime asimilimi, me ndikim të jashtëzakonshëm politik mbi shqiptarët, stimulonte arsimin në gjuhën turke, shpërnguljen e shqiptarëve, minimizimin e arsimit shqip.

Gjysmë shekulli më vonë shkolla dhe arsini shqip filloi të marrë fizionomi të re, fuqimisht e përkrahur nga shqiptarët. Në këtë kontekst, ajo dallohet në dy aspekte:

Së pari, shkolla shqipe me gjithë mangësitë në ecje e sipër arrinë t'i imponohet pushtetit maqedonas dhe të përfitoj mbështetje nga popullata shqiptare për masovitet që nuk ishte karakteristike e viteve pas çlirimit 1945 – 1960.

Së dyti, shkolla shqipe arrinë në kontinuitet t'i imponohet politikisht shoqërisë duke u bërë faktor relevant në zhvillimet politike, intelektuale, arsimore, fetare, shkencore e të ngjashme.

4. PËRFUNDIM

Nga këto që thamë mund të arrihet në përfundimin se:

(1) Hapja e shkollave në viset shqiptare ishte kthesë historike për arsimin, historinë dhe të ardhmen e shqiptarëve. Shkollat e para e

kthyen dinjitetin në jetën e shqiptarëve, ato e ndryshuan politikën ndaj tyre;

(2) Shkollat e para në gjuhën shqipe dhe mësuesit e tyre gjithmonë kanë patur në qendër të vëmendjes së tyre ngritjen e vetëdijes kombëtare, kulturës dhe gjuhës amtare. Ky është qëllimi themelor historik mbase shqiptarët kishin mësuar në gjuhë të huaj e histori të huaj;

(3) Roli historik i shkollës shqipe në kontinuitet me të sotmen, arriti vizione dhe hapi shtigje të reja. Natyrisht këto shkolla dhe mësuesit e tyre zhvilluan edhe aspekte të tjera patriotike e kombëtare me çka e begatonin jetën. Shkolla u bë vendi ku përcaktoheshin vlerat dhe kultura shqiptare;

(4) Meqë shkolla në gjuhën shqipe mungonte përshkak të pushtimit serb dhe arimi realizohej në gjuhën serbe, hapja e shkollave në gjuhën shqipe edhe pse u përkrah fuqishëm nga popullata shqiptare, përsëri në nismën e shkollave kishte pengesa të shumta objektive dhe subjektive.

TAHIR ZAJAZI

Shkup

VËSHTRIM NË KATËR BARRIERA QË E DENIGRUAN ARSIMIN SHQIP NË MAQEDONI (1941–2016)

Për ngritjen e një shoqërie të shëndetshme dhe perspektive në mirëqenie, janë dy shtylla substanciale: arsini dhe shëndetësia. E para ushtron forcën e trurit, ndërsa e dyta mbështet mendjen në ndryshimin e gjendjeve të mjedisit. Mendja gjeneron ide mbi humanizimin e natyrës dhe përshtatjen e burimeve të saj që njeriu të jetojë në mirëqenie. Mendjen e ndrit shkollimi dhe si rrjedhojë, gjithë çfarë perceptojmë në hapësirën përreth, është prodhim i forcës së arsimit. Kjo forcë e favorizon, gjithashtu, evoluimin e civilizimit dhe të kulturës së mjedisit shoqëror. Dhe kështu, ndodh avancimi i cilësisë së konceptioneve nga ata të botkuptimeve tradicionale të mjedisve primitive agrare, deri në konceptime moderne të shkallëzuara regjionale e kombëtare, deri globale. Sepse në ndërkohë, krijohen vlera me cilësi të reja, që trashëgohen nga brezi në brez dhe në rrjedhë kontinuive shkallëzon avancimi i themeleve të civilizimit dhe të kulturës mbi baza të shkencës, që ne e quajmë modernizim. Kjo më parë fillon në familje, e më pastaj proceson gjatë arsimit formal e joformal, me trend drejt majave të vlerave gjithënjëzore. Fare shkurt, arsini e bën jetën e njeriut të jetë në mirëqenie.

Kombi i jonë, për fatin e tij nuk arriti t'i prek statet e evoluimit të avancuar të arsimit në shekuj. Në presion të perandorive të radhave (romake, bizantine, osmane, sllave), shqiptarit iu imponua që ai të rrjeshtohet në skaje të arsimit dhe të kulturës. Bile edhe aktualisht kur shënojmë 75 vjetorin e shkollës shqipe, nuk arritëm

dot t'i shpëtojmë diskriminimit shtetëror të arsimit shqip në Republikën e Maqedonisë.

Për rastin konkret, pretendojmë që nga një kënd tjetër të hedhim dritë në katër barriera, që në intervalin e viteve 1941–2016 e rrudhën gamën e shkollimit të popullatës shqiptare.

1. POLITIKA E PËRFSHIRJES SË PJESËRISHME TË SHQIPTARËVE NË SISTEMIN E SHKOLLIMIT

Ne të gjeneratës që e jetuam intervalin e viteve 1941–2016, jemi protagonist të qëndrimit diskriminues me elegancë tinëzare të politikës shtetërore ndaj arsimit formal dhe joformal shqip. Për ta perceptuar këtë më nga afër, rikujtomë se shkolla nuk është thjesht klasë, nxënës, mësues. Janë edhe faktorë të tjerë që shkollën dhe sistemin e shkollimit e bëjnë të jetë rezultativ në misionin që ushtron. Ai është një kompleks i orkestruar nga një sërë institucione që e favorizojnë efektin e arsimimit të gjeneratave. Ne qëllimisht i nominojmë ata si, p.sh. institucionet e politikës globale të pushtetit, ata të politikës parciale për arsim, shkencë dhe kulturë, madje universiteti, akademia e arteve të bukura, institutet e shkencave adekuate, akademia e shkencave dhe arteve, biblioteka, universitetet popullore shumë të favorshme të kohës për tejkalimin e analfabetizmit, institucionet profesionale për arsim (enti pedagogjik, etj.), masmediat, institucionet e kulturës dhe çdo çerdhe tjetër e organizuar shoqërore, e cila qëllimisht dhe funksionalisht e mbështet arsimin formal të gjeneratave kur ata shkollohen, dhe atë joformal jashta shkollës dhe pas shkollimit gjatë tërë jetës; favorizojnë, gjithashtu, transferin e vlerave në ndërrimin e gjeneratave. Provat e studimeve empirike për këtë demonstrojnë se institucionet e posatheksuara, janë çerdhe ku ndodh gjenerimi i ideve mbi standarde dhe vlera arsimore, që madje u adresohen gjeneratave.

Në favor të këtij diskutimi, theksojmë se që nga vitet e pas Luftës së Dytë Botërore dhe në vazhdimësi, institucionet përcjellëse të sistemit të shkollimit që i nominuam, përjashtuar shkollën si objekt fizik formal i traditës dhe resurseve elementare që e bëjnë atë (mësuesi, klasa, bankat, numërorja, dërrasa e zezë), nuk u themelua ndonjë institucion i kësaj natyre që do mbulonte edhe pjesëmarrësit shqiptar në sistem (nxënësin, mësuesin, prindin). Por jo vetëm kjo.

Ende edhe më e keqja është se shkolla shqipe evoluoi, jo vetëm e rrudhur maksimalisht, por edhe e vonuar me ndjeshmëri të skajshme në hapjen e saj, me gjasë qëllimisht e menduar, që me elegancë të arrihet minimumi i përfshirjes së kësaj popullate në shkollim. Kjo kështu shprehet në tërësinë e evoluimit të rrjetit të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm. Numërohej në gishta ndonjë institucion parashkollor shqip. Madje, shkollat e para tetëvjeçare dhe ato të mesme ishin edhe të vonuara, edhe të rralla. Ndërsa, arsimimi universitar shqip ishte tabu—temë, bile fare e pa planifikuar. Regjistrimi i ndonjë shqiptari në Universitetin e Shkupit ishte i rastisur, në kuota të veçanta, ashtu siç ndodhte për qytetarë të shteteve të huaja. Për kurtuazi, nga gjithsej të diplomuar në Universitetin e Shkupit, ishim vetëm 1.8% shqiptarë.

Për rastin, përzgjedhëm tre shembuj që e demonstrojnë këtë. Demonstrojmë me shembulin e Kërçovës me regjionin e tij atje. Shkolla e vetme e plotë fillore ishte ajo e fshatit Sërbicë, “GJ.K. Skenderbe”, e imponuar të mbulojë shkollimin e fëmijëve të shqiptarëve të qytetit me rrethinë në dy krahët e regjionit, Zajazit dhe Oslomesë, me afër 20 fshatra. Për gjeneratat sot tingëllon si të ishte përrallë t’ua shpjegosh sakrificën e pak nxënësve të fshatrave që udhëtonim në këmbë deri edhe 15 kilometër rrugë në një drejtim, për t’u shkolluar në kushte të ashpra klimatike.

Edhe një shembull që demonstroi gjendjen në rrethinën e Shkupit. Për shkollimin tetëvjeçar të fëmijëve shqiptarë të Nerezit

dhe fshatrave të Dërvenit, duhej pritur afër dy dekada kur në vitin shkollor 1960–61 u avancua Shkolla Fillore “Drita” e Sarajit, në tetëvjeçare e vetme e këtij regjioni, ku autori i këtij shkrimi është mësuesi i parë që drejtoi klasën e pestë me gjithsej 36 nxënës të regjionit të Dërvenit me Nerezin. Ironia është se shqiptarët e Shkupit me rrethinë u akuzuan, bile akoma edhe aktualisht se si ndodhi që ata, pranë metropolës së Shkupit, nuk u shkolluan!

E mbyllim me shembullin e tretë të shkollimin të lartë. Pas themelimit të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, më 1947, që ndodhi paralelisht me 7 shkronjat e para të alfabetit cirilik në formim dhe gramatikës së parë, e përkujdesur nga prof. Krume Kepevski, me përjashtim të seminarit të Albanologjisë që e drejtonte dr. Petro Janura, duhej pritur plot dy dekada derisa në vitin 1967, pranë Akademisë Pedagogjike “Shën Klimenti i Ohrit” që dispononte gjithsej 15 grupe studiuëse, u lejua themelimi i 5 grupeve për studime paralel në gjuhën shqipe: biologji–kimi; kimi–fizikë; matematikë–fizikë, histori–gjeografi dhe grupi klasor, që ishin të pashmangshëm për mbulimin e kuadrit të fushave elementare të shkollave fillore shqipe. Dhe për kurtuazi, po përmendim se, deri në mbylljen e dhunshme të studimeve shqipe në Akademinë Pedagogjike, nga gjithsej të diplomuar (7.147), janë 986 shqiptarë, ose në shprehje relative, 23.77% shqiptarë (*Zajazi, T. 1999&1944*).

Llogaritur në shembuj të radhave të kësaj natyre nga njëra anë, dhe vështruar në institucione plotësuese që ishin në numër me bollëk, nga ana tjetër dhe t’i perceptosh ato në raport me gjendje të mjerueshme të institucioneve shqip, shtuar edhe ato të kulturës, të kaplon tmerrri përball diskriminimit aq të egër të gjeneratave shqiptare në arsim dhe në kulturë.

2. RRUDHJA TINËZARE E SHANSEVE PËR T’U PUNËSUAR

Sfida e dytë e diskriminimit në arsim, ishte ngushtimi i grykës së punësimit të kuadrit shqiptar në sektorin shoqëror. Një mbulesë dinake e kësaj politike që na ndiqte, ishte “arsyeja” absurde që akuzonte se “shqiptarët nuk kanë kuadër të shkolluar”, por pa e sqaruar deri në fund burimin e shkaqeve. Kjo “mbulesë” iracionale e inskenuar i shërbente politikës si mjet për zbehjen e motivit të gjeneratave për shkollim, që më pastaj me elegancë prefide i imponohet shqiptarit të vetpërrjashtohet nga jeta produktive shoqërore.

Për këtë flasin të dhënat statistike. Në sektorin shoqëror, shënohen vetëm 3% të shqiptarëve të zënë me punë. Andaj, ata pak shqiptarë të shkolluar u detyruan të kërkojnë burime tjera alternative, bile edhe më banale për të mbijetuar. Nda 3% –shi i të punësuarve, më të fatshëm ishin mësuesit, sepse natyra e misionit që ata e ushtronin, kërkonte të dinë të flasin shqip. Falë qëndrimit averziv të palës tjetër të mësojë shqip, dominoi kuadri i palës shqiptare.

Një e keqe tjetër më tmerruese ishte përndjekja ideopolitike, që në vazhdimësi e torturoi shtresën e intelektualëve më dinjitozë dhe cilësorë shqiptar. Fushata e shpërnguljes me dhunë të familjeve shqiptare, ndikoi akoma më ndjeshëm në qëndrimin averziv të prindërve ndaj shkollimit të fëmijëve të tyre. Ka të ngjarë se shqiptari i përballur me sfida të kësaj natyre barbare, asnjëherë nuk e përjetoi shkollën si tempull të vetin për të vjel dije dhe kulturë. Në ndjesi latente ai shkollën e përjetoi si të ishte e huaja, e pushtetit që frymon ndryshe dhe e diskriminon. Andaj, shqiptari i futur në shkollë (si mësues, nxënës, prind), shkollën e përjetoi më shumë si institucion i përndjekjes se sa çerdhe e dijes dhe kulturës.

3. RRËNIMI I PAS NGJARJEVE TË VITIT 1981

Në intervalin e dekadave të qeverisjes socialiste, hapësira e arsimit shqip u zgjerua aq sa ishte në interes të politikës shtetërore. Me elegancë u limitua vijë e kuqe e shansës së emancipimit shpirtëror

dhe material të kësaj popullate. Në ndërkohë u inskenua qëndrimi mbi “emancipimin” e gruas, me theks të asaj shqiptare, por jo edhe përkrahje e sinqertë me shansë për punësimin e saj.

Kushtetuta e vitit 1974 krijoi kushte për arritje të lakmueshme të shqiptarëve në arsim. Ajo ishte koha më e ndritur për shqiptarët. U zgjerua rrjeta e shkollave të mesme. U respektua kuota e 10%-shit të përfshirjes së pakicave nacionale në shkollim universitar.

Më e keqja ndodhi pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë. Eskaloj epshi albanofob. Ndërsa, në Maqedoni u zhvilluan laboratore eksperimentale kundër arsimit dhe kulturës shqiptare, që ajo madje të bartet edhe në Kosovë. U rrënuan edhe ato pak të arritura të periudhës së kaluar në arsim. Me parullën e politikës djallëzore mbi “paralele të përzieria”, u ngrit mekanizmi i mbylljes së paraleleve shqipe në shkollat e mesme të Maqedonisë. Nga gjithsej 17 shkolla të mesme shqipe, apo shkolla të mesme ku zhvillohej mësimi edhe në gjuhën shqipe, mbetën formalisht të hapura vetëm dy sish, Gjinnazi “Zef Lush Marku” në Shkup dhe ai në Dibër. Ndodhi, bile edhe djegia e librave dhe bibliotekave të shkollave fillore e të mesme shqipe.

Gjithashtu, me parullën e diferencimit ideopolitik të kuadrit shqiptar, u larguan nga puna mësuesit më cilësor të shkollave fillore dhe të mesme. Kjo akoma edhe më egërsisht u demonstrua në Akademinë Pedagogjike, të asaj kohe në Shkup. U inskenua parulla e politikës, kinse e “racionalizimit të arsimit universitar” dhe me metoda më barbare e më çnjerëzore ndodhi shkapërderdhja e 24 profesorëve të këtij institucioni të lartë, i vetëm që frymonte shqip. Disa u akuzuan se kanë “rënë” ndesh me Platformën e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë që të fitojnë diferencimin ideopolitik, si parakusht për t’i përjashtuar edhe nga puna; ca të tjerë më me “fat” u pensionuan para kohe dhe një numër sish pësuan me degradimin e vendit të punës që kështu, pikërisht më 7 tetor të vitit 1987, me dekret të ministrit të Arsimit të asaj kohe, Savo Klimovski,

përfundimisht u shua veprimtaria e studimeve shqip edhe në Akademinë Pedagogjike “Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup.

Qëndrimi diskriminues në dekada i politikës shtetërore ndaj arsimit shqip, arriti efekt të drejtpërdrejt në reduktimin me elegancë të shqiptarëve në shkollim. Rrjedhimisht, vonesa në hapjen e shkollave tetëvjeçare, nxënësit e shkollave katërvjeçare ishin të demotivuar, sepse nuk kishin hyrje të plotë në tetëvjeçare; nxënësit e kryer të tetëvjeçares i ndiqnin ethet e hyrjes në ndonjë shkollë të mesme; ata të shkollës së mesme i tmerronte restrikcioni selektiv i hyrjes në shkollim të lartë; absolvimi në ndodnjë shkollë të mesme apo të lartë, nuk të siguronte një vend pune.

Për tejkalimin e këtyre sfidave, një numër i të rinjtë të moshës shkollore, vazhduan shkollimin e mesëm dhe universitar jashtë Maqedonisë. Disa që absolvuan, u hodhën atje me ndonjë angazhim pune. Të tjerët morën rrugën e kurbetit, ashtu si edhe pjesa tjetër e rinisë shqiptare, e mbetur jashtë sistemit të shkollimit në përpjekje për të gjetur ekzistencë në ndonjë vend të perëndimit.

4. TRANZICIONI ME PASOJA TË NJË EKSTREMI NDR YSHE

Pavarësimi i Maqedonisë (1991) me Kushtetutën e re të deklaruar demokratike, nuk e garantoj atë që e prisnim shqiptarët autokton, që të jenë shtetformues të shtetit që u takon. Sepse, politika plurale e tranzicionit u vu mbi themele të politikës moniste, që akoma edhe aktualisht është vazhdimësi e saj me avaze nga e kaluara ndaj arsimit dhe kulturës shqiptare.

Me nismë të shoqatave civile shqiptare dhe përkrahjen e bllokut politik shqiptar, nga rrënojat passocialiste u ngit ajo çka ishte e mundur në arsimin fillor dhe të mesëm shqip. Me nismë të kuadrit akademik shqiptar, të përkrahur nga politika shqiptare e tri

komunave (Tetovë, Gostivar, Dibër) dhe përkrahjen e fuqishme materiale e morale të popullatës shqiptare, e etur për dije, u themelua Universiteti ilegal i Tetovës, më 17 dhjetor 1994. Gjithashtu, me nismë të Bashkimit Evropian dhe SHBA–ve që kishin për qëllim relaksim të tensioneve të rënduara ndëretnike, u themelua një universitet prestigjioz që do të shembëllente në mjedis dhe në regjion, Universiteti i Evropës Juglindore, me kusht të politikës maqedonase që edhe ai të ngritet jashtë Shkupit, në Tetovë, më 20 nëntor 2001. Këto ishin arritje e mundshme maksimale të shqiptarëve të Maqedonisë.

Në pritje të avancimit, ndodhi ngulfatja e gjërave në presion të politikës në tranzicion. Ajo ra ndesh me idealin e premtuar. Për ideal e imponoi interesin e ngusht familjar, klanor dhe grupor. Edhe arsini u okupua në interes të politikës. Filloi rënia sistematike e standardeve dhe i vlerave, bile edhe i atyre tradicionale që i trashëguam nga regjimi i kaluar në arsim. Rrjedhimisht, vërshoi vala e seminareve të dizajnuara, me pretendim që kuadri arsimor tradicional i shkolluar ndryshe të transformohet në kuadër modern, që ai më pastaj ta ndyshojë klasën, shkollën dhe mjedisin. Kjo praktikë e dështuar kohë më parë në vendet e zhvilluara, tek ne u katandis në intervalin e viteve 1994–2006, që për ironi, fakultetet prodhonin, bile edhe aktualisht prodhojnë kuadër tradicional. Andaj, rezultati që pritej dështoi ashtu siç kishte ndodhur më herët edhe në vende të zhvilluara, kur ata kishin kushte të zhvillojnë prova eksperimentale, siç ishin SHBA–të, Japonia e më gjërë vendet e zhvilluara të Evropës. Jo që politika nuk e dinte atë, por ashtu i konvenon interesit të saj. Dhe si rrjedhojë, përtej harxhimeve materiale që i mbulonin fondet e jashtme, ndodhi ngatërrimi i kuadrit aktual midis konceptimeve tradicionale dhe atyre moderne, dhe si rrjedhojë vërshoi rrënimi edhe i atyre standardeve dhe vlerave të arsimit socialist që i trashëguam.

Për të fituar në kohë, politika në tranzicion u katandis në zbatimin e projekteve të improvizuara, siç ishte, p.sh. vlerësimi me shkrim i nxënësve veç e veç, një nxënës – një kompjuter, puna në grupe të vogla, improvizimi i maturës shtetërore, ditari elektronik, etj. Kjo imponoi që edhe kuadri arsimor ta improvozonte idealin e misionit duke u zhytur akoma edhe më thellësisht në devalvimin e standardeve dhe vlerave arsimore. Por jo vetëm kaq.

Politika e personalizuar reflektoi edhe në personalizimin e arsimit. Ajo u vu në rolin e Agjencisë për Punësim. U fut edhe në universitetet. U deklarua se 80% e stafit akademik të universiteteve, është kuadër i dështuar ose kuadër i rezervuar i partive politike. Për të fituar një gradë shkencore, u hapën kanale me bollëk në Shqipëri, Kosovë, Bullgari, Serbi, bile edhe në Maqedoni, ku që nga themelimi (1947) e deri në vitin 1994, nuk ndodhi asnjë rast që ndonjë shqiptar të merr gradën shkencore magjistër apo doktor i shkencave (Zajazi, T., 2005).

Ky avaz i politikës zhvillohet në gjithë ciklin e sistemit të shkollimit. Drejtorët i cakton politika, që drejtori madje nuk është në shërbim të shkollës, por të politikës. Edhe kuadrin për vende të lira të punës e dikton politika për qëllime të intereseve të veta materiale dhe politike. Ende edhe më e keqja që ndodh është korrupsioni i shfrenuar në arsim. E gjithë kjo rezulton me pasoja serioze materiale, ekonomike, sociale, psikologjike, morale në shkollimin e gjeneratave aktuale, por tani më jo vetëm ato shqiptare.

BURIMET:

1. Tahir Zajazi (1994): *“Zhvillimi i arsimit dhe kulturës shqiptare në Maqedoni – 1944–194”*. Në dorëshkrim.
 2. Revista, *“Jehona”* (1999): Nr. 1–2. Tahir Zajazi: *“Evoluimi i elementit shqiptar në Universitetin “Shën Cirili dhe Metodi”*” (f. 69–96). Shkup
- Revista, *“Universitas”* (2005): Nr. 6&7. Tahir Zajazi: *“Si ta rivendosim arsimin shqip në Maqedoni”* (f. 222–244). Tetovë/Vjenë;

SKENDER ASANI & SEVDAIL DEMIRI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

GJENDJA E (MOS)ARSIMIMIT NË TERRITORET VERILINDORE SHQIPTARE

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, autoriteti i Tokave të Liruar nuk shtrihej në disa nga territoret verilindore shqiptare. Në këtë areal bënte pjesë Shkupi, Kumanova, Presheva e Kaçaniku me rrethinat e tyre, të cilët mbetën nën sundimin bullgar.

Realisht, ishin këto vende shumë strategjike, të cilat kishin luajtur rol të rëndësishëm nëpër kapërcyellin e historisë. Ato edhe në atë kohë, e kishin rëndësinë e vetë, ndërsa fakti që kishin mbetur jashtë “Tokave të Liruar”, tregon se sa ishte e vështirë të realizoheshin aspiratat e shqiptarëve, madje edhe në momentin kur u mendua se po bie “Ora e Shqipërisë”.

Kështu, gjendja e popullatës shqiptare në këto treva ishte shumë e rëndë në të gjitha aspektet, ndërsa pushteti fashist bullgar ishte shumë i rreptë, me tendenca asimiluese dhe shfarosëse ndaj vendasve. Si rrjedhojë, shqiptarët, sikurse edhe popujt tjerë jobullgar, nuk kishin kurrfarë të drejte kombëtare, përmes të cilave do ta shfaqnin identitetin e tyre.

Konsulli shqiptar në Shkup, Hamit Kokalari, ja se si e përshkruan gjendjen e asokohshme në këto territore: *“Në çështje fetare dhe arsimore, autoritetet bullgare në fillim i prishën dhe i suprimuan krejt të gjitha institucionet fetare dhe shkollore, që ekzistonin në kohën e regjimit jugosllav. Të dy shkollat e mesme për elementin mysliman të Shkupit u mbyllën dhe u zhveshën nga materiali dhe mobiljet e tyre. U mbyllën gjithashtu dhe shkollat elementare fetare që ndodheshin pothuaj në çdo katund. Në disa krahina, fëmijët*

*shqiptarë nuk kanë të drejtë të shkojnë as në shkollat bullgare (në krahinën e Preshevës) me qëllim që elementi shqiptar mos të ketë mundësi të mësojë dhe të zhvillohet*¹⁴⁰.

Pra, këto vise shqiptare jo vetëm që nuk e patën fatin të jenë pjesë e Mbretërisë së re Shqiptare, por nga një pushtues i ashpër, siç ishte Mbretëria SKS, u hodhën në pamëshirën e një pushtuesi edhe më të ashpër. Kështu, gjendja bëhet shumë e rëndë dhe e padurueshme për popullatën civile shqiptare që mbeti nën regjimin fashist bullgar.

Disa dokumente që kemi hulumtuar së fundi në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë në Tiranë, japin shumë informata lidhur me gjendjen e shqiptarëve nën Bullgari. Në të vërtetë, Ministria e Kulturës Popullore të Shqipërisë, me porosi të drejtorit të gazetës “Kosova”, Masar Sopoti, gjatë atyre dy-tre viteve kishte dërguar në Shkup dhe qarkun e tij, Jahja Karavelijën (një bashkëatdhetar i ikur nga Presheva), për të hetuar gjendjen e shqiptarëve nën Bullgari. Karavelija kishte shkuar disa herë duke hyrë e dalë tinëzisht në Bullgari dhe duke i sjellë shtetit shqiptar në mënyrë vullnetare raporte dhe dokumentime mbi torturat, vrasjet e masakrimet e bullgarëve kundër shqiptarëve¹⁴¹.

Në një dokument, veç tjerash shkruan: *“Nga Shkupi, Kumanova dhe Presheva, bullgarët kanë marrë afër 2.000 ushtarë dhe i kanë dërguar në minat e Sinitlisë, ku ata punojnë si rob. Këta të marrë si rob po trajtohen shumë keq, nuk po u jepen ushqime dhe po rrihen për çdo ditë prej bullgarëve. Shumë prej tyre verret vesh se kanë vdekur*¹⁴². Në dokumentin e njëjtë flitet për masakrime të shqiptarëve sidomos në malësinë e Preshevës, përkatësisht nëpër fshatrat Raincë, Corroticë, Miratoc, Bilaç e Pisjan, ku janë

¹⁴⁰ Hamit Kokalari, S H K U P I - Konsiderata etnografike, historike, ekonomike (1942), Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe Instituti i Historisë së Qendrës të Studimeve Albanologjike – Tiranë, Shkup, 2015, fq.52-53

¹⁴¹ Arkivi i MPJ-Tiranë, viti 1943, dosja 32, fleta 20.

¹⁴² Arkivi i MPJ-Tiranë, viti 1944, dosja 99, fleta 37.

regjistruar rrahje deri në vdekje. Përmenden edhe çnderime të femrave shqiptare para burrave të tyre, ndërsa rasti më flagrant është ai me 10 familjet shqiptare të Pisjanit, të cilat më pas detyrohen të shpërngulen në Gjilan.

Ndër masat e para të pushtesve bullgar në qytetin e Shkupit dhe komunën e Kumanovës, ishte ai i largimit të atyre pak nëpunësve me origjinë shqiptare të cilët patën mundur të bënin ndonjë klasë shkollë nën regjimin e Mbretërisë SKS. Nën preteksin se Kumanova ka qenë dhe është bullgare, ata vodhën në mjaft shtëpi të këtyre shqiptarëve etnikë të cilët për çdo rast njoftuan edhe administratën vendore. Por kur e panë se ankimet e atyre binin në vesh të shurdhër, atëherë rrëmbyen armët duke luftuar së toku kundër këtyre bandave shtetërore bullgare. Autoritetet e vendit me këtë rast, nuk munguan të ngrenë padi e gjyqe ndaj shqiptarëve të Kumanovës të cilët, më tej, për t'iu shpëtuar burgimeve të llahtarshëm, muarën rrugën pa kthim drejt shtetit amë (dhe Turqisë, v.j.)¹⁴³.

Një nga masat asimiluese ishte heqja e dhunshme e plisit të bardhë të shqiptarëve të këtyre viseve nga ana e policisë bullgare. Këto metoda kishin ngjallur reagime të ashpra në popull, dhe shpeshherë ishin kundërshtuar këto masa antishqiptare.

Siç theksuam, gjatë kësaj kohe nuk mund të flitej për arsimim në gjuhën shqipe nëpër territoret shqiptare jashtë jurisdiksionit të qeverisë së Tiranës, e cila udhëhiqej nga Mustafa Kruja. Prandaj, gjendja e shqiptarëve në rajonet e Shkupit, Kumanovës e Preshevës, në aspekt të arsimimit, ishte e mjerushme. Si rrjedhojë, shkalla e analfabetizmit ishte tejet e lartë.

Në këtë kohë, arsimimi i mangët zhvillohej nëpër disa shkolla bullgare, si dhe diku–diku fshehurazi nëpër medrese e xhami, ku mund zhvillohej mësim–besimi islam. Ndërsa, u regjistruan edhe

¹⁴³ Eugen Shehu <http://www.albeu.com/maqedoni/pushtimi-bullgar-i-kumanoves-shkupit-e-manastirit-1941-44-/163103/>

disa raste të kalimit ilegal të literaturës shqipe nga zona e pushtimit italian, në zonën e pushtimit bullgar. “Në kushtet kur në zonat gjermane dhe italiane të pushtimit u fut gjërësisht literatura në shkollat shqipe të lejuara, këto tekste nuk munguan edhe në zonën bullgare të pushtimit. Ishin nacionalistët (atdhetarët, v.j.) e këtyre trevave të okupuara nga Bullgaria, të cilët duke pasur mbështetje të plotë nga politika e shtetit amë shqiptar, shkuan atje dhe fshehurazi çuan në viset e shtypura të tyre tekste të gjeografisë, historisë apo vepra të autorëve shqiptarë si, Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Çajupi, etj.”¹⁴⁴.

Në vitin 1942, drejtuesit e LKpÇB-së¹⁴⁵, respektivisht, Shaban Efendi, së bashku me Azem Hoxhën, Mulla Hajdarin dhe Hafëz Jasharin, morën një nismë për hapjen e shkollave shqipe në rajonin e gjerë të Karadakut. Kësaj nisme iu bashkua edhe Muhamed Ali Hoxha nga Elbasani, i cili shërbente në Orizare të Kumanovës. Ky i fundit bashkë me Mulla Hajdarin, kishin udhëtuar në Sofje, ku kishin takuar sekretarin e Ambasadës italiane, Atlas Koçin, të cilin Muhamed Aliu e kishte mik të ngushtë. Ata, veç të tjerash, kishin kërkuar nga Koçi, të merrnin një sërë materialesh dhe pajisje mësimore, përfshirë këtu edhe ‘*Historinë e shqiptarëve*’, të botuar në vitin 1937 në Tiranë. Menjëherë sapo ishin kthyer nga Sofja, së bashku me Shaban Efendin, Hafëz Jasharin, Azem Hoxhën, etj., kishin ndërmarrë një aktivitet të ngjeshur nëpër fshatrat shqiptare, jo vetëm të Kumanovës, por edhe nëpër ato të Shkupit dhe të Preshevës, ku ishte harku i fushëveprimit të tyre¹⁴⁶. Mirëpo, fatkeqësisht, këto nisma arsimdashëse nuk kishin arritur të realizoheshin, për shkak të reagimit të shpejtë dhe të ashpër të autoriteteve bullgare, të cilët filluan ndjekjen e veprimtarëve të lartpërmendur.

¹⁴⁴ Eugen Shehu, po aty

¹⁴⁵ Lëvizja Kombëtare për Çlirim dhe Bashkim

¹⁴⁶ Qerim Lita, Shaban Efendia atdhetar i devotshëm, Kumanovë, 2010, fq. 122-123

Një tjetër pengesë në këtë rrugëtim të atdhetarëve shqiptarë, më vonë ishte edhe një nismë e autoriteteve bullgare që të hapnin disa shkolla në gjuhën turke nëpër vendbanimet më të mëdha shqiptare, në mënyrë që shqiptarët t'i paraqesin si element turk.

Në anën tjetër, një numër i konsiderueshëm i nxënësve shqiptarë nga zona e pushtimit bullgar, e shfrytëzuan rastin dhe shkuan nëpër qytetet tjera shqiptare, ku ishin hapur shkolla normale në gjuhën shqipe. Radhiten një plejadë e veprimtarëve shqiptarë të këtyre trevave, të cilët u shkolluan kryesisht në Dega Liceale ose ndryshe i njohur si Gjimazi “Sami Frashëri”¹⁴⁷ në Prishtinë, ku ishin inkadruar emra të njohur të arsimit kombëtar shqip. Nxënësit apo studentët që mësuhan në këtë shkollë, pas kryerjes së kurseve pedagogjike, vazhdonin me punë si mësues nëpër fshatra e qytete të ndryshme shqiptare ku funksiononin shkollat shqipe në Maqedoninë përëndimore dhe në Kosovë.

Një rol të jashtëzakonshëm në dërgimin e këtyre nxënësve për mësim në Normalen e Prishtinës, e kishte diplomati vizionar që asaj kohe shërbeu në Shkup, Hamit Kokalari¹⁴⁸.

Në mesin e këtyre nxënësve – mësuesve të ardhshëm, po përmendim disa emra më të njohur, që vinin nga zona e Shkupit, Kumanovës e Preshevës:

¹⁴⁷ Ministria e Arsimit e qeverisë shqiptare, e udhëhequr nga prof. Ernest Koliqi, qysh në verë të vitit 1941, hartoi një projekt në të cilin parashihte hapjen e një numri të madh shkollash fillore në të gjitha trojet etnike, kurse në qendrat kryesore ishte planifikuar hapja e shkollave të mesme. Në këtë kuadër, në Prishtinë ishte vendosur të hapet një shkollë e mesme me dy degë: 1. Dega e shkollës normale, që do të ishte e ngjajshme me shkollën normale të Elbasanit; dhe 2. Dega Liceale ose Gjinnazi. Kjo shkollë e përzier me emrin “Sami Frashëri” e filloi punën në dhjetor të vitit 1941, në gjuhën shqipe dhe ishte shkolla e parë e këtij rangu në Prishtinë dhe në Kosovë e Maqedoni.

¹⁴⁸ Hamit Kokalari (Gjirokastrë, 5 gusht 1909 – 26 mars 1989, Tiranë). U shkollua në Turqi, Shqipëri dhe Francë. Në vitet 1941-1943, shërbeu si diplomat në Konsullatën shqiptare në Shkup. Pas Luftës së Dytë Botërore, familjarisht u persekutua nga regjimi komunist shqiptar. Është një nga përkthyesit më të shquar të kohës, dhe autor i veprës së njohur “Kosova, djepi i shqiptarizmit” (1943).

Azem Marana – nga Shkupi, një nga figurat qendrore të NDSH-së, vijoi mësimet e mësuesisë në Shkollën Normale “Sami Frashëri” të Prishtinës, të cilën e kreu me sukses të veçantë. Pasi kthehet në vendlindje, ilegalisht hap shkollë shqipe në Maranë. Pasi hetohet nga forcat pushtuese bullgare, largohet në Tetovë, ku angazhohet si mësues në fshatin Gajre, ku punon me shumë zell prej vitit 1942 deri në vitin 1944. Në fund të vitit 1944, bashkë me Hasan Bilallin themelon shkollën e parë shqipe në Shkup “Liria”, ndërsa për shkak të aktivitetit të tij atdhetar dhe antikomunist, gjatë verës së vitit 1946 arrestohet nga ana e OZN-ës dhe pushkatohet¹⁴⁹.

Ibrahim Haki-Kelmendi – nga Presheva, ishte një veprimtar i shquar i çështjes kombëtare, i cili shtriu aktivitetet e tij atdhetare me penë e me pushkë në gjithë hapësirën shqiptare. Pas mbarimit të studimeve në Shkup, Beograd, Zagreb e Peruxha, Ibrahim Osmani-Kelmendi (prej atëherë e ndërron mbiemrin në Kelmendi), më 01.11.1942, punësohet në Shkollën Normale – Dega liceale “Sami Frashëri” në Prishtinë, si profesor i historisë. Falë aftësisë dhe rezultateve shumë të mira në punë, që në vitin 1943 emërohet zëvendësudrejtor i Shkollës Normale “Sami Frashëri” në Prishtinë dhe rektor i Konviktit të të njejtës shkollë¹⁵⁰.

Shinasi Hallaçi: nga Presheva, gjatë vitit 1941, kaloi në Shkollën Normale “Sami Frashëri” të Prishtinës, ku në vitin 1942 e kreu kursin pedagogjik, dhe menjëherë angazhohet si mësues në Pozhoran të Gjilanit dhe më pas në Shtime të Kosovës. Pas ndryshimit të sistemit, angazhohet evidentimin e nxënësve shqiptarë dhe ishte një nga mësuesit e parë shqiptarë në Shkollën Fillore “Bajram Shabani” në Kumanovë gjatë vitit 1945¹⁵¹.

¹⁴⁹ Tokat e liruara (1941-1944) – përmbledhje dokumentesh IV, red.Qerim Lita, Logos-A, Shkup, 2016, f.370.

¹⁵⁰ Shih më tepër: Ibrahim Kelmendi, Një shtyllë e Kosovës quhet Preshevë, Preshevë, 2006.

¹⁵¹ Agim Rushiti, po aty, f.114

Refik Shaqiri – nga Vaksinca e Kumanovës, pasi largohet nga Medreseja e Mbretit Aleksandër në Shkup, gjatë vitit shkollor 1941/42 regjistrohet në Shkollën Normale të Prishtinës. Pasi e kryen këtu kursin pedagogjik, emërohet mësues në fshatin Lisec, dhe më pas edhe në Pallçishtë të Tetovës. Me ndryshimin e pushtetit, ai në fund të vitit 1944, së bashku me Azem Hoxhën, Shaban Efendiun dhe Shinasi Hallaçin, iu rrek punës për evidentimin e nxënësve shqiptarë që do të vijonin shkollimin në rajonin e Kumanovës, në shkollat e reja që i hapi pushteti komunist gjatë vitit 1945.¹⁵²

Rexhep Bajra – poashtu nga Vaksinca e Kumanovës, pasi kishte kryer pesë klasë në Medresenë e Madhe të Mbretit Aleksandër në Shkup, e ndërpret shkollimin për shkak të fillimit të luftës, dhe regjistrohet në Normalen e Prishtinës¹⁵³. Pas LDB-së punoi si mësues dhe aktivist shoqëroro-politik. Vuajti burgun e Goli Otokut.

Hamit Thaçi – gjithashtu nga Vaksinca e Kumanovës, pas shkollimit fetar në Medresenën e Mbretit në Shkup, i vijon mësimet e Normales së Prishtinës dhe kyçet në LNÇJ. Pak kohë merret me profesionin e mësuesisë, dhe gjatë gjithë jetës ishte punëtor shoqëroro-politik, duke ushtruar poste të rëndësishme politike gjatë sistemit komunist jugosllav.

Edhe pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, kur Kosova dhe Maqedonia perëndimore rikthehen nën sundimin jugosllav, shumica e këtyre mësuesve të Normales së Prishtinës, hapën shkollat e para shqipe në trevat e Shkupit, Kumanovës e Preshevës që nga fillimi i vitit 1945. Disa nga ata që vazhduan rezistencën antijugosllave, u burgosen dhe u eliminuan politikisht dhe fizikisht, kurse ata që u vunë në shërbim të sistemit komunist jugosllav, patën ngritje të vazhdueshme në karrierë.

¹⁵² Agim Rushiti, *Me pishtarët e arsimit shqip në Komunën e Kumanovës dhe Lipkovës (1945-1960)*, Kumanovë, 2000, f.172-173.

¹⁵³ A.Rushiti, po aty, f.90-91

MEMLI KRASNIQI*Instituti Albanologjik – Prishtinë***KONTRIBUTI I STUDIUESIT ABDYLAZIZ
VESELI, PËR HISTORINË E ARSIMIT SHQIP
NË KOSOVË NË VITET 1941–1944**

Me përfundimin e luftërave ballkanike më 1912–13, Perandoria Osmane përfundimisht u dëbua nga pjesa më e madhe e kontinentit evropian. Mirëpo, për fat të keq, dëbimi i osmanëve nga Ballkani solli vetëm pjesërisht një liri të kufizuar për popullin shqiptar, ngase hapësira etnike e tij u nda padrejtësisht nga fqinjët e saj. Ndonëse u krijua një shtet shqiptar i pavarur, ai jo vetëm që nuk përfshinte brenda kufijve të vetë minimumin prej 60 % të popullsisë shqiptare në Ballkan, por me rastin e përcaktimit të kufijve nuk u mor parasysh as e kaluara e afërt historike, në të cilën Kosova, Janina dhe Manastiri, në mënyra të ndryshme përcaktuan fatin e shqiptarëve. Pra, për serbët, malazezët, grekët dhe bullgarët, argumentet historike nga periudha mesjetare u pranuan si të mirëqena, kurse për shqiptarët faktori historik u bazua kryesisht në periudhën e Skënderbeut.

Elitat vendimmarrëse në Evropë duke mos marrë për bazë periudhën para-sllave kur paraardhësit e shqiptarëve, ilirët, jo vetëm popullonin pothuajse gjithë Gadishullin Juglindor të Evropës, por edhe kishin luajtur një rol me rëndësi në jetën politike, ushtarake, religjioze dhe kulturore të Perandorisë Romake. Po kështu në përcaktimin e kufijve të shtetit shqiptar nuk ishte marrë parasysh as kontributi i tyre madhor, jo vetëm në kuadër të aparatit administrativ, ushtarak, politik, tregtar e kulturor të Perandorisë Osmane, por edhe të bashkëpunimit të tyre me fuqitë kryesore të Evropës së shekujve XVII, XVIII dhe gjysmës së parë të shekullit të XIX.

Mjerisht për shqiptarët, ashtu si edhe për paraardhësit e tyre më parë, ilirët, rënia e perandorive si të asaj romake ashtu edhe të asaj osmane, kishte vetëm kuptimin e rrudhjes territoriale dhe të një lirie jo të plotë. Natyrisht si rrjedhojë e një gjendje të re okupimi, shqiptarët jashtë kufijve politikë do të mbeteshin mbrapa edhe në procesin e arsimimit. Kjo gjendje e tyre e mjeruar, për ironi të fatit, do të ndryshonte për të mirë, kur këto hapësira do të pushtoheshin nga zaptuesit e rinj, pra nga Italia fashiste dhe Gjermania naziste.

Lidhur me gjendjen arsimore të Kosovës, Maqedonisë perëndimore dhe të zonave në Mal të Zi, një kontribut të madh ka dhënë edhe studiuesi tashmë i ndjerë, prof.dr.Abdylaziz Veseli. Profesor Veseli në shtatë monografi të tij kushtuar kësaj tematike dhe të cilat janë të mbështetura në të dhënat arkivore, ka arritur që të zbardhë një aspekt të së kaluarës së popullit shqiptar. Kështu fillimisht ai do të bëjë fjalë për kapitullimin e Mbretërisë Jugosllave dhe për dekretligjin nr.264 të 12 shtatorit të vitit 1941, me të cilin Kosova dhe Maqedonia perëndimore i bashkoheshin Mbretërisë Shqiptare, nën Italinë fashiste. Një pjesë e territoreve shqiptare mbetej nën Bullgarinë, ndërsa pjesa veriore dhe verilindore e Kosovës përfshihej në Serbinë e Milan Nediqit. Mirëpo, Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Podujevës, që mbetën në zonën gjermane të pushtimit, Serbia u detyrua t'ua njohë autonominë. Ndërsa në Kosovë dhe në Maqedoninë perëndimore, të cilat iu kthyen Mbretërisë Shqiptare nën Italinë fashiste, organizimi i pushtetit iu besua Komisarariatit të lartë për Kosovë, Dibër e Strugë, në krye të së cilës u caktua Fejzi Alizoti.¹⁵⁴ Duhet thënë që me kapitullimin e Jugosllavisë në Shqipërinë italiane filluan të lajmërohen mësuesit kosovarë, të cilët dëshironin vullnetarisht të shkonin në Kosovë për të punuar në kurset verore për të rriturit.¹⁵⁵

¹⁵⁴ Abdylaziz Veseli, Shkollat dhe arsimi shqip në Prefekturën e Pejës gjatë periudhës 1941-44, IV, Gjilan, 2003, 9.

¹⁵⁵ Po aty, 17.

Ministria e Arsimit e Mbretërisë Shqiptare nën Italinë fashiste, pas bashkimit të këtyre viseve, më 1941 krijoi 5 inspektorate, me qendër në Prishtinë, Prizren, Pejë, Tetovë dhe Dibër.¹⁵⁶ Ministria e Arsimit autorizoi që për vitin shkollor 1941–42 të hapeshin aq shkolla fillore sa nevojiteshin për viset shqiptare të bashkuara me Shqipërinë. Në këto vise të bashkuara, banorëve u lejohej regjistrimi i nxënësve deri në moshën 9 vjeçare dhe që shkollën fillore 5 vjeçare ta ndjekin deri në moshën 15 vjeçare. I gjithë plani arsimor edhe për ish–viset shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë londineze u jetësuan në bazë të dekretit nr.340 të 20 nëntorit 1941, me të cilin edhe në këto vise hynte në fuqi dekretligji organik i arsimit. Me këto vendime parashihej, përpos të tjerave, edhe rritja e numrit të inspektorateve për pesë, të drejtorëve didaktikë (inspektorë i shkollave fillore dhe kurseve për analfabetë) për 18, si dhe rritja e numrit të mësuesve, numri i të cilëve në fazën e parë sillej rreth 300.¹⁵⁷

Në Kosovë shkollimi fillor ishte pesë vjeçar dhe ai do të përfshinte edhe fëmijët e të gjitha fshatrave, në kohën kur të krijoheshin kushtet për të zbatuar një plan të tillë. Ministri i Arsimit, Ernest Koliqi, paraprakisht për të studiuar gjendjen arsimore në Kosovë, më 23 qershor 1941 dërgoi një Mision shkollor të jashtëzakonshëm, në krye të së cilës ishte Ali Hashorva, ndërsa anëtarët e saj ishin: Jonuz Blakçori, Profesor i Shkollës së Punës, Tiranë; Abdurrahim Buza, Profesor në Liceun e Tiranës; Flora Pali, mësuese në Institutin Donika Kastrioti; Shaban Arra, Inspektor i Arsimit; Zef Pali, mësues i gjuhës shqipe në Liceun e Shkodrës; Xhavid Nimani, mësues në qarkun e Kosovës; Fadil Haxhihoxha, mësues në qarkun e Kosovës.¹⁵⁸ Pra, anëtarë të këtij misioni ishin edhe Fadil Hoxha dhe Xhavit Nimani, të cilët më vonë, në kuadër të Jugosllavisë

¹⁵⁶ Po aty, 18

¹⁵⁷ Po aty, 19.

¹⁵⁸ Ilir Hashorva, "Misioni i Jashtëzakonshëm shkollor- 75 vjet më parë në Kosovë", <http://gazetadielli.com/misioni-i-jashtezakonshem-shkollor-75-vjet-me-pare-ne-kosove/>, marrë më 15 nëntor 2016

socialiste, do të luanin një nga rolet kyçe në jetën politike të Kosovës.

Ali Hashorva së bashku me familjen e tij dhe me anëtarët e misionit u nisën menjëherë për në Kosovë. Më 9 Shtator 1941, Ali Hashorva në një raport tjetër dërguar Ministrisë së Arsimit mbi Gjendjen Arsimore të Kosovës, do të shkruante se në këto vise kishte 202 shkolla fillore me 30000 nxënës dhe 491 mësues, si dhe tre gjimnaze; i Prizrenit me 579 nxënës, prej të cilëve 82 shqiptarë; i Pejës me 998 nxënës, prej të cilëve 71 shqiptarë; i Prishtinës me 871 nxënës, prej të cilëve 25 shqiptarë. Kjo do të thoshte se në të gjitha shkollat e mesme të Kosovës deri në kapitullimin e Mbretërisë Jugosllave mësonin vetëm 276 nxënës shqiptarë. Më pas Ali Hashorva jep mendime për rregullimin e shkollave për vitin 1941–1942, ku kërkohet që shkollat të ishin vetëm në gjuhën shqipe, duke konsideruar se serbët ishin vetëm shqiptarë të krishterë ortodoks dhe vllahë të sllavizuar, argument të cilin ai e mbështeste në rastin e Rahovecit, ku në disa fshatra të përziera të kësaj zone, serbët e flisnin shumë mirë gjuhën shqipe.¹⁵⁹ Në raportin e tij jepen edhe hollësi për caktimin e Prishtinës si qendër arsimore e Kosovës, në të cilën ai argumente se “...Në Kosovë është e domosdoshme çelja e një shkolle normale me internat... Vendi më i përshtatshëm për të na duket Prishtina, mbasi gjendet në qendër të Kosovës e mund të arrihet me lehtësi si nga veriu (Mitrovica, Jeni–Pazari, Vuçiterna, Podujeva), si nga lindja (Gilani, Medvegja, Presheva, Kumanova), si nga jugu (Ferizoku, Kaçaniku e Shkupi), ashtu dhe nga perëndimi (Peja, Gjakova e Prizreni). Prishtina në të ardhmen duhet të bëhet qendër drite e bashkimi shpirtëror si për Kosovën e çliruar, ashtu dhe për pjesën e mbetur jashtë kufijve, që neve, me sa patëm rasë ta shihnim e ta dëgjonim, na u paraqit plot jetë e gjallëri dhe e vendosur të mbetet shqiptare e të çlirohet me çdo mënyrë sapo t’i paraqitet rasta e volitshme... Normalja ka për

¹⁵⁹ Po aty

të rrënjosur mirë në qytet edhe gjuhën shqipe që ka pësuar njafë nga robëria shekulllore”.¹⁶⁰

Dëshmitë më të mira që mbështesin një pohim të tillë janë edhe rrëfimet e nxënësve shqiptarë të asaj periudhe. Kështu, një nga nxënësit shqiptarë të asaj epoke historike, Njazi Straja, shumë vite më vonë, do të rrëfente se ai si një qytetar i Prishtinës, deri në vitin 1941, nuk e fliste gjuhën shqipe. Kjo ndodhte ngase qytetarët kryesisht flisnin gjuhën arkaike turko-osmane, si pjesë kjo e një tradite historike osmane, gjatë së cilës gjuha turko-osmane ishte gjuhë e pushtetit, e tregtisë dhe e kulturës, por edhe si rrjedhojë e një botëkuptimi, sipas së cilës, ‘sheherlijtë’ ose qytetarët pos gjuhës amtare duhej të flisnin edhe gjuhën turko-osmane, kurse shtresa “katunare” apo fshatarësia ndërkohë komunikonte vetëm në gjuhën shqipe. Këto dallime, edhe sipas rrëfimit të Njazi Strajës, ishin më tepër sociale se sa etnike.¹⁶¹ Ndërsa hapja e shkollave në gjuhën shqipe mundësoi, jo vetëm ndërgjegjësimin kombëtar të shtresës qytetare të Kosovës e viseve të tjera, por edhe zbutjen e dallimeve sociale ndërmjet qytetarëve dhe fshatarëve. Pra, arsimimi në gjuhën amtare ishte në shërbim të unitetit kombëtar shqiptar, duke zvogëluar kështu, në një anë, dallimet sociale, religjioze, krahinore e klanore dhe njëkohësisht duke e ngritur vetëdijen e tij politike e kulturore. Rrjedhimisht, politikë të tillë arsimore do të ndiqnin edhe gjermanët, të cilët edhe në zonën e tyre të pushtimit do të lejonin hapjen shkollave në gjuhën shqipe. Kështu në Mitrovicë do të angazhoheshin 9 mësues, në Novi Pazar 2, një nga të cilët ishte edhe Xhevdet Doda. Ky Mision arsimor i jashtëzakonshëm veprimtarinë e tij në Kosovë e kryente nga dy qendra, në Prizren për Rrafshin e Dukagjinit dhe në Prishtinë për Rrafshin e Kosovës.

¹⁶⁰ Ilir Hashorva, ” Misioni i Jashtëzakonshëm shkollor- 75 vjet më parë në Kosovë”, <http://gazetadielli.com/misioni-i-jashtezakonshem-shkollor-75-vjet-me-pare-ne-kosove/>, më 15 nëntor 2016

¹⁶¹ Memli Krasniqi, Hysen Matoshi,.....[et al.], Kujtesa Kolektive: Dëshmi dhe Ngjarje (1944-1966), Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2016, 263-264

Objektet shkollore nëpër qytetet e Kosovës dhe në fshatrat me popullsi të përzier ishin të reja dhe në një numër të konsideruar.¹⁶²

Sipas të dhënave statistikore në hapësirat shqiptare të ish-Mbretërisë Jugosllave kishin funksionuar 417 shkolla fillore në të cilat mësimi ishte zhvilluar në gjuhën serbe.¹⁶³ Duhet thënë se që në fillim në Mitrovicë, më 25 maj 1941, Bedri Gjinaj, i cili kishte kryer shkollën amerikane të Fulcit në Tiranë, kishte hapur shkollën fillore “Skënderbeg”.¹⁶⁴ Raportin mbi gjendjen arsimore në Prefekturën e Mitrovicës, me rrethet e Vushtrisë, të Podujevës dhe të Novi Pazarit, e kishte përpiluar Kryetari i Misionit arsimor për Mitrovicën, dr. Rexhep Krasniqi. Këto zona shqiptare që kishin mbetur në kuadër të Serbisë së Milan Nediqit, sipas kryetarit të këtij misioni, kishin nevojë për 48 shkolla fillore me 104 mësues.¹⁶⁵ Shteti kuisling i Serbisë ishte i shtyrë që të pranojë hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, ndonëse u mundua që me rrugë ligjore të pengojë funksionalizimin e tyre. Kështu qeveria serbe e bëri obligative lëndën e gjuhës serbe në shkollat shqipe, pastaj futi kushtin që mësuesit duhej të kishin nënshtetësi serbe, si dhe që personeli arsimor duhej të ishte i kualifikuar.¹⁶⁶ Kërkesa këto të arsyeshme të qeverisë kuislinge Serbe, por që kishin një prapavijë bllokuese, ashtu siç do të veprojnë më vonë në kohën e Aleksandër Rankoviqit kuadrot arsimore dhe politike serbe në Kosovë e në vise të tjera shqiptare.

Një nga problemet madhore me të cilat kuadri arsimor në Kosovë u ballafaqua që në fillim ishte edhe numri i madh i nxënësve që braktisnin shkollën. Kështu në shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Pejë nga 429 nxënës që e filluan vitin shkollor 1941–42, 242

¹⁶² Abdylaziz Veseli, Shkollat dhe Arsimi shqip në Prefekturën e Pejës..., 27

¹⁶³ Abdylaziz Veseli, Shkollat dhe Arsimi shqip në Prefekturën e Mitrovicës gjatë periudhës 1941–44, V, Gjilan 2004, 15.

¹⁶⁴ Po aty, 45.

¹⁶⁵ Po aty, 31, 41.

¹⁶⁶ Abdylaziz Veseli, Shkollat dhe Arsimi shqip në Prefekturën e Mitrovicës..., 42.

nga ta ose e përsëritën klasën ose e ndërprejnë shkollimin.¹⁶⁷ Shkolla fillore shqipe në këto vite ishin hapur edhe në Plavë, ku mësues ishte Esad Mekuli, po kështu edhe në Rozhajë ku mësues ishte Sokol Salihu Bërdynaj. Ndërsa në Pejë në vitin 1942 ishte hapur shkolla e femrave për punë dore “28 Nëntori”.¹⁶⁸ Në anën tjetër, në nënprefekturën e Ulqinit, që ishte pjesë e Prefekturës së Shkodrës, shkolla fillore në gjuhën shqipe ishte hapur më 21 nëntor 1941 dhe ajo që ishte interesant është edhe e dhëna se mësues në shkollën shqipe ishte edhe greku Minja Nikollaidisi, babai i të cilit ishte vendosur në Ulqin që më 1913.¹⁶⁹ Në Prizren në vitet 1941–44 ishin hapur pesë shkolla fillore si dhe liceu “Gjon Buzuku” në të cilën drejtor ishte Kolë Margjini, nënkryetar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, ndërsa mësime të ndryshme ishin : Lorenc Antoni, Luk Çuni, Llazër Berisha, etj.¹⁷⁰

Pra, Prof.dr.Abdylaziz Veseli, me studimet e tij të shumta, dokumentoi se themelet e sistemit arsimor në gjuhën shqipe në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare, ishin vendosur që gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe se përkundër pengesave të shumta ai asnjëherë nuk do të pezullohej plotësisht. Sistemi arsimor në gjuhën shqipe në Kosovë, përfundimisht do të institucionalizohej vetëm në vitet e 60 dhe të 70 të shekullit të XX, duke përmbyllur kështu ciklin e plotë arsimor nga ai fillor e deri te ai superior.

¹⁶⁷ Abdylaziz Veseli, Shkollat dhe Arsimi shqip në Prefekturën e Pejës....., 35

¹⁶⁸ Po aty, 110-111

¹⁶⁹ Abdylaziz Veseli, Shkollat dhe Arsimi shqip në trevat e Ulqinit dhe të Tuzit-nënprefektura të Prefekturës së Shkodrës gjatë periudhës 1941-44, VI, Gjilan 2004, 34.

¹⁷⁰ Abdylaziz Veseli, Shkollat dhe Arsimi shqip në Prefekturën e Prizrenit gjatë periudhës 1941-44, III, Gjilan, 2003, 56

MILAZIM ELSHANI & DAUT BISLIMI

Prishtinë

SHKOLLAT SHQIPE DHE KUADRI ARSIMOR NË NËNPREFEKTURËN E SUHAREKËS (1941/42)

Në fund të Luftës së Parë Botërore, Serbia dhe Mali i Zi, së bashku me kroatët, sllovenët dhe maqedonasit, më 1 dhjetor 1918 formuan shtetin e tyre të përbashkët: Mbretërinë Serbo–Kroate–Sllovene, e cila bashkoi pesë popuj. Edhe pse ishin popuj me zanafillë të ngjashme (slavë të jugut), më parë kurrë nuk kishin qenë të bashkuar në një shtet të vetëm. E kaluara e tyre politike, ekonomike, sociale dhe kulturore është dalluar mjaft. Kanë jetuar në tetë territore historikisht të definuara mirë dhe i kanë përdorur dy alfabetë, atë latin dhe cirilik.

Duke i hedhur një vështrim të përgjithshëm kësaj periudhe historike, me të drejtë mund të konstatojmë se formimi i Mbretërisë SKS më 1918, është ndodhi e veçantë në vargun e ngjarjeve me rëndësi në historinë e ekspansionizmit shovinist serb. Përbërja shumë nacionale e Jugosllavisë versajase, e dyta në Evropë, dhe fakti se numri më i madh i popujve që Qeveria serbe i quante “pakica kombëtare”, kanë jetuar në territoret etnike – në afërsi të shtetit amë, siç është rasti me shqiptarët dhe Shqipërinë, dhe kur shovinizmi nacional ekstrem serb “pakicave të mëdha” – shqiptarëve, u imponoi kufizime politike, ekonomike, kulturore dhe duke shfrytëzuar ligje diskriminuese, ushtroi dhunën, terrorin, vrasjet e deri në shfarosje fizike, bënë që shteti i ri i SKS–së të vendosej në shtyllat të qelqit, ndaj në horizont i shihej fundi i

shpartallimit.¹⁷¹ Me shtetin e ri shumë nacional, që aso kohe kishte 12 milionë banorë, administronte si në punët e brendshme, ashtu edhe në ato të jashtme elita shoviniste serbomadhe vetëm me 3,5 milionë banorë¹⁷² dhe me pak dallim se para vitit 1918.

Populli shqiptar në Kosovë gjatë Mbretërisë SKS, nuk i gëzonte të drejtat më elementare nacionale; ato të shkollimit në gjuhën shqipe, të zhvillimit dhe kultivimit të kulturës nacionale, të botimit në gjuhën shqipe dhe të gjitha ato të drejta themelore me të cilat do të karakterizohej kombi shqiptar. Qeveria Jugosllave i mbylli të gjitha shkollat shqipe në Kosovë, madje edhe ato private dhe hapi shkollat serbe në ato vende ku kishte një koncentrim më të madh të popullsisë serbe. Në ato shkolla zakonisht përfshiheshin fëmijët e nëpunësve, ushtarakëve, xhandarëve, etj. Pastaj u hapën shkollat në kolonitë e posaformuara serbo-malazeze dhe më në fund edhe në viset me popullsi të përzier, e më rrallë hapeshin shkolla në vendbanimet vetëm me shqiptarë.¹⁷³ Madje as feja dhe reliktet fetare nuk mund të mësoheshin në gjuhën shqipe. U mbyllën shkollat private në Ferizaj, në Gjakovë, mësuesit: Jusuf Puka, Salih Morina, Niman Ferizi, Ferid Imanmi, Ibrahim Kolqi, Ibrahim Fehmiu, Lush Ndahu, në Vushtrri mësuesi Haxhi Tafili me 60 nxënës; në Prizren, mësuesi Lazër Lumezi më 76 nxënës etj.,¹⁷⁴

Dokumentet e shumta, dëshmojnë se çështjes së shkollave dhe arsimit, madje edhe në periudhat e luftës për liri, ju është kushtuar kujdesi i veçantë. Luftërat që bënë shqiptarët për liri, kanë qenë njëherësh edhe luftëra për gjuhën, shkollën dhe arsimin shqip. Kështu ndodhi edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë 1941–1945.

¹⁷¹. Daut Bislimi, *Formacionet poplitiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945*. Prishtinë, 1997, f. 17.

¹⁷². W.Wucinich, *Nationalism and Communnism*, Los Angeles, 1969, f. 236-284.

¹⁷³. Avdulla Vokrri, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore*. Prishtinë 1990, 82.

¹⁷⁴. Abdylaziz Veseli, *Shkolla dhe arsimi shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941-1944*. Tetovë 2000, 10.

Kosova hyri në Luftën e Dytë Botërore me të gjitha kundërthëniet e shprehura në fushën nacionale, ekonomike dhe kulturore, të krijuara gjatë historisë, e që ishte një veçori e imponuar për këtë territor.

Në zonën ndërkufitare me Shqipërinë, kishte filluar propaganda, se Italia me Shqipërinë ka krijuar bashkim të veçantë vetëm nga shkak, që të ruhet emri i Shqipërisë, dhe në bazë të kësaj Italia në momentin e volitshëm mundet ta shtroj çështjen e bashkimit të atyre viseve ku në shumicë jetojnë shqiptarët.¹⁷⁵

Pas disfatës së turpshme të Ushtrisë Jugosllave, në prill të vitit 1941, prej gjysmës së majit 1941, Kosova u nda në tri zona pushtuese: në zonën pushtuese gjermane, italiane dhe në atë bullgare. Pjesa më e madhe e Kosovës mbeti nën pushtimin e italianëve. Ajo i aneksohet Shqipërisë me dekretligjin mbretëror dhe me dekret të mëkëmbësit të mbretit nr.254, të datës 12.VIII.1941. Po me këtë dekretligj, Italia aneksoi edhe rrethet e Dibrës, të Tetovës dhe të Kërçovës. Pjesa tjetër, viset shqiptare në lindje dhe në perëndim të Shkupit mbetën në zonën bullgare të okupimit.

Kosova dhe Shqiptarët e Maqedonisë “përfituan” nga okupimi nazifashist, sepse është një shembull tipik i çlirimit kombëtar i ardhur nga fashizmi. Edhe burimet bashkëkohore të historiografisë sllave e vërtetojnë këtë fakt.¹⁷⁶

Në pjesën italiane u zbatua administrata sipas modelit të administratës në Shqipëri. Institucioni më i lartë i kësaj administrate ishte Komisariati i Lartë Civil me seli në Prizren. Kompetencat territoriale të këtij Komisariati shtriheshin në të gjitha viset e Shqipërisë Etnike. Në krye të Komisariatit të Lartë Civil u emërua

¹⁷⁵ . Po aty.

¹⁷⁶ . Daut Bislimi, Rrjedhimet e Marrëveshjes së Mukjes në Kosovë, “Mukja si apel”, Tiranë 2003, 19.

Fejzi Alizoti, sepse ky kishte përvojë të madhe duke shërbyer në administratën shtetërore të Shqipërisë.¹⁷⁷

Kjo rikujtoi e ribëri lidhjet historike mes territoreve shqiptare. Njëherësh, kjo dëshmoi dhe aktualizoi problemin kombëtar të popullit shqiptar si një çështje të padrejtësive të mëdha etniko-territoriale. Shqiptarët po preknin dhe po përjetonin atë aspiratë, që kishin ëndërruar vazhdimisht, bashkimin kombëtar. Megjithëkëtë, në momentet e caktuara, ky realitet nuk e zbehu luftën kundër pushtuesve fashist. Ky ishte një rezultat logjik historik, kur popujt e shtypur përpiqen me çdo rrugë të mundshme të shkundnin zgjedhën e tyre shekullore, duke shfrytëzuar çdo rrethanë e çdo mundësi që u vjen në dorë. Ishte absurde që shqiptarët ta kundërshtonin këtë bashkim, duke e trajtuar nga pozitat e interesat kombëtare.¹⁷⁸

Pushteti nazifashist jo vetëm që kishin shpallur bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, por ata u treguan edhe shumë “dashamirës” të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë. Andaj, ata jo vetëm që nuk penguan hapjen e shkollave shqipe në Kosovë, por edhe inkurajuan hapjen e tyre.

Ministria e Arsimit në Tiranë, e udhëhequr nga ministri, profesori Ernest Koliqi, kishte marrë masa përgatitore për fillimin e punës së shkollave shqipe në Kosovë.¹⁷⁹ Ministria e Arsimit për ta studiuar gjendjen arsimore në Kosovë, dërgoi njerëzit kompetentë nëpër të gjitha viset e Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore dhe nga analiza dhe raportet e tyre, arriti t'i definonte nevojat e shkollave dhe të mësuesve shqiptarë në Kosovë.

Paralelisht, nisen punën mësimore me kurse të gjuhës shqipe dhe me ato të rriturve, duke i shpërndarë librat dhe abetaret e para

¹⁷⁷. Arkivi i Kosovës, Prefektura e Prizrenit, k.XXXV-1, 61/1941.

¹⁷⁸. Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria në luftë (1939-1944)*. (Studime dhe refleksione). Tiranë, 2001, 26-27.

¹⁷⁹. Abdylayiy Veseli, *Shkollat dhe arsimi shqip në Prefekturën e Prizrenit gjatë periudhës 1941-1944*, III. Gjilan 2003, 16.

shqiptare.¹⁸⁰ Nevoja për t'i ndihmuar arsimit dhe shkollës shqipe në Kosovë depërtoi anembanë Shqipërisë. Edhe nxënësit e shkollave bënë përpjekje që, duke i dërguar libra e tekste mësimore, ta ndihmonin shkollën shqipe në Kosovë.¹⁸¹

Në Kosovë shkollimi i detyrueshëm fillor ishte 5-vjeçar. Këto shkolla punonin sipas të njëjtit program si ato në Shqipëri. Ky sistem 5-vjeçar pritej të zbatohej edhe nëpër fshatra ku do të ishte e mundshme. Për vitin shkollor 1941/1942 parashihej që më tepër të bëhej mësimi i gjuhës shqipe, i historisë, i gjeografisë, i aritmetikës dhe i këngës. Nxënësit e kl.II,III dhe IV do t'i ndjekin mësimet në klasat suksesive.¹⁸²

Si rezultat i këtyre kushteve dhe rrethanave të favorshme, në Kosovë u hapën një numër i konsiderueshëm i shkollave fillore dhe atyre të mesme.

Gjatë viteve 1941–1944, në Kosovë u hapën 173 shkolla fillore, 3 të mesme dhe disa gjimnaze të ulëta.

Edhe në zonën e pushtimit gjerman, në Mitrovicë, në Vushtrri, në Podujevë dhe në Pazarin e Ri u organizuan shkolla me mësim në gjuhën shqipe.

Studimi i gjendjes arsimore në Prefekturën e Prizrenit dhe në veçanti evidencimi i objekteve shkollore dhe i pajisjes së tyre me orëndi e mjete mësimore ekzistuese, i mësuesve dhe i nxënësve mundëson të fitohet një pasqyrë mjaft reale e gjendjes. Andaj edhe hapat e parë që i ndërmori Ministria e Arsimit në Tiranë ishin të sigurt për trasimin e rrugës që çonte nga hapja e drejtë dhe e

¹⁸⁰. Rexhep Krasniqi, *Organizimi i arsimit në Kosovën e lirume*. “Kosova”, nr.12. Tiranë 1941, 2.

¹⁸¹. *Fëmijët shqiptarë për vëllezërit Kosovarë*. “Tomori”, 6 maj. Tiranë 1942, 2.

¹⁸². AQSH, FMA-295. Dosja 112/1, Tiranë 1941, fleta 312. (“*Organizimi i shkollave për Kosovë-udhëzimet të MA në Tiranë dërguar inspektorëve të arsimit në Prizren, Prishtinë, Pejë, Dibër dhe Tetovë*”). Shih edhe: A.Veseli, vep. e cit.,21.

suksesshme e shkollave shqipe në Kosovë në vitin shkollor 1941–1942.

Prefekturën e Prizrenit, e cila në kuadrin e vet përfshinte edhe 4 nënprefektura, në vitin shkollor 1941/1942 kanë punuar 45 shkolla shqipe, me gjithsej 5202 nxënës, në vitin shkollor 1942/1943 kanë punuar 52 shkolla, me gjithsej 6589 nxënës dhe në vitin shkollor 1943/1944, kanë punuar 50 shkolla, me gjithsej 5817 nxënës.

Në kuadrin e këtyre nënprefekturave ishte edhe ajo e Suharekës (Therandës), të cilën e drejtonte nënprefekti.¹⁸³ Rrjeti i shkollave në nënprefekturën e Suharekës kishte edhe hierarkinë e organizimit. Organi më i lartë arsimor në prefekturë ishte Drejtoria e Arsimit e Nënnprefekturës, e cila përcillte dhe kontrollonte zhvillimin e procesit arsimor në shkolla .

Në vitin shkollor 1941/42 shkolla fillore në ***Suharekë (Therandë)*** filloi punën me 128 nxënës. Gjatë këtij viti nuk pati asnjë nxënës klasa e II fillore. Mësuesi i parë ishte Hilmi Duli (i ardhur nga Shkodra) dhe më vonë, nga marsi i vitit 1942, filloi punën mësuesi Ali Hamdiu. Klasa e I–rë kishte gjithsej 99 nxënës, prej tyre 4 femra, kl.III–të 9 nxënës, kl.IV–të 10 nxënës, prej tyre 3 femra, kl.V–të 14 nxënës, prej tyre 5 femra. Ndërtesa shkollore kishte 2 mësonjëtoje të mëdha, korridor të madh dhe 4 dhoma të tjera më të vogla për banim të mësuesve. Në këtë shkollë mësimet i ndiqnin edhe nxënësit nga fshatrat Reçan dhe Sllapuzhan. Në vitin shkollor 1942/1943 në Suharekë hapën paralele të reja, më 110 nxënës. Shtohet edhe numri i mësuesve më Pashk Ndokilija (nga Shkodra) i cili punoi me klasën e III–të dhe mësuesin Abedin Mehmetin nga Prizreni, i cili punoi me klasën e IV–të.¹⁸⁴

¹⁸³. Muhamet Shatri, *Sistemi pushtues në Prizren dhe në rrethinë 1941-1944*. “Kosova”, 1978, nr.7, 405-423.

¹⁸⁴. AQSH, F.295. Dos.284/4, fletat, 64,68. (*Procesverbali i inspektimit të Shkollës fillore në Suharekë nga inspektori i arsimit në Prizren, dt.20.05.1942*). Shif edhe: A.Veseli, vepr. e cit., 119-112.

Në fshatin Mushtisht, shkolla fillore filloi punën në prillin e vitit 1942. Në këtë shkollë vjen për të punuar Frrok Lekë Dushi. Shkolla ishte katërklasëshe me gjithsej 206 nxënës, prej të cilëve 20 ishin femra. Në kl.I–rë ishin të regjistruar 86 nxënës prej të cilëve 8 ishin femra, ndërsa mësues ishte Ramadan Reçi. Në klasën e II–të ishin të regjistruar 81 nxënës prej tyre 66 femra, me mësuesin Ramadan Reçin. Kl.III–të kishte 28 nxënës, prej tyre 1 femër, me mësuesin Frrok Lekë Dushin.

Lokali shkollor kishte 3 dhoma mësimi, një zyre, një kuzhinë dhe një dhomë për banimin e mësuesve.¹⁸⁵

Në vitin shkollor 1943/44, shkolla fillore e Mushtishtit ishte 5–klasëshe me gjithsej 85 nxënës, pa asnjë femër. Me të gjitha klasët punonte Adelajde Vuçaj, mësuese në prituni.¹⁸⁶

Shkolla fillore në fshatin *Duhël*, për shkak të mungesës së kuadrit mësimdhënës, mësimin e filloi me vonesë. Pasi në fshatin Nishor, nuk u gjet zgjidhja e lokalit mësimor, atëherë mësuesi i cili ishte caktuar për këtë fshat Tajar Hatipi, me Dekretligjin e Inspektoratit Arsimor të Prizrenit, nr.230/2 të datës 15.IV.1942, u emërua mësues në Duhël dhe filloi punën më 16 prill 1942.¹⁸⁷

Shkolla kishte vetëm klasën e I–rë me gjithsej 60 nxënës, prej tyre 3 femra. Mësimet i ndiqnin nxënësit nga fshatrat Bllacë dhe Duhël. Lokali i shkollës kishte vetëm një klasë të madhe për të gjithë nxënësit. Në vitin shkollor 1943–1944, shkolla fillore e Duhlës kishte kl.I–rë me 35 nxënës dhe kl.II–të me 40 nxënës (38

¹⁸⁵. AQSH, F-295, viti 1942, Dos.284/2, fleta 124, 82. (*Procesverbali i inspektimit të shkollës fillore Mushtishtë nga inspektoriniarsimit në Prizren më dt.24.5.1942*).

¹⁸⁶. Po aty, fleta 78.

¹⁸⁷. AQSH, F.295, viti 1942, dos.284/2, fleta 139. (*Procesverbali i inspektimit të shkollës fillore në Duhël nga Inspektoratini Arsimit në Prizren më dt.24.5.1942*).

meshkuj dhe 2 femra). Në këtë vit shkollor mësues ishin Tajar Hatipi dhe Maliq Bala nga Vlora.¹⁸⁸

Në fshatin Gjinovc, shkolla fillore e cila kishte vetëm kl. I-rë, u hap në vitin shkollor 1943–1944. Mësuesi i Shkollës ishte Qemal Musliu. Lokali shkollor gjendej në hapësirën e xhamisë së fshatit dhe kishte një mësonjëtoje të madhe dhe dy dhoma të vogla për nevojat e shkollës.¹⁸⁹

Në vitin shkollor 1943–1944, u hap shkolla fillore dyklasëshe edhe në fshati Vraniq në Nënprefekturës së Suharekës. Shkolla kishte 81 nxënës, pa asnjë vajzë në dy klasat e fillores, kl.I-rë–56 nxënës dhe kl.II-të 25 nxënës. Mësuesi i shkollës ishte Abdyrrahman Zhuri. Objekti i shkollës kishte dy mësonjëtoje dhe pesë dhoma të tjera për zyre dhe banim të mësuesve.¹⁹⁰

¹⁸⁸. AQSH, F-295, viti 1944, dosja 146, fleta 139. (*Raporti fina i inspektorit të arsimit në Prizren për vitin shkollor 1943-1944, dërguar Ministrisë së Arsimit në Tiranë me nr. 24/III. Res.dt. 5.8.1944*).

¹⁸⁹. AQSH, F-295, viti 1944, dosja 146, fleta 139. (*Raporti i inspektoratit të arsimit në Prizren për vitin shkollor 1943-1944*).

¹⁹⁰. AQSH, F_295, viti 1944, dosja 146, fleta 79. (*Raporti final i inspektoratit të arsimit në Prizren për vitin shkollor 1943-1944, dërguar Ministrisë së Arsimit në Tiranë, nr. 24/III. Res. dt.5.8.1944*).

HAMDI V. THAÇI

Prishtinë

REXHEP KRASNIQI (1906–1999), DREJTORI I PARË I SHKOLLËS NORMALE–LICEALE “SAMI FRASHËRI” NË PRISHTINË

Njëri nga personalitetet që kontribuoi në ngritjen dhe përhapjen e shkollës shqipe në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë së pavarur, është edhe intelektual i dhe patrioti i madh shqiptar, prof. dr. Rexhep Krasniqi.

Rexhep Krasniqi u lind në Gjakovë në vitin 1906¹⁹¹. Është i biri i Musli Hoxhës së Krasniqes, i afërt me Maxhun Nimanin e Krasniqes¹⁹². Meqë i ati i Rexhepit kishte vdekur herët, dhe Rexhepi i ri kishte mbetur pakujdesjen prindërore, nga mosha 5–6 vjeçare rritet nën pakujdesjen e Bajram Currit, i cili ishte njëherësh ndër njerëzit më të afërt me lidhje gjaku me të. Duke u rritur në gjirin familjar të Bajram Currit, në vullkanin e patriotizmit shqiptar, Rexhepi herët do të brumoset me ideale të larta, në rrugën e drejtë të dashurisë për atdhe. Flakadanin e luftës për liri e mori nga Bacë Bajrami dhe rrethi i tij patriotik. Ai edhe vetë do të rrezatojë tërë jetën me ato tipare që i mori nga edukata familjare: trimërinë, guximin, atdhedashurinë, vendosmërinë, qëndrueshmërinë, të gjitha këto të veshura me një urtësi që nuk u zbeh kurrë.

¹⁹¹ .Rexhep Krasniqi, *Kongresi i Berlinit e Verilindja e Shqipnisë*, Nju-Jork, përkthimi shqip, 1998, f.1.

¹⁹² .Idriz Lamaj, *Kush ishte Rexhep Krasniqja*, “Bujku”, Prishtinë, 1997.

Bajram Curri, siç dihet, ishte dashamir i madh i shkollës dhe arsimit. Prandaj, ai nuk do të kujdesej vetëm për rritjen e këtij djaloshi të zgjuar, por u kujdes edhe për shkollimin e tij.

Në Gjakovë shkolla e parë shqipe ishte hapur në vitin shkollor 1915/16 dhe ishte emëruar “Skënderbeg”¹⁹³. Gjakova gjatë Luftës së Parë Botërore kishte rënë në zonën okupuese të Austro-Hungarisë, e cila lejonte shkollat shqipe. Në Gjakovë gjatë periudhës austro-hungareze në shkollat shqipe i vijonin mësimet 840 nxënës. Në gjeneratën e parë, nga viti 1915, mësimet e shkollës fillore i kishte ndjekur edhe Rexhep Krasniqi. Rolin më të madh për shkollimin e tij këtu dhe në shkollimin e mëtejshëm e kishte luajtur Bajram Curri, i cili njihet si dashamir i madh i shkollës shqipe.¹⁹⁴

Terrori serb që u zbatua pas riokupimit të Kosovës nga Serbia në vitin 1918, bëri që shumë individë dhe familje, që ishin dalluar në rezistencën antiserbe në vjeshtën e vitit 1918, ta lëshojnë Kosovën përkohësisht dhe të vendosen në vende të ndryshme të Ballkanit ose në Turqi. Një nga ata persona që u detyrua të shpërngulet me gjithë familje ishte edhe Bajram Curri. Ai kishte zgjedhur Shkodrën për vendstrehim të përkohshëm. Ky ishte vendosur në shtëpinë e

¹⁹³ Murat Z. Gecaj, *Nëpër udhët e shkollës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 124; * Shkolla e parë fillore që u hap në Gjakovë nën përkujdesjen e Bajram Currit dhe nën dejtimin e Mësuesit të Popullit Sali Morina. Kjo shkollë shpejt u shndërrua në shkollë gjashtëklasëshe. Në Gjakovë dhe në viset tjera shqiptare që ishin nën Austro-Hungarinë u hapën shumë shkolla në gjuhën shqipe. Për mbajtjen e atyre shkollave u kthyen mësues që e kishin mbaruar shkollën Normale në Elbasan, Shkup ose Berat. Kështu, përveç Sali Morinës, në Gjakovë ishin kthyer edhe Niman Ferizi, Ibrahim Fehmiu, Isuf Puka, Murat Gjakova, Ferid Imami, Qazim Bakalli, Osman Shaqiri etj.

¹⁹⁴ Historia e Popullit Shqiptar II, Prishtinë, 1969, f.417; Dr. Liman Rushiti, *Lëvizja Kaçake në Kosovë (1918-1928)*, Prishtinë, 1981, f.20; Kosova 1, Prishtinë 1972, f.228,229; Skënder Drini, *Bajram Curri*, Tiranë, 1984, f.212.

Shan Koliqit, babait të patriotit dhe intelektualit të madh, Ernest Koliqi.¹⁹⁵

Shkodra piktoreske, por e zyrtë nga shkatërrimet që kishin lënë pushtuesit njëri pas tjetrit, gjatë Luftës së Parë Botërore, sidomos vrasjet dhe plaçkitjet që kishin bërë serbët e malazezët në shfryrjet e tyre barbare mbi këtë qytet të lashtë mijëvjeçar. Por, me gjithë zymtësinë e pasluftës, Shkodra nuk po dorëzohej. Populli e ka cilësuar si vend ku është e mbledhur gjithë “urtësia e shqiptarisë”. Kjo dëshmonte urtësinë shekullore, traditën e lashtë e kulturën e shtresuar me shekuj në këtë qytet. Këtë traditë që trashëgonte dhe që vazhdonte ta kultivojë Shkodra, nuk e kishin zhdukur as romakët e as turqit, që e kishin mbajtur me shekuj nën sundimin e tyre, por as hordhitë barbare serbe e malazeze. Por Shkodra kishte mbetur shqiptare dhe simbol i urtësisë shqiptare. Ajo dha shembujt më të dalluar të trimërisë shqiptare, por njëkohësisht edhe mendjet më të ndritura të kulturës kombëtare. Pra, në këtë metropol diturie ishte vendosur Rexhep Krasniqi i ri, ku iu mundësua ta vazhdojë shkollimin dhe të njëjhej me shumë personalitete të kulturës dhe patriotizmit shqiptar. Aty u njoh me Shan Koliqin, Luigj Gura-kuqin, simbolin e rezistencës antiosmane e antisërbo-malazeze, apostullin e shkollës shqipe, i cili u bë frymëzim për shumë breza për “Qindresën” e tij të njohur. Aty u njoh edhe me Homerin Shqiptar, vjershëtarin e papërsëritshëm Atë Gjergj Fishtën dhe me shumë figura të tjera të çmuara të kulturës shqiptare, kulturë kjo që po kultivohej në Shkodër e që po rrezatonte në tërë Shqipërinë. Të gjithë këta lanë mbresa të thella të Rexhepi i ri, që po piquej para kohe.

¹⁹⁵ „Shëjzat”, numër i jashtëzakonshëm kushtuar Ernest Koliqit me rastin e vdekjes, Romë, 1975, f.16; Skënder Drini, vep. e cituar, f.255.

Pas vendosjes në Shkodër, Rexhepi i kishte vazhduar edhe dy klasë të shkollës fillore , dhe kjo konsiderohej atëherë si shkollë e plotë e fillores.¹⁹⁶

Shkollimin e mesëm e vazhdoi në Austri. Në Vjenë Rexhep Krasniqi u regjistrua në shkollën e mesme “Theresianum”. Kjo ishte një ndër shkollat më të vjetra dhe më e njohura në tërë Evropën Qendrore. Pasi mbaroi me sukses të shkëlqyeshëm këtë shkollë, i vazhdoi studimet në Universitetin e Vjenës, në drejtimin e shkencave shoqërore, duke pasur për profilizim shkencat shoqërore të historisë dhe diplomacisë, më saktësisht historinë e Ballkanit. Pasi kishte përfunduar me sukses të jashtëzakonshëm fakultetin dhe studimet pasuniversitare, ishte orientuar për titullin e doktoratës , me të cilin u lauria në vitin 1934. Teza e doktoratës me të cilën u lauria doktor i shkencave të historisë titullohej: ”Kongresi i Berlinit e Verilindja e Shqipërisë” ose titulli origjinal ishte “*Der Berliner Kongress und Nordostalbanien*”.¹⁹⁷

Mendoj se kjo temë ishte trajtuar për herë të parë në një shkallë të tillë studimi dhe hulumtimi shkencor. Edhe për studiuesin e ri nga Kosova , që tash e kishte përjetuar copëtimin e sërishëm të atdheut të vet, kjo temë kishte qenë me shumë interes, për t’ua përkujtuar qarqeve ndërkombëtare dhe qendrave të vendosjes, se shqiptarët nuk ishin pajtuar me padrejtësitë që Fuqitë e Mëdha kishin bërë ndaj Shqipërisë dhe nuk po pajtoheshin as në kohën e autorit të kësaj doktorate, mbasi padrejtësitë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve po vazhdonin të përsëriteshin edhe më tutje.

¹⁹⁶ Dr. Rexhep Krasniqi, *Kongresi i Berlinit e Verilindja e Shqipërisë*, Vjenë , korrik 1934; Idriz Lamaj, *Një laborator krijues dhe hulumtues*, “Bujku”, 1996.

¹⁹⁷ . Dr. Rexhep Krasniqi, vep. e cit. në parathënie.

Përveç temës, studenti i ri shqiptar kishte zgjedhur për relator (mentor) dijetarin më të madh të kohës prof. dr. Carl Patch¹⁹⁸. Ky shkencëtar është i njohur si albanolog dhe historian, i cili për shkencën e albanologjisë ka bërë shumë. Po ashtu është i njohur edhe për atë se ishte njohës i mirë i historisë së Ballkanit. Në kohën kur ishte caktuar relator për profesor Rexhepin, ishte profesor në Universitetin e Vjenës dhe kryetar i Institutit të Ballkanologjisë pranë këtij universiteti.¹⁹⁹

Në vitin 1934, Rexhep Krasniqi u shpall solemnisht *Doktor i shkencave të historisë*, por teza e doktoratës, e botuar në gjermanisht, për lexuesin shqiptar, e përkthyer në gjuhën shqipe u botua vetëm në vitin 1998. Përkthimin e bëri në mënyrë vullnetare dr. Fejzi Domni, kurse shpenzimet e botimit shqip i kishte siguruar dr. Hasan Biberaç. Kur autori e kishte marrë vesh se përkthimi ishte kah fundi, dhe vetë autori prof. Rexhepi ishte në pleqëri të thellë, pak kohë para vdekjes, përkthyesit dhe botuesit i kishte dërguar këtë falënderim: *"Ju falënderoj me zemër, se pa mundin t'uj, ky studim nuk kishte m'ë pa dritën e botimit!"*²⁰⁰

Pas përfundimit të studimeve, dr. Rexhep Krasniqi kthehet në Shqipëri. Profesori i ri dhe i përgatitur në shkallë superiore fillimisht punoi në shkollën qytetëse të Gjirokastrës. Në të njëjtën shkollë

¹⁹⁸ Dr. Karl Patch.

¹⁹⁹ Idriz Lamaj, *Shënime për autorin*, në vend të parathënies në vep. e dr. R. Krasniqit, Kongresi i Berlinit e Verilindja e Shqipërisë, Vjenë, korrik 1934, përkthyer në shqip dhe botuar në vitin 1988 në Nju-Jork. Librin e ka përkthyer në shqip, ose siç thotë përkthyesi, z. dr. Fezi Domni "pjellun në shqip".

²⁰⁰ Idriz Lamaj, *Shënime për autorin*, në vend të parathënies për librin e dr. Rexhep Krasniqit, *Kongresi i Berlinit e Verilindja e Shqipërisë, Nju -Jork, 1998*.

profesor Krasniqi më vonë ishte emëruar në pozitën e zëvendës-drejtorit.²⁰¹

Në vitin 1938, dr. Rexhep Krasniqi emërtohet drejtor i Arsimit të Mesëm në Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë. Nga viti 1939 ishte Inspektor Epror në Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë.²⁰²

Në vitin 1941, mbas prishjes së burgut të popujve të Ballkanit, atij shtetit surrogat të quajtur Jugosllavi, që nuk ishte gjë tjetër vetëm një kamuflim i qëllimshëm për Serbinë e Madhe, një pjesë e tokave shqiptare, që kishin qenë nën sundimin serb nga viti 1918, iu bashkuan Shqipërisë. Viset shqiptare që u bashkuan me shtetin shqiptar, por nën sundimin e Italisë, quheshin atëherë *Toka të lirume*, në kuptimin të çliruara nga Serbia. Në të vërtetë, ato ishin tokat shqiptare që i takonin zonës italiane, pas ndarjes së zonave të interesit të shteteve që e pushtuan dhe e copëtuan Jugosllavinë e Versajës.

Viset shqiptare që kishin qenë nën okupimin serb kishin ngelur mbraja në shumë aspekte, pra edhe në aspektin e arsimit, administratës, etj. Për këtë arsye, qeveria shqiptare për këto vise kishte caktuar forma të veçanta të organizimit të administratës dhe të arsimit shqip, duke dërguar në këto anë njerëz të arsimuar dhe profesionalistë, që do të ndihmonin popullsinë e këtyre anëve të dalin nga ajo gjendje, ose siç thoshte prof. Ernest Koliqi “...që n`ato krahina të zhdukët sa më parë edhe shenji më i vogël i robërisë së viseve të lirume...”²⁰³

²⁰¹ . Idriz Lamaj, vepra e cituar.

²⁰² Akademik J. Rexhepagiq, Dr. Abdullah Vokrri, Mr. A. Veseli, *Shkolla Normale "Sami Frashëri" Prishtinë*, Prishtinë 1997, f.139.

²⁰³ . AQSH , Fondi 295, viti 1941, dosja 16, fl. 1,2 .

Me përkushtimin që kishte ministri Koliqi për përhapjen e arsimit në këto vende ku kurrë më parë nuk kishte pasur shkolla shqipe, qysh në vitin 1941u hapën shumë shkolla fillore. Përveç shkollave fillore, ministri Koliqi ishte kujdesur që për Viset e Lirume të hapën në qendrat e Prefekturave nga një shkollë e mesme. Kurse në Prishtinë e kishte paraparë një shkollë Normale, e cila do të ishte barasvlershme me Normalen e Elbasanit. Kjo shkollë duhej të plotësonte nevojat e këtyre viseve me kuadro arsimore, sepse ndihej mungesë e madhe për mësues. Për këtë shkollë, vet ministri Koliqi do të kujdeset që të zgjidhte kuadrin arsimor, por edhe stafin drejtues të saj. Vendimi për hapjen e kësaj shkolle u mor më 12 nëntor 1941, kurse shkolla do të fillojë punën më 17 dhjetor 1941. Shkolla e parë e mesme në Prishtinë u emërua Shkolla Normale – Liceale “Sami Frashëri”.²⁰⁴

Për drejtor të Shkollës Normale–Dega Liceale, ishte zgjedhur prof. dr. Rexhep Krasniqi. Detyrën e drejtorit e kishte marrë më 12.XII.1941. Me këtë rast dr. Rexhep Krasniqi, i magjepsur nga gëzimi, shkruan më vonë: “...*më në fund erdhi çasti historik i hapjes së Shkollës së parë të mesme në gjuhën shqipe, që u realizua më 12 dhjetor 1941*”. Kjo shkollë, sipas dr. Rexhep Krasniqit, do të bëhet bazë e gjithë sistemit shkollor për shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare që mbetën nën administrimin jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore.²⁰⁵

Sipas kësaj të dhëne që na ofron prof. Rexhep Krasniqi del se Shkolla Normale– Dega Liceale “Sami Frashëri“ në Prishtinë është hapur më 12 dhjetor 1941, kurse të gjitha burimet tjera që i kemi

²⁰⁴ Po aty;

²⁰⁵ . “Shëjzat” viti XVIII, Romë, 1975,f. 16, Numër përkujtimor kushtuar profesor Ernest Koliqit.

në dispozicion thonë se kjo shkollë punën e kishte filluar më 17 dhjetor 1941.²⁰⁶ Sipas të gjitha gjasave dr. Krasniqi me 12 dhjetor e kishte filluar punën si drejtor, prandaj këtë datë e quan si fillim të punës së shkollës, kurse nxënësit kanë filluar mësimin më 17 dhjetor 1941. Nuk është e tepërt për të shtuar me këtë rast se në këtë shkollë kishte nxënës nga të gjitha viset shqiptare duke filluar nga Ulqini, Pazari i Ri, Presheva e deri në Manastir në jug. Por kishte edhe nga brendia e Shqipërisë, Durrësi, Elbasani, Shkodra e deri në Gjirokastrë në jug²⁰⁷.

Prof. Rexhep Krasniqi dhe prof. Vasil Andoni, njëri drejtor i Shkollës e tjetri drejtor i Konviktit, ishin dy shtyllat kryesore, që mbanin dhe orientonin drejt institucionin më të rëndësishëm arsimor që kishte Kosova dhe Shqipëria në vitin 1941²⁰⁸.

Në kujtimet e tij dhënë autorit të këtij shkrimi, ish-nxënësi i Gjinnazit, dr. Nexhip Morina, shkruan se “*autoriteti i drejtorit Rexhep Krasniqi ishte i veçantë nga të tjerët. Qëndrimi i tij në fillim të linte përshtypjen e një njeriu paksa i tërhequr, por në bashkëpunim ishte i afërt , i dashur, korrekt , prandaj kishte fituar respektin e nxënësve të kësaj shkolle*”.²⁰⁹

Përveç se e kryente detyrën e drejtorit të shkollës, dr. Rexhep Krasniqi, e kishte edhe normën me nëntë orë mësim në javë nga lënda e gjuhës gjermane në klasat V, VI, VII dhe kl. VIII.²¹⁰

²⁰⁶ . “Shëjzat“, po aty, f. 78; AQSH, fondi 295, dosja 16, fl.1.

²⁰⁷ Hamdi V. Thaçi *Gjinnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë, 1941-1944 I*, Prishtinë, 2011, f.307;

²⁰⁸ Po aty f.327. vr. e autorit: Në këtë monografi është biografia e prof. Vasil Andonit, pedagogut më të mirë që kishin shkollat shqipe në at kohë. Ai ishte i veçantë si njeri e si edukator, si mesmdhënës e si patriot.

²⁰⁹ Po aty, f. 601;

²¹⁰ J.Rexhepagiq, A.Vokri, A. Veseli, Vep. e cituar , f.138.

Kur në shumë vende të botës lufta po zhvillohej në një front mes fashizmit dhe antifashizmit, në trojet shqiptare kjo luftë ishte shumë e ndërlikuar, sepse po zhvillohej luftë edhe brendapërbrenda shqiptarëve. Dështimi i Mbledhjes së Mukjes për bashkimin e të gjitha forcave kombëtare në luftë kundër të gjithë pushtuesve të vendit, e çoi Shqipërinë në një luftë të brendshme. PKSH nën ndikimin dhe dirigjimin e misionarëve komunistë jugosllavë hoqi dorë nga lufta për bashkimin e trojeve etnike dhe të gjithë ata që kërkonin këtë të drejtë të natyrshme kombëtare i shpalli “armiq”. Përveç luftës vëllavrasëse që shpërtheu në Shqipëri, edhe më rëndë do ta pësojnë viset shqiptare që iu patën bashkuar Shqipërisë më 1941 e tash po rrezikoheshin që serish të bien nën sundimin serbo-jugosllav.

Nga të dhënat që kam hasur gjatë hulumtimit tim kam ardhur në përfundim se diku nga muaji janar 1943 prof. Rexhep Krasniqi do ta ketë lënë detyrën e drejtorit të Shkollës Normale–Liceale të Prishtinës dhe do të shkojë në detyrë të re– Ministër i Arsimit në qeverinë e Mehdi Frashërit.²¹¹

Krahas aktivitetit edukativo–arsimor, dr. Rexhep Krasniqi, pas vitit 1943, gati plotësisht iu përkushtohet çështjeve politike, jo për të zënë ndonjë post, që do t’i sillte përfitime, porse rrethanat historike në këtë kohë diktonin fatin e intelektualëve e shkencëtarëve të kohës. Kështu prof. Rexhep Krasniqin në shtator të vitit 1943 do ta gjejmë si njërin ndër organizatorët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Pastaj një kohë edhe në Kuvendin Kombëtar të Tiranës, tetor

²¹¹ . Mehdi Frashëri ishte një politikan me përvojë. Ishte kryeministër në kohën e italianëve e pas hyrjes së gjermanve në Shqipëri në shtator 1943, Mhediu një kohë e kishte mbajtur serish pozitën e kryeministrit.

1943²¹². Pas këtij aktiviteti, mbasi në Shqipëri pushtetin e morën komunistët, prof. Rexhepi do të përjetojë fatin e shumë patriotëve e intelektualëve shqiptarë, fat ky që do të përfundonte në varr, burg ose në mërgim. Mërgimi ishte fati më “i bardhë”, për të gjallët që do t’iu shpëtojnë persekutimeve, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri.

Prof. Rexhep Krasniqi, nga karriera e vet politike të viteve 1943/44 më nuk kishte mundësi të qëndronte në Shqipëri, mbas fitores së komunizmit, ideologji të cilën kurrë nuk e pranoi dhe gjithmonë e urreji.

Në rrethana të tilla historike, duke u gjetur në udhëkryqe të tilla pa orientim të caktuar ose pa një orientim të përbashkët të forcave liridashëse e patriotike shqiptare dr. Rexhep Krasniqi së bashku me një grup bashkëpunëtorësh²¹³, të udhëhequr nga Xhafer Deva, ikën jashtë vendit dhe fillimisht u vendos në Austri.²¹⁴ Pas një qëndrimi disa vjeçar në Austri, dr. Rexhep Krasniqi, me grupin prej pesë emigrantëve, kaluan në Itali në vitin 1947, dhe prej aty në Siri. Të udhëhequr nga Xhafer Deva, grupi i emigrantëve që u vendosën në Siri, nga viti 1948 nxorën gazetën “*Bashkimi i Kombit*“, e cila u

²¹² Për herë të parë, sigurisht nën ndikimin e dr. Rexhepit, në Kuvendin Kombëtar merrnin pjesë edhe deputetë nga Kosova dhe nga vise të tjera shqiptare që më parë kishin qenë nën okupimin serb, e tash iu kishin bashkuar Shqipërisë.

²¹³ Tomë Mrijaj, Klajd Kapinova, *Lidhja e Prizrenit...*, Nju- Jork, 2003, f.26. Në këtë grup, që udhëhiqej nga Xhafer Deva, bënin pjesë: Rexhep Mitrovica, i cili ishte i sëmurë rëndë, Rexhep Krasniqi, Tahir Zajmi dhe Xhelal Mitrovica. Xhaferi e siguroi vendin për shërim të Rexhep Mitrovicës te një mik i tij në Austri. Nga grupi i përmendur, pasi përmirësohet nga shëndeti, Rexhep Mitrovica shkon në Stamboll, kurse këta të tjerët në Siri.

²¹⁴ Tomë Mrijaj, Klajd Kapinova, *Lidhja e Prizrenit (1962- 2002)*, Nju- Jork, 2003, f. 26.

bë zëdhënëse e të gjitha grupeve nacionaliste, patriotike, që jetonin e vepronin në mërgim.²¹⁵

Nga Siria kaloi në Australi ku qëndroi deri në vitin 1956. Në vitin 1956, u ftua nga qeveria amerikane për ta udhëhequr Komitetin “Shqipëria e Lirë”. Komiteti i parë dhe i dytë “Shqipëria e Lirë” po kalonte nëpër vështirësi të natyrave të ndryshme, sidomos përballja me situatën ndërkombëtare dhe ndikimin e saj në çintegrimin e këtyre. Për këtë arsye, sigurisht për organizimin më të mirë të këtij Komiteti ishte interesuar edhe qeveria amerikane, e cila edhe e kishte thirrur dr. Rexhepin që ta merrte timonin e emigracionit shqiptar, që vepronte në Amerikë dhe në botë.

Më 23 nëntor 1956, u themelua në Nju-Jork Komiteti *Shqipëria Lirë*. Ky komitet ishte pasardhës i dy komiteteve të mëparshme, por kishte një ndryshim, sepse u themelua në baza jashtë partiake, e kjo në fillim hasi në kundërshtimin e disa individëve.²¹⁶ Komiteti *Shqipëria e Lirë* ishte anëtar i Asamblesë të Kombeve të Robëruara Evropiane (ACEN). Veprimtaria e dr. Rexhep Krasniqit ka qenë shumë e madhe në afirmimin e pozitës së popullit shqiptar, që kishte mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë londineze si dhe të popullit shqiptar nën diktaturën e komunizmit.

Komiteti *Shqipëria e Lirë* zhvillonte një aktivitet të gjithanshëm politik, kulturor dhe propagandistik me theks të veçantë në aktivitetet informative. Për këtë arsye, ishte vendosur që Komiteti *Shqipëria e Lirë* të nxirrte gazetën e vet “*Shqiptari i Lirë*”. Nga viti 1956 deri në vitin 1970 kryeredaktor i kësaj gazete kishte qenë prof. Nexhat Peshkëpia, kurse një rol shumë të rëndësishëm në të gjitha drejtimet e veprimtarisë së kësaj gazete e kishte luajtur edhe

²¹⁵ . Po aty, f. 27.

²¹⁶ Po aty, f.8.

prof. Rexhep Krasniqi²¹⁷. Për kontributin në afirmimin e kulturës dhe të shkollës shqipe, kryetari i Shqipërisë, dr. Sali Berisha, e dekoroi dr. Rexhep Krasniqin me Urdhrin “Naim Frashëri” të Klasit të Parë, në vitin 1994²¹⁸.

Dr. Rexhep Krasniqi, me gjithë vuajtjet e shumta dhe peripecitë ndër nga më të ndryshmet që përjetoi gjatë jetës së tij, sikur Anteu, sa herë që shkruante, fliste ose punonte diçka në të mirë të atdheut dhe popullit të vet, sikur i shtohet fuqia. Me gjithë vështirësitë jetësore dhe vuajtjeve shpirtërore, jetoi më se 93 vjet. Pas vitit 1990, kur Shqipëria u demokratizua, sikur iu shërua njëra plagë. Ai, kah fundi i jetës së tij kishte shprehur dëshirën që të vinte në Shqipëri dhe aty ta bënte vdekjen. Mirëpo, ngjarjet e vitit 1997 dhe flaka që përfshiu Shqipërinë, sikur e ndalën dhunshëm që të mos e realizonte ëndrrën e tij për t’u kthye i gjallë në Shqipëri. Ai, edhe pse i lindur në Gjakovë, vendlindje të tij e konsideronte gjithë Shqipërinë etnike. Kjo ëndërr e tij nuk u realizua. Kurse plaga tjetër, Kosova dhe viset e tjera etnike shqiptare, që mbetën nën okupimin e vendeve fqinje nga Kongresi i Berlinit (1878) dhe Konferenca e Londrës (1913), e çoi në varr. Ishte kohë shumë e shkurtër që e ndante nga vdekja dhe përfundimi i Luftës Çlirimtare në Kosovë, të cilën e çmonte aq shumë, kur më 12 shkurt 1999 vdiq në një shtëpi pleqsh në Nju-Jork.²¹⁹

Dr. Rexhep Krasniqi kishte një fat ose më mirë të themi kishte ndjekur një rrugë që kishin ndjekur shumë patriotë shqiptarë, si Faik Konica, Vasil Andoni, Luigj Gurakuqi etj., që duke iu përkushtuar çështjes kombëtare, kishte hequr dorë nga interesat

²¹⁷ . Dr. Rexhep Krasniqi, Komiteti “Shqipëria e Lirë”..., f.15.

²¹⁸ . Zenun Çelaj, *Vdiq dr. Rexhep Krasniqi*, “Bujku”, shkurt 1999.

²¹⁹ Po aty;

personale dhe nga martesë. Ai, pra, nuk la trashëgimtar, por nën kujdesin e bashkëpunëtorëve dhe bashkëkombësve u varros me nderime. Është detyrë e të dy shteteve shqiptare, Shqipërisë dhe Kosovës, që të bëjnë kthimin e eshtrave dhe varrosjen e tyre në Atdhe, dëshirë e parealizuar për së gjalli e dr. Rexhep Krasniqit.

Dr. Rexhep Krasniqi ka lënë në Nju Jork një arkiv dhe një bibliotekë shumë të pasur. E gjithë ajo lëndë ka mbetur e mbyllur dhe në mëshirën e kohës. Po ashtu Dr. Rexhep Krasniqi ka lënë edhe një numër të madh shkrimesh, të cilat, përveç në botime të veçanta, janë botuar në formë të artikujve në shumë gazeta e revista të ndryshme të kohës. Ai, krahas luftës për mbrojtjen e popullit shqiptar, që ishte nën sundimin e shteteve fqinje të Shqipërisë, nuk pushoi së mbrojturi edhe të drejtat e popullit shqiptar nën diktaturën komuniste dhe izolimin e tij, pas vitit 1944. Nga ky vend propozoj që një institut ose dy e më tepër sosh, në Shqipëri, Kosovë ose Maqedoni, ta fusin në projektet e tyre sjelljen e asaj biblioteke dhe të atij arkivi të dr. Rexhep Krasniqit në Shqipëri ose në Kosovë. Besoj se është më inertes kombëtar përpunimi dhe shfrytëzimi i gjithë atij thesari që ka lënë një njeri dhe një intelektual siç ishte dr. Rexhep Krasniqi.

Po ashtu mendoj se është koha që ndonjë institucion i lartë arsimor në Kosovë, në Shqipëri ose në Maqedoni të emërtohet me emrin e këtij kolosi të lëvizjes kombëtare e kulturore shqiptare.

Një nder i madh dhe një respekt i merituar për këtë dijetar e patriot do të ishte që njëri nga dy shtetet tona, Kosova ose Shqipëria, t'i sillnin eshtrat e tij në atdhe, ku ishte dëshira e tij në jetën e gjatë gati një shekull, që të pushojnë të qetë.



Rexhep Krasniqi
(1906-1999)

NURIDIN AHMETI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

VËSHTRIM MBI PËRMBAJTJET HISTORIKE TË NJË TEKSTI MËSIMOR TË VITIT 1943

Pushtimi i Italisë fashiste më 1939 dhe instalimi i organeve të saj në Shqipëri dhe në “Tokat e Lirume” siç quhej atëherë, është mendim i studiuesve të huaj e vendorë, se i dha hov edhe botimeve në gjuhën shqipe, si libra, gazeta, revista, etj., me një fjalë, ishte periudhë që karakterizohej edhe nga “bollëku i botimeve”.²²⁰

Në botimet e shumta të asaj periudhe, janë edhe librat shkollorë në gjuhën shqipe, të përgatitura kryesisht nga studiues shqiptarë dhe njohës të mirë të shkencave albanologjike.

Librat shkollorë, janë të përgatitura me mjaftë kujdes, dhe aty, e kuptueshme, vërehen edhe elementet fashiste, si fotografi të Musolinit, Duçes, ndonjë vjershë kushtuar fashizmit etj.

Përkritazi me këtë ne, në këtë vështrim kemi bërë përpjekje, për një vështrim tekstit me titull: “*Bota Shqiptare*”, libër leximi për Kursin e Naltë të Shkollave të Mesme, botim i Ministrisë së Arsimit, i vitit 1943.

Libri është gjithëpërfshirës, trajton mite, besime, legjenda, histori, etnografi, gjuhësi të shqiptarët. Në jemi ndalë vetëm te përmbajtja historike e këtij teksti.

E kemi parë të arsyeshme për një vështrim, sepse pjesa dërmuese e këtij teksti trajton aspekte historike të shqiptarët dhe numër kopjesh të këtij libri kemi hasur përveç Bibliotekës Kombëtare të Tiranës edhe në disa biblioteka personale në Kosovës, të trashëguara nga

²²⁰ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, ShB, 55, Tiranë, f. 421

paraardhësit e tyre, çka do të thotë se ky libër është përdorur njafhtë në Kosovë, një gjë të tillë, të përdorimit të këtij teksti në Kosovë na kanë konfirmuar edhe disa të intervistuar në terren.

MËSIMI I HISTORISË KOMBËTARE NË TEKSTET SHKOLLORE TË HISTORISË MË 1943

Ky tekst është i ndarë në disa kapituj, dhe është përgatitur nga Ernest Koliqi, Aleksandër Xhuvani, Karl Gurkuqi, Kolë Kamsi e Eqrem Çabej, ka gjashtëqind faqe dhe është shtypur në shtypshkronjën “Gurakuqi” në Tiranë.

Libri hapet me kapitullin për “Mite, besime e legjenda”,²²¹ dhe vazhdon më kapitujt “Histori, etnografi, gjuhësi”,²²² “Shqipnija prej kohës ilire deri te sundimi otoman”,²²³ “Gjergj Kastrioti Skanderbeg, legjenda, histori, gojëdhëna”,²²⁴ “Zgjidhimi ndiesis kombëtare, Rilindja, vetëqeverimi”,²²⁵ “Jeta botore e private, zakone e doke, letërsi popullore”,²²⁶ “Shqipnija arkeologjike”,²²⁷ “Shqipnija e bukur”,²²⁸ “Shqiptarët në botë – shqiptarët humnaista, artista e dijetarë”,²²⁹ “Shqiptarët shkallënantë”,²³⁰ “Shqiptarët ndër koloni”.²³¹

Pothuajse, në të gjitha kapitujt në një mënyrë apo në një tjetër është e prekur edhe tema e historisë, por ne, ashtu siç e potencuam

²²¹ Grup autorësh, *Besa Shqiptare*, Botim i Ministris S’Arsimit, Tiranë, 1943, f. 7-90

²²² *Po aty*, f. 91-138

²²³ *Po aty*, f. 139-188

²²⁴ *Po aty*, f. 189-252

²²⁵ *Po aty*, f. 253-322

²²⁶ *Po aty*, f. 323-330

²²⁷ *Po aty*, f. 331-400

²²⁸ *Po aty*, f. 401-518

²²⁹ *Po aty*, f. 519-541

²³⁰ *Po aty*, f. 543-569

²³¹ *Po aty*, f. 572-598

edhe më lartë, do të ndalemi vetën në ato pjesë të librit ku flitet ekskluzivisht për historinë.

Duhet theksuar, se në ato pjesë ku bëhet fjalë për një periudhë historike të shqiptarët apo personalitet historike, përgatitësit e këtij teksti i kanë marr nga autorët vendorë apo të huaj që kanë shkruar për këto figura apo ngjarje historike, p.sh., te pjesa ku flitet për parahistori, fillon me titullin “Shtegtimet e herëshme t’Iirvet” ku sqarohen këto shtegtime dhe në fund të kësaj njësie mësimore, është i vendosur emri i autorit të kësaj ku përgatitësit e tekstit e kanë marrë, në këtë rast, ata e sqarojnë në fushnotë se e kanë marrë na dijetari gjerman Hans Krahe dhe së bashku me emrin, te dijetarët e huaj ata japin edhe disa të dhëna bazike për autorin ku theksojnë: “H.Krahe është përmveshur prej disa vjetesh gjurmimit të stërgjyshet t’onë ilirë.....Copa që paraqisim këtu është përkthimi i një artikulli të tij të botuar në të përkohëshmen “Geist der Zeit”, Viti V, Nr. 18, 20 Shtator 1938”.²³²

Në këtë kapitull në tërësi flitet për ilirët, për qytetërimin ilir, cilësitë racore të tyre, prejardhja e shqiptarëve nga ilirët, gjuhën e ilirëve, zakonet, etj. Kapitulli është i përberë prej gjithsej tetëmbëdhjetë njësive dhe gjashtë nga këto njësi flasin për ilirët, të shkruara nga dijetarët si: Luigj Ugolini, Oto Reche, I. Schweidetzky, Eugen Obërehummer, L. Thalloczy, Paul Krechmer, Konstantin Jeriçek, etj.

Kapitulli në vazhdim në këtë tekst trajton problematikën historike të shqiptarëve prej “kohës ilire deri te sundimi otoman”. Kur flitet për ilirët nuk mund të mos e potencojmë, se i japin hapësirë lidhjeve ilire—romake, që sigurisht se temat e tilla do t’i konvenonin edhe pushtetit të kohës, ky kapitull përbehet prej gjithsej 14 njësive mësimore dhe përfundon me njësinë mësimore mbi rolin e

²³² *Po aty*, f. 94

shqiptarëve në Perandorinë Osmane, të autorit Gorge Stadt-muller.²³³

Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe veprimtaria e tij, në këtë tekst zënë një kapitull të terë, tekstpërgatitësit, në njëzetë njësitë, trajtojnë figurën e heroit tonë kombëtare nga origjina e familjes së Kastriotëve e deri në fundin e jetës së Skënderbeut, duke futur edhe vargje të cilat janë mbledhur kryesisht tek arbëreshët e Italisë. Në këtë pjesë nuk mungojnë as gojëdhënat e legjendat, siç e potencojnë edhe vetë tekstpërgatitësit. Berandrin Palaj, Fan Noli, Marin Sirdani, Marin Barleti, Shtjefen Gjeçovi, janë disa nga autorët, tekstet e të cilëve u radhitën në këtë kapitull.²³⁴

Periodha e Rilindjes Kombëtare, natyrisht, e kuptueshme, edhe në këtë tekst zë një kapitull të terë. Kjo periudhë vjen e shpjeguar përmes teksteve të autorëve Zef Valentini, Theoddor Ippen, Tefë Curani, Bernadrin Palaj, etj., dhe fillohet me njësinë mësimore mbi përpjekjet e shqiptarëve për pavarësim nga Perandoria Osmane dhe përfundon me disa vargje për vrasjen e Atë Shtjefen Gjeçovin. Lidhja e Prizrenit, Ali Pashë Tepelena, Ali Pashë Gucia, Kostaq Kosturi, Papa Kristo Negovani, Zef Harapi, Dedë Gjo Luli, Çerçiz Topulli, Themistokli Gërmenji, janë disa nga personalitetet që trajtohen në këtë kapitull. Ali Pashë Gucia dhe Papa Kristo Negovani trajtohen në vargje, të shkruara nga Gjergj Fisha e Zef Skiroi. Personaliteti i Papa Kristo Negovanit, shkruhet në vargje për vrasjen e tij, autori Zef Skiroi edhe i titullon vargje e tij “Vrasja e Negovanit”. Ndërsa, 28 Nëntori i viti 1912, prezantohej përmes një teksti me autor Luigj Gurakuqin, “me 28 Nanduer 1912, n’ora 4 e gjymës pas dreke, përfaqësuesit e të gjitha viseve të Shqipnis, tue i dhane vllaznisht dorën njëni tjetrit e tue u lidhun me besën e burravet qi me u përpjekun me gja e me jetë për vendin e të parvet

²³³ *Po aty*, f. 188

²³⁴ *Po aty*, f. 191-251

të vet, venduen të ndamunit e Shqipnis nga Turqija....,”²³⁵—shkruan në tekstin me autor Luigj Gurakuqin, të vendosur në këtë kapitull.

Për dallim prej teksteve të kohës së sotme, ku njësit mësimore që lidhen me arkeologjinë, i gjejmë në fillim të librit, te ky tekst mësimor, kapitulli “Shqipnija arkeologjike” është vendosur nga mesi i tekstit. Është për t’u theksuar, se në këtë kapitull trajtohen qytete nga gjithë hapësira shqiptare, si: Shkodra, Durrësi, Pojani, Butrinti, Amantia, Ulqini, Prizreni, Voskopoja, etj. Duhet të theksohet se teksti përveç historikut dhe rëndësisë që sqaron për gjetjet arkeologjike në Shqipëri, një nëntitull i veçantë në këtë kapitull, ve në fokus përmes shkrimit edhe kujdesin që duhet të kenë njerëzit ndaj gjetjeve arkeologjike dhe si duhet trajtuar ato nga masa e gjerë.²³⁶ Tekstet e shkruara në këtë pjesë në masë të madhe kanë për autor arkeologun e njohur Hasan Ceka. Si përmbajtje mësimor, por duke ia përshtatur rrethanave të sotme, unë mendoj se edhe sot është e nevojshme tu shpjegohet nxënësve në shkollat tona, për kujdesin ndaj trashëgimisë tonë kulturore.

Një kapitull njaftë interesantë i vendosur në fund të librit, trajton shqiptarët në botë dhe duke i ndarë në tri pjesë apo njësi mësimore:

E para – shqiptarët humanista, artista e dijetarë, ku përshihen: Gjon Gazulli, Marin Biçikemi, Leonik Tomeu, Aleksander Mojsiu, Viktor Eftemiu, Marin Barleti, Dora Distria, tekstet për këto figura janë të shkruara nga Kolë Kamsi, Faik Konica, Lumo Skendo etj.²³⁷

E dyta – shqiptarët shkallënantë apo në pozita të larta, ku fillohet me vezirët e mëdhenj shqiptare që shërbyen në Perandorinë Osmane, vazhdojnë me Klementin XI Papa Shqiptarë, Mehmet Ali Pasha, Gjergj Basta, Patrona Halil, Hoxha Hasan Tahsini, Françesko

²³⁵ *Po aty*, f. 319

²³⁶ *Po aty*, f. 431-400

²³⁷ *Po aty*, f. 319-541

Krispi, autor të këtyre teksteve janë Sami Frashëri, Hamdi Bushati, Zef Valenti etj.²³⁸

E treta – shqiptarë ndër koloni, ku fillojnë me shqiptarët në Itali, historikun e vendosjes së tyre atje, kontributin e tyre në Rilindjen Kombëtare Italiane, Horën e Arbëreshëve, shqiptarët në Lecce, Napoli, Slavoni, etj. Në këtë pjesë flitet edhe për letërsinë e italo-shqiptarëve dhe një nëntitull i është kushtuar Lëvizjes Kombëtare të Shqiptarëve të Rusisë.²³⁹ Kur është fjala për pjesëmarrjen e shqiptarëve në rrjedhat çlirimtare të Rusisë, në këtë tekst theksohet se emri i shqiptarëve është i njohur në Rusi nga shekulli XIV, në kohën e Jovanit, ky njëri kishte ofruar afër vetës njëri nga dijetarët e njohur të Rusisë së asaj kohe, por me origjinë shqiptare, Maksim Grekun, “për të cilin historia e shënjtë e kishës ruse thotë: ishte shqiptar prej Nartës së Shqipërisë dhe latinist e helenist i mbaruar”.²⁴⁰ Por, sipas tekstit nuk përjashtohet që të ketë pasur edhe numër më të madh shqiptarësh, por mjerisht, nuk kanë mundur të hulumtojnë me shumë – theksohet në këtë tekst.²⁴¹

PËRFUNDIM

Nga materiali shfletuar mund të konstatojmë se teksti “*Bota Shqiptare*”, libër leximi, për Kursin e Lartë të Shkollave të Mesme, i hartuar më 1943 nga emra të njohur të albanologjisë shqiptare dhe i botuar nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë, për kohën kur u përgatit ishte një tekst mjaft i kompletuar dhe me informacione të bollshme edhe për historinë tonë dhe disa personalitete të historisë tonë kombëtare

Pothuajse, i terë teksti është i mbushur me ngjarje nga e kaluara jonë, edhe atëherë kur fletë për bukurit e vendit tonë, letërsi etj.

²³⁸ *Po aty*, f. 543-569

²³⁹ *Po aty*, f. 571-598

²⁴⁰ *Po aty*, f. 597

²⁴¹ *Po aty*, f. 598



Teksti, përshkohet edhe nga ideologjia e kohës, pothuajse në çdo kapitull, hasim shkrime të autorëve italian, por edhe tekste që flasin për marrëdhëniet e mira sipas tyre të vendit tonë me Italinë në të kaluarën dhe tanishmen

Historisë tonë kombëtare dhe figurave tona historikë u dha hapësirë të konsiderueshme, krahasuar me tekstet e sotme të historisë mund të thuhet se personaliteteve të historisë tonë kombëtare më shumë iu dha hapësirë më 1943, se që kanë sot.

Shikuar nga ana përmbajtjesore, ndoshta edhe sot disa pjesë mund të merren parasysh si një model i mirë nga ana e përpiluesve të kurrikulave shkollore dhe tekstshkruesve.

Sigurisht që kjo përmbajte e këtij teksti për historinë tonë kombëtare, të disa shkrimeve në nivelin për t'ia pasur lakmi, nuk duhet edhe të na habit shumë, kur dihet se përpiluesit ishin emrat e njohur të albanologjisë shqiptare.

Hiq pjesët që i përkasin ideologjisë dhe sistemit të kohës, jashtë të cilit nuk kanë mundur të dalin as autorët e këtij teksti, disa nga tezat konstatimet e parashtruara këtu që kanë të bëjnë me historinë tonë, edhe sot janë të qëndrueshme dhe mendojmë janë interesante për t'u marrë parasysh dhe për t'u trajtuar e elaboruar nga historianët e sotëm.



(Faqja e dytë dhe e tretë e librit “Bota Shqiptare”)

HAXHI ADEMI

Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

DISA TË DHËNA RRETH ARSIMIT SHQIP NË KOSOVË, NË ZONËN ITALIANE TË PUSHTIMIT, GJATË LDB-SË

Pas ofensivës së forcave nazifashiste ndaj Jugosllavisë, që filluan më 6 prill 1941, e që vazhduan deri më 17 të atij muaji,²⁴² Jugosllavia nënshkroi aktin e kapitullimit, i cili hyri në fuqi më 18 prill 1941.²⁴³ Pushtimi u shoqërua me copëtimin e territorit të Jugosllavisë midis pushtuesve gjermanë, italianë e bullgarë. Synimet e shteteve pjesëtare të Bllokut Fashist ishin drejt realizimit, të njëjtut pushtues ndanë edhe trojet shqiptare.²⁴⁴

Në bazë të Dekretit nr. 264 të Mëkëmbësit të mbretit të datës 12 gusht 1941 këto territore iu bashkuan Shqipërisë.²⁴⁵ Me këtë rast,

²⁴² Akademi e Shkencave e Shqipërisë - Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Botim i ri, Vëllimi i tretë: N – Zh dhe një shtesë, Tiranë 2009, f. 2129.

²⁴³ Ali Hadri, *Sistemi i pushtimit fashist në Kosovë, 1941-1944*, Kosova, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978, f.15.

²⁴⁴ *Historia e Popullit Shqiptar IV*, grup autorësh, Instituti i Historisë, Tiranë, 2008, f. 129-130.

²⁴⁵ Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë (1941-1945)*, Rilindja, Prishtinë, 1971, f.106; Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore (1941-1945)*, Toena, Prishtinë, 1997, f.17. Për sa i përket marrëveshjes së arritur në Vjenë, më 21 - 22 prill 1941, ndërmjet Berlinit dhe Romës, të përfaqësuar nga ministri i Jashtëm gjerman, Ribentrop, dhe ministri i Jashtëm i Italisë, Galeaco Çiano, për caktuan hartën e re politike të Ballkanit. Harta mbështetej në parimet e ndarjes së zonave të influencës midis Gjermanisë, Italisë dhe Bullgarisë, nga ky parim viset shqiptare nën Jugosllavi u ndanë ndërmjet këtyre tri shteteve. Në këtë marrëveshje, Italia do të merrte pjesën më të madhe të Rrafshit të Kosovës, me qytete si Prishtinën, Ferizajn, Gjilanin, Kamenicën, rajonin e Drenicës, Rrafshin e Dukagjinit me Pejën, Gjakovën, Prizrenin, trevat në veriperëndim të Plavës, Gucisë, Rozhajës, Tutanit pastaj Ulqinin, Tuzin, trevat lindore etnike shqiptare Tetovën, Gostivarin, Kërçovën, Strugën dhe një pjesë e Prespes etj.

me shtetin amë u bashkua një territor me një sipërfaqe prej 11.780 km me një popullsi prej 820.000 banorësh,²⁴⁶ pra me shtetin amë Shqipërisë ju bashkuan 19 prefektura, 13 bashki, 141 komuna, 1.501 katunde.²⁴⁷

Bashkimi i pjesës më të madhe të Kosovës me shtetin amë në gusht të vitit 1941, nuk është realizuar nga shqiptarët edhe pse ata e aspironi një bashkim të tillë.²⁴⁸ Regjimi pushtues i Italisë fashiste i vendosur në vitin 1941 për shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë Perëndimore dhe të trevave shqiptare në Mal të Zi ndryshon shumë prej regjimeve pushtuese të fqinjëve ballkanik të vendosur më 1912 e pastaj të rivendosur prej Mbretërisë Serbe–Kroate–Sllovene më 1918. Gjendja në të cilën jetonin shqiptarët në Mbretërinë e Jugosllavisë është arsyeja kryesore pse një numër i madh i tyre ardhjen dhe vendosjen e ushtrisë italiane e përjetuan si çlirim: si çlirim prej persekutimeve, burgosjeve dhe vrasjeve të pandërprera dhe të zhvilluara në mënyrë sistematike.²⁴⁹

Mirëpo të njëjtin fat nuk e kishin edhe bashkëkombësit e tyre të rajonit të zonës gjermane.^{★250} Po ashtu, në bisedimet e Vjenës,

²⁴⁶Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, (1941-1945), Instituti i Historisë, Prishtinë, 1997, f. 17-18

²⁴⁷*Arkivi Qendror i Shtetit të Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi 267, vitit 1945, dos. 46, f. 32.

²⁴⁸Sabit Sylja, “*Qëndrimi i forcave politik dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore*”, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, (Përmbledhje studimesh), Instituti i Historisë “Ali Hadri” Prishtinë& Instituti i Historisë- Tiranë, Prishtinë, 2014, f. 112.

²⁴⁹Rexhep Qosja, *Çështja Shqiptare- Historia dhe Politika*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1994, f.181.

²⁵⁰*Historia e Popullit Shqiptar IV*, vep. cit.,f. 129-130. Në kuadër të zonës gjermane të pushtimit u përfshinë si Mitrovica, Podujeva e Vuçitërna, ngase për shkak të industrisë, minierave të Trepçës dhe pasurisë nëntokësore që ofronte ky rajon dhe për interesa strategjike të Gjermanisë dhe nevojën që kishte për luftë, u përfshin në kuadër të shtetit kuisling serb të Millan Nediçit.

Gjermania kërkoi edhe plotësimin e kërkesave të Bullgarisë*, aleatit tjetër të Bllokut Fashist.²⁵¹

ZONA ITALIANE

Siç dihet e ashtuquajtura “Shqipëria e Madhe”* nuk ishte Shqipëri etnike*, ajo në fakt nuk përfshinte të gjitha trojet etnike shqiptare, ngase jashtë saj mbetet një pjesë e madhe e banuar historikisht me shqiptarë,²⁵² pra krijimi i të ashtuquajturës “Shqipëri e madhe” siç e quanin pa të drejtë ata (në fakt Shqipëri etnike) ishte e lidhur me fitoren e Fuqive të Boshtit Romë – Berlin.²⁵³ Në radhë të parë u formua për interesa strategjike të pushtuesit, ngase pushtuesi italian u mundua t’i shfrytëzonte imperialistët shqiptarë për të zgjeruar influencën e tyre. Pavarësisht nga synimet e pushtuesit, bashkimi i Kosovës dhe viset e tjera etnike me Shqipërinë solli disa rrjedhoja pozitive për shqiptarët, sepse u shemb “Muri i Berlinit”, që mbante të ndarë prej vitesh dhe krijoi një komunikim të lirë e të drejtpërdrejt ndërmjet tyre. Pushtuesi u njohu të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe dhe lejoi zhvillimin e arsimit e të

²⁵¹ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, vep. cit., f. 20. Me gjerësisht për zonën e pushtimit bullgar: Kështu në bisedimet e Vjenës parashikohej që të kalonin nën sundimin bullgar një pjesë e rretheve të Gjilanit, Vitia, Kaçaniku i Vjetër, rajoni i Preshevës, i Kumanovës, i Shkupit, i Velesit, i Prilepit, dhe Manastirit. Në këto rajone jetonin rreth 200. 000 shqiptarë të cilët u vunë nën pushtimin bullgar. Pra, në zonën bullgare të pushtimit në Kosovë përfshinte një sipërfaqe prej 900 km², me 60 842 banorë, ose 8% të sipërfaqes dhe mbi 9% të popullsisë së saj.

*Termi “*Shqipëri e Madhe*” për herë të parë në burimet historike shfaqet në prag të Luftës së Parë Ballkanike kur qeveritë e Serbisë, Greqisë e Bullgarisë, kundërshtuan pranimin e shqiptarëve në Aleancën Ballkanike kundër Perandorisë Osmane, sepse këto shtete kishin pretendime territoriale ndaj hapësirave shqiptare.

*Termi *Shqipëria etnike* nuk nënkupton asgjë më shumë se hapësirën e banuar etnikisht me shumicë shqiptare.

²⁵² *Historia e Popullit Shqiptar IV*, vep.cit.,f. 129-130.

²⁵³ Kristo Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar* (Nga kohët e lashta deri në fundin e Luftës së Dytë Botërore), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 295.

shkollave shqipe. Këto masa do të ndikonin në forcimin e lidhjeve, të unitetit e të vetëdijes kombëtare të shqiptarëve.²⁵⁴

Pushteti okupues italian u mundua që të shfrytëzoj dëshirën e madhe të shqiptarëve për hapjen e shkollave shqipe, si mjet për hapjen e ideologjisë fashiste, duke futur gjuhën, kulturën dhe ideologjinë fashiste në shkollat shqipe. Italianët për të paraqitur veten si emancipues të shqiptarëve, favorizuan hapjen e shkollave shqipe, mirëpo vetëm ato të nivelit fillor dhe atë të mesëm, ndërsa siç dihet shkolla të larta dhe fakultete në gjuhën shqipe nuk u lejuan të hapen. Fashizmi italian këtyre shkollave u caktoi të përhapnin gjuhën italiane, e cila dëshmohet në qarkoret e dhëna të Mbretërisë shqiptare, nr. 4529, të datës 25 tetor 1941 dhe nr. 12 e datës 10 janar 1943 si dhe nga artikulli *“Misioni historik i shkollave në Kosovë”*, ku bëhet fjalë për përhapjen e arsimit shqip në Kosovë.²⁵⁵

Por me gjithë këto përpjekje nga ana e fashistëve italianë, shkolla shqipe mbeti vatër e forcimit të ndërgjegjes kombëtare, madje hapja e shkollave shqipe dhe krijimi i administratës ku përdorej gjuha shqipe e cila u shfrytëzua mjaft mirë nga atdhetarët shqiptarë, si një mundësi e mirë për të dërguar në ato treva kuadro të afta, me qëllim që të ofrojnë ndihmesë në riorganizimin dhe zgjerimin e rrjetit të arsimit shqiptar.²⁵⁶

Kështu më 31 dhjetor 1941 është krijuara Ministria e Tokave të Liruar që ndahej në tri zyre në kuadër të secilës përfshihej dhe Zyra e Studimeve dhe çështjeve të Përgjithshme,²⁵⁷ e cila ndikoj në fillimin e hapjes së shkollave shqipe e që është padyshim njëra ndër periudhat më të rëndësishme të zhvillimit të arsimit dhe shkollës

²⁵⁴ *Historia e Popullit Shqiptar IV, vep.cit.*, f. 130.

²⁵⁵ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në Shekullin XX, sfida, dëshira, fakte*, I, Libri Shkollor, Prishtinë, 2006, f. 49.

²⁵⁶ Qerim Zariqi, *Shkollat dhe arsimi në Drenicë gjatë shekullit XX*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2011, f. 66.

²⁵⁷ Fletorja Zyrtare, 3 dhjetor 1941, nr.333.

shqipe në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare. Këtë e themi ngase, për herë të parë është organizuar sistemi i arsimit dhe veprimtaria edukativo–arsimore e shkollës shqipe në mënyrë legale, me mësuese të ardhur nga Shqipëria, në mesin e të cilëve kishte edhe kosovarë që kishin mbaruara shkollat normale në Shqipëri.²⁵⁸ Për këtë padyshim meritë të veçantë kishte Ernest Koliqi, që ishte ministër i Arsimit i Shqipërisë, i cili e kuptoi rëndësinë e arsimit shqip, jo vetëm në Shqipërinë politike, por në gjithë hapësirën shqiptare që ishte bashkuar më shtetin amë. Për ministrin Koliqi viti 1941 ishte viti historik sepse shkollat shqipe filluan së vepruari edhe në viset e liruar.²⁵⁹ Kështu, ai vendosi të ndërtohej një sistem unik arsimor kombëtar. Për të arritur këtë qëllim sa human dhe njerëzor, po aq edhe patriotik, Ernest Koliqi, dërgoi njerëzit më kompetentë që të studionin gjendjen arsimore në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare. Pas një studimi të bërë nga këta përfaqësues, ai i pa dhe i vlerësoi qartë kërkesat dhe nevojat që kishte sistemi arsimor në këto treva.²⁶⁰

Për këtë qëllim, Ministria e Arsimit e Shqipërisë, caktoi Misionin e Jashtëzakonshëm Shkollor, i cili mori si detyrë studimin e përpiktë të gjendjes së arsimit shqip, që pastaj të propozoi masa e aksione konkrete për organizimin dhe rregullimin e sistemit të arsimit në të gjitha viset që iu bashkuan Shqipërisë.²⁶¹

Udhëheqja e Misionit Shkollor të Jashtëzakonshëm iu besua Ali Harshorvës, ndërsa anëtarë të këtij misioni ishin: Jonuz Blakçori, nënkryetar; Shaban Arra, anëtar; Zef Pali, Muharrem Musa, sekretarë; Xhavit Nimani dhe Fadil Hoxha, anëtarë ndihmës. Misioni i Jashtëzakonshëm Shkollor, me efikasitet dhe përgjegjësi të

²⁵⁸ *AQSH*, Fondi 295, nr. i kutisë 7, dosja 137.

²⁵⁹ Agjensioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës (më tej: *ASHAK*), Fondi: Drejtoria Didaktike Gjakovë Kutia, nr. 1, Mbretëria Shqiptare, Ministria e Arsimit, Qarkore, të gjitha shkollave të mesme të mbretnis , Konvikeve te Shtetit, Inspektorive të Arsimit, Tiranë 25.X.1941 –XIX.

²⁶⁰ Qerim Zariqi, *Shkollat dhe arsimit në Drenicë gjatë shekullit XX*, vep.cit., f. 66.

²⁶¹ *Po aty*, f. 67.

lartë kreu detyrën e ngarkuar, dhe me kohë hartoi raportin analitik, të cilin ia dorëzoi Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, më 25 korrik 1941. Ky institucion, në bazë të këtij raporti bëri përcaktimin e detyrave dhe obligimeve konkrete për ta organizuar sistemin arsimor fillor dhe të mesëm. Brenda një kohe të shkurtër u ndërmorën një varg masash konkrete për organizimin dhe funksionimin e sistemit të arsimit në Kosovë dhe në viset tjera.

Në këtë periudhë vlen të përmendet edhe formimi i pesë inspektorateve në qendrat kryesore, si në Prishtinë, Prizren, Pejë, Dibër dhe Tetovë, pastaj u formuan edhe drejtoritë didaktike në nivel të nënprefekturave, të cilat vepronin pranë zyrave të inspektorateve të shkollave në qendrat kryesore, e që si qëllim kryesor kishin mbikëqyrjen e punës edukativo – arsimore të mësuesve në shkollat fillore. Po ashtu, detyrë tjetër e këtyre drejtorive ishte mbikëqyrja e funksionimit të kurseve për të rritur, të cilët organizoheshin për të ulur shkallën e lartë të analfabetizmit.²⁶²

Për të punuar në administratë dhe në shkollat shqipe, u dërguan personalitete të njohura, si Ahmet Gashi, Selman Riza, Hamit Kokalari, Rexhep Shpendi, Shaban Arra, Zekerie Rexha, Haki Taha, Bedri Pejani, Bedri Gjinaj, Vasil Antoni, etj., të cilët dhanë ndihmesë të rëndësishme për forcimin e karakterit kombëtar të administratës dhe të shkollave shqipe.²⁶³

Sipas Dekretligjit të Mëkëmbësit, prej vitit shkollor 1941/42 deri në vitin shkollor 1942/43, në shkollat fillore shqipe lejohej regjistrimi i nxënësve të rregullt, deri në moshën 9 vjeçare. Meqë shkalla e analfabetizmit tek shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera ishte e lartë, Ministria e Arsimit vendosi që paralel punës së rregullt edukativo–mësimore me nxënësit në shkolla, të organizohen edhe kurset e shkrim–leximit, përkatësisht kurset për zhdukjen e

²⁶²*Po aty*, f. 67.

²⁶³*Po aty*, f. 66.

analfabetizmit. Po ashtu, Ministria e Arsimit vendosi që në vitin shkollor 1941/42 të hapen shkolla fillore vetëm në ato vende ku ekzistonin kushtet e domosdoshme për punë, ndërsa vitet në vijim të hapeshin shkolla të reja krahas me krijimin e kushteve për një gjë të tillë. Gjithashtu u përcaktuan edhe lëndët mësimore për të cilat do të zhvillohej mësimi: Gjuhë Shqipe 3 orë në javë, Aritmetikë 2 orë dhe Histori–Gjeografi 2 orë në javë.

Ministria e Arsimit vendosi që në të gjitha shkollat shqipe, në tërë hapësirën shqiptare, të punohet me plan–program unik mësimor.²⁶⁴

Me krijimin e kushteve të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor, ministri i Arsimit Ernest Koliqi në qarkoren me nr. 4182 të datës 20.10.1941 Inspektorëve të Arsimit, Drejtorëve të shkollave të mesme të Mbretërisë, punëtorëve teknik te konvikteve të shtetit u *“Tërheq vëmendjen... mos japni lajme mbi ngjarjet të vajtushëme, shkaktue nga gjendja...veçanerisht nga nan e fëmijevë dhe të rinjeve, veglat lufte, tu perdore pa mend, pelsaisin, me pasojatë tmerrshëm”* ky apel i ministrisë u drejtua kryesisht drejtuesve dhe mësuesve t’ atyene vendeve që kanë qenë drejtpërsëdrejti të përfshira në luftë.²⁶⁵

Me hapjen e shkollave të para shqipe në Kosovë, personelit mësimor i’u është dhënë porosi që:

1. Mos me u përzi në çështjet politike, fetare e etnike;
2. Mos me u përzi në çështjet lokale administrative;
3. Me u sjellë mirë me popull dhe me punu mirë, për të përfutur përkrahjen e tyre;
4. Me i trajtu nxënësit me dashamirësinë e një edukatori të mirë;

²⁶⁴ Qerim Zatriqi, *vep.cit.*, f. 68.

²⁶⁵ *ASHAK*, Fondi: Drejtoria Didaktike Gjakovë Kutia, nr. 1, Mbretëria Shqiptare, Ministria e Arsimit, Qarkore, Drejtorëve te Shkollave të Mesme të Mbretnis, Rektorëve dhe Rektorehave të Konvikteve të shtetit Inspektorëve të Arsimit, Tiranë 20.10.1941-XIX.

5. Me jetën t'uaj të ndershme, të jeni shembull i mirë i një shqiptari të kulturuar.²⁶⁶

Më poshtë do të ofrojmë disa të dhëna për shkollat shqipe, që kanë punuar në Kosovë gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, konkretisht në zonën e pushtimit italian. Mirëpo pas kapitullimit të Italisë në shtator 1943, një pjesë e këtyre shkollave vazhduan punën e tyre edhe nën pushtimin gjerman.

Kështu, në Prefekturën e Prishtinës, në kuadër e së cilës bënin pjesë edhe dy komuna nga territori i Drenicës (Komuna e Komoranit dhe K. Sedllarit– Shalës) që nga viti 1941 u hapën shkolla fillore shqipe. Mirëpo në rrethinën e Prishtinës deri në vitin 1941 ka pasur vetëm 28 shkolla fillore, të gjitha në gjuhën serbe. Ndërsa, në vitin 1942 janë hapur 40 shkolla që punojnë në të dy gjuhët, prej të cilave 28 serbe dhe 12 shqipe me 75 klasë. Megjithatë ende numri i shkollave ishte i pamjaftueshëm, ngase prej 7000 fëmijëve të rritur për shkollë janë regjistruar dhe vijnë në mësimet 4 530 prej tyre, ndërsa 2500 të tjerë nuk i vijonin mësimet në shkollë.²⁶⁷ Në vitin shkollor 1941/42, për herë të parë u hapën këto shkolla fillore shqipe: në qytete 5 shkolla, si në Prishtinë 3, në Ferizaj 1 dhe në Gjiilan 1, ndërsa në fshatra u hapën 18 sosh.²⁶⁸

Në qytetin e Prishtinës u hapën këto shkolla fillore shqipe: në vitin shkollor 1941/42 u hapën dhe punuan dy shkolla (Shkolla Fillore nr. 1 dhe Shkolla Fillore nr. 2 dhe një Shkollë Fillore Femërore dhe një Foshnjore. Mirëpo, me rastin e tridhjetëvjetorit të shteti kombëtar, pra më 28 nëntor 1942 këto shkolla pagëzohen dhe mbajnë këta emra: Shkolla Fillore nr. 1, “Naim Frashëri”, Shkolla Fillore nr. 2, “Hasan Prishtina” dhe Shkolla Femërore “Teuta” (me

²⁶⁶ *ASHAK*, Fondi: Drejtoria Didaktike Gjakovë Kutia, nr. 1, Mbretëria Shqiptare, Ministria e Arsimit, Porosi për personelin mësimor të viseve të lirime, Tiranë 3.XI.1941 –XIX. f.5

²⁶⁷ *Shkolla dhe kurse analfabetike*, Rilindja, nr.24, 1 janar 1946, Prizren, f. 4.

²⁶⁸ Qerim Zariqi, *vep.cit.*, f.71.

paralele parashkollore–foshnjore).²⁶⁹ Nga emërtimi i shkollave me emrat e personaliteteve më të njohura nga historia kombëtare, kuptojmë dy gjëra: e para ndikimin lirinë e të shprehurit të identitetit kombëtar në mënyrë të hapur dhe e dyta, frymëzimi nga mësimdhënësit e ardhur nga Shqipëria.

Përveç hapjes së shkollave shqipe në qytetin e Prishtinës, të tilla u hapën edhe në fshatrat e kësaj prefekturë. Kështu, shkolla fillore u hapën në fshatrat Komoran, Sadllar, Krojmir, Rusinofc, Petershticë, Janjevë, Kraishtë, Sllatinë, Dobrevë, Lipjan, Rufcë të Ri, Bresje, Kraishtë dhe në Kastriot.²⁷⁰

Shkolla fillore në gjuhën shqipe në harkun kohor 1941/1944 janë hapur edhe në Nënprefekturën e Ferizajt dhe të Gjilanit. Kështu, në qytetin e Ferizajt është hapur shkolla “Ismajl Qemali”, ndërsa në fshatrat e kësaj komune janë hapur shkolla në Talinoc, në Greme, në Shtime, në Llugagji, në Neredime, në Slivovë, në Bibaj, në Mirash dhe në Varosh.²⁷¹ Ndërsa në Nënprefekturën e Gjilanit që ishte e ndarë ndërmjet pushtuesve bullgar dhe atij italian, shkolla u hapën vetëm në zonën italiane, ndërsa në atë bullgare nuk u lejua hapja e tyre. Kështu, në vitin shkollor 1941/42, u hap shkolla fillore “Bogdani”, në Gjilan si dhe disa shkolla fillore katërklasëshe në fshatrat Livoç, Desioviçë, Bresalc, Cërnice, dhe në Kometovc.²⁷²

Në komunën e sotme të Lipjanit, në periudhën kohore 1941–1944, u hap shkolla fillore “Shtjefan Gjeçovi” në Janjevë. Po ashtu disa shkolla u hapën edhe në Sadllar, Rufcë të Ri dhe në Grashticë.²⁷³ Ndërsa komunën e sotme të Kamenicës, shkolla shqipe

²⁶⁹ Abdylaziz Veseli, *Shkollat dhe arsimit shqip ne prefekturën e Prishtinës gjatë periudhës 1941-1944*, II, Biblioteka: Historia e pedagogjisë shqiptare, Gjilan, 2003, f. 35.

²⁷⁰ *Po aty*, f. 59-61.

²⁷¹ *Po aty*, f. 53.

²⁷² Fehmi Rexhepi, *Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941 - 1945)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, f.74.

²⁷³ Bajrami Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX*, vep. cit., f.303.

janë hapur në fshatrat Hogosht, Desijocë, Strezovc dhe në Koretinë.²⁷⁴

Në Prefekturën e Pejës u hapën shkollat e para shqipe që nga vitit 1941. Kështu, në këtë qytet u hapën tri shkolla fillore: “Lidhja e Prizrenit”, “Haxhi Zeka” dhe “Bajram Curri”. Kjo e fundit filloi punën që nga viti 1943. Në Pejë, po ashtu është hapur Instituti Bujqësor – Gjinnazi i Pejës, i cili funksionoi gjatë viteve 1941 – 1944. Gjithashtu, në këtë qytet është hapur edhe Shkolla Femërore e Punës “28 Nëntori” që funksionoi gjatë viteve 1942 – 1944.²⁷⁵

Ndërsa në fshatrat e kësaj prefekturë, shkolla shqipe u hapën në Srellc, Prapaçan, në Baran, në Garazhdec, në Gllaviçicë, në Drenoc, në Budisalc, në Jogodë, në Novosellë dhe në Nakllës.²⁷⁶

Në Nënprefekturën e Istogut u hap një shkollë fillore “Bajram Curri” në Istog, ndërsa në fshatra u hapën shkolla fillore në Zllakuçan, në Uçë, në Gjurakovc, në Pogradjë, dhe në Vrellë.²⁷⁷

Në Drenicë gjatë viteve 1941/44 u hapën shkolla fillore në Skenderaj (Qendër) dhe në fshatrat si në Prekaz, në Obri, në Turiçefc, në Polac, në Dubofc, në Runik, në Drenas, në Dobroshefc, në Leqinë, në Vitak dhe në Broboniq.²⁷⁸ Kështu, në vitin shkollor 1941/42 në Skenderaj është hapur shkolla fillore “Skënderbeu”, ku i vijonin mësimet 65 nxënës, kurse mësues i parë ishte Jaho Dibra. Gjatë vitit shkollor 1942/43, i vijonin mësimet 91 nxënës, ndërsa mësues ishin Bajram Bajrami dhe Petraq Postoli.

²⁷⁴ Abdylaziz Veseli, *Shkollat dhe arsimi shqip ne prefekturën e Prishtinës gjatë periudhës 1941-1944*, II, *vep.cit.*, f. 142

²⁷⁵ Abdylaziz Veseli, *Shkollat dhe arsimi shqip ne Prefekturën e Pejës gjatë periudhës 1941 - 1944*, IV, *vep.cit.*, f. 111-125.

²⁷⁶ *Po aty*, f. 33-76.

²⁷⁷ Abdylaziz Veseli, *Shkollat dhe arsimi shqip ne Prefekturën e Pejës gjatë periudhës 1941 - 1944*, IV, *vep.cit.*, fq. 76-90. Për zhvillimi e arsimit shqip në këtë komunë shih dhe Sadik Bicaj, *Nga historiku i shkollave fillore shqipe të komunës së Istogut*, Arti Poetik, Pejë, 1997

²⁷⁸ Qerim Zatriqi, *vep.cit.*, f. 70.

Ndërsa në vitin shkollor 1943/44 i vijonin mësimet 81 nxënës me mësues Til Antoni, Bajram Bajrami, Jaho Braha dhe Haxhi Lulja.²⁷⁹

Shkolla e para në gjuhen shqipe në Komunën e Klinës gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore u hapën në Zllakuqan, Pogradë, Budisalc, Jagodë, dhe Drenoc.²⁸⁰ Pushteti italian kishte për qëllim që institucionin shkollor ta shfrytëzonte për përhapjen e ideologjisë së tij fashiste tek të rinjtë, por me gjithë këto përpjekje nuk arriti rezultatet e pritura, ngase shqiptarët i kishin të qarta idetë dhe qëllimet e pushtuesve italianë. Sa për ilustrim mund të përmendim këtu shtypin e kohës gjatë viteve 1941–1944, ku bëhet fjalë për arsimin dhe shkollën shqipe, kritikoheshin përmbajtja dhe fryma e shkollës fashiste.²⁸¹

Rrjedhimisht edhe në Prefekturën e Prizrenit, u lejua hapja e shkollave shqipe. Në Prizren hapen me dhjetëra shkolla shqipe të nivelit fillor, në të cilat mësimi kishte karakter obligativ dhe ishte i përcaktuar me dispozita ligjore. Në Prefekturën e Prizrenit, në vitin shkollor 1941/42, kanë punuar 45 shkolla shqipe, me gjithsej 5.202 nxënës, në vitin shkollor 1942/43 kanë punuar 52 shkolla, me gjithsej 6.589 nxënës dhe në vitin shkollor 1943/44 kanë punuar 50 shkolla, me gjithsej 5817 nxënës.²⁸² Në kuadër të Prefekturës së Prizrenit hynin komuna e Prizrenit, e Gjakovës, e Therandës, e Dragashit, e Rahovecit dhe e Kukësit.

Në këtë kuadër të kësaj prefekturë janë hapur shkolla shqipe, më tepër se kudo tjetër. Kështu, vetëm në qytetin e Prizrenit janë hapur disa shkolla si: Shkolla Fillore “Bajram Curri”, me 493 nxënës, Shkolla “Haxhi Ymeri”, me 556 nxënës, Foshnjorja

²⁷⁹ Fazli Hajrizi, *Rexhep Mitrovica në Lëvizjen Kombëtare*, Monografi, Libri Shkollor, Prishtinë, 2008, f. 421.

²⁸⁰ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX*, Vellimi I, vep. cit., 293.

²⁸¹ Fehmi Rexhepi, *Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941 - 1945)*, vep. cit., f. 149.

²⁸² Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX*, Vellimi I, vep. cit., f. 46.

“Lidhja e Prizrenit”, Shkolla “Shtjefën Gjeçovi”, Shkolla “Haxhi Ymeri”, shkolla “Abdyl Frashri”,²⁸³ shkolla Fillore e përzier e Tabhanes, shkolla (katolike) në Prizren dhe me Dekretin Mëkëmbësit nr. 317 të datës 12 nëntor 1941 u hap Liceu i shtetit “Gjon Buzuku” në Prizren i pari lice shqip në Kosovë. Ministria e Arsimit për drejtor emëroi profesor Kolë Margjinin. Aktivitetin ky lice e ka vazhduar deri në vitin 1944.²⁸⁴

Përveç hapjes së shkollave në qytetin e Prizrenit, janë hapur të tilla edhe në trembëdhjetë fshatra të kësaj prefekturë. Kështu, shkolla fillore shqipe u hapën në Korishë, në Zym, në Rogovë, në Hoçë të Zhurit, në Vërbiçan, në Dojnicë (Skorobishtë), në Llokvicë, në Manastirc, në Lubinë të Epërme, në Serbicë të Epërme, në Korishë të Madhe,²⁸⁵ në Gjonaj dhe në Zhurrë.²⁸⁶ Në Nënprefekturën e Suharekës janë hapur shkolla fillore, që nga viti 1941 një në qytet “7 Marsi” dhe gjashtë të tjera në fshatrat Mushtisht, Duhël, Gjinovc, Vraniq,²⁸⁷ Nishor, dhe në Studençan.²⁸⁸ Po ashtu në Nënprefekturën e Dragashit gjatë viteve 1941/44 janë hapur shkolla shqipe. Megjithëse në këtë nënprefekturë thuajse të gjithë banorët e saj flisnin gjuhën serbe, nga viti 1942 janë pikërisht banorët e saj që kërkuan të hapën shkolla të tilla. Kështu, më 4 nëntor 1942 kryeqytetë e fshatrave të Nënprefekturës së Dragashit kërkuan me shkrim nga Ministria e Arsimit në Tiranë që të hapeshin shkolla fillore në Dragash. Kështu, shkolla fillore u hapën edhe në disa fshatra si në Brod në vitin shkollor 1942/43, pastaj në

²⁸³ ASHAK, Inspektoria e Arsimit në Prizren, vitet 1943 - 1944, Nr. 2.

²⁸⁴ Abdylaziz Veseli, *Shkolla dhe arsimi shqip ne Prefekturën e Prizrenit*, Gjatë periudhës 1941 - 1944, III, *vep. cit.*, f. 154-174.

²⁸⁵ Po aty, f. 35-109.

²⁸⁶ ASHAK, Fondi. Inspektoriati i Arsimit në Prefekturën e Prizrenit 1941-1944, kutia. 3, Telegram nga Ministria e Arsimit e Shtetit Shqiptar, Tiranë, 04.02.1944, f. 2.

²⁸⁷ Abdylaziz Veseli, *Shkolla dhe arsimi shqip ne Prefekturën e Prizrenit*, *vep. cit.*, f. 109-119.

²⁸⁸ ASHAK, Fondi. Inspektoriati i Arsimit në Prefekturën e Prizrenit 1941-1944, kutia. 3, Telegram nga Ministria e Arsimit e Shtetit Shqiptar, Tiranë, 04.02.1944, f. 2-3.

Zhur, në Rapçe (komuna e Dragashit), më 7 mars 1942 në Bllacë, 1943/1944, në Buçë, 1943/44, në Brut, 1943/44, dhe në Restelicë, 1943/44.²⁸⁹ Në Nënprefekturën e Rahovecit janë hapur Shkolla Filllore, qe nga viti 1941 një në qytet “Isa Boletini” dhe dhjetë të tjera në fshatrat si në Hoçë të Madhe, në Hoçë të Vogël, në Kijevë, në Banjë, në Drenoc, në Mamushë²⁹⁰, Caralluk, Ostrazub, Arllat dhe në Zeqishtë.²⁹¹ Edhe në Nënprefekturën e Gjakovës me rrethinë në harkun kohor 1941/44, janë hapur shkolla fillore. Në qytetin e Gjakovës u hapën shkolla “Bajram Curri” dhe “Sylejman Vokshi”, në të cilat deri më 10 dhjetor 1941 ishin të regjistruar 888 nxënës, pastaj u hap edhe shkolla “Ali Kryeziu”.²⁹²

Me dekret të Mëkëmbësit Nr. 273 të datës 23 tetor 1942 hapet edhe Shkolla Normale “Gjon Kazazi”, në Gjakovë, në të cilën në fillim u regjistruan 100 nxënës.²⁹³ Po ashtu u hapen shkolla fillore edhe në fshatrat e Gjakovës si në Deçan, në Carabreg, në Irzniq, në Junik, në Novosellë në Brekoc,²⁹⁴ në Voksh, në Ponoshec, në Skijanë.²⁹⁵ Në të gjitha këto shkolla shqipe që u hapën në tërë zonën italiane punohej me plane dhe programe të miratuara po ashtu nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë. Kështu, nxënësit

²⁸⁹ ASHAK, Fondi. Inspektorati i Arsimit në Prefekturën e Prizrenit 1941-1944, kutia. 3, Telegram nga Ministria e Arsimit e Shtetit Shqiptar, Tiranë, 04.02.1944, f. 3.

²⁹⁰ Abdylaziz Veseli, *Shkolla dhe arsimi shqip ne Prefekturën e Prizrenit, vep.cit* f. 133-152.

²⁹¹ ASHAK, Fondi. Inspektorati i Arsimit në Prefekturën e Prizrenit 1941-1944, kutia. 3, Telegram nga Ministria e Arsimit e Shtetit Shqiptar, Tiranë, 04.02.1944, f. 3.

²⁹² ASHAK, Fondi. Inspektorati i Arsimit në Prefekturën e Prizrenit 1941-1944, kutia. 3, Telegram nga Ministria e Arsimit e Shtetit Shqiptar, Tiranë, 04.02.1944, f. 3.

²⁹³ AQSH, *Fletorja Zyrtare*, nr.130, 14 nëntor 1942, f. 1-2

²⁹⁴ Abdylaziz Veseli, *Shkolla dhe arsimi shqip ne Prefekturën e Prizrenit, vep.cit* f. 179-229.

²⁹⁵ ASHAK, Fondi. Inspektorati i Arsimit në Prefekturën e Prizrenit 1941-1944, kutia. 3, Telegram nga Ministria e Arsimit e Shtetit Shqiptar, Tiranë, 04.02.1944, f. 3.

shqiptarë të Kosovës tani patën mundësi që të mësonin në gjuhën amtare historinë, kulturën dhe traditat kombëtare shqiptare.²⁹⁶

Për këtë më së miri fletë e dhëna tabelare, ku pasqyrohen të gjitha lëndët që mësoheshin në shkollat shqipe, që u hapën në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare:

1. Mësim moral e qytetar,	Aritmetikë me gjeometri,
2. Mësim jetë e vendi,	Gjeografi,
3. Këndim (lexim) e recitim,	Histori,
4. Ushtrime në të folur,	Mësim natyre e higjienë,
5. Gramatikë,	Bujqësi,
6. Bukurshkrim,	Histori e Italisë etj. ²⁹⁷

Nga kjo çfarë shihet në këtë tabelë del se lëndës së gjuhës amtare iu është kushtuar rëndësi e veçantë, duke e ndarë atë në disa fusha si: këndim, recitim, ushtrime në të folur e në të shkruar, gramatikë, bukurshkrim etj.

Nga kjo çfarë theksuam më lartë del që në shkollat shqipe që u hapën në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, në zonën e pushtimit italian punonin me planet dhe programet mësimore të Shqipërisë. Vlen të specifikohet që të domosdoshme e kishin edhe lëndën “Doktrina fashiste e shtetit” që zhvillohej në bazë të tekstit “Kultura fashiste” që ishte futur në klasat e shkollës fillore.²⁹⁸ Gjatë viteve 1941–1944 emërimi dhe përjashtimi i mësuesve është bërë nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë.²⁹⁹ Po ashtu gjatë kësaj periudhe kohore u organizuan

²⁹⁶Qerim Zariqi, *Shkollat dhe arsimi në Drenicë gjatë shekullit XX*, vep.cit., f. 89.

²⁹⁷*Po aty.*

²⁹⁸ Jašar Redžepagič, Školostovo u Kosovskoj Mitrovici i okolini u godinama okupacije (1941-1944, Instituti i Historisë, Kosova nr 7, Prishtinë, 1978, f. 503-511. Sipas Akademi Jašar Redžepagič, në këto tekste madhështoj figura e Duçës dhe e Viktor Emanuletit III, që kishin për qëllim italizimin e popullastës shqiptare.

²⁹⁹ Bajtram Shatri, *Arsimi Fillorë në Kosovë në shekullin XX*, I, vep. cit.,f.51

dhe kurse për zhdukjen e analfabetizmit me mësues të ardhur nga Shqipëria.

KURSET VERORE

Në bazë të Dekretligjit të Mëkëmbësit, prej vitit shkollor 1941/42 deri në vitin shkollor 1942/43, në shkollat fillore shqipe lejohej regjistrimi i nxënësve të rregullt, deri në moshën 9 vjeçare. Meqë shkalla e analfabetizmit tek shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera ishte e lartë, Ministria e Arsimit vendosi që, paralel punës së rregullt edukativo – mësimore me nxënësit në shkolla, të organizohen edhe kurset analfabetike, përkatësisht kurset për zhdukjen e analfabetizmit. Këto kurse mund t'i ndiqnin edhe grup moshat më të rritura, të cilat fatkeqësisht nuk kishin mundur të shkonin në shkollë për shkak të mungesës së tyre.

Në kuadër të Mbretërisë Shqiptare është formuar dhe Kryesia e Misionit Shkollor ku Ali Hashorva u zgjodh kryetar i këtij misioni. Me qëllim të organizimit të kurseve Hashorva caktoj Ibrahim Fehmiun, Sulejman Aliun, Persifani Musa, Murteza e Shehrim Shehdulla, Sheqet Veliu, Ibrahim Riza e Mufid Shehu, në shërbim të kurseve verore në qendër të Prizrenit. Përonave të lartëshënuar u është rekomanduar që të bashkëpunojnë me mësuesit në evidentimin e problemeve dhe në vështirësitë që hasnin në hapjen e shkollave dhe kurseve në këto treva.³⁰⁰

Po ashtu, në bazë të vendimit të datë 17.07.1941, u caktuan drejtuesit e këtyre kurseve nga kryetari Ali Hashorva: Për Prizren Ibrahim Fehmiu; Gjakovë Hysen Zajmi; Pejë Minush Shala; Prishtinë Rexhep Dizdari; Gjilan Fadil Llazani; Mitrovicë Ahmet Ashikaj; Podujevë Amet Caka; Vushtrri Idriz Fishta dhe për Novi Pazar Xhevdet Doda. Këta ishin persona të autorizuar për misionin

³⁰⁰ *ASHAK*, Prefektura e Prizrenit, Inspektoria 1941-1942, Mbrinja Shqiptare, Kryesia e Misionit Shkollor, Nr.1/6, Shërbyesit e Kurseve verore të gjuhës shqipe në qendër Prizerend, Prizrend. 47.7.1941-XIX.

në për lokalitete ku ishin paraparë që të zhvillonin kurse për zhdukjen e analfabetizimit.

Këta drejtues ishin po ashtu edhe mësuesit e këtyre kurseve dhe duhej t’ju nënshtroheshin të gjitha ligjeve e rregulloreve në fuqi për shkollat e Mbretërisë.³⁰¹

Në bazë të vendimit të datës 18.7.1941, u caktuan edhe programet e kurseve verore të Kosovës. Kështu, fillimisht, *“në tri orët e mëngjesit do t’i bahen mësimi nxësve të shkollave fillore, të cilët do të ndahen në klasë sipas aftësive dhe moshave; në dy orët e mbas ditës do të mbahej mësimi për të rriturit, të cilët do të ndahen në analfabetë e në asish që din shkrim e këndim”*. Kurset me fëmijë do të zhvilloheshin në këto lëndë mësimore: Ushtrimet e të folurit, Shkrim këndim, recitim vjershash të zgjedhura e sidomos në frymën kombëtarë, Historinë kombëtare (originën e popullit shqiptarë, periudhën e Skënderbeut, Lidhjen e Prizrenit, mëvetësinë shqiptare, çlirimin e Kosovës, djepi ‘i lëvizjeve të para kombëtare) këngë e nga pak edhe gjimnastikë.

Në kurset për të rritur që ishin analfabet do të mësohej: shkrim, këndim, vjersha të lehta e nga ndonjë këngë; atyre që dinë shkrim e këndim do t’u bëhej këndim pjesësh të zgjedhura, recitim vjershash e sidomos do t’ju shpjegohej “Lahuta e Malsisë”. Do të bëjnë edhe hartime të thjeshta, pastaj do të mësojnë edhe për historinë kombëtare, si në kurse të fëmijëve por në mënyrë më të zgjeruar. Sa i përket orëve ato do të përpilohen nga drejtuesit e kurseve.³⁰²

³⁰¹ ASHAK, Fondi: Inspektorati i Arsimit në Prefektura e Prizrenit, 1941-1942, Kutia: 1, Mbrenija Shqiptare, Kryesia e Misionit Shkolluer, Nr.11, *Kurseve verore*, Prizrend. 17.7.1941-XIX

³⁰² ASHAK, Fondi: Inspektorati i Arsimit në Prefektura e Prizrenit, 1941-1942, Kutia: 1, Mbrenija Shqiptare, Kryesia e Misionit Shkolluer, Nr.16, Gjithë drejtuesve të kurseve verore të Kosovës, Prizrend. 18.7.1941, f. 69.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE
TË SHQIPTARËVE – SHKUP
INSTITUTI ALBANOLOGJIK – PRISHTINË
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE – TIRANË

SCUPI, vëllimi 17 – 2017

*75–vjetori i hapjes së shkollave shqipe
në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore
(Konferencë shkencore, 20 nëntor 2016)*

Përpunimi kompjuterik: Blerim Qaili
Redaktor gjuhësor: Dr.Sevdail Demiri
Korrektor: Mr.Agron Salihi
Mbikëqyrës shtypi: Mr.Murtezan Idrizi

Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3(=18:497.115+497.7-15)"1941/..."(062)

SHSTATËDHJETË e pesë

75-vjetori i hapjes së shkollave shqipe në Kosovë dhe në
Maqedoninë perëndimore : (konferencë shkencore, 20 nëntor 2016,
Shkup). 17 / [kryeredaktor Sevdail Demiri]. - Shkup : Instituti i
trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2017.

- 206 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4653-45-5

1. Дополн. насл.

а) Албански училишта - Косово - 1941 - Собири б) Албански училишта -
Западна Македонија - 1941 - Собири

COBISS.MK-ID 103629578